


**ENVER HOXHA**

*Letra  
të zgjedhura*

**2**

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH**

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»



Vëllimi që po i jepet në dorë lexuesit, është i dyti në serinë me «Letra të zgjedhura» të udhëheqësit të dashur e të paharruar të Partisë e të popullit, shokut Enver Hoxha. Pas vëllimit të parë, që u botua në tetor të vitit 1985, ky vëllim e plotëson dhe e zgjeron më tej njohjen e korrespondencës së shokut Enver nga komunistët, punonjësit e rinia e vendit tonë, të cilët do të gjejnë atje mësimet e çmuara dhe idetë e mëdha që udhëheqin e frymëzojnë popullin gjatë epokës së socializmit. Zgjedhja e materialeve që përmban ky vëllim, është bërë po me ato kritere si në vëllimin e parë: ato pasqyrojnë gjerësinë e problematikës së letërkëmbimit të shokut Enver, shtrirjen shoqërore e gjeografike, pasqyrojnë veprimtarinë kolosale të Tij në shërbim të popullit, Partisë e atdheut. Edhe në këtë vëllim ka letra e telegrame drejtuar kolektivave punonjës në fshat e në qytet, veteranëve e pionierëve, prindërve e familjeve të dëshmorëve, shokëve e bashkëpunëtorëve të vet, njerëzve të shquar për kontributin e tyre për përparimin e atdheut tonë socialist.

Gjithashtu në këtë vëllim botohet një pjesë

e korrespondencës së shokut Enver Hoxha me bashkatdhetarë jashtë vendit, me miq e dashamirë të Shqipërisë në botë, me revolucionarë e shokë marksistë-leninistë në vende të ndryshme. Këto hedhin dritë mbi veprimtarinë e madhe të shokut Enver Hoxha si politikan e diplomat, si personalitet i shquar i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, mbrojtës i flaktë i çështjes së revolucionit e të popujve. Një pjesë e madhe e letrave dhe e telegrameve të këtij vëllimi botohen për herë të parë.

Ky vëllim me «Letra të zgjedhura» të shokut Enver Hoxha, që del në prag të 78-vjetorit të lindjes së Tij, do t'i ndihmojë komunistët e punonjësit për të zbatuar porositë e Partisë e të shokut Ramiz Alia për studimin e vazhdueshëm të veprës teorike e praktike të shokut Enver.

**MESAZH DREJTUAR PIONIERËVE  
TË SHQIPËRISË ME RASTIN E 5-VJETORIT  
TË KRIJIMIT TË ORGANIZATËS  
SË PIONIERIT**

**11 shkurt 1947**

Të dashur pionierë dhe pioniere,

Sot keni festën tuaj, sa gëzim i madh për ju! Por edhe unë jam aq i gëzuar sa edhe ju, pse kjo ditë na kujton shumë gjëra, na kujton luftën e madhe të çlirimit të atdheut dhe, lidhur ngushtë me të, luftën dhe përpjekjet heroike të pionierëve të Shqipërisë.

Ka disa që thonë: «Eh! çfarë bënë pionierët në këtë luftë? Ata ishin kalamaj». Këtyre mendjeshkurtërve ne u përgjigjemi: «Po, është e vërtetë që ata ishin kalamaj, pse ndryshe nuk i quanin pionierë, mirëpo ata ishin trima e të vendosur kundër okupatorit dhe ballistëve tradhtarë». Shumë është folur dhe është shkruar për trimëritë e

pionierëve shqiptarë; por sa heroizma të tjerë të pionierëve tanë nuk dihen dhe nuk janë shkruar akoma! Unë kam mjaft për të thënë për pionierët, por sot do të mjaftohem t'ju tregoj juve vetëm një episod të jetës sime gjatë luftës, ku një pionier katundar ka luajtur një rol të rëndësishëm e vendimtar dhe që mund të themi se më ka shpëtuar jetën mua dhe disa shokëve të mi të Shtabit të Përgjithshëm.

Ishte koha e Ofensivës së madhe të Dimrit<sup>1</sup>. Gjermanët na sulmuan nga të katër anët. Bora ishte e madhe; ditë të rënda për partizanët tanë! Tok me gjermanët na sulmuan edhe ballistët e zogistët. Partizanët luftuan si luanë, megjithëqë shumë herë s'kishin as këpucë në këmbë dhe kishin veshur në trup nga një palë rroba të grisura. Sa për ushqime, mos e zini në gojë, partizanët tanë trima rrinin edhe tri ditë pa ngrënë bukë, por asnjë minutë pa luftuar. Unë me disa shokë të mi, pas luftimeve me gjermano-ballistët u ndodhëm të shkëputur nga forcat tona dhe u detyruam të qëndrojmë te miqtë tanë katundarë përderisa të gjenim shtegun, të çanim rrethimin dhe të bashkoheshim me forcat partizane. Që të mos zgjatem, pas një kohe të gjatë dhe pasi rregulluam shtigjet me anën e shokëve katundarë, u nisëm të çanim rrethimin. Ishim në malësitë e Elbasanit dhe duhej të kalonim në malet e Korçës. Rrugë e gjatë,

---

1. Është fjala për operacionin e pushtuesve gjermanë dhe të tradhtarëve të vendit kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare në dimrin e vitit 1943-1944.

plot rreziqe, plot borë e plot gjermanë dhe ballistë. Duhej të ecnim vetëm natën, të veshur si shokët katundarë, duke mbajtur me vete vetëm koburet dhe bombat. U nisëm nëpër natën e errët, shumë herë kalonim përmes fshatrave, shumë herë nëpër maja malesh, larg rrugës së zakonshme, për të mos hasur me patrullat e armikut, të cilat kishin shkelur fshatrat dhe terrorizonin popullin. Pas shumë ditësh udhëtimi, të lodhur dhe të uritur, arritëm në një fshat të vogël të Vërçës<sup>1</sup>. Atje vajtëm në shtëpinë e një katundari partizan, shoku ynë. Sa mirë ishte në shtëpinë e tij! Atje kishte bukë, atje kishte zjarr, atje kishte mbulesa, atje ishte dhe një pionier i vogël, pionieri për të cilin do t'ju flas. Pionieri i vogël rrinte me ne, afër vatrës, ai mbante vesh çfarë flisnim, ai na pyeste dhe gëzonte me dorën e tij të vogël koburet tona; kur ne flisnim për gjermanët dhe ballistët, sigurisht ai thoshte me vete: «Ah të kem dhe unë një kobure si kjo!». Pionieri fjeti në dhomën tonë. Ai që në mëngjes u çua, nxori lopët nga hauri dhe filloi të luajë me qenin që lehte shumë.

Kur po bisedonim se si ta kalonim Qafën e rrezikshme të Shënepremtes, rruga jonë e vetme, pionieri hyri në dhomë dhe tha: «Ja grahnë ballistët». Dhe me të vërtetë ballistët e Vërçës dhe të Korçës erdhën në fshatin ku ishim ne. Fshati

---

1. Fshati Kishtë, ku shoku Enver Hoxha bashkë me shokët e Shtabit të Përgjithshëm u strehuan në shtëpinë e patriotit File Musai. Shih edhe në librin «Mes njerëzve të thjeshtë» — Kujtime, f. 301.

u mbush plot, në të gjitha shtëpitë u shpërndanë ballistë. Ne u bëmë gati të luftonim, po të na dik-tonin.

Ju e dini se ç'bënin ballistët kur binin në ndonjë fshat. Ata nuk largoheshin veçse kur dë-gjonin pushkën e partizanëve, ose kur merrnin vesh se po vinin partizanët. Ata, ballistët, ishin kusarë të poshtër, ata ishin frikacakë si dreqi. Kur binin ballistët në ndonjë fshat, ata e shtronin gunën dhe ia hanin të gjitha ç'kishte katundari. Neve, që ishim mbyllur në odë, s'na leverdiste kjo punë. Sa më tepër të rrinim në atë fshat, ku ishin forcat balliste, aq më i madh ishte rreziku. Ose duhej të dilnim ne nga fshati, ose duhej të iknin forcat balliste. Që të dilnim ne, ishte marrëzi, pse do të na vritnin, se ata kishin vënë rojë kudo dhe e kishin rrethuar fshatin. Atëherë duhej patjetër të largonim ballistët nga fshati që kështu ta ki-shim rrugën të çelur. Dhe këtë detyrë të madhe dhe vendimtare ia ngarkuam shokut të vogël, pio-nierit katundar. Ai e kreu detyrën me trimërinë dhe zgjuarsinë më të madhe. Pasi ia shpjeguan se ç'duhej të bënte, pionieri ia filloi punës. Brenda tri orëve ai mundi t'u kallë një frikë të tmerr-shme ballistëve. Ai shkoi shtëpi më shtëpi, ku qëndronin ballistët dhe u thoshte: «E morët vesh? Tashti poqa poshtë në çaire një katundar nga Grabova dhe ai më tha se Riza Kodheli me 300 partizanë kaloi Qafën e Shënepremtes dhe sonte, një pjesë e tyre, do të hidhet në Grabovë, për në drejtim të Dumresë».

Këtë punë bëri pionieri për tri orë rresht. Ballistët u alarmuan në kulm. Ata filluan të shanin në sy të pionierit kryetarët e tyre, që nuk jepnin urdhër të largoheshin sa më parë nga fshati. Në një shtëpi ku ishin pesëmbëdhjetë ballistë, frika ishte aq e madhe, saqë ata i thanë pionierit: «Aman, eja merr këto pushkët tona dhe i fshih ose u thuaj partizanëve që këto pushkë i kanë lënë partizanët». Kjo ishte përsëri efekti i propagandës demoralizuese që u bënte pionieri ynë ballistëve, të cilëve ai u thoshte: «Partizanët i duan shumë katundarët, kurse ballistët i urrejnë dhe po t'ju zënë me pushkë, ata do të kuptojnë që jeni ballistë dhe ju piu e zeza». Të nesërmen me natë të thellë, ballistët, të trembur, u larguan nga fshati ku ishim ne. Ata morën rrugën e Elbasanit dhe rruga jonë ishte e çelur, rrugën tonë na e çeli trimëria dhe zgjuarsia e një pionieri trim nga një katund i Vërçës.

Sa kujtime të tilla na sjell ndër mend dita e festës suaj, o shokë të dashur pionierë! Ju, bij të vegjël të Shqipërisë, sa vite të hidhura kaluat nga shkaku i luftës! Keni vuajtur nga uria, nga të ftohtit, keni parë tmerret që na bëri armiku, keni parë të digjen dhe të grabiten shtëpitë tona nga italianët, gjermanët, ballistët, zogistët, keni humbur të dashurit tuaj në luftë.

Këto nuk i meritoni. Por pas furtunës, thotë populli ynë, vjen kohë e bukur. Ne të mëdhenjtë dhe ju pionierët i rezistuaam furtunës me ballin lart; çliruam atdheun dhe tani po ndërtojmë një jetë të bukur.

Për ju pionierët e Shqipërisë tani e tutje do të ketë ditë të lumtura, për ju punon gjithë populli shqiptar, që t'ju sigurojë një jetë të gëzuar. Ju tani keni shkolla, juve nuk do t'ju mungojë kurrë buka. Çdo ditë që shkon, do të sjellë përmirësime në të gjithë jetën tonë dhe në radhë të parë, tuajën; në familjet tuaja do të ketë gëzim, pse të gjithë do të punojnë të gëzuar dhe do të fitojnë me nder dhe me djersë jetën e re dhe të begatshme. Një gjë kërkojmë nga ju, o shokë pionierë: Të doni atdheun, të doni popullin, të doni të afërmit tuaj dhe të mësoni, të mësoni! Në traditat e luftës sonë heroike të rritet dhe të çelikoset brezi juaj, shpresa e ardhshme e vendit tonë dhe sot në ditën e festës suaj le të gëzohet gjithë Shqipëria dhe të festojë tok me ju këtë ditë të shënuar të pionierëve trima të Shqipërisë.

Me dashuri  
Gjeneralkolonel  
*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 4, f. 18*

# TELEGRAM DËRGUAR NDËRTUESVE TË HEKURUDHËS KASHAR—ZONA INDUSTRIALE

4 shtator 1949

Mora përshëndetjet dhe lajmin tuaj gazmor për mbarimin me sukses të punimeve të hekurudhës Kashar—Zona industriale. Ju shtuat një fitore të re në vargun e fitoreve të shkëlqyera të rinisë sonë heroike, që ka mbajtur gjithmonë lart flamurin e Partisë sonë, që është treguar gjithmonë e gatshme t'u përgjigjet detyrave të saj me besim dhe me entuziazëm shembullor, si në çlirimin edhe në mbrojtjen e atdheut, si në rindërtimin edhe në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Me plot të drejtë Partia, Qeveria dhe populli ynë mburren me rininë e vendit tonë, e cila me hovin dhe entuziazmin e saj revolucionar, me disiplinën dhe me shpirtin e saj të sakrificës, me besimin e saj të pamposhtur në të ardhmen, ka

merituar dashurinë e madhe të tyre. Me mbarimin e hekurudhës Kashar—Zona industriale ju treguat edhe një herë vetitë e shkëlqyeshme të rinisë sonë heroike dhe patriotizmin tuaj të lartë.

Përshëndetjet e mia më të përzemërta dhe urime për suksese të reja!

Gjeneralkolonel

*Enver Hoxha*

«Për rininë» (Përmbledhje veprash), vëll. I, f. 181

## LETËR DREJTUAR NDËRTUESVE TË KOMBINATIT TË TEKSTILIT

*Yzberish*

**24 nëntor 1949**

Shokë punëtorë, të rinj dhe teknikë ndërtues të kombinatit të tekstilit,

Me gëzim të madh u informova se kryet me sukses angazhimin që kishit marrë për nder të 5-vjetorit të Çlirimit të Atdheut tonë, duke realizuar planin vjetor 102,3 për qind qysh në datën 20 nëntor.

Me këtë rast më lejoni t'ju dërgoj urimet dhe përgëzimet e mia më të përzemërta për suksesin tuaj, për punën vetëmohuese dhe devocionin që treguat në realizimin e planit të vitit 1949 të njërës nga veprat më të rëndësishme të planit tonë dyvjeçar.

Me njerëz si ju me të drejtë mund të mburret populli ynë. Me vepra ju treguat dashurinë

për atdheun dhe vendosmërinë tuaj për të kryer me nder detyrat që ju ka ngarkuar Partia.

Çdo ndalesë dhe vështirësi, çdo përpjekje e armiqve për të na penguar në rrugën tonë, do të thyhet dhe do të dërrmohet përpara patriotizmit të klasës sonë punëtoresh dhe të masave tona punonjëse.

Me njerëz si ju është e siguar e ardhmja e lulëzuar e atdheut tonë, ndërtimi i socializmit.

Iniciativa juaj për ta nderuar 70-vjetorin e ditëlindjes së flamurtarit të njerëzimit përparimtar në luftën për paqe e socializëm, mikut më të dashur dhe më të shtrenjtë të popullit shqiptar, shokut të madh Stalin, është një akt tjetër i patriotizmit tuaj të lartë.

Ju uroj suksese më të mëdha në punën tuaj. Vazhdoni më me vrull dhe me entuziazmin që ju karakterizon veprën tuaj të ndërtimit të socializmit dhe heroizmi juaj në punë të vlejshme si shembull për gjithë punonjësit e vendit tonë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave

Gjeneral Armate

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 283 (356), 26 nëntor 1949*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOLEKTIVIT  
PUNONJËS TË FABRIKËS SË SHEQERIT  
«8 NËNTORI»**

*Maliq*

**31 tetor 1951**

Qofshi të gëzuar dhe të nderuar, ju, shokë punëtorë, teknikë, inxhinierë, ndërtues, që gëzuat popullin tonë, duke ndërtuar për të një nga fabrikat madhështore të planit të parë pesëvjeçar, fabrikën e sheqerit «8 Nëntori».

Ju falënderoj nxehtësisht dhe i uroj, gjithashtu, kolektivit punonjës të shfrytëzimit të ndjekë rrugën tuaj plot zotësi dhe heroizëm, për t'i dhënë popullit sa më shpejt dhe sa më shumë sheqer.

Rroftë Partia jonë e dashur që na udhëheq në rrugën e fitoreve!

Kryeministri

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 8, f. 363*

# LETËR DREJTUAR SHUAIP ELEZIT, KULTIVUES I DALLUAR I DUHANIT NË SHTËRMEN

*Elbasan*

22 shkurt 1954

E mora letrën tuaj. U gëzova shumë për sukseset që keni arritur në prodhimin e duhanit dhe për zotimin e ri që merrni.

Letra juaj flet për një problem shumë të rëndësishëm: për arritjen e rendimenteve të larta në kulturën e duhanit.

Fshatarësia jonë punonjëse, e çliruar përgjithmonë nga shfrytëzimi dhe shtypja e bejlerëve, e agallarëve dhe e ndihmuar vazhdimisht nga Partia e pushteti popullor, po merr gjithnjë rendimente më të larta në të gjitha kulturat bujqësore, duke e përmirësuar kështu dita-ditës jetesën e saj. Radhët e fshatarëve përparimtarë, të atyre që zbatojnë agroteknikën e re, që punojnë sipas shembullit të bujqësisë së përparuar në botë po rriten nga viti në vit. Dhe ju bëni pjesë në radhët

e atyre fshatarëve, nga të cilët duhet të marrë shëmbull gjithë fshatarësia jonë punonjëse.

Këto përpjekje për të marrë rendimente më të larta, kujdesi dhe vrulli në punë për ta çuar bujqësinë përpara, janë një garanci e shëndoshë për përparimin e ekonomisë sonë popullore, për përmirësimin e jetesës së gjithë punonjësve. Shumë fshatarë si ju, duke zbatuar rregullat agroteknike, kanë marrë prodhime të shkëlqyera në kulturën e duhanit dhe kanë përmirësuar ekonominë e tyre, si në Buzujë të Shkodrës ku kanë marrë 28 kuintalë për hektar në 22 dynym tokë, ose në katundin Aliaj të Shkodrës ku u morën 25 kuintalë duhan në një hektar, ndërsa në Kujan të Elbasanit janë marrë 17 kuintalë për hektar e të tjera.

Partia dhe Qeveria u kushtojnë një rëndësi të madhe rritjes së mëtejshme të rendimenteve dhe zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella me duhan. Vendimet e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë, të cilat përcaktojnë masat për përmirësimin e mëtejshëm të konditave të jetesës së masave punonjëse, shtrojnë si detyrë që prodhimi i duhanit të shtohet në mënyrë të atillë që të bëhet një nga artikujt e radhës së parë dhe brenda 3-4 vjetëve të ardhshëm prodhimi i tij të dyfishohet.

Partia dhe Qeveria kanë marrë vendime të veçanta për të ndikuar kultivuesit e duhanit duke u dhënë kredi për blerje plugjesh e plehrash kimike, për të ndërtuar kanale dhe hauze për

mbajtjen e ujit për ujitje, për të ndërtuar hangarë dhe për të përdorur sa më shumë SMT-të dhe teknikët bujqësorë. Kultivuesit e duhanit duhet të përfitojnë në maksimum nga ndihma e Partisë dhe e Qeverisë dhe të tregojnë një kujdes të veçantë për rritjen e bimës. Dhe ky kujdes fillon që tani, me mbjelljen e shpejtë e të mirë të farish-teve, me sigurimin e bimëve të caktuara për çdo dynym, me prashitjen e bimëve e deri në vjeljen me kohë, në tharjen dhe manipulimin e duhanit sipas rregullave agroteknike. Të gjitha këto janë kusht i domosdoshëm për të marrë rendimente të larta.

Ju keni një eksperiencë të gjatë në kultivimin e duhanit. Detyra juaj është që këtë eksperiencë t'ua mësoni edhe fshatarëve të tjerë dhe njëkohësisht të bëni të gjitha përpjekjet për ta shtuar edhe më tepër prodhimin.

Ju thoni se nuk e ndani punën e familjes me atë të shtetit dhe të Partisë. Kjo është shprehje e zjarritë e ndjenjave të të gjithë patriotëve të vendit, kjo është shumë e rëndësishme. Puna juaj si bujk përparimtar është e lidhur ngushtë me ngritjen e ekonomisë popullore në përgjithësi dhe forcimin e Republikës Popullore. Partia dhe Qeveria kanë për qëllim dhe përpiqen që jeta e popullit të përmirësohet, të përmirësohet jeta e fshatarit, që ai të ndërtojë shtëpi të re, në shtëpinë e tij të ketë çdo gjë që i nevojitet për të bërë një jetë të këndshme dhe të gëzuar.

Të gjitha këto do të arrihen me punë të pa-

lodhur dhe garanci e madhe është Partia jonë që na udhëheq, është patriotizmi i flaktë i të gjithë punonjësve të Shqipërisë së re, që janë të lidhur si mishi me thoin me pushtetin popullor, me Partinë e tyre të dashur.

Ju uroj shëndet, ta plotësoni me nder angazhimin tuaj dhe të arrini suksese gjithnjë më të mëdha!

Të fala, juve dhe familjes suaj

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 11, f. 238*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
BEHAR SHTYLLA<sup>1</sup>**

**9 nëntor 1954**

Shoku Behar,

Po bëhet ose u bë në Paris «La vente du Vel.' d'hiv.»<sup>2</sup>. Prandaj të lutem lajmëro në ambasadë që tok me librat e shënuar në listën tjetër të më dërgojnë dhe këto që po të shënoj në këtë listë. Po të ketë mundësi, të mos m'i vonojnë, pse ti e di që jam merak për libra.

Të fala

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme.

2. La vente du Vélodrome d'hiver — aktivitet që zhvillohej në Francë çdo vit, ku organizohej edhe shitja e librit.

## LETËR DREJTUAR KOMPOZITORIT KRISTO KONO

20 nëntor 1954

Ju uroj përzemërsisht sukses të madh për veprën tuaj, operetën «Agimi» që shfaqet për herë të parë në Korçë. Opereta «Agimi», e para veprë e këtij lloji në historinë e muzikës sonë, qoftë për ju fillimi i mirë për një sërë veprash të tjera kombëtare, ku të pasqyrohen veprat madhështore të popullit dhe të Partisë së tij heroike! Uroj, gjithashtu, që vepra dhe përpjekjet tuaja në krijimtarinë e frytshme muzikore të bëhen shembull dhe inkurajim për të gjithë kompozitorët e vendit tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë i çmon shumë veprat e bukura të të gjithë kompozitorëve tanë dhe këta kanë te Partia e tyre ndihmësen dhe përkrahësen më të zjarrtë.

Ju lutem t'i transmetoni të gjithë kolektivit të artistëve dhe punonjësve të Teatrit të Korçës,

urimet e mia të përzemërta dhe suksese në punën e tyre krijuese. Të gjithë vëllezërve dhe motrave korçare, ju uroj nga zemra festën e madhe të lavdishme të 10-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë.

*Enver Hoxha*

*«Mbi letërsinë dhe artin», f. 50*

## LETËR DREJTUAR PIONIERËVE TË QYTETIT TË KRUIJËS

20 tetor 1956

Të dashur pionierë të qytetit të Krujës,

Ju falënderoj nga zemra për urimet që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime dhe ju uroj të gjithëve shëndet të mirë, jetë të gëzuar dhe suksese në mësim, që të bëheni bij të denjë të atdheut tonë të dashur.

Ju, pionierët e qytetit heroik, ku Skënderbeu ynë i lavdishëm ka zhvilluar beteja legjendare dhe fitimtare kundër hordhive turke, të bëheni trashëgimtarë të denjë të traditave heroike të të parëve tanë. Sikundër i gjithë brezi i ri i vendit tonë, që edukohet nga Partia jonë e dashur dhe nga organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës, duhet të bëheni shembull në përvetësimin e mësimëve, në sjellje, në familje, në shkollë e kudo, të nderoni e të dëgjoni me kujdes këshillat e prindërve e të mësuesve tuaj, të kryeni plotësisht

detyrat që ju ngarkon organizata juaj e pionierit, që të bëheni kështu patriotë të mirë, ndërtues aktivë të shoqërisë socialiste dhe mbrojtës të flaktë të fitoreve historike të popullit tonë.

## Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT MARSEL KASHEN

[Tetor] 1956

Shumë i dashur dhe i nderuar shoku Kashen,

Përfitoj nga rasti i kthimit nga pushimet që kaloi në Shqipëri shoku Monmuso për t'Ju shkruar këto radhë dhe për t'Ju thënë se sa e dashur është për ne dhe na bën të lumtur të dimë për Ju se jeni mirë me shëndet. Me gjithë zemër ne Ju urojmë, shumë i dashur shok dhe mik, jetë të gjatë, të lumtur!

Ne ruajmë një kujtim të paharruar nga qëndrimi Juaj midis nesh. Partia jonë dhe populli ynë Ju janë mirënjohës, sepse qëndrimi Juaj i shkurtër te ne ka qenë në të njëjtën kohë një ndihmë shumë e çmueshme për forcimin e pozitive të Partisë sonë dhe të vendit tonë në planin ndërkombëtar. Artikujt Tuaj në gazetën «Hymnitate» e kanë ndihmuar shumë vendin tonë, sepse ishin shkrime që dilnin nga zemra e njërit prej

militantëve më të mëdhenj të lëvizjes punëtore ndërkombëtare dhe të një militanti të shquar komunist, i cili është jo vetëm krenaria e Partisë Komuniste Franceze, por e të gjitha partive komuniste e punëtore të botës së tërë.

Shumë i dashur shoku Kashen,

Unë nuk do të doja t'Ju lodhja duke Ju shkruar gjatë mbi zhvillimin e vendit tonë, sepse e di që shoku Monmuso do t'Ju tregojë ato që ka parë dhe ka konstatuar te ne, po kështu edhe Zhan Bako, që është mjeshtër për këtë çështje, dhe do të jetë një tablo objektive e gjendjes te ne, sepse shoku Monmuso është një militant i vjetër plot eksperiencë, me një zemër të artë dhe që e do me pasion popullin tim të vogël dhe vendin tim.

Shumë i dashur shoku Kashen,

Unë e di që Ju i kuptoni më mirë se çdo njeri tjetër dëshirat e pangopura të të rinjve. E mirë, pra, ja, ne do të donim që Ju të vinit prapë te ne për të kaluar pushimet e ardhshme dhe nuk do të kënaqeshim me një qëndrim të shkurtër, por të qëndronit disa muaj dhe së bashku me të gjithë familjen Tuaj dhe me cilindo shok që është i dashur për ne dhe që është afër Jush.

Ne e quajmë këtë një nder të madh për Partinë tonë dhe për popullin tonë që shikon te Ju një nga miqtë më besnikë.

Ju lutem, shoku Kashen, t'u transmetoni shokëve Moris, Zhak, Raimond dhe të gjithë të tjerëve urimet e mia më të mira, shëndet të mirë dhe lutju atyre nga ana ime që të mos e harrojnë premtimin për të ardhur në Shqipëri.

Shumë i dashur shoku Kashen,

Ju lutem të pranoni në emër të Komitetit tonë Qendror dhe në emrin tim personal përshëndetjet më të përzemërta; ne do të donim me gjithë zemër t'Ju shtrëngonim në krahët tanë, sikurse thotë populli ynë, dhe Ju urojmë një jetë të gjatë si atë të maleve, siç thotë një fjalë e popullit!

Me shumë respekt dhe dashuri për Ju  
Në të mirën Tuaj

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 14, f. 59*

**LETËR DREJTUAR PËRFAQËSUESVE TË  
SHOQËRISË PATRIOTIKE «SKËNDERBEU»  
NË ARGJENTINË**

**12 nëntor 1958**

Shokëve Musa Nexhipi dhe Bajram Veizi

Të dashur shokë,

Jam prekur thellë nga urimet aq të ngroh-  
ta që më dërguat në emrin tuaj, të shoqërisë  
patriotike «Skënderbeu» dhe të të gjithë shqip-  
tarëve të Argjentinës me rastin e 50-vjetorit të  
ditëlindjes sime.

Unë e di që urimet tuaja të përzemërta, që  
më dërguat mua, i përkasin në radhë të parë po-  
pullit tonë heroik, i cili shekuj me radhë luftoi  
për lirinë e për pavarësinë e atdheut të tij të da-  
shur dhe që në Luftën Nacionalçlirimtare, nën  
udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, me gjakun e  
tij të shenjtë fitoi lirinë e pavarësinë e vërtetë  
dhe vendosi pushtetin e tij.

Populli ynë dhe Partia e tij i çmojnë shumë ndjenjat e flakta të patriotizmit dhe të atdhedashurisë që vlojnë në zemrat tuaja dhe ju duan ju me gjithë shpirt. Mëma Shqipëri i ka dashur, i do dhe do t'i dojë sa të jetë jeta bijtë e saj, që nuk e harrojnë, por e ruajnë në zemër dashurinë e zjarrtë për të.

Ju uroj me gjithë zemër juve, familjeve tuaja dhe gjithë vëllezërve tanë shqiptarë në Argjentinë shëndet të mirë dhe suksese në veprimtarinë fisnike të shoqërisë suaj që mban emrin e heroit të lavdishëm të Shqipërisë, Skënderbeut!

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 16, f. 407*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT THOMA PAPAPANO

3 dhjetor 1958

I nderuari shoku Thoma Papapano,

Ju përgëzoj për kujdesin që keni treguar së bashku me kolegët tuaj në lidhje me ngritjen e muzeut të shkollës së parë shqipe në qytetin e Gjirokastrës. Kujdesi që tregoni ju dhe kolegët tuaj për të ruajtur dhe për të nxjerrë në dritë traditat patriotike të popullit të Gjirokastrës, është një kontribut i vlefshëm për edukimin patriotik të brezit të ri e të punonjësve jo vetëm të rrethit të Gjirokastrës, por të të gjithë atdheut tonë.

Ju uroj me gjithë zemër, shoku Thoma, shëndet, pleqëri të bardhë dhe suksese në punën tuaj të palodhur!

Me nderime  
*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 16, f. 429*

**RADIOGRAM**  
**DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO**

**2 shtator 1959**

Shoku Hysni,

U hidhërova për fatkeqësinë që pësoi populli nga tërmeti<sup>1</sup>, por shyqyr që nuk patëm të vrarë. Duhet të shkoni vetë në vendet më të dëmtuara dhe të merrni kontakt me popullin që të qetësohet. Nga ana tjetër, duhet të merren masa të shpejta, për ndreqjen dhe meremetimin e shtëpive. Fatkeqësitë që i ngjasin popullit, duhet t'i riparojmë shpejt. Mos i lër çështjet t'i zgjatë ndërtimi me muaj, por brenda një kohe rekord të zhduket çdo shenjë e tërmetit. Më vjen shumë

---

1. Është fjala për tërmetin e 1 shtatorit 1959, i cili preku veçanërisht rrethet e Lushnjës, Fierit, Beratit dhe Elbasanit (zonën e Peqinit).

keq që nuk u ndodha në Shqipëri<sup>1</sup>, po le të shpre-  
sojmë se nuk do të ketë më tërmet.

Të fala

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Në atë kohë shoku Enver ndodhej për pushime në Sofje.

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR NXËNËSVE DHE  
PEDAGOGËVE TË SHKOLLËS SË PARTISË  
«V. I. LENIN»**

**16 shtator 1959**

DREJTORISË SË SHKOLLËS SË PARTISË «V. I. LENIN»,  
GJITHË PEDAGOGËVE DHE NXËNËSVE TË KËSAJ  
SHKOLLE

Të dashur shokë,

Me rastin e përvjetorit të themelimit të shkollës së Partisë «V. I. Lenin», Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ju përshëndet ju, shokë drejtues, pedagogë e nxënës dhe ju uron suksese sa më të mëdha në punën tuaj të frytshme dhe me shumë përgjegjësi që ju ka besuar Partia!

Hapja e shkollës së Partisë «V. I. Lenin» shënon një ngjarje me rëndësi të madhe në historinë e Partisë sonë të lavdishme.

Gjatë këtyre viteve, shkolla e Partisë «V. I.

Lenin» ka dhënë një kontribut të çmuar në përgatitjen marksiste-leniniste të kuadrove të Partisë sonë. Qindra kuadro kanë kryer me sukses studimet në shkollën dyvjeçare e trevjeçare dhe në kursin njëvjeçar pranë Shkollës së Partisë. Në shkollë ata kanë marrë njohuritë bazë të shkencës marksiste-leniniste, janë njohur me veprat e pavdekshme të mësuesve të mëdhenj të marksizëm-leninizmit, kanë marrë mjaft njohuri mbi drejtimin konkret të degëve të ndryshme të ekonomisë, kanë zgjeruar horizontin e tyre të përgjithshëm kulturor, ata janë bërë më të aftë për zgjidhjen me sukses të detyrave që u ka besuar Partia.

Marksizëm-leninizmi është shkenca e ligjeve të zhvillimit të natyrës dhe të shoqërisë, shkenca e revolucionit të masave të shtypura e të shfrytëzuara, shkenca e fitores së socializmit, shkenca e ndërtimit të shoqërisë komuniste. Prandaj Partia jonë, si një parti marksiste-leniniste, që në ditët e para të organizimit, i ka kushtuar një kujdes të veçantë edukimit ideologjik të anëtarëve të saj.

Marksizëm-leninizmi u dha anëtarëve të Partisë sonë forcën e orientimit, sigurinë në luftën që bënin dhe besimin në fitore. Prandaj, të edukuar nga Partia, komunistët hidheshin në sulm të parët kundër armikut dhe binin heroikisht në luftën për çlirimin e atdheut, për idealet e larta të Partisë dhe të popullit.

Partia jonë, e udhëhequr nga Komiteti Qe-

ndror i saj, ka luftuar me të gjitha forcat për ruajtjen e unitetit të çeliktë ideologjik dhe organizativ të radhëve të saj, duke goditur pa mëshirë dhe duke shpartalluar gjithë armiqtë e brendshëm. Ajo ka bërë një luftë të vendosur për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e saj nga çdo rrymë oportuniste dhe sektare, ajo ka zhvilluar një luftë të ashpër kundër revizionizmit modern, flamurin e të cilit e mbajnë revizionistët jugosllavë. E edukuar në frymën e internacionalizmit proletar ajo ka përkrahur tërë lëvizjen përparimtare të popujve të shtypur, që luftojnë për liri, pavarësi dhe socializëm.

Detyra akoma shumë të mëdha kemi përpara, për ta bërë vendin tonë, në një të ardhme, të aftë që të hyjë në rrugën e ndërtimit të shoqërisë komuniste. Për këtë duhet që kuadrot tanë, gjithë anëtarët e Partisë dhe pastaj gjithë punonjësit të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për këtë rrugë kaq të ndritur, të shohin dhe të dinë të ecin përpara, të kuptojnë qartë ligjet e zhvillimit të shoqërisë. Këtë zotësi ua jep marksizëm-leninizmi, i cili përbën jetën dhe forcën e Partisë sonë, të ardhmen dhe sigurinë e popullit shqiptar. Prandaj Shkolla e Partisë, si institucioni më i rëndësishëm që ka Partia jonë për edukimin dhe kalitjen ideopolitike të kuadrove, ka detyra të mëdha. Ajo duhet të përgatitë kuadro, të cilët gjithnjë e më mirë të zotërojnë teorinë lidhur edhe me praktikën e vendit tonë, kuadro të pje-

kur ideologjikisht dhe politikisht, organizatorë të zotë, të aftë që të mobilizojnë dhe të udhëheqin masat punonjëse për ndërtimin e socializmit.

Shkolla e Partisë duhet të mbajë kurdoherë parasysh se marksizëm-leninizmi nuk mund të kuptohet dhe as të zbatohet si duhet pa u lidhur me të gjitha shkencat e tjera, me politikën, me ekonominë dhe me problemet shoqërore, pa u lidhur ngushtë me jetën dhe me problemet që ka shtruar Partia para popullit tonë. Masat që ka marrë Komiteti Qendror i Partisë sonë, për organizimin e praktikës së prodhimit, për punën praktike të nxënësve dhe të pedagogëve, pranë komiteteve të Partisë në rrethe, kanë një rëndësi të madhe. Prandaj drejtorja dhe këshilli i shkollës, organizata e Partisë në shkollë, çdo pedagog dhe çdo nxënës duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme jo vetëm mësimin në shkollë, por edhe praktikës.

Pedagogët duhet të thellohen më shumë në vijën dhe vendimet e Partisë sonë, të njihen mirë me jetën dhe punën që bën populli nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e socializmit, pra ata duhet të njohin mirë realitetin e vendit tonë dhe ta lidhin mirë teorinë me praktikën. Shkolla e Partisë duhet ta ngrejë akoma punën shkencore dhe metodike mësimore, të ndihmojë nxënësit nga ana metodike si të studiojnë dhe si të punojnë, në mënyrë që, pas mbarimit të shkollës, çdo nxënës të jetë në gjendje që jo vetëm të punojë mirë, por dhe të studiojë për ngritjen e mëtej-

shme të nivelit ideologjik, kulturor dhe profesional.

Drejtoria e shkollës, gjithë pedagogët, së bashku me organizatën e Partisë në shkollë duhet të bëjnë një punë të madhe për edukimin komunist të nxënësve, të cilët, nga ana e tyre, duhet ta kuptojnë se Partia, duke i sjellë në shkollë, u jep një ndihmë shumë të madhe për të mësuar marksizëm-leninizmin, për të marrë këtu atë kyç që hap të gjitha portat, që krijon të gjitha mundësitë, që sheshon të gjitha pengesat dhe e bën komunistin shumë të fortë. Prandaj, të dashur shokë, ta shfrytëzoni mirë kohën, të thelloheni në veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe në vendimet e në vijën e Partisë sonë, të dëgjoni me kujdes leksionet që ju bëjnë pedagogët dhe të konsultoheni me ta për gjërat e paqarta. Të forconi disiplinën në mësim dhe në jetën e shkollës, të përfitoni nga jeta e organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës dhe nga jeta politike e kulturore në kryeqytet dhe gjithnjë të mendoni, të punoni dhe të jetoni si komunistë, që, kur të ktheheni në punë, të jeni më të edukuar, më të aftë, se edhe detyra më të mëdha ju presin.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, po ndërton me sukses socializmin. Janë arritur sukseset më të mëdha në të gjitha fushat. Një e ardhme akoma më e lulëzuar e pret popullin tonë dhe kjo do të arrihet me punë, në ballë të së cilës duhet të jenë, si kurdoherë, komunistët, me shembullin, heroizmin dhe vetëmohimin e tyre.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka bindje se drejtuesit, pedagogët dhe nxënësit e Shkollës së Partisë, që mban emrin e Leninit të madh, do t'i kryejnë gjithnjë me nder detyrat që u ka ngarkuar Partia.

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

«Për arsimin dhe edukatën»  
(Përmbledhje veprash), botim  
i dytë, f. 97

# LETËR DREJTUAR QYTETARIT SOVJETIK A. MUROMCJEV

*Moskë*

**21 tetor 1959**

I dashur shoku Muromcjev,

Mora letrën tuaj, e cila më ka prekur thellësisht. Letra juaj, sidomos fotografia, në të cilën unë dhe bashkëshortja ime kemi dalë me vëllanë tuaj, të ndjerin Viktor Nikollajeviç<sup>1</sup>, më kujtoi vitet e largëta të luftës sonë për çlirimin e atdheut, ajo më kujtoi edhe ditët e këndshme plot entuziazëm që ne kaluam duke pasur në gjirin tonë mikun dhe vëllanë tonë të dashur, birin e denjë të popullit sovjetik, shokun Viktor, i cili i donte aq shumë Shqipërinë dhe popullin tonë dhe që

---

1. Toger Viktor Nikollajeviç Muromcjev, kinooperator sovjetik, laureat i çmimit «Stalin». U vra më 30 prill 1945 në luftë për çlirimin e Triestes.

luftoi e punoi pa u kursyer për të paraqitur në mënyrë sa më të drejtë e të denjë vendin tonë në filmin «Shqipëria».

Unë personalisht si dhe shokët e mi e gjithë ata që e kanë njohur shokun Viktor, veçanërisht banorët e kryeqytetit të vendit tonë, nuk do t'i harrojnë kurrë heroizmat që ai tregoi për kryerjen e detyrës së tij gjatë luftës për çlirimin e Tiranës nga pushtuesit fashistë gjermanë. Ai punoi e luftoi ashtu siç i ka hije njeriut sovjetik, të edukuar nga Partia e madhe e Leninit, të mësuar nga shkolla e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe të kalitur në betejat legjendare të popullit sovjetik kundër armiqve të njerëzimit. Ne u hidhëruam pa masë, kur morëm vesh se Viktori ka rënë në luftën kundër fashizmit pikërisht në pragun e ditës së fitores, në kohën kur e gjithë bota do të festonte me madhështi triumfin e plotë të armëve ngadhënjimtare sovjetike mbi bishën fashiste. Viktori, duke plotësuar deri në fund detyrën ndaj popullit, atdheut dhe gjithë njerëzimit, ra në fuqinë e nderit. Por, siç thotë populli, njerëz të tillë nuk vdesin, ata rrojnë për shekuj në mendjen dhe në zemrat e popujve, për të cilët ata japin jetën. Ne do të ruajmë përgjithmonë kujtimet më të mira nga vëllai juaj dëshmor.

Duke ju shprehur, ndonëse pas 14 vjetësh, ngushëllimet e mia të thella për vdekjen e vëllait tuaj, ju dërgoj falënderimet më të përzemërta për letrën dhe fotografinë aq të dashur që më dërguat, si edhe ju uroj juve dhe familjes suaj shën-

det të mirë, jetë të lumtur e të gëzuar, suksese në punën tuaj fisnike! Shumë të fala ju dërgon gjithashtu shoqja ime, Nexhmija.

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 17, f. 337*

# LETËR DREJTUAR ORGANIZATËS SË BRPSH TË REPARTIT USHTARAK «N»

23 tetor 1959

Të dashur shokë,

Me vëmendje të madhe lexova letrën që më dërguat me rastin e konferencës së repartit për dhënie llogari e zgjedhje në organizatën e BRPSH. Në emër të Komitetit Qendror të PPSH ju përsëndes dhe ju uroj nga zemra për sukseset që keni arritur në edukimin komunist të rinisë dhe në kryerjen e detyrës së shenjtë për ruajtjen e kufijve të atdheut tonë të dashur.

Ashtu si ju mëson Partia, ju flisni në letrën tuaj me zemër të hapët, flisni jo vetëm për sukseset, por edhe për të metat e për dobësitë në punë<sup>1</sup>. Por, në të njëjtën kohë, letra juaj është e përshkuar fund e krye nga besimi i patundur që ju, ashtu si gjithë rinia heroike e vendit tonë, keni

---

1. Në diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, datë 24 dhjetor 1958, duke folur për forcimin e punës së Partisë në repartet e kufirit, shoku Enver ndalet në çështjen e edukimit të rinisë kufitare, ku viheshin re disa dobësi.

te Partia, nga dashuria e pakufishme për popullin e për atdheun, nga shpirti i vetëmohimit, vendosmëria dhe gatishmëria për të kapërcyer çdo vështirësi, për të ndrequr çdo të metë dhe për të kryer kurdoherë me nder detyrën.

Juve ju është besuar detyra e shenjtë e ruajtjes së paprekshmërisë së kufijve dhe të integritetit tokësor të atdheut; ju siguroni punën dhe jetën paqësore të popullit tonë. Kjo është një çështje e madhe nderi dhe një detyrë patriotike.

Sigurisht, ju e dini mirë se imperialistët luftënxitës dhe shërbëtorët e tyre të të gjitha ngjyrave janë përpjekur dhe akoma përpiqen t'i vënë zjarrin botës; ata mundohen të ruajnë «luftën e ftohtë» e ta shndërrojnë atë në një «luftë të nxehtë», zhvillojnë garën e shfrenuar të armatimeve dhe ndërtojnë baza agresive atomike rreth kampit socialist. . . Por mos vallë njerëzit paqdashës duhet të prehen mbi dafina? Përkundrazi. Fjala e urtë e popullit tonë thotë: «Ujët fle, hasmi s'fle». Ujqit monopolistë, që tërë jetën e tyre e kanë kaluar duke thithur gjakun dhe djersën e popujve dhe që nxjerrin fitime kolosale nga gara e armatimeve, qimen mund ta ndërrojnë, por zakonin jo; ata janë gati të shfrytëzojnë çdo rast për t'i ngulur dhëmbët e tyre. Pa dyshim në një rast të tillë ata do të mbeteshin jo vetëm pa dhëmbë, por dhe pa kokë... Ju vetë jeni ndeshur më se një herë me spiunë, me diversantë e me shkelës të kufirit dhe u keni treguar atyre vendin; me të tillë ju do të ndesheni edhe në të ardhmen.

Prandaj është e domosdoshme që të ruhet e të forcohet vigjilenca revolucionare që karakterizon popullin tonë dhe sidomos rojat tona trime të kufirit. Duke qenë vigjilentë, syrit tuaj të mprehtë nuk do të mund t'i shpëtojë asnjë armik dhe kufirin tonë s'do të mund ta kapërcejë asnjë këmbë e tij. Për këtë arsye kufitari s'mund dhe s'duhet të pajtohet kurrsesi me mungesën e vigjilencës. Por që kufitari ta kryejë me nder besimin që i është dhënë, nuk mjafton vetëm kjo. Për këtë duhet dhe disiplinë e çeliktë. Të gjithë e dinë se disiplina në çdo detyrë bën që punët të shkojnë si sahat dhe të kryhen me përpikëri. Por për vetë natyrën dhe karakterin e detyrës së kufitarit ajo për ju ka një rëndësi vendimtare. Prandaj s'duhet të pajtoheni në asnjë rast me thyerjet e disiplinës dhe me shthurjet në shërbim e në jetën e përditshme. Zbatimi i ndërgjegjshëm, pa kushte, shpejt, me përpikëri dhe mirë i urdhrave të oficerëve dhe të nënoficerëve duhet të jetë motivi kryesor i kufitarit. Ndryshe s'mund të sigurohet mbrojtja e pakapërcyeshme e kufirit.

Sigurisht në kufi ka më tepër vështirësi se në sektorët e tjerë të jetës sonë; ju nuk i keni të gjitha kushtet që kanë punonjësit e tjerë në detyrat dhe në jetën e tyre të përditshme; ju jeni të detyruar të përlesheni me vështirësitë e natyrës, me shiun, me borën e tufanin. Por pikërisht për këtë arsye populli ka dërguar në kufi bijtë e tij më të mirë që natë e ditë i mban në zemër, prandaj ju duhet të jeni gjithmonë të papërkulur për-

para çdo vështirësie. Në luftë me vështirësitë duhet të kaliten shpirti dhe trupi i kufitarit të Shqipërisë së re.

Një kusht i domosdoshëm për të kryer me nder detyrën është rritja e mjeshtërisë kufitare. Çdo njeri, që dëshiron ta kryejë mirë punën në sektorin e tij, përpiqet, në radhë të parë, të zotërojë profesionin, të rritë mjeshtërinë e tij. Të dish të ruash kufirin, të gjurmosh, të zbulosh dhe të neutralizosh armikun është, si të thuash, një art më vete. Këtë art mund dhe duhet ta përvetësojë më së miri çdo njeri që i thotë vetes kufitar i vërtetë. Në këtë drejtim ju keni grumbulluar një eksperiencë të madhe, sepse të panumërta janë mrekullitë e kufitarëve tanë të lavdishëm. Kjo eksperiencë duhet përgjithësuar me të gjitha mjetet e format. Ajo duhet pasuruar me iniciativën tuaj krijuese në përputhje me kërkesat e rregulloreve dhe urdhrat e komandës.

Ne kemi marrë vesh se ju aktivizoheni në punime të ndryshme; organizatat e rinisë kanë shpallur si aksion të tyre zbulimin e postave me lulishte e me pemë, ju po krijoni ekonomi ndihmëse pranë tyre, ndihmoni fshatarët në punë etj. Të gjitha këto janë gjëra shumë të mira dhe për këtë Partia ju përgëzon. Ato ndihmojnë për ta bërë sa më të këndshme jetën në postat tuaja, për të krijuar kushte sa më të mira jetese. Këtë punë ju duhet ta vazhdoni edhe në të ardhmen, bile të punoni edhe më shumë dhe të aktivizoheni të gjithë, atëherë përfitimet do të jenë edhe më

të mëdha. Por duhet pasur kujdes që ato të mos bëhen në kurriz të detyrës kryesore që ju është ngarkuar, të mos pengojnë kryerjen mirë të shërbimit për mbrojtjen e kufirit. Këto duhet të bëhen me plan, me orar dhe sipas udhëzimeve që janë dhënë.

Një çështje mjaft me rëndësi është ajo e marrëdhënieve që ju kufitarët duhet të keni me masat e popullit dhe me organizatat e rinisë të terrenit. Ju ruani popullin, por bazën dhe burimin e fuqisë suaj e keni te populli. Në të vërtetë, ashtu siç ju ka mësuar Partia, lidhjet midis jush janë mjaft të mira. Shprehje e qartë e kësaj është ndihma që ju u jepni fshatarëve në punët bujqësore, ndihma që ata ju japin juve në ndërtimet xhenero-teknike, njësitet e vigjilencës që kanë ngritur organizatat e rinisë të fshatrave, bashkëpunimi në kapjen e shkelësve të kufirit, mbrëmjet e përbashkëta të dëfrimit që organizoni etj. Por këto lidhje në të ardhmen duhet të çelikosen vazhdimisht. Nga ana tjetër, ju që mbron popullin duhet të jeni edhe mbrojtësit më të zjarhtë të ligjshmërisë socialiste. T'i respektoni dhe t'i ruani si sytë e ballit të drejtat dhe pasurinë e popullit.

S'ka dyshim se këto detyra do të kryhen aq më mirë, sa më e lartë të jetë ndërgjegjja e kufitarit. Në këtë çështje organizatat e rinisë duhet të luajnë rolin e tyre kryesor. Të përmirësojnë dhe të forcojnë punën e tyre ideopolitike dhe kulturore — ja ç'kërkohet në radhë të parë nga organizatat e rinisë. Ju duhet të jeni në korent të

vendimeve të Partisë e të Qeverisë, të kuptoni sa më thellë politikën e Partisë, të dini sa më mirë se ç'bëhet në botë dhe t'i keni sa më të qarta fytyrën e egër dhe qëllimet agresive të imperialistëve. Nga ana tjetër, kufitari duhet të jetë kudo e kurdoherë shembull i moralit të lartë komunist. Kufitarët duhet t'i karakterizojë, gjithashtu, dashuria e pakufishme për shoku-shokun, për kolektivin. Pas kryerjes së afatit të shërbimit ushtarak, nga repartet e kufirit duhet të kthehen në terren reparte të tëra punëtorësh e fshatarësh të kalitur nga pikëpamja ideologjike, politike dhe kulturore. Prandaj organizatat e rinisë të bëjnë vazhdimisht një punë edukative në forma sa më interesante, të zgjerojnë punën me leksione, të shfrytëzojnë sa më mirë shtypin, t'ju afrojnë sa më tepër me librin, të pajisin dhe të shfrytëzojnë si duhet dhomat ushtarako-politike.

Si gjithnjë në punën tuaj ju do të keni ndihmën e pakursyer të organizatave të Partisë dhe të komandave. Ju duhet të përpiqeni të siguronit sa më mirë udhëheqjen e Partisë, pasi kjo është garancia kryesore e të gjitha fitoreve tona. Kërkoni të zbatohen fjala e Partisë dhe urdhrat e komandës, shkoni te komunistët si te vëllezërit tuaj dhe ata do t'ju kuptojnë e do t'ju ndihmojnë për çdo gjë, shkoni te komandantët dhe te zëvendëskomandantët për punë politike, si te prindërit tuaj, me zemër të hapët dhe ata do t'ju dëgjojnë e s'do të kursehen për t'ju ndihmuar që punët të shkojnë sa më mirë. Ata e dinë mirë detyrën

e tyre dhe, si gjithnjë, do të jenë pranë jush.

Së shpejti do të festojmë 15-vjetorin e Çlirimit të Atdheut, që është ngjarja më e lavdishme në historinë e popullit tonë. Fitore të shkëlqyera ka arritur populli ynë në këta vjet nën udhëheqjen e PPSH. Në rojë të këtyre fitoreve kanë qenë dhe janë forcat tona të armatosura heroike, Forcat e lavdishme të Kufirit, gjithë populli ynë. Partia ka besim të patundur te ju dhe në të gjitha Forcat e Kufirit dhe është e sigurt, ashtu siç thoni edhe ju në letrën tuaj, se «armiqtë s'do të mund të prekin e të prishin lirinë e fitoret tona as në shekujt e ardhshëm».

Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror dhe timin personal, ju uroj juve dhe të gjitha Forcave të lavdishme të Kufirit që 15-vjetorin e Çlirimit të Atdheut ta pritni me sa më shumë suksese në kryerjen e detyrës suaj fisnike, me gëzime e me lumturi!

Rroftë BRPSH, ndihmësja dhe rezerva luftarake e PPSH!

Rrofshin Forcat e Kufirit, mbrojtëse besnike të kufijve të shenjtë të atdheut tonë të dashur!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

«Për rininë» (Përmbledhje  
veprash), vëll. I, f. 316

# LETËR DREJTUAR TË REJAVE NË RRETHE TË NDRYSHME TË VENDIT<sup>1</sup>

8 nëntor 1959

Të dashura shoqe,

Me kënaqësi të madhe lexova letrat tuaja dhe u gëzova pa masë për sukseset që keni arritur. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju përgëzoj dhe ju uroj që në të ardhmen, si anëtare të denja të BRPSH, të korrni suksese të reja për të mirën e atdheut dhe tuajën.

Ajo që më bëri më tepër përshtypje në këto letra është pjekuria me të cilën ju vlerësoni fito-

---

1. Këtë letër shoku Enver Hoxha ua dërgoi të rejave të kooperativës bujqësore të zmadhuar Yzberish në Tiranë, të kooperativës bujqësore të zmadhuar të Lumas-Pëllumbasit në Berat, të kooperativave bujqësore të lokalitetit të Semanit në Fier, të rejave të rrethit të Mirditës, të kooperativës bujqësore «Skënderbej» të Gjoricës së Epërme në Peshkopi dhe të kooperativës bujqësore «Shkëndija» të Shtërmenit në Elbasan, të cilat i kishin shkruar letra udhëheqësit të Partisë.

ret e mëdha që ka arritur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë, besimi dhe vullneti juaj i paturtur për të shkuar përpara, drejt një të ardhmeje gjithnjë më të ndritur. Prapa çdo fjale tuajën fshihet një forcë e çuditshme dhe kolosale që ka nisur, por që akoma më me vrull dëshiron të vërshojë për të vaditur kopshtin e lulëzuar që po lind kudo në atdheun tonë të ri socialist.

Ju shpesh bëni pyetjen: «E ç'ishim më parë ne të shkretat?». Me të vërtetë të shkreta ishit dje ju, shoqe të dashura; «edhe trarët e shtëpisë qajnë kur lindin vajza», thoshin dje për ju. Të katër muret e shtëpive, ku vajzat e gratë rrinin të mbyllura, janë dëshmitaret e lotëve të tyre të pashterur. Të shtypura dhe të lëna në errësirë, të paditura ishin nënat, gratë dhe motrat tona. Çarçafi dhe perçja e zezë ishin për to si një qefin për së gjalli. Por këto tani i takojnë së kaluarës. Rënkimet dhe protestën e tyre i dëgjoi Partia, ashtu siç dëgjoi edhe protestat e rënkimet e të gjitha masave punonjëse dhe me dufin e zemrave të tyre u sul mbi armiqtë dhe tradhtarët anadollakë, duke bërë shkumb e hi fronet e tyre. 15 vjet më parë, me Çlirimin e Shqipërisë dhe vendosjen e pushtetit popullor, agoi një ditë e re edhe për të rehat e gratë e vendit tonë. Çlirimi i femrës nga shtypja shekullore dhe dhënia asaj e të drejtave të barabarta me burrin është një nga realizimet më të mëdha të Partisë sonë, një nga fitoret më të shkëlqyera të popullit tonë. Tani në Shqipëri nuk ka vepër që të mos ketë edhe vulën e

heroizmit e të vetëmohimit të vajzave dhe të grave tona, nuk ka fushë të aktivitetit ku të mos ndritë djersa juaj. Pa pjesëmarrjen e femrës nuk mund të ndërtohen socializmi dhe komunizmi.

Duke hyrë në radhët e Bashkimit të Rinisë, ju keni bërë një punë shumë të mirë dhe një hap tjetër të madh përpara<sup>1</sup>. Organizata e rinisë është bërë ndihmësja dhe rezerva luftarake e Partisë. Ajo është një shkollë e madhe, ku edukohet dhe kalitet me vetitë e larta të moralit komunist brezi ynë i ri. Aty ju do të merrni mësimet e Partisë, të cilat do t'ju japin krahë dhe energji të pashtershme për të bërë shumë më tepër se deri tani, për të mirën e atdheut dhe tuajën.

Ju vetë thoni në letrat tuaja mbi ndryshimet dhe përparimet që janë bërë në fshat e kudo në Shqipëri. Po a mund të ndalemi ne këtu dhe të kënaqemi me kaq? Derisa u bëmë zotër të fateve tona, ne jetën do ta bëjmë gjithnjë më të pasur e më të bukur. Për këtë një rol vendimtar do të luani edhe ju, të rejtat. Puna është nder thotë një fjalë e urtë e popullit tonë. Prandaj duart tuaja të arta dhe mendja juaj e shëndoshë le të mos pushojnë së punuari. Rinia punëtore është zotuar ta realizojë pesëvjeçarin e dytë në katër vjet e gjysmë. Shoqet tuaja në fabrika, uzina e kombinatë po luftojnë për ta mbajtur me nder këtë zotim. Qindra prej tyre tani bëjnë pjesë

---

1. Në prag të 15-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, si rezultat i një pune të gjerë nga Partia dhe organizata e rinisë, shumë vajza nga rinia e fshatit hynë në radhët e BRPSH.

në brigadat që punojnë për të fituar titullin e 15-vjetorit të Çlirimit. Te këto të reja populli shikon figurën e njeriut të ri, të brumosur nga Partia, të njeriut të epokës së socializmit, që, pa marrë parasysh asnjë pengesë e vështirësi, ka vendosur «të punojë më mirë, të mësojë më shumë dhe të jetojë në mënyrë të kulturuar». She-mbullin e tyre duhet ta ndjekin mijëra të reja punëto-re dhe kooperativiste.

Sikundër e shikoni edhe vetë, atdheu ynë është bërë si një kantier i madh ku vlon puna ndërtimore. Plane dhe vepra të reja, edhe më madhështore, kemi përpara. Është rritur dhe akoma më shumë do të rritet armata e lavdishme e klasës sonë punëto-re. Në radhët e saj duhet të futen sa më shumë të reja që punojnë në industri, artizanat, ndërtim, transport etj. Partia ka besim se ato, që kurrë s'e kanë bërë dy fjalën e saj, pa-tjetër do ta plotësojnë këtë porosi.

Rinia e kooperativave bujqësore dhe e fshat-rave po punon me të gjitha forcat për të reali-zuar me nder zotimet e saj lidhur me mbjelljen e pemëve frutore, të ullinjve dhe në zhvillimin e blegtorisë. Në këto suksese një meritë e madhe ju takon juve, të rejave fshatare e malësore. Qindra të reja luftojnë sot për të marrë rëndi-mente të larta në qumësht nga lopët, për të rritur sa më mirë vëçat, për të marrë sa më shumë mish nga bagëtitë, për të rritur shpendë të majmë, krimbin e mëndafshit etj. Por këto janë akoma pak, mijëra e mijëra të tjera duhet të futen në

garë me to, për ta bërë sa më të pasur jetën e fshatit dhe të mbarë vendit tonë. Sa gëzim i madh është kur mëson se ju luftoni për të tejkaluar minimumin e ditëve të punës, se ju punoni me dashuri të madhe e me plot rezultate në kultivimin e pambukut, të duhanit, të të lashtave etj.! Në shembullin tuaj duhet të ecin dhjetëra mijë të reja të fshatit tonë të ri. Partia ka besim se kurdoherë ato do ta plotësojnë këtë porosi tjetër të saj.

Por që të punosh mirë duhet të dish. Pa këtë s'mund të realizohen as dëshirat, as zotimet. Qindra shkolla e kurse profesionale për teknikë, agrozooteknikë etj. janë hapur në të katër anët e vendit. Mjaft prej jush i ndjekin ato dhe po përfitojnë shumë. Për këtë Partia ju përgëzon. Por ato duhet t'i ndjekin sa më shumë të reja kooperativiste e punëtore, sepse nga radhët tuaja duhet e do të dalin sa më shumë brigadiere, skuadërkomandante, teknike etj. Kryetarët e kooperativave bujqësore dhe drejtorët, agronomët dhe specialistët nuk janë kursyer dhe nuk do të kursehen as edhe në të ardhmen për t'ju bërë të zonjat për sektorët tuaj, mjafton që ju të keni vullnet. Ju me siguri do ta përmbushni edhe këtë porosi të Partisë.

Për t'u lavdëruar janë edhe përpjekjet e iniciativat tuaja për një jetë sa më të kulturuar në familje dhe në shoqëri. Me duart tuaja të shkahtëta ju keni nisur të vendosni rregull e pastërti në shtëpi, ju po shkelmoni me guxim mënyrën

primitive e antihigjienike të jetesës, zakonet prapanike e paragjykimet fetare që u sillnin aq mjerime e fatkeqësi fshatarëve e malësorëve; ju keni nisur të visheni sa më bukur, të merrni pjesë në grupe e aktivitete artistike dhe sportive. Ç'pamje të mrekullueshme po merr fshati ynë nga dita në ditë me vajza e gra të tilla të mrekullueshme si ju! Por ju nuk duhet të ndaleni në sukseset e para. Për të arritur atje ku duhet, nevojitet akoma shumë punë e luftë. Vajzat, kudo qofshin, në kooperativë, në fabrikë ose në shkollë, duhet të mësojnë vazhdimisht ta ekonomisin sa më mirë shtëpinë, të presin, të qepin ose të qëndisin. Ju duhet t'i bëni shtëpitë tuaja model të një jetese të kulturuar. Ju duhet të qëndroni të forta, ashtu si është gjithë rinia jonë heroike, në luftën kundër zakoneve prapanike që janë të dëmshme për të ardhmen tuaj. Mësimet e Partisë sonë, fjala e Partisë për ju duhet të jenë kurdoherë feneri që ndriçon rrugën e lavdishme në të cilën ecën gjithë rinia jonë; ju nuk duhet t'i lejoni vetes që të zgjidhen problemet sipas zakoneve prapanike, në kundërshtim me edukatën që ju jep Partia, në kundërshtim me vullnetin tuaj. Të luftoni me vendosmëri çdo pengesë që ju del përpara dhe që ka të bëjë me të ardhmen tuaj. Të gjitha këto mundësi të mëdha që ka krijuar pushteti popullor për rininë tonë të lavdishme, si shkolla, qendra kulture, artistike, fizkulturore etj., duhet t'i shfrytëzoni sa më shumë. Mos harroni se të drejtat tuaja mbrohen me ligj nga pushteti popullor

dhe ato s'guxon t'i shkelë asnjë njeri. Pranë jush kurdoherë është Partia. Kërkoni dhe ju do të gjeni gjithmonë mbrojtjen e përkrahjen e saj, të komunistëve, të organizatave të Partisë, të organizatave tuaja të rinisë dhe të organizatës së BGSH.

Tani ju, duke qenë anëtare të BRPSH, mos harroni se duhet të jeni shembull për shoqet tuaja të tjera në çdo drejtim. Ato duhet të shohin te ju luftëtarët e papërkulura dhe më aktive për jetën e re të lumtur socialiste. Merrni pjesë gjallërisht në të gjitha aktivitetet e organizatës së rinisë. Tërhiqni në to edhe shoqet tuaja që nuk janë akoma të organizuara në rini dhe punoni për shtimin e radhëve të organizatës me sa më shumë të reja, të denja për titullin e lartë të anëtares së BRPSH. Bëhuni agjitatore të flakta, në radhë të parë te prindërit, vëllezërit dhe burrat tuaj, pastaj edhe në shoqet tuaja. Do të shihni se, në fund të fundit, përpjekjet tuaja do të kurorëzohen me sukses. Si lulet në pranverë që çelin, zbukurojnë e mbushin me aromë natyrën, ashtu të rejat heroike të vendit tonë do të futen gjithnjë e më shumë në jetën aktive dhe do ta bëjnë atë më të këndshme e më të bukur.

Së shpejti ne do të festojmë 15-vjetorin e lavdishëm të Çlirimit të Atdheut. Edhe një herë ju uroj nga zemra, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, që këtë festë të madhe ta pritni me sa më shumë suksese në punët tuaja paqësore e fisnike dhe me sa më shumë gëzim në jetën tuaj

personale! Uroj, gjithashtu, që konferenca e dytë kombëtare e të rejave, që së shpejti do të mbli-dhet në Tiranë, të bëhet një armë e fuqishme në duart tuaja, për të shkuar gjithmonë përpara!

Rroftë BRPSH, ndihmësja dhe rezerva luf-tarake e Partisë së Punës të Shqipërisë!

Rrofshin të rejat dhe gratë heroike të vendit tonë, bashkëlufëtare aktive në rrugën e ndërti-mit të socializmit dhe të komunizmit!

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Vepra, vëll. 17, f. 387*

**LETËR DREJTUAR ANËTARËVE TË  
KOOPERATIVËS BUJQËSORE  
«3 DËSHMORËT», BODRISHTË**

*Dropull i Sipërm*

**11 nëntor 1959**

Të dashur shokë,

Prita me kënaqësi ftesën që më bëtë për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të lapidarit kushtuar tre dëshmorëve të fshatit tuaj dhe 4-vjetorit të ngritjes së kooperativës bujqësore, dhe ju falënderoj me gjithë zemër për këtë ftesë.

Fshati juaj, sikurse gjithë krahina minoritare e Dropullit, bashkë me gjithë popullin tonë punonjës, në të kaluarën ka hequr të zitë e ullirit nën sundimin e çifligarëve, bejlerëve dhe agallarëve të vendit, ka vuajtur shpeshherë edhe për copën e bukës. Për këtë shkak disa nga bashkëfshatarët tuaj kanë qenë të detyruar të merrnin

rrugën e mërgimit, duke braktisur prindërit, gratë dhe fëmijët, me shpresë se kështu do të mund të siguronin jetën e familjeve të tyre. Prandaj në vitet e luftës për çlirimin e atdheut edhe fshati juaj iu përgjigj thirrjes së Partisë dhe u ngrit me armë në dorë për t'u çliruar një herë e mirë nga pushtuesit e huaj dhe nga shtypësit e brendshëm.

Me gjakun e mijëra e mijëra dëshmorëve që dha populli ynë në këtë luftë të shenjtë, duke përfshirë edhe dëshmorët e fshatit tuaj, u farkëtua Shqipëria e lirë socialiste, u përmirësua jeta e popullit punonjës që tani po ndërton me sukses jetën e re socialiste.

Ne gëzohemi shumë që punët në kooperativën tuaj shkojnë mirë, që ju keni realizuar me sukses angazhimet e marra për nder të 15-vjetorit të Çlirimit dhe që jeta juaj përmirësohet nga dita në ditë. Unë jam i sigurt se këto suksese do t'ju nxitin për të luftuar më me vendosmëri për suksese edhe më të mëdha, për ta bërë sa më të bukur e më të begatshme jetën tuaj, duke realizuar kështu qëllimin për të cilin derdhën gjakun e tyre dëshmorët e lirisë.

Në pamundësi për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të lapidarit, u dërgoj të gjithë kooperativistëve dhe kooperativistëve, gjithë popullit të fshatit tuaj përshëndetjet më të mira dhe ju uroj suksese të reja në punën e kooperativës, që të merrni sa më shumë prodhime bujqësore e blegtorale, të përmirësoni çdo ditë e më shumë mirëqenien materiale dhe nivelin kul-

turor, të plotësoni kurdoherë me nder detyrat që shtrohen nga Partia dhe pushteti, për të mirën tuaj dhe të të gjithë popullit tonë heroik e punëtor.

*Enver Hoxha*

«Dy popuj miq», f. 85

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË**

**1 tetor 1960**

Shoku Hysni,

1) Problemi shtrohet kështu: Në ç'rrugë duhet të ecë lëvizja komuniste ndërkombëtare në situatat aktuale dhe si ka ecur që prej Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e deri tash.

2) Ne mendojmë se janë bërë gabime të rënda parimore, taktike dhe strategjike, nga grupi i Hrushovit. Ky grup ka devijuar nga parimet marksiste-leniniste dhe ka shkelur Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të vitit 1957. Ky grup jo vetëm thelloi gabimet e veta, por bëri edhe Mbledhjen e Bukureshtit dhe akuzoi direkt Kinën dhe indirekt ne për dogmatizëm etj. Pra kinezët edhe ne do të luftojmë që të vërtetohen dhe të pranohen nga të gjithë tezat tona të drejta dhe

plus gabimi i madh i udhëheqjes sovjetike në Mbledhjen e Bukureshtit.

3) Grupi i Hrushovit dhe ata që ka komprometuar, mbrojnë tezën e kundërt. Ai në Bukuresht i rreshtoi pothuajse të gjithë ata që ishin të pranishëm atje dhe i bëri, të paktën udhëheqjet, të pranojnë se «Hrushovi s'ka gabuar dhe kinezët kanë gabuar, se Bukureshti ishte i nevojshëm dhe i drejtë».

4) Për ne, në Mbledhjen e ardhshme të Moskës [1960] duhet të gjitha problemet të zgjidhen. Kurse grupi i Hrushovit për qëllimet e tij i ka zgjidhur në Bukuresht. Në Mbledhjen e Moskës grupi i Hrushovit vjen, pra, me pikëpamjen se rruga dhe veprimet e tij kanë qenë të drejta dhe ne duhet të pranojmë një deklaratë, në të cilën të thuhet se ku duhet të shkojë lëvizja komuniste ndërkombëtare; por kush ka devijuar, kush ka faj dhe ç'përfaqëson Mbledhja e Bukureshtit, mbeten në heshtje, domethënë Kina mbetet e dënuar.

5) Tash të supozojmë se Deklarata e Mbledhjes së ardhshme të Moskës mund të rregullohet mirë dhe mund të caktojë rrugën e drejtë të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Një deklaratë e tillë do të jetë njëfarë kopje e asaj që adoptoi Mbledhja e Moskës më 1957. Po kështu, të supozojmë se komisioni, që është mbledhur aty për të përgatitur Mbledhjen e Moskës, e rregulloi deklaratën, por nuk sqaroi konkretisht kush ka devijuar dhe pse u dënua Kina në Bukuresht. Edhe

kështu po të ndodhë, qëllimi i drejtë yni nuk arrihet.

6) Qëllimi ynë dhe detyra jonë nuk qëndron në shtimin e koleksioneve të deklaratave, por në ndreqjen dhe në dënimin e gabimeve dhe kjo ka rëndësi, pse vetëm atëherë ka siguri që, qoftë Deklarata e vitit 1957, qoftë e reja, do të zbatohen drejt dhe në rrugën marksiste-leniniste.

7) Për grupin e Hrushovit, marksizëm-leninizmi, Deklarata e Mbledhjes së Moskës e vitit 1957 dhe e reja që do të dalë nga Mbledhja e ardhshme e Moskës, s'kanë asnjë vlerë. Pra, edhe po të përpiqemi ta bëjmë këtë të fundit të mirë, kjo s'ka asnjë vlerë pa u analizuar dhe pa u njohur nga ana e tyre gabimet. Prandaj mbledhja juaj të fillojë luftën kundër gabimeve dhe jo të mbetet vetëm në diskutimin e deklaratës. Deklarata të diskutohet nëpërmjet demaskimit të gabimeve të grupit të Hrushovit. Mund të mos arrihet në asnjë përfundim deri në konferencë. Pra, manovra u dështon.

8) Dokumenti i ri ka shumë dobësi, për atë do të flasim më vonë, por lëshimet e zbehta të grupit të Hrushovit kanë për qëllim të na vënë në gjumë dhe të mendojmë se me rregullimin e deklaratës u pritet rruga diskutimeve për gabimet e grupit.

9) Në Mbledhjen e Moskës ne do t'i shtrojmë problemet ashtu si thamë më lart, pse nga ana jonë problemi qëndron i tëri. Ne u kemi dhënë grupit të Hrushovit dhe gjithë partive një projekt-

deklaratë të drejtë, mbi bazën e së cilës kërkojmë të zhvillohen punimet. Ne do të dalim në mbledhje nga kufijtë e deklaratës, pse këtë e konsiderojmë si konkluzion të debateve që do të zhvillohen, kurse grupi i Hrushovit e konsideron ndryshe, synon të kundërtën. Shumë përfaqësues të partive të tjera në këtë mbledhje, në një mënyrë ose në një tjetër, janë që më parë të komprometuar, kush më shumë e kush më pak, dhe, duke u gjen-dur përpara një deklaratë të parapërgatitur mirë nga komisioni, do të habiten nga diskutimi ynë i drejtë, nga kritikrat tona të ashpra dhe të drejta, të cilat grupi i Hrushovit do t'i kundërshtojë, në pamundësi t'i ndalojë; dhe më në fund do të arrihet në konkluzion që ne s'jemi dakord me grupin e Hrushovit dhe me përkrahësit e tij, por me projektdeklaratën e parapërgatitur jemi dakord.

10) Nga një anë ne arrijmë në mosmarrëveshje, pse grupi i Hrushovit s'pranon kurrë gabimet dhe, nga ana tjetër, Mbledhja e Moskës do të na vërë përpara çështjen: e firmosni këtë deklaratë, që është e drejtë (por ku nuk flitet se kush ka gabime në vijë etj.), apo nuk e firmosni? Po ta firmosim një deklaratë të tillë me gabime parimore dhe pa arritur qëllimin tonë që të vihen mirë në dukje gabimet e grupit të Hrushovit, atëherë ky grup ka triumfuar dhe Kina mbetet e dënuar. Po të mos e firmosim, u japim një armë tjetër grupit të Hrushovit dhe atyre që e pasojnë, për të na akuzuar që ne s'firmosim një deklaratë të drejtë.

Kjo përbën një taktikë të menduar mirë nga

grupi i Hrushovit. Kjo taktikë është përpunuar me siguri nga i gjithë grupi i sovjetikëve dhe i Zhivkos me shokë, të cilët kanë dijeni që më parë për këtë material. Prandaj, bëni përpjekje të ndreqni deklaratën, sipas pikëpamjeve tona. Po s'u bë kjo, atëherë dalim në rrugën që u shpjegua më lart dhe që ka rreziqe.

Në deklaratën e përpunuar drejt të njihen gabimet e grupit të Hrushovit dhe të dënohen qëllimet e tij në Mbledhjen e Bukureshtit. Grupi i Hrushovit s'i pranon gabimet, dokumenti do të mbetet pezull dhe pra, çdo gjë do të vendoset pas diskutimeve në mbledhje.

Si përfundim, këto janë disa ide të para. Ju vetë reflektoni dhe veproni sipas vijës së drejtë të Partisë sonë, sipas udhëzimeve që ju ka dhënë dhe ju jep Byroja Politike. Na vini edhe ne në korent.

Për vërejtjet e materialit po punojmë dhe, me sa mundësi që kemi, do t'ju ndihmojmë.

Shumë të fala ty, Ramizit e gjithë shokëve.

*Enver*

*Vepra, vëll. 19, f. 283*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË**

**4 tetor 1960**

I dashur shoku Hysni,

Letrën e mora sot në mëngjes dhe i kuptova pikëpamjet tuaja dhe të shokëve kinezë në lidhje me çështjen. Të gjitha këto përputhen në përgjithësi me tonat.

Jam dakord me taktikën që duhet të ndiqni dhe që propozoni, pse në përgjithësi koincidon me sa ju shkrova. Mendoj edhe unë se është e drejtë. Vetëm sikundër kemi biseduar kur ike nga Tirana, në komision mos i hap të gjitha bateritë, rezervo ato çështje të cilat thamë se do t'i përdorim në Mbledhjen e Moskës.

Pra edhe një herë ju do të luftoni që Deklarata e Mbledhjes së Moskës të bëhet sa më e fortë, me barut dhe jo me pambuk, dhe të përmbajë çështjet të formulara drejt, sipas pikëpamjes

sonë dhe të kinezëve dhe jo pikëpamje ekuivoke e të shpëlara siç do të përpiqen të vënë sovjetikët, domethënë oportuniste dhe revizioniste.

Ju duhet të keni parasysh një gjë, që me anë të deklaratës ne jo vetëm të shprehim pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë mbi problemet, por çdo komunist në botë, kur ta këndojë këtë dokument, të kuptojë përnjëherë se «në konfliktin ideologjik», që trumbetoi në kamp dhe jashtë kampit grupi i Hrushovit, ky humbi dhe u dënua kursi i tij revizionist. Këtë gjë ta kuptojnë duke lexuar deklaratën, në radhë të parë, anëtarët e atyre partive ku çështjet u shtruan në mënyrë shpifarake dhe Partia Komuniste e Kinës e Partia e Punës e Shqipërisë u dënuan padrejtësisht dhe u hodh baltë kundër tyre. Kjo ka shumë rëndësi, pse shpifësit as kanë kurrë ndër mend të rikthehen në partitë e tyre dhe të bëjnë autokritikë. Prandaj varet shumë nga diskutimet tuaja që do të zhvilloni aty, varet shumë nga formulimet që do të propozohen nga ju. Prandaj u vini shumë kujdes formulimeve të çështjeve kryesore dhe kini parasysh mos u qëndroni caqeve të tekstit sovjetik dhe formës që ata i kanë dhënë shtruarjes së një problemi. Me këtë dua të them mos u përpiqni të rregulloni çështjen mbi frazën e ndërtuar nga sovjetikët ose të mos prishni «kuadrin» e përgjithshëm ose të pjesshëm të strukturës së tekstit sovjetik. Një mënyrë ndërtimi e tillë do t'ju pengojë në formulimin e ideve siç i konceptojmë ne, sepse sovjetikët e kanë ndërtuar atë

tekst konform pikëpamjeve të tyre, janë zgjeruar në disa vende për të futur një copë helm, ose helm-in e kanë shpërndarë në një «tiradë» të tërë, ku kanë hedhur rrugës edhe një çikë pluhur sheqeri. Prandaj as mos çani kokën për strukturën dhe për ndërtimin e tekstit sovjetik, ju preokupohuni për problemet kyç, hiqni ato që janë lakra dhe profka, pastaj Sekretariati le ta ndreqë strukturën e Deklaratës.

Deklarata, sipas mendimit tim, qelbet në çështjet kryesore dhe është ashtu si mendoni edhe ju. Unë e lexova një herë me kujdes dhe duke e lexuar kam bërë edhe shënime përbri tekstit. T'i përmblihdhja të gjitha këto vërejtje e t'i përpunojta, s'më premtonte koha. Kështu që vendosa t'ju dërgoj tekstin ku kam bërë shënimet. Mos mendoni se çdo shënim në atë tekst është xhevahir, atje ka plot gjëra të tepërta, të shpejtuara, të bëra nën presionin e zemërimit, prandaj i shikoni vetë, më tepër qëllimi është për t'ju kujtuar diçka që mundet s'ju ka rënë në sy juve dhe më ka rënë mua e *vice versa*. Jam i sigurt se ju i keni nxjerrë ujë materialit sovjetik dhe të gjitha çështjet delikate i keni parë, prandaj nga ajo anë jam i qetë. Por, sidoqoftë, megjithëse do të hiqni ca keq për t'i lexuar shënimet e mia, se i kam shkarravitur, do të jem i kënaqur në rast se do t'ju ndihmojnë ndopak.

Në rast se keni ndonjë gjë të veçantë që të konsultohemi, më bëni radiogram. Për sa i përket fjalimit që do të mbani, do të jetë shumë mirë

të na dërgoni një kopje, siç e thoni edhe vetë, se mund t'ju ndihmojmë me ndonjë vërejtje qoftë me radiogram, qoftë duke ju kthyer tekstin me vërejtje, në qoftë se do të kemi të tilla dhe në qoftë se na premtan koha e kthimit të avionit.

Dakord jam që të flisni pas kinezit, domethënë nga e enjtja ose e premtja.

Kjo çështje<sup>1</sup> nuk është e ngutshme, do të kemi kohë ta diskutojmë kur të vini, por mua më duket se ajo që thonë shokët kinezë se e kanë planifikuar që kjo çështje të zgjidhet brenda 10-15 vjetësh, ka rreziqet e veta të mëdha.

Grupi i Hrushovit i ka rreshtuar në anën e tij një numër të madh partish, të cilat i kapi në befasi dhe i shfrytëzon në besimin dhe në dashurinë që kanë për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Do të jetë zor për këto parti dhe për këta komunistë që të kenë guximin e menjëhershëm të mbajnë qëndrim të prerë. Kjo është e vërtetë. Por bëhet shumë e rrezikshme ta lësh këtë çështje të zvarritet, pse revizionizmi do të bëjë punën e vet të tmerrshme, do të komprometojë njerëz dhe parti, do të zhvillojë demagogji të madhe me propagandë dhe me fonde materiale të mëdha. Brenda dhjetë vjetësh klika e Titos e shthuri fare partinë dhe komunistët e patriotët e vërtetë i rراس në burgje ose i vrau. Prandaj që-

---

1. Është fjala për pikëpamjen e udhëheqjes kineze, e cila, nën pretekstin e forcimit të pozitave të përgjithshme të Kinës, këmbëngulte për të mos dalë hapur kundër revizionistëve hrushovianë.

ndrimi më i drejtë është që në këtë mbledhje t'i vemi çështjes deri në fund, si marksistë. Të dalë lakuriq kush është në rrugë antimarksiste, kush po e tradhton marksizëm-leninizmin dhe po shkel Deklaratën e Moskës të vitit 1957. Ky është grupi i Hrushovit. Prandaj mbledhja t'i vërë pikat mbi i. Të vihen pikat mbi i mbi Bukureshtin dhe ata që kanë bërë gabime, t'i njohin këto në mbledhje si marksistë dhe të shkojnë në partitë e tyre t'i korrigjojnë. Grupi i Hrushovit nuk do t'i pranojë gabimet, atëherë ai është shkaktar i përçarjes së unitetit ideologjik të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ne jemi në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Grupi i Hrushovit ka devijuar në revizionizëm, prandaj do ta demaskojnë lufta jonë dhe koha. Por ka një gjë veç, se kërcënimi dhe përçarja do të shpejtojnë procesin e falimentimit të grupit të Hrushovit dhe izolimin e tij nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë e tjera, të cilat do të tronditen dhe do t'i vënë më mirë dhe më shpejt gishtin kokës. Ndryshe, këto parti e heqin veten si jashtë konfliktit, bile e quajnë si një sukses që nuk u arrit përçarja, ia lënë kohës ta vërtetojë drejtësinë e vijës sovjetike apo të vijës sonë. Parulla që «vijën ta vërtetojë koha», që i vjen për osh Hrushovit, është parullë oportuniste, revizioniste dhe antimarksiste. Ajo përmban në vetvete frikën për mos me u shkue gjërave deri në fund dhe për mos me i shërue rrënjësisht gabimet. Ky mendim shërben për të mbajtur statukuonë hrushoviane me disa arnime,

të cilat as i ka peshuar, as i peshon dhe as do t'i peshojë fare Hrushovi. Kjo parullë u jep dorë revizionistëve të veprojnë më tej, të përhapin revizionizmin. Me një fjalë, po të adoptohet kjo parullë, duhet të jemi të bindur se ka rreziqe të mëdha.

Revizionizmi është rreziku kryesor, duhet goditur, sado të mëdha që të jenë «kokët» që e kanë brenda këtë sëmundje të qelbur. Absesi duhet pastruar me bisturi. Të gjithë ata që thonë «t'ia lëmë kohës» i kuptojnë situatat, por nuk e kanë guximin e revolucionarëve që t'i vënë gishtin plagës dhe të përdorin mjetet efikase për ta pastruar atë.

Nga ana tjetër, duhet të dimë se grupi i Hrushovit i trembet situatës së krijuar, i trembet përçarjes. Ai e sheh se politika e tij pëson disfata, se ka krijuar situata të rënda, jo të drejta, se ideologjikisht ai është me vetëdije të plotë në rrugën e greminës, pa shpresa. Pra, në këto situata, a na lejohet neve ta lëmë këtë grup revizionistësh të marrë frymë, të kapërcejë këtë hendek të madh që krijoi? Mua më duket se nuk duhet ta lejojmë. Do të bëjmë gabim po të mos e demaskojmë grupin e Hrushovit, sepse ky do të përfitojë për të dëmtuar më shumë Bashkimin Sovjetik, Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe komunizmin ndërkombëtar. Hrushovi është pehlivan pannaresh. Shihni se ç'bën në OKB. Vini re manovrën e fundit për Kinën, derisa edhe Pen Çeni t'i mbrojtë. Kjo është arsyeja që unë të bëra atë radiogram të gjatë parmbremë.

Por, sidoqoftë, i dashur Hysni, ju vazhdoni punën që keni zënë, drejt e keni. Sa për këtë çështje e diskutojmë më vonë, për «grushtin e fundit» në mbledhje. S'është e nevojshme ta bisedosh prapë me Ten Hsiao Pinin. Idenë ia hodhe, le të reflektojnë vetë dhe do të kemi më vonë kohë të bisedojmë me ta.

Viton e ke mirë, u grinë së mësuari me Nexhmijen<sup>1</sup>. Besnikun gjithashtu e ke mirë, e kisha për drekë të dielën.

Nga delegacioni ynë në Nju-Jork marr çdo ditë telegrame zbavitëse. Punët vazhdojnë si më parë. Asnjë rezultat konkret. As çarmatim, as riorganizim të Sekretariatit të OKB-së, as takim, as drej. Vetëm «suksesi» ka qenë krijimi i forcës së tretë me Titon dhe pagëzimi nga ana e «djadja» Hrushovit. Iniciativa kaloi nga duart tona, këtë detyrohen ta njojnë edhe vetë sovjetikët.

Ramizit dhe shokëve shumë të fala. Shokët këndej ju përshëndesin.

Ju përqafoj

*Enver*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

---

1. Shoqet Vito Kapo e Nexhmije Hoxha në atë kohë ndiqnin me korrespondencë studimet në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

## LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

7 tetor 1960

I dashur shoku Hysni,

Sot hapëm Plenumin, punimet shkojnë mirë, vazhdojnë diskutimet për reformën e shkollës. Diskutimet janë të mira. Nesër do të vazhdojmë me diskutimet e reformës dhe pastaj me direktivat e pesëvjeçarit.

Sot në drekë mora pakon me materialin që më dërgove, dhe e kupton se materialisht kam pasë shumë pak kohë, por me shpejtësi u hodha një sy letrave tuaja, fjalimit tënd si edhe riformulimeve dhe korigjimeve që do t'i bëni projektdeklaratës.

1. — Për sa i përket fjalimit tënd, në përgjithësi më pëlqeu, ishin prekur mirë problemet dhe toni ishte në rregull. Në qoftë se ju vjen rasti, qoftë në mbledhje plenare, qoftë Ramizi në komision, me mbrojt më fort Partinë Komuniste të

**Kinës** se lufta kryesore i bëhet asaj, **bateritë kryesore janë drejtuar kundër saj.** Ne na kanë mëri sa edhe kinezët, ata, s'ka dyshim, do të na sulmojnë edhe ne, por sulmi kryesor i tyre do të përqendrohet te Partia Komuniste e Kinës, pse, ata mendojnë, dhe ashtu është, rreziku më i madh, si potencial, për ta është Partia Komuniste e Kinës dhe mendojnë **po e mposhtën këtë, puna e shqiptarëve s'ka rëndësi për ta.**

Prandaj ne, tash për tash, jemi në pozita të paatakueshme, **por do të atakohemi pse mbajmë anën e Kinës** dhe pse, pra, kemi një vijë «dogmatike» me Kinën. Ne pra duhet t'u tregojmë sovjetikëve dhe përkrahësve të tyre, se **kemi një vijë marksiste-leniniste, se ne e mbrojmë Partinë Komuniste të Kinës, pse ajo ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste, në çështjet në fjalë, dhe luftojmë pikëpamjet revizioniste, oportuniste të djathta, shpifësit dhe falsifikatorët.**

Nga këto pozita **ne atakojmë të gjithë ata që do të guxojnë në mënyrë të maskuar ose haptazi të na sulmojnë.**

Ato parti, përveç atyre që dimë se janë në pozita të gabuara, që hezitojnë, që s'kanë kurajë të flasin hapët, që s'flasin për Partinë tonë, ose thonë ndonjë **fjalë pa zarar** për ne, mos i ngitni, **mos i hidhni në luftë të hapët me ne, manovroni. Sulmi të përqendrohet kundër kryesorëve që janë shkaktarët e deviacionit oportunist dhe sulmuesit e vijës sonë të drejtë.** Në qoftë se këto parti të dyta (jo sovjetike, bullgare etj.) sulmojnë

lehtë Partinë Komuniste të Kinës **pse s'bëjnë dot ndryshe, ju mos i ngitni**, lini kinezin të gjykojë vetë taktikën që duhet të ndjekë.

2. — Këndova fjalimin e kinezit, ai ishte, gjithashtu, sipas mendimit tim, në përgjithësi i mirë. I mirë mund të konsiderohet, por si një «prelud», që më pas duhet të shpërthejë si muzika e Bethovenit, se në rast se shpërthen jo me forcë, atëherë kthehet në serenatë nokturne. Aty i ngre drejt çështjet, asgjë s'i ka shpëtuar syrit të tij, i vë në dukje kthesat, ose më mirë zbythjet e sovjetikëve, pastaj dhe djallëzitë e tyre. Toni si i shtron, është si me thënë pajtues, jo lëshues, por në rast se **sovjetikët kanë interes t'i mbyllin gjërat, t'u vënë kapakun qelbësirave të tyre, pse nuk është në interesin e tyre hëpërhë që t'i thellojnë, atëherë ata kanë një okazion të mirë të kapen nga fjalimi i Ten Hsiao Pinit**, të bëjnë korrigjimet e kërkuara, në një formë ose në një formë tjetër, dhe s'ke pse bën debate e diskutime. «Jemi dakord». Meqenëse «shoku Ten Hsiao Pin s'do të polemizojë atëherë ne (thonë sovjetikët) të krijojmë konditat që të mos polemizojë as në komision». Ata kanë praktikën, me çështjen e **propozimeve të Dë Golit**, për çështjen e raketave, që ia pranuan propozimet e tij, por Dë Goli lëvizi. Atëherë shpejt e bëri barazimin Kozllovka dhe thotë «është aqik, ju propozoni, ne pranojmë, por në fakt ju kinezët s'keni ardhur që të merremi vesh, por të na sulmoni». Mundet që gabohem në vlerësimin që bëj, qoftë për sa i përket tonit të fjalimit të kine-

zit, qoftë të manovrës që mund të lozin sovjetikët. Ta thashë edhe në fillim që vetëm sa u hodha shpejt e shpejt një sy materialeve. Kurse fjalimi yt, nuk ua jep këtë mundësi sovjetikëve, pse andej del hapët që «kemi hesape për të larë».

3. — Lexova, gjithashtu, formulimet e vërejtjeve të projektdeklaratës. Mua më duken të mira. Konsultohuni dhe bashkëpunoni me kinezët. Përse sovjetikët të bëjnë një punë të koordinuar dhe ne jo?

Unë vetëm do të thosha të rishikoni edhe një herë formulimet e «kalimit në socializëm» që të dalë më mirë fryma e pikëpamjes sonë. Ju kujtoj edhe një herë çështjen e «kultit», duhet të formulohet në një mënyrë tjetër, se në nëntor do ta prekim në lidhje me Stalinin dhe qëndrimin e Hrushovit. Në një vend flitet për «fraksione» shiheni edhe një herë se mos është vënë me djallëzi; pastaj edhe një vërejtje të fundit: në faqen 27 paragrafi 2 i projektdeklaratës së shtypur në Tiranë ose në faqen 14 të formulimit tuaj duhet të dalë ideja e Leninit: «... derisa borgjezia nuk pengon lëvizjen punëtore dhe pararojën e saj në luftën e saj ideologjike, politike dhe ekonomike...» (ky është citat i Leninit, por ideja që duhet shtuar atje e kam fjalën te Nehru, Sukarno e të tjerë, dhe ndihmën që u japin sovjetikët).

4. — Është e zorshme të të them se çfarë t'u hedhësh në fytyrë e çfarë të mos u hedhësh. Kjo varet nga situatat. Ti shko nga parimi, mbro Partinë dhe vijën e saj pa druajtje, pa hezitar:

«ta them këtë ose ta rezervoj?». Si ta gjykoshe vetë. Ti duhet **kundërshtarin ta demaskosh me argumente të drejta dhe ta dërrmosh.** Për këtë mund të të mjaftojë vetëm një fakt i përdorur me kohë, dhe me vend, që ai (kundërshtari) të bjerë me fytyrën në pluhur. Prandaj **mos i lidh duart dhe mos u preokupo se mos bësh ndonjë gabim.**

Çështja vetëm është këtu, që disa gjëra t'i ruanim se mund të bëjnë efekt më shumë në Mbledhjen e Moskës sesa në komision dhe sovjetikët do të përpunonin taktikën për kundërsulm po t'i dinin.

**Bullgarëve, rumunëve dhe polakëve, numërojuara pa hezitim, se ata janë bythë e brekë me sovjetikët.** Edhe të tjerët atje vërtiten, por shih e bëj. Më i rezervuar ji me çekët, në rast se nuk na sulmojnë, ta them këtë se Novotni u soll mirë me tanët në Nju-Jork. Dhe hungarezët nuk tregohen aktivë, me sa dimë ne, pavarësisht nga fjallimi i tyre atje.

Francezët, derisa hezitojnë, ngacmoi, u thoni në forma të ndryshme, «**Ku po shkoni?** Ne e ndiejmë që ju i kuptoni ku janë gabimet, dhe duhet të ndihmoni që të mos bëhen gabime akoma më të rënda» etj., etj. Përpiquni në këtë drejtim.

Informatë e sigurt është se ç'do të shtrohej në Bukuresht, (udhëheqësit e partive komuniste e punëtoresh të kampit, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Kinës, i dinin, sepse Hrushovi ishte konsultuar me ta. **Pra Bukureshti ishte organizuar që më**

parë në prapaskenë si fraksion ndërkombëtar (këtë argument mund ta ruajmë për në Mbledhjen e Moskës). Tjetër ç'të të them, punë të mbarë. E di që lodheni dhe vuani nga «akulli» por s'kemi ç'bëjmë, lufta për të drejtën, s'ta shtron fushën me lule, por kur lufton për Partinë, për popullin, për komunizmin, s'ka as lodhje as mërzë. Shokët shkuan në «prijom» te gjermanët, unë nuk shkova, se të shkrova këtë letër që të ta çoj nesër me avion. S'vajta te gjermani në pritje edhe për t'u lënë të kuptojnë se s'na erdhi mirë që nuk erdhi delegacioni i tyre për të kthyer vizitën zyrtare, megjithëse e kishin vendosur datën dhe përbërjen. Ata dhanë arsye të kota për mosardhje, por arsyet janë ato që dimë e për të cilat luftoni ju atje.

**Në OKB «fiasko». Me F të madhe. Delegacioni ynë nisët nga Nju-Jorku më 11 tetor dhe arrin në Tiranë më 20-21.**

Më 25 tetor mbledhim Kuvendin Popullor, pse duhet sipas Kushtetutës, dhe me këtë rast do të flitet për «triumfin e çarmatimit dhe të bashkëzistencës së Rrapo Lelos në OKB». Ramizit i bëj shumë të fala.

Ju përqafoj me mall

*Enver*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR NAFTËTARËVE DHE EFEKTIVIT TË REPARTEVE TË AVIACIONIT**

*Qyteti Stalin*

**7 shkurt 1961**

Të dashur shokë,

Lajmi juaj mbi prodhimin e lëndës djegëse për aviacionin tonë reaktiv na gëzoi shumë. Ky sukses i ri i specialistëve të naftës dhe të regjimentit të aviacionit në pragun e Kongresit të 4-t të Partisë sonë të dashur është një fitore e rëndësishme në forcimin e ekonomisë dhe të aftësive luftarake të ushtrisë sonë të lavdishme, për mbrojtjen e kufijve ajrorë të atdheut tonë socialist.

Partia jonë e Punës e ka çmuar gjithmonë shumë kontributin e punonjësve të industrisë së naftës për ndërtimin socialist të vendit. Përfundimi me sukses i provave për prodhimin dhe për përdorimin e lëndës djegëse reaktive për aviacionin është një shembull i ri i patriotizmit të lartë të naftëtarëve, i dashurisë që ata ushqejnë

për Partinë e Punës dhe për Ushtrinë tonë Popullore, që lindi në betejat e ashpra të luftës kundër okupatorëve dhe kundër tradhtarëve të vendit. Ai është fryt i bashkëpunimit krijues e të ngushtë midis specialistëve të naftës dhe të aviacionit tonë ushtarak, i cili e ka burimin në punën e madhe që ka bërë Partia për edukimin komunist të punonjësve, të cilët nuk kursejnë asgjë për të mirën e atdheut dhe të popullit, për forcimin e ushtrisë sonë që është rojë vigjilente e pavarësisë dhe e tërësisë tokësore të Shqipërisë, e fitoreve të mëdha që ka korrur populli ynë në ndërtimin socialist.

Duke ju përshëndetur nxehtësisht dhe duke ju përgëzuar nga zemra për këtë sukses, u uroj gjithë punonjësve, inxhinierëve dhe teknikëve të industrisë së naftës fitore më të shkëlqyera në punë, për të prodhuar sa më shumë produkte të reja naftë të nevojshme për ekonominë tonë popullore!

I uroj gjithashtu gjithë efektivit të reparteve të aviacionit suksese më të mëdha në përgatitjen luftarake për mbrojtjen e kufijve të shtrenjtë të Republikës Popullore të Shqipërisë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 20, f. 34*

## TELEGRAM DËRGUAR KOMISIONIT PËR KREMTIMIN E 18-VJETORIT TË FESTËS SË BREGDETIT

*Piqeras—Sarandë*

Duke ju përshëndetur nxehetësisht dhe duke  
10 qershor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe,  
të reja naftë të nevojshme për ekonominë tonë

Ju dërgoj përshëndetjet më të nxehta me  
rastin e 18-vjetorit të festës suaj, në të cilën ju  
do të përkujtoni përpjekjet dhe luftërat që ka  
bërë populli patriot i Bregdetit, nën udhëheqjen  
e Partisë sonë të lavdishme, kundër okupatorëve  
dhe tradhtarëve të atdheut.

Populli i krahinës së Bregdetit, i udhëhequr  
nga Partia e tij e dashur dhe duke ndjekur me  
besnikëri mësimet e saj të urta, pas Çlirimit ka  
korrur suksese të mëdha në ngritjen e ekonomisë  
dhe të kulturës. Ai përqafoi rrugën e ndritur të  
kolektivizimit dhe tani, duke i forcuar çdo vit e

më shumë kooperativat bujqësore, ka arritur suksese të mëdha në përmirësimin e mirëqenies së tij materiale e kulturore.

Populli i Bregut, si i gjithë populli ynë, krahas punës paqësore ka rritur vazhdimisht vigjilencën e tij revolucionare kundër armiqve të lirisë, pavarësisë së atdheut dhe ndërtimit të socializmit në Shqipëri, imperialistëve dhe kryesisht atyre amerikanë, monarko-fashistëve grekë dhe revizionistëve modernë, në radhë të parë atyre të Beogradit.

Duke mos pasur mundësi të marr pjesë në këtë festë të gëzueshme, ju dërgoj me këtë rast, të dashur shokë dhe shoqe, urimet më të përzemërta për suksese të reja akoma më të mëdha në forcimin e ekonomisë kooperativiste, në zhvillimin e mëtejshëm arsimor e kulturor dhe në lulëzimin e gjithanshëm të krahinës së bukur të bregdetit jugor të atdheut tonë të mrekullueshëm.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA<sup>1</sup>**

**1 qershor 1962**

Shokut Hysni dhe Ramiz,

Taktika hrushoviane, siç duket nga shumë shfaqje publike zyrtare, është që në mbledhje e në konferenca të mos mbahet nga vendet e demokracisë popullore, e kam fjalën për ato vende që e pasojnë klikën e Hrushovit, një qëndrim i njëjtë për shumë probleme. Bile këto ditët e fundit, në mbledhje zyrtare ndërkombëtare me shtete kapitaliste, Ukraina të votojë në kundërshtim me Bashkimin Sovjetik, Bjellorusia jo vetëm të mos votojë si vendet e tjera, por të abstenojë. Pa lere

---

1. Këtë radiogram dhe disa të tjera shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia i mörën gjatë udhëtimit me vapor. (Shih shënimin 1 të faqes 87 të librit: Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. 1.)

Polonia dhe Çekoslovakia! Karakteristike janë këshillat publike që jepen për konferencën e paqes e çarmatimin nga sovjetikët. Në mes tjerash thuhet se cilido mund të ketë mendimin e vet dhe ka të drejtë ta shprehë atë. Të gjithë duhet të sulmojmë ata që mendojnë se lufta mund të mos ndalet etj.

Këtej, mund të nxjerrim konkluzionin se hrushovianët jo vetëm çajnë unitetin e mendimit dhe të veprimit, por qëllimi tjetër është të zvogëlojnë efektin kolosal që do t'u shkaktojë humbje e demaskim, qëndrimi i vendosur i Shqipërisë etj. mbi problemet ndërkombëtare dhe mënyra e drejtë që ne do t'i shtrojmë ato. Pra hrushovianët, me këtë taktikë të re, duan të zvogëlojnë efektin e mosmarrëveshjeve, të predikojnë që tash dhe të përgatitin opinionin, se mund të ketë opinione të ndryshme, dhe kjo s'ka asnjë rëndësi. Këtë taktikë duhet ta keni parasysh në bisedime me kinezët. Një taktikë të tillë hrushovianët mund ta përgjithësojnë edhe në mbledhjet eventuale të partive komuniste e punëtore. Pra t'i shndërrojnë këto mbledhje në tavolina të rrumbullakta, si ato që organizon Axhubei e Erenburgu me kapitalistët, ose Toliati dhe Amendola me gazetarët borgjezë në televizion. Gjithsecili, thotë pikëpamjen e tij dhe ku ishe? Asgjëkundi.

Ne duhet ta demaskojmë këtë taktikë përçarëse të hrushovianëve dhe me unitetin tonë ideo-

logjik, politik dhe të veprimit t'i qëndrojmë përballë atyre. Shokëve kinezë ua shfaqni këtë opinion.

Ju përqafoj

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA**

**2 qershor 1962**

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Ngritja e çmimeve të mishit, të qumështit dhe të derivateve të tij, tregon disfatën e madhe të politikës bujqësore të hrushovianëve, të cilët janë hequr deri tash si të vetmit dhe më të mëdhenjtë specialistë në botë për çështje bujqësore. Ç'nuk thanë ata në këtë drejtim kundër Stalinit dhe metodave të punës në kolkoze. Gjithçka bëri Stalini për bujqësinë pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas tërë atyre shkatërrimeve kolosale që pësoi bujqësia, qeni Hrushov, mund të themi, i shkatërroi. Me reformat revizioniste që ata kanë bërë në bujqësi, po shkojnë drejt anarkisë, po futen gjithnjë e më thellë në rrugën e Titos dhe do të arrijnë deri aty sa të kërkojnë kredi nga Amerika. Politikisht Hrushovi favorizon fshatarët dhe përçan aleancën me klasën punëtore. Ai është

nrjē narodnik, një buharin i kohëve të sotme. Sigurisht nga brenda do të ketë rezistencë sidomos nga punëtorët dhe nga pjesa e ndërgjegjshme e inteligjencies. Nuk duhet shkëputur kjo çështje edhe me rezistencën në ushtri. Për këtë gjë shihni «Krasnaja Zvezda» ku shkruhet për një mbledhje me kuadrot e ushtrisë dhe ku hrushovianët u detyruan të njohin gabimet që kanë bërë me kuadrin oficer. Por për të gjitha këto fajin ia hodhën drejtorit politik, Golikov. Nga kjo ne duhet të nxjerrim si konkluzion se pozitat e tyre në ushtri po dobësohen dhe Hrushovi bën manovra të shpëtojë. Emërimi si drejtor politik i Jepishevit që s'ka asnjë vlerë për atë vend, është vënë me qëllim, mendoj unë, për të qetësuar amerikanët dhe për t'u thënë atyre se duke vënë një njeri të dekoruar nga Titoja të mos kenë frikë nga pakënaqësitë në ushtrinë sovjetike, stalinistët nuk do t'i lërë të marrin fuqinë.

Mund të konkludojmë, se kriza në bujqësinë sovjetike nuk është shkaktuar nga fatkeqësitë e natyrës, por nga fajet dhe vija revizioniste e Hrushovit, i cili së bashku me grupin e tij propaganduan dhe blufuan për bollëk, për të bërë destalinizimin dhe për të zhvilluar dhe forcuar revizionizmin, jo vetëm në vijën e bujqësisë, por edhe në të gjithë sektorët.

Problemin e mbrojtjes, Hrushovi e ka dobësuar me teoritë e tij antistaliniane të taktikës e strategjisë dhe me masat e spastrimit, kjo natyrisht s'mund të dihet me saktësi, duhet të ketë

blofe edhe në çështjen e armatimeve. Që Bashkimi Sovjetik është i armatosur, s'ka dyshim, por ashtu si gërthet Hrushovi, si mburret ai, mund të blofojë, mbasi jo vetëm që s'është njeri serioz, por mbi të gjitha, është një pacifist, që ecën drejt puthjes me amerikanët. Renegati Hrushov s'ka asnjë arsye të armatoset në shkallën e nevojshme që e lypin situatat po të gjykohen ato si leniniste. Kjo është shumë serioze për të ardhmen. Por ne kemi shpresë te popujt sovjetikë dhe te komunistët e vërtetë sovjetikë. Besojmë se ata i shohin këto tradhti të mëdha që bëhen. Keq na vjen për popullin sovjetik, por le t'u shërbejnë disfatat që po pësojnë, jo për fajin e ndokujt tjetër, dhe të vënë mend, se kanë përgjegjësi kolosale përpara historisë. Bisedoni për këto çështje me kinezët, rrihni mendimet dhe të mos u zbutet atyre zemra dhe të marrin ndonjë masë apo veprim, që të ndihmojnë këtë tradhtar të mbytur për ta nxjerrë nga balta. Asnië mëshirë, por ta futim më thellë në baltë, pse kështu ndihmojmë popujt vëllezër sovjetikë dhe komunizmi të triumfojë në botë.

Ju përqafoj

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA**

**2 qershor 1962**

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Tregu i Përbashkët Evropian bëhet me qëllim që të forcojë prapavijat e NATO-s dhe të imperializmit, i cili përgatit luftën, bëhet njëkohësisht, të dobësojë kampin e socializmit dhe të fuqizojë akoma më shumë veprën tradhtare përçarëse të Hrushovit. Tash Hrushovi u detyrua të thotë një fjalë kundër Tregut të Përbashkët Evropian dhe propozimi për të krijuar gjoja me anën e OKB-së një organizatë tregtare ndërkombëtare është demagogji. Këto janë përralla për të nanuritur dhe për t'u marrë me mbledhje e me diskutime të pafund dhe pa asnjë rezultat, ose të cilat kanë vetëm një rezultat, që gjatë kohës së pallavrave, Tregu i Përbashkët të forcohet, të konsolidohet, të organizohen prapavijat e armikut dhe Hrushovi të thellojë përçarjen në kamp

dhe të krijojë kaos në ekonominë botërore socialiste.

Anëtarët e Këshillit Ekonomik janë si gërthelat ose karavidhet, të gjithë ia kanë njëri-tjetrit me lesh në bark dhe gjithsecili tërheq nga ana e tij për fitime më të mëdha. Ndjenja internacionaliste dhe ndihma vëllazërore nuk mund të ekzistojë në mes tyre në kuptimin marksist dhe koordinimi i planeve bëhet nën diktatin e vijës revizioniste, shoviniste.

Çekosllovakia, në radhë të parë do të vuajë pa masë nga Tregu i Përbashkët, sepse ajo është e lidhur ngushtë me të deri edhe te qepa. Bashkimi Sovjetik, s'është në gjendje, ose nuk do të dojë, pa e nënshtruar mirë t'ia zëvendësojë tregjet kapitaliste që Çekosllovakia mund të humbasë. Ç'do të bëjë Çekosllovakia? Me këta njerëz revizionistë, që ka në krye, ajo do të devijojë dhe do të bëjë tregti me parimet. Për Poloninë e Gomulkës as që është nevoja të zgjatemi. Ajo ka marrë, merr dhe do të marrë kredi nga Amerika dhe shkon në rrugën jugosllave, ajo zaten është plotësisht në këtë rrugë. Ulbrihti, që do të rrojë në kurriz të të tjerëve, kërkon kredi nga Adenaueri, do të kërkojë edhe nesër duke bërë lëshime dhe tregti me parimet. Hrushovi, i inkurajon dhe do t'i inkurajojë në këtë drejtim. Ai, si revizionist që është, ka në plan të likuidojë kampin socialist, të heqë qafe barrën që tash mund të ketë mbi supe, të bëjë një politikë ekonomike më in-dipendente, të lërë partnerët e tij të veprojnë më

të lirë me perëndimorët, gjithmonë në bazë të vijës revizioniste që kanë përcaktuar, dhe çdo marrëdhënie në mes tyre të bazohet në marrëveshjet dhe traktatet në kuptimin borgjez të fjalës. Sigurisht klika e Hrushovit do të jetë vigjilente, që satelitët e saj të mos e kalojnë masën e «independencës» që i ka caktuar ajo dhe shovinizmi i shtetit të madh do të vazhdojë të luajë rolin e tij dominues, organizues dhe drejtues.

Grupi i Hrushovit, përpara kërcënimit të Tregut të Përbashkët, as që vepron për konsolidimin e ekonomive tona socialiste. Fakt është lufta ekonomike që i bën Shqipërisë.

Duhet të konkludojmë se është e ngutshme të veprojmë në të gjitha drejtimet. Revizionistët po veprojnë me furi dhe veprimtarisë së tyre i kanë hedhur një vello të hollë që quhet «të bisedojmë», «të merremi vesh», «të shohim përpara» e të tjera përralla për naivët. Naivë s'duhet të jemi. Bisedojini këto ide me kinezët. Ç'mendojnë ata, ç'kundërmasa kanë marrë? Vallë s'ka ardhur koha që të fillojë të fryjë era e të ngrihet në uragan? Unë mendoj se po. Ç'po pritet me këtë heshtje. Heshtja s'nxjerr asgjë të mirë.

Ju përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA**

**15 qershor 1962**

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Morëm radiogramin e fundit tuaj dhe kuptojmë insistimin e Tenit për të na bindur të marrim pjesë në mbledhje, pa kondita.

Ju mos lëvizni nga pikëpamjet tona, mbi këtë çështje kyç. Ne nuk vemi në mbledhje, në qoftë se grupi i Hrushovit nuk pranon publikisht gabimet, domethënë të pranojë konditat tona.

Arsyet e kinezëve, për vajtje në mbledhje pa kondita, janë pa baza, të dobëta, s'qëndrojnë në këmbë dhe kontradiktore. Kjo tregon një dozë të theksuar oportunitizmi dhe një dëshirë të pamohueshme për ulje tensioni, deri në njëfarë pajtimi provizor.

Ne nuk mund të pranojmë një gjë të tillë.

Kinezëve nuk do t'u interesojë të venë në

mbledhje pa ne, për arsye se vajtja pa ne është një humbje politike për ta në sytë e komunistëve të vërtetë, të bërthamës revolucionare, siç thonë ata. Pozitat tona janë të drejta dhe në asnjë mënyrë nuk tërhiqemi prej tyre. Në rast se ne bëjmë gabim dhe pranojmë të vemi në mbledhje pa kondita, pavarësisht se tani thuhet se Hrushovi nuk bën mbledhje me ne, atij do t'i bëhen nga turli miqsh në thonjëza, premtime për lëshime në parime dhe në kurrizin tonë. Hrushovi kuptohet që do të pranojë. Prandaj ne nuk duhet të lëshojmë asnjë çikë në këtë drejtim. Kinezëve mund të mos u vijë mirë, por më vonë do ta kuptojnë se sa drejt e kemi pasur. Ju ruani miqësinë, mbledhjet të vazhdojnë me ton shoqëror e të sinqertë, pavarësisht se në këtë çështje kemi pikëpamje jo të njëjta. Prandaj përpiquni t'i bindni në drejtësinë e pikëpamjeve tona. Kinezëve sigurisht nuk do t'u vijë mirë për çështjen që do të flasim me rastin e Kuvendit Popullor<sup>1</sup>, pse u prishen planet, por hrushovianët ishin të parët që na sulmuan, përveç gazetave çeke, bullgare, të cilat vazhdojnë të na sulmojnë. Prandaj për këtë s'ka rrugë tjetër, ne do të mbrojmë çështjen tonë të drejtë. Çudi na vjen që Liu<sup>2</sup> nuk ju ka pritur akoma. Ata siç duket presin që bisedimet të ma-

1. Sesioni i parë i legjislaturës së pestë të Kuvendit Popullor u mbajt më 14 korrik 1962. Në këtë sesion u shpreh edhe një herë vendosmëria e PPSH për të mbrojtur deri në fund marksizëm-leninizmin në luftë me revizionistët e çdo lloji.

2. Liu Shao Çi, në atë kohë kryetar i RP të Kinës.

rrin njëfarë rruge, por megjithatë, kjo s'është arsye e shëndoshë. Mund t'ju priste që në fillim pastaj të fillonin bisedimet. Por s'ka gjë mos e vini re.

Çdo gjë këtej shkon mirë.

Përçafime

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR**

### **SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA**

19 qershor 1962

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Ambasada jonë në Berlin na njoftoi dje se Partia e Ulbrihtit i ka dhënë përgjigje Partisë Komuniste Kineze për mbledhje, ku i thotë se gjermanët nuk do pranojnë një mbledhje ku të diskutohen marrëdhëniet në mes Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në përgjigje ai sulmon, gjithashtu, edhe për Konferencën e Stokholmit<sup>1</sup>. Siç e shikoni kjo

---

1. Konferenca e Stokholmit u zhvillua në dhjetor të vitit 1961. Delegacioni sovjetik mbajti një qëndrim antimarksist lidhur me problemet e çarmatimit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve për pavarësi e çlirim kombëtar. Veç të tjerash, ai refuzoi me këmbëngulje të madhe që të futej në rendin e ditës të Kongresit të ardhshëm Botëror për Çarmatimin e Përgjithshëm dhe Paqen problemi i luftës së popujve të ro-

forcon pozitat tona dhe dobëson argumentet e kinézëve. Këta mund të kenë marrë nga partitë komuniste e punëtore të Evropës edhe përgjigje të tjera të këtij lloji. Interesant do të jetë, do t'ju vënë në korent për këtë të gjermanëve apo jo. Ju mos pyesni.

Nga të dhënat e deritanishme, mund të konkludojmë se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik në letrën e vet nuk shprehet as po, as jo për mbledhje, por në 40 faqe bën procesin tonë. Kurse gjermanët dhe të tjerët si këta as që tregohen të preokupuar për ndonjë mbledhje. Revizionistët e dinë pikëpamjen tonë për mbledhje, mund t'u ketë rënë erë për diskutimet që po bëni ju dhe filluan me letrën e Ulbrihtit sulmin kundër pikëpamjeve tona. Revizionistët dinë, gjithashtu, fare mirë pikëpamjet për mbledhje të partive të treta<sup>1</sup>, pikëpamje që synojnë në kompro-

---

bëruar kundër kolonializmit, për pavarësinë kombëtare.

Ky qëndrim i delegacionit sovjetik revoltoi me të drejtë jo vetëm revolucionarët komunistë, por edhe shumë delegatë jokomunistë të vendeve të Azisë, të Afrikës e të Amerikës Latine, të cilët kundërshtuan me forcë pikëpamjet e delegacionit sovjetik.

1. Në fillim të vitit 1962 tri parti komuniste, ajo indoneziane, vietnameze dhe neozelandeze, duke u përpjekur të ishin në rolin e një të treti, propozuan të bëhej një mbledhje e partive komuniste e punëtore të botës, që, sipas tyre, do të kishte për qëllim forcimin e unitetit në lëvizjen komuniste botërore. Në këto parti, siç theksonte Partia jonë, mbizotëronte dëshira sentimentale e «unitetit për unitet». Me këtë tezë pajtohej edhe Partia Komuniste e Kinës.

mise. Është interesante ç'qëndrim do të mbajnë kinezët karshi këtyre shantazheve, të cilat nga njëra anë vërtetojnë tezat tona, nga ana tjetër u thonë kinezëve që në rast se vazhdoni të mbroni çështjen shqiptare, do ta pësoni si ata dhe do të humbisni dhe partitë e treta që kanë kaq dëshirë për mbledhje kompromisi.

Në qoftë se kinezët insistojnë për mbledhje, bëhet çdo ditë e më e qartë se ata kërkojnë kompromis, në kurriz të parimeve dhe të Partisë sonë.

Unë mendoj se kinezët bëjnë përpjekje që ne në parim të pranojmë të vemi në mbledhje dhe pasi t'u kemi dhënë gishtin të na rrëmbejnë krahun. Pas kësaj ata do të fillojnë pazarllëqet me sovjetikët në kurriz të Partisë së Punës të Shqipërisë, domethënë Kina do të bëhet ndërmjetëse në mes nesh dhe Bashkimit Sovjetik, sa lëshojmë ne, sa lëshojnë ata. Vijnë kështu në situatën që i këshilloi Hrushovi Çu En Lait, që Kina mund të ndërmjetësojë pranë Shqipërisë etj. Kështu ne të vemi në mbledhje, me punë «të rregulluara» nëpërmjet lëshimesh në kurrizin tonë, dhe mosmarrëveshjet u rregulluan, «u bëmë miq», «u forcua uniteti», «ishte një grindje në mes vëllait të madh e vëllait të vogël», «nxjerrim dhe një komunikatë me formula stereotipe dhe shkoni në shtëpi».

E gjithë kjo manovër e rrezikshme, natyrisht, ndihmon revizionizmin modern dhe bandën e Hrushovit dhe dobëson marksizëm-leninizmin.

Prandaj shokët kinezë gabohen rëndë në

taktikën që kanë adoptuar për mbledhje. Kjo taktikë i përshtatet dhe asaj që thonë se lufta do të jetë e gjatë. Ne s'themi të kundërtën. Armiku duhet luftuar me taktika të drejta. Po të përdoren taktika të drejta, lufta relativisht mund dhe të mos jetë e gjatë. Pse të jemi dogmatikë dhe të themi se lufta do të jetë medoemos e gjatë.

Prandaj, ashtu si e kemi vendosur, mos lëvizim nga pozitat tona të drejta. Shokët kinezë mund të reflektojnë.

Është shumë kuptimplote informata që na dhatë për krahinën e Sinkiangut<sup>1</sup>. Si këto ata mund të kenë edhe të tjera. Atëherë vihet pyetja: Çfarë presin më?

Është i çuditshëm ky qëndrim. Me nuhatjen tuaj të hollë, përpiquni ta shihni qartë këtë çështje.

Ju përqafoj

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Në krahinën kufitare të Sinkiangut sovjetikët me anën e konsullatave të tyre kishin tentuar për organizimin e rebelimeve. Ata kishin përforcuar kufirin me divizione të tëra dhe kishin organizuar diversion për arratisje të popullsisë kineze.

## TELEGRAM DËRGUAR NDËRTUESVE TË HIDROCENTRALIT TË BISTRICËS

21 janar 1963

Të dashur shokë,

Lajmi mbi suksesin tuaj të ri dhe të madh, takimin e përpiktë të dy tuneleve, më 17 janar, më gëzoi shumë, ashtu siç ka gëzuar të gjithë Partinë e popullin tonë. Këtu u manifestuan dhe një herë ndërgjegjja e lartë socialiste, vullneti i hekurt dhe aftësitë e shëndosha të punëtorëve, të teknikëve, të inxhinierëve dhe të kuadrove tanë të tjerë, të cilët zgjidhën detyra të komplikuar dhe përballuan pengesa e vështirësi të mëdha e të papritura, duke triumfuar mbi to.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju përshëndes nga zemra dhe ju falënderoj për këtë fitore të re që i dhatë popullit! Në të njëjtën kohë shpreh besimin dhe uroj që ajo t'ju nxitë për të kryer sa më parë e më mirë detyrat që keni për-

para për t'i dhënë atdheut këtë vepër të madhe të planit të tretë pesëvjeçar.

Çdo sukses juaji është një fitore e re në rru-  
gën e ndërtimit të socializmit, në luftën kundër  
armiqve imperialistë, revizionistë e monarko-fa-  
shistë që na kanë halë në sy.

Le t'jua dëgjojmë zërin vetëm për të mirë,  
ashtu sikundër ua ka dëgjuar zërin tërë bota Par-  
tisë e popullit tonë!

Lavdi ndërtuesve të hidrocentralit të Bis-  
tricës!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 24, f. 133*

## MESAZH DREJTUAR ORGANEVE TË SIGURIMIT TË SHETIT ME RASTIN E 20-VJETORIT TË KRIJIMIT TË TYRE

19 mars 1963

Të dashur shokë,

Sot, së bashku me ju, punonjësit e organeve të Punëve të Brendshme, të gjithë komunistët e njerëzit e paorganizuar në Parti, mbarë populli ynë festojnë 20-vjetorin e themelimit të Armës së lavdishme të Sigurimit të Shtetit. Më lejoni që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të të gjithë Partisë dhe popullit tonë si dhe në emrin tim personal t'ju përshëndes nga zemra në këtë ditë kaq të shënuar dhe t'ju uroj suksese të reja të shkëlqyera në kryerjen e detyrave tuaja sa të vështira aq edhe fisnike e njerëzore! Ju jeni nga luftëtarët e vijës së parë në luftën e shenjtë për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit tonë, për sigurimin e ndërtimit socialist dhe të punës paqësore të popullit, për

triumfin e çështjes së madhe të komunizmit, kundër armiqve të betuar të popullit tonë e të mbarë njerëzimit, imperialistëve amerikanë e bashkëpunëtorëve dhe veglave të tyre të çdo ngjyre, kundër revizionistëve modernë, këtyre renegatëve të urryer të marksizëm-leninizmit.

Arma e Sigurimit lindi në zjarrin e Luftës Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve. Atë e krioi Partia nga gjiri i popullit dhe, tok me popullin, nën udhëheqjen e Partisë, ajo dha një kontribut shumë të madh. Sigurimi i Shtetit së bashku me armët e tjera të diktaturës së proletariatit dërrmoi rezistencën e klasave të mundura shfrytëzuese, të mbeturinave të tyre dhe të armiqve të jashtëm, siguroi qetësinë dhe jetën e re e të lumtur në Shqipërinë socialiste. Këtë armë të fuqishme e kanë njohur më së miri agjenturat dhe bandat mercenare të imperialistëve amerikano-anglezë, të revizionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë e të tjerë, të cilëve kaq herë aio u ka shkurtuar duart grabitqare që i drejtoheshin atdheut tonë. Punonjësit e Sigurimit janë bërë nga njerëzit më të afërt e më të dashur të masave punonjëse. Në vijën dhe udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe në mbështetjen te populli qëndron forca e armës sonë të Sigurimit.

Te ju, të dashur shokë të Sigurimit, atdheu ka armatën e heronjve të heshtur, që mishëroni cilësitë e njerëzve të rinj me moral të lartë komunist, të thjeshtë, të palodhur, patriotë të zjarrtë,

trima, të gatshëm të sakrifikoni gjithçka për popullin, të dashur me të, të rreptë dhe të pamëshirshëm me armiqtë. Partia kërkon që edhe në të ardhmen ju t'i kushtoni popullit gjithë shpirtin dhe zemrën tuaj, ndërsa armiqtë t'u rezervoni vetëm grushtin dërrmues!

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë po përparon vazhdimisht, planet e shtetit po realizohen dhe po tejkalohen, jeta e popullit është përmirësuar e do të përmirësohet edhe më tej në të ardhmen. Vështirësitë dhe pengesat, që na kanë ngritur armiqtë, janë kapërcyer dhe do të kapërcehen në sajë të patriotizmit të masave punoniëse dhe të udhëheqjes së drejtë e largpamëse të Partisë.

Misioni juaj në situatën aktuale për popullin, atdheun e socializmin ka një rëndësi kolosale. Rrota e historisë vazhdon pa u ndalur përpara, drejt komunizmit. Imperialistët me ata të SHBA-së në krve, të ndihmuar nga llumi i mbarë nierëzimit deri te revizionistët modernë Tito-Hrushov e kompani, po mundohen ta kthejnë atë prapa. Ata kurdisin komplete kundër paqes, kundër socializmit, kundër lëvizies komuniste ndërkombëtare, kundër atdheut tonë. Po s'ka asnjë dyshim se ata do të dështojnë. Nën udhëheqjen e Partisë, duke u mbështetur vazhdimisht te mëma juaj — populli, dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha armët e tjera të diktaturës së proletariatit, ju, si kurdoherë, të jeni vigjilentë, në gjendje gatishmërie që t'u shkaktoni atyre disfata të pandreqshme.

Armiqtë do të përpiqen kurdoherë të na dëmtojnë. Të dërrmohet çdo përpjekje e tyre në këtë drejtim!

Armiqtë do të mundohen të bëjnë provokacione, të dërgojnë spiunë e të hedhin banda diversantësh në vendin tonë. Jini vigjilentë dhe shpartalloni me kohë dhe pa mëshirë çdo tentativë të tyre në këto drejtime!

Përgjithësoni dhe pasuroni më tej eksperiencën tuaj për t'i prerë rrugën çdo veprimi të dëmshëm nga ana e armikut, për ta hutuar, neutralizuar dhe për ta likuiduar atë!

Sot nga arma e Sigurimit kërkohet një punë sa më e kualifikuar. Ajo duhet të godasë kurdoherë në shenjë. Ajo duhet të parandalojë të keqen aty ku mund të shfaqet ose të zhvillohet, të zbatojë dhe të mbrojë me vendosmëri ligjshmërinë socialiste. Punonjësi i Sigurimit të jetë sa luftëtar i shkëlqyer kundër armiqve, aq edhe punëtor politik dhe agjikator i shquar i masave.

Të ngrihet vazhdimisht niveli profesional dhe ideopolitik i punonjësve të Sigurimit të Shtetit!

Si kurdoherë pranë jush do të jetë Partia. Ajo, që e krijoi dhe e ka udhëhequr armën e Sigurimit nga fitorja në fitore, edhe në të ardhmen do ta udhëheqë atë në fitore të reja. Te Partia ju do të gjeni forcën e pamposhtur për të kapërcyer çdo pengesë e vështirësi. Të përshkohet e gjithë puna e Sigurimit nga një partishmëri e thellë bolshevike.

Arma e Sigurimit është dora e çeliktë e popullit që ndërton socializmin. Ta bëni atë të pathonjshme dhe ta ngrini lart e më lart lavdinë e saj!

Edhe një herë ju uroj, të dashur shokë, që gjithmonë të qëndroni ballëlart para Partisë e atdheut, që nga radhët tuaja të dalin heronj të rinj legjendarë, për të cilët do të jenë krenarë brezi ynë dhe ata që do vijnë pas nesh, që në kështjellën e pamposhtur — Republikën Popullore të Shqipërisë dhe në çështjen e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, në socializmin e komunizmin, të ndritë dhe mendja, djersa e gjaku i punonjësve të lavdishëm të armës sonë të Sigurimit!

*Enver Hoxha*

**Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë**

*Vepra, vëll. 24, f. 325*

## **PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOLEKTIVIT TË GAZETËS «BASHKIMI»**

**25 mars 1963**

**Të dashur shokë,**

Me rastin e 20-vjetorit të daljes së numrit të parë të gazetës «Bashkimi», në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe timin personal ju përshëndes me gjithë zemër dhe ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj fisnike për të mirën e popullit, të Partisë dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë!

E vështirë por e lavdishme, ashtu si e gjithë shtypit tonë popullor, ka qenë rruga e përshkuar nga gazeta «Bashkimi», organ qendror i Frontit Demokratik të Shqipërisë, gjatë këtyre 20 vjetëve të jetës së saj, sepse e vështirë dhe e lavdishme ka qenë rruga nëpër të cilën ka ecur populli ynë

gjatë këtyre viteve nën udhëheqjen e Partisë sonë heroike.

«Bashkimi» lindi në zjarrin e luftës për çlirimin e atdheut vetëm disa muaj pas Konferencës së Pezës dhe u bë një armë e fuqishme për bashkimin e të gjithë popullit në Frontin Nacional-çlirimtar. Ai u bë një organ luftarak për mobilizimin dhe për organizimin e masave në luftën kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit, për demaskimin e armiqve të bashkimit të popullit tonë dhe për krijimin e Shqipërisë së lirë, demokratike e popullore.

Në vitet e para pas Çlirimit të vendit «Bashkimi» dha një kontribut të madh për organizimin dhe për forcimin e pushtetit popullor, për mobilizimin e masave në shërimin e plagëve të luftës dhe në rimëkëmbjen e ekonomisë, si dhe për propagandimin e vënies në jetë të reformave të mëdha revolucionare.

«Bashkimi» ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në luftën për forcimin e pavarësisë së atdheut, kundër armiqve të tërbuar të popullit tonë, imperialistëve, si dhe kundër revizionistëve modernë; ka ndihmuar dhe ndihmon në forcimin dhe në modernizimin e pushtetit popullor të këshillave, në mobilizimin e masave për vënien në jetë të politikës së Partisë, të kolektivizimit të fshatit dhe për forcimin ekonomik-organizativ të kooperativave bujqësore, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe për edukimin patriotik të punonjësve; ka dhënë dhe jep një kontri-

but të çmueshëm për forcimin e unitetit moralopolitik të popullit tonë në Frontin Demokratik të Shqipërisë, të udhëhequr nga Partia.

Urojmë që edhe në të ardhmen gazeta «Bashkimi», si një organ i rëndësishëm i shtypit tonë popullor, duke zhvilluar më tej traditat e tij luftarake, të arrijë suksese edhe më të mëdha në luftën e tij për edukimin e masave me frymën e patriotizmit të lartë dhe të internacionalizmit proletar, për çelikosjen e unitetit të popullit tonë rreth Partisë, për demaskimin e armiqve të socializmit, imperialistëve dhe revizionistëve modernë, për mobilizimin e punonjësve në luftën për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë. Duke ecur në këtë rrugë dhe duke ngritur vazhdimisht cilësinë e shkrimeve, operativitetin e lidhjet me masat, gazeta «Bashkimi» do të rritë më tej rolin e saj si agjitate, propagandiste dhe organizatore kolektive dhe do të bëhet një gazetë edhe më e dashur për popullin.

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 24, f. 330*

# **LETËR PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR KONFERENCËS SË PARË KOMBËTARE PËR PËRHAPJEN DHE LEXIMIN E LIBRIT**

**3 qershor 1963**

Të dashur miq të librit,

Jam edhe unë një mik i librit, prandaj më lejoni t'ju përshëndes nga zemra e t'ju përgëzoj për iniciativën që keni marrë e jeni mbledhur për të diskutuar se si të organizohet më mirë puna për botimin, përhapjen e për leximin e librit!

Libri është një nga thesarët më të çmuar për njeriun. Ai është mësuesi, edukuesi, këshilluesi dhe frymëzuesi i tij. Në librat pasqyrohet zhvillimi i shumanshëm i botës ashtu siç ishte, siç është dhe siç do të jetë. Libri është prej letre të lehtë, por ka të tillë peshë dhe forcë sa ta fisnikërojë e ta ngrejë njeriun në majat më të larta të diturisë e të shkencës, sa t'i zbulojë çdo sekret të universit dhe të jetës, sa ta bëjë atë zot të forcës bërthamore dhe të kozmosit.

Që kur u shpik shkrimi e filluan të shkruhen librat në gur, në pergamen e në letër, bashkë me përparimin e shoqërisë nga një fazë në tjetrën, ka përparuar dhe libri. Ai nuk mbeti si i ngurosur brenda mureve të piramidave e të tempujve, as në raftet e nxira të kishave mesjetare, as si një unazë e rrallë xhevahiri në dorën e aristokratit, por si një «rebel» i vërtetë çau rrugën për te masat dhe u ngrit në lartësi të pashoqe. Librat kanë pasur dhe kanë partizanë të tyre të flaktë, që i kanë shkruar ata ose i kanë mbrojtur nga obskurantizmi mesjetar, nga barbaria fashiste, e sot akoma nga dekadentizmi borgjez kapitalist, me zjarrin e zemrave të tyre fisnike, me vullnetin e hekurt e mendjet e tyre të ndritura. Vetëm në vendet socialiste, bashkë me masat punonjëse, fituan lirinë e plotë e të vërtetë edhe libri e dituria; ata fituan të drejtën të futen kudo, gjer në kasollen më të humbur, ku gjetën miq, mbrojtës, propagandistë të flaktë dhe të panumërt.

Libri sot, veçanërisht në kushtet e shoqërisë socialiste, është një armë e fuqishme njohjeje, pune, lufte, që i armatos njerëzit me eksperiencën shekullore të jetës e të luftës së mbarë njerëzimit, me trashëgimin më të mirë të diturisë botërore dhe i ndihmon të transformojnë natyrën dhe shoqërinë, ta bëjnë jetën më të lehtë dhe më të bukur.

Në libra njerëzit shprehin dituritë e tyre, ndjenjat e tyre më të mira, nëpërmjet librave njerëzit njohin mendimet, vuajtjet, aspiratat e

njëri-tjetrit, prandaj libri është një trumbetar që ndihmon në zgjimin e në çlirimin e popujve, një fener që u ndrit mendjen e rrugën, që u kalit ndër-gjegjen, që i shërben miqësimit të tyre, paqes e progresit shoqëror. Prandaj libri është një nga shpikjet dhe thesarët më të mrekullueshëm të njeriut.

Në botë janë botuar dhe botohen aq shumë libra, sa nuk besoj të arrijë t'i regjistrojë edhe shërbimi më i përsosur statistikor e janë aq sa nuk mjaftojnë shumë jetë të njeriut për t'i lexuar. Dihet se shumë nga ata që janë botuar e që botohen janë jo për të ndriçuar mendjet e njerëzve, por për t'i helmuar e për t'i shushatur ato. Veçse librat e artë nuk i shlyejnë as stuhitë e rrebesht e shekujve, kurse të këqijtë i merr rrëkeja.

Libri është e duhet të jetë për njeriun shok besnik e i pandarë, shok pune, bashkëpunëtor, shok që të mëson, që të udhëheq në jetë, është shok e mik që edhe të çlodh, që të bën ta kalosh kohën e lirë në mënyrë të këndshme e të frytshme. Këto funksione të librave janë të dobishme dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Prandaj ato duhen kombinuar në jetë. Por gjithë kjo varet nga lloji i librit dhe qëllimi që njeriu i vë vetes para leximit të tij.

Që libri të jetë sa më i dobishëm, ai duhet trajtuar me seriozitetin më të madh: librat duhen lexuar me sy kritik, duhen studiuar, duhen nxjerrë mësimë prej tyre. Ndryshe truri i lexuesit do t'i përngjante një magazine pa inventar,

ku do të depozitoheshin së bashku mallra të vlefshme e plehra, gjë që natyrisht do ta bënte atë jo vetëm të padobishëm, por dhe një vatër me lloj-lloj sëmundjesh.

Partia jonë gjithmonë e ka vlerësuar lart librin, si ndihmës dhe armë të fuqishme revolucionare, armë në luftë dhe në punë. Dje, në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, ajo i këshillonte partizanët që pranë pushkës të mbanin dhe librin. Atëherë germat e abetares, fjala e shkruar në libra, gjenialiteti shekullor i mendimit njerëzor, mësimet jetëdhënëse të Marksit, Engelsit, Leninit e të Stalinit, mësimet e Partisë u shndërruan në forcë kolosale, që e bënë dhe pushkën të gjëmojë më fort, që i bënë partizanët të pathyeshëm. Pastaj më vonë, njerëzit tanë, duke ndjekur përsëri këshillat e Partisë, s'i ndanë abetaret dhe libra të tjerë as kur ndërtuan urat, rrugët, hekurudhat, fabrikat e hidrocentralet e para.

Sot Partia porosit që pranë kazmës dhe pushkës, pranë makinës dhe traktorit të mbajmë kurdoherë edhe librin, këtë armë të pazëvendësueshme për ndërtimin e socializmit. Me ndihmën e librave do të krijohet armata e pafund e qindra mijëra punonjësve tanë të ditur dhe të kalitur nga pikëpamja politike, ideologjike e profesionale, që do ta bëjnë gjithnjë më të bukur e më të lumtur atdheun tonë dhe që do ta ngrenë lart e më lart lavdinë e Shqipërisë së re socialiste.

Të jesh mik i librit, ky është një titull nderi. Kam dëgjuar që këtë titull e marrin ata që lexoj-

në e kanë në bibliotekën e tyre një numër të caktuar librash. Kjo është një gjë e mirë. Por ndoshta do të jetë akoma më mirë në qoftë se mik i librit do të konsiderohet jo vetëm lexuesi i thjeshtë, ai që lexon për vete, por në radhë të parë ai që është njëkohësisht dhe aktivist, përhapës e propagandist i flaktë i librit.

Në shtyp kam lexuar se shpesh bëhen takime të shkrimtarëve me punonjës, ku poetët e prozatorët lexojnë pjesë nga krijimtaria e tyre, dëgjojnë vërejtjet dhe sugjerimet e masave. Kjo është një iniciativë shumë e mirë, që duhet vazhduar dhe duhet zgjeruar. Por nga ana tjetër, ndoshta nuk jam i informuar sa duhet, më duket sikur nuk bëhet një punë e tillë edhe nga specialistët e çdo dege. Dhe këtu e kam fjalën jo vetëm, për shembull, për historianët e mësuesit e historisë, gjeografisë, gjuhës, që mund të bëjnë dhe duhet të bëjnë një punë kolosale për përhapjen e propagandimin e gjithë atyre librave aq të vlefshëm që janë botuar për luftën e jetën e popullit tonë, por edhe për inxhinierët, agronomët, mjekët, ekonomistët, fizikanët e të tjerë, që të shkruajnë e të lexojnë në masa për ato që bëhen e na duhen sot.

Natyrisht literatura artistike i tërheq më shumë masat e gjera. Por kjo nuk do të thotë se tek ato nuk mund të ngjallet po aq interesimi dhe për librat tekniko-shkencorë, ose librat që, përgjithësisht, japin njohuri mbi jetën e vendit e botën, mbi të fshehtat e natyrës, mbi jetën e za-

konet e popujve, mbi eksperiencën e tyre shekullore. Libra të tillë për masat, veçanërisht për rininë ka pak, ose shpeshherë janë të thatë e të papërshtatshëm. Specialistët, me të tilla botime, natyrisht, s'mund të kenë suksesin e shkrimtarëve me lexuesit e tyre. Prandaj më duket se entet botuese, në bashkëpunim të ngushtë me institutet e larta dhe me specialistët e ndryshëm, duhet ta gjejnë, ta zgjedhin, ta përpunojnë, ta botojnë e ta përhapin më shumë këtë lloj literature. Të botohen më shumë dhe më me kujdes libra për fëmijët e moshave të ndryshme dhe për të rinjtë, libra artistikë ose tekniko-shkencorë popullorë që të nxitin fantazinë, të ndezin guximin, të kalitin si çeliku mendjen e shpirtin e brezit tonë të ri.

Më lart theksova se lexuesi duhet të qëndrojë seriozisht përpara librit, por këtë çështje dua ta theksoj akoma më me forcë përpara atyre që shkruajnë librat, që i përkthejnë dhe që i shtypin. Shkrimtarët, përkthyesit dhe tipografët duhet të kenë parasysh vazhdimisht, orë e çast, se puna e tyre nuk është një punë si të thuash tregtie, ajo është, në radhë të parë, një punë fisnike edukuese. Veçanërisht botimi i librave nga gjuhët e huaja duhet të bëhet objekt i një studimi të vazhdueshëm, jo vetëm për sa i përket zgjedhjes së veprave, por edhe cilësisë së përkthimit. Shumë përkthime masakrohen me tërë kuptimin e fjalës. Nuk duhet lejuar më, që disa përkthyes ta shikojnë këtë çështje vetëm në rrugën e përfitimit të tyre personal. Të tillë përkthyes s'kanë respekt

as për autorin, as për lexuesin. Tipografitë tona po bëjnë një punë të madhe e të lavdërueshme, por do të dëshiroja të theksoj për to se një kujdes akoma më i madh në të gjithë procesin e punës së tyre, do të lehtësojë leximin nga kushdo, do të ngjallë një dashuri e respekt më të madh për një libër, të shtypur pastër, bukur dhe të lidhur mirë.

Duke ju uruar punë të mbarë dhe suksese të mëtejshme, më lejoni që në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe timin personal të shpreh bindjen se edhe në të ardhmen ju do të vini të gjitha fuqitë tuaja shpirtërore e mendore që të përhapet sa më gjerë libri në masat, të lexohet sa më shumë nga punëtorët dhe fshatarët, burra dhe gra, të rinj, të reja e fëmijë, si nga ata që dinë pak, ashtu dhe nga ata që dinë më shumë.

Le të bëhet libri mik i ngushtë e shok i pëndarë, bashkudhëtar i përjetshëm i çdo njeriu. Mbani mend gjithmonë fjalët e arta të Leninit të madh se, pa ditur të përdorësh librin, nuk mund të ndërtosh socializmin, pa libra s'ka dijeni, pa dijeni s'ka komunizëm.

Le të ndihmojë mbledhja juaj që, nga lëvizja e thjeshtë e sotme e miqve të librit, të shpërthejë një lëvizje e fuqishme për propagandimin e leximin në masë të librit, që drita e tij të përhapet në të gjitha skajet e atdheut dhe që ai t'i mësojë njerëzit tanë të punojnë e të rrojnë më mirë, të ndër-

tojnë si duhet jetën e lumtur socialiste, të mbrojnë dhe të çojnë më tej frytet e shkëlqyera të revolucionit tonë fitimtar!

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 25, f. 1*

31 dhjetor 1983

I jashtëm

Të nderuar,  
Lumtur të gjërat dhe shërbimet të shpejtë dhe të  
përkrahshme. Në këto ditë të gjëra, me a mbij-  
më mangësi tërë dhe mendime nga më të mi-  
rat vijnë tek ti. Të dëshiroj që vetëm dhe mëzi-  
tesh, por jam i gjërat që është shkon drejt  
shërbimit prandaj bëj durim dhe disa javë.  
Nëse të dëshiroj i ke shumë mirë. Nëse  
të për shumë të fatis dhe unim të përveçta.

Të përparoj

Enver

Botohet për herë të parë si-  
par origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

# LETËR DREJTUAR SHOKUT MANUSH MYFTIU NË VJENË

31 dhjetor 1963

I dashur Manush,

Të uroj me gjithë zemër një Vit të Ri, të lumtur, të gëzuar dhe shërim të shpejtë dhe të përhershëm. Në këto ditë të gëzuara, ne e ndiejmë mungesën tënde dhe mendime nga më të mirat vijnë tek ti. Të dimë që je vetëm dhe mërzi-tesh, por jam i gëzuar që çështja shkon drejt shërimit, prandaj bëj durim dhe disa javë.

Nefon, fëmijët i ke shumë mirë. Nexhmija të bën shumë të fala dhe urime të përzemërta.

Të përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR SHOKUT SADIK BLETA, SHOQËRIA «SKËNDERBEU»

*Argjentinë*

**4 shkurt 1964**

I dashur shoku Sadik,

Ju falënderoj nga zemra për urimet e ngrohta që më dërguat me rastin e Vitit të Ri 1964. Fjalët tuaja të zjarrta për Partinë heroike të Punës e atdheun tonë socialist janë shprehje e patriotizmit revolucionar të shqiptarëve të Argjentinës të bashkuar në shoqërinë «Skënderbeu».

Ju të gjithë, anëtarë të kësaj shoqërie, ndonëse ndodheni larg atdheut, bëni një punë shumë të nderuar, brenda mundësive tuaja, për të lartësuar emrin e mëmës Shqipëri, veprën e Partisë e të pushtetit popullor dhe për të luftuar armiqtë e hapët e të maskuar të popullit tonë që i kanë bërë kaq të zeza dhe që sot sulen pas kockave të impe-

rialistëve amerikanë e veglave të tyre. Atdheu do t'u jetë në shekuj mirënjohës të gjithë bijve të tij të ndershëm kudo që jetojnë e luftojnë për të mirën e tij.

Juve personalisht dhe patriotëve të tjerë të shoqërisë «Skënderbeu» ju uroj me gjithë zemër një vit të mbarë, me shëndet të mirë, me suksese në kryerjen e detyrave patriotike dhe me lumturi në jetën familjare.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT JAKUP MAHMUT

*Paris*

**19 shkurt 1964**

I dashur shoku Jakup,

Ju falënderoj nga zemra për urimet që më dërguat me rastin e Vitit të Ri dhe për fjalët tuaja të ngrohta, të cilat i përkasin popullit heroik shqiptar dhe Partisë së lavdishme të Punës, që na kanë lindur, rritur dhe edukuar.

Populli ynë, i udhëhequr nga Partia e Punës, lufton i patundur për ideale të mëdha, për ndërtimin e socializmit, për paqe e liri në botë, për triumfin e marksizëm-leninizmit, kundër imperializmit me atë të SHBA-së në krye dhe kundër agjenturës së tij, revizionizmit modern, të përfaqësuar nga tradhtarët Hrushov-Tito e pasuesit e tyre në vende të tjera. Viti i Ri 1964 do të kurorë-

zohet patjetër me fitore të reja në këtë luftë të drejtë.

Popullit i bëhet zemra mal kur sheh se në këtë luftë marrin pjesë të gjithë bijtë e tij të ndershëm, patriotë e revolucionarë si ata brenda, ashtu edhe ata jashtë atdheut, si ju me shokë në Francë e gjetkë. Për këtë arsye ai do t'ju kujtojë kurdoherë me mirënjohje.

Partia jonë e Punës, ashtu si deri më sot, s'do të mungojë kurrë të përmbushë me nder detyrat e saj historike ndaj popullit të vet dhe lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, pavarësisht nga sakrificat. Për këtë mund të krenoheni dhe ju që jetoni, punoni e luftoni me këtë Parti trime në zemër.

Në këtë Vit të Ri, shoku Jakup, ju uroj juve personalisht si edhe shokëve tuaj, shëndet të mirë, suksese në punë e në luftë për të mirën e atdheut, kundër armiqve të paqes e të socializmit dhe lumturi personale.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR KOMSOMOLASVE TË SHKOLLËS «J. A. GAGARIN» KRAHINA E KRASNODARIT**

**10 mars 1964**

Të dashur komsomolas, motra dhe vëllezër të rinj,

Mora letrën që më dërgonit dhe ju falënderoj nga zemra për fjalët aq të ngrohta në adresë të atdheut, popullit e rinisë sonë.

Unë gëzohem shumë që ju jeni nxënës dhe komsomolas të mirë, që e studioni me vëmendje historinë dhe që nga ajo përpiqeni të nxirrni sa më shumë mësimë. Historia është një nga lëndët që i mëson më shumë njeriut. Ajo juve ju mëson të kaluarën e lavdishme të popujve sovjetikë dhe të Partisë së bolshevikëve të Lenin-Stalinit që udhëhoqi Revolucionin e Madh të Tetorit, ndërtimin socialist, fitoren mbi fashizmin, begatinë e atdheut sovjetik, luftën kundër armiqve të paqes, lirisë, demokracisë e socializmit, imperialistëve me ata

të SHBA-së në krye dhe kundër revizionistëve modernë, si Titoja me shokë.

Iniciativa juaj është për t'u lavdëruar. Dëshira për të pasur në dhomën tuaj muze materiale edhe nga Shqipëria socialiste, miqësia që shprehni ndaj rinisë sonë, dëshmojnë për ndjenjat tuaja fisnike të internacionalizmit proletar, që ka rrënjosur te prindërit tuaj dhe te ju Partia Bolshevike. Ruajeni si sytë e ballit këtë thesar, internacionalizmin proletar, se ai ju bën të pamposhtur dhe ju ndihmon të dalloni kurdoherë të vërtetën nga gënjeshtra dhe shpifjet, të dalloni miqtë tuaj të vërtetë nga armiqtë e hapët ose të maskuar.

Rinia jonë, ashtu si i gjithë populli shqiptar, e edukuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, ushqen për rininë e popullin vëlla sovjetik dashurinë e sinqertë dhe miqësinë më të thellë.

Fitoret e popullit tonë janë arritur me gjak e sakrifica të panumërta. Vështirësitë atë s'e kanë mposhtur dhe nuk do ta mposhtin kurrë as sot, as nesër. Ai e shikon të ardhmen e ndritur më i sigurt se kurrë. Besimi i patundur dhe forca e tij bazohen në besnikërinë e pakufishme të Partisë së Punës të Shqipërisë ndaj marksizëm-leninizmit kurdoherë fitimtar.

Në materialet që, sipas kërkesës suaj, po ju dërgoj, ju do të gjeni të pasqyruar një pjesë sado të vogël të luftës së rinisë dhe të popullit tonë.

Le ta ruajmë si gjë të shenjtë miqësinë luftarake midis popujve tanë dhe besnikërinë e përjetshme ndaj doktrinës së pavdekshme të Marksit,

Engelsit, Leninit e Stalinit, tek të cilat do të thyejnë kokën të gjithë armiqtë e tërbuar të çështjes së madhe të socializmit, imperialistët me ata të SHBA-së në krye dhe shërbëtorët e tyre, revizionistët modernë.

Përshëndetje komuniste

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR PËRSHËNDETJEJE DREJTUAR  
KONFERENCËS SË 4-T KOMBËTARE  
TË GAZETARËVE TË SHQIPËRISË**

**18 prill 1964**

Të dashur shokë,

Konferenca e 4-t e gazetarëve të Shqipërisë është një ngjarje me rëndësi jo vetëm për ju, por edhe për Partinë, sepse shtypi, të cilit ju i keni kushtuar mendjen dhe zemrën tuaj, është një nga armët më të fuqishme të Partisë në luftën për ndërtimin e jetës së re socialiste në vendin tonë, për triumfin e çështjes së madhe të marksizëm-leninizmit. Prandaj, në emër të Partisë — themelueses së shtypit tonë popullor, si dhe në emrin tim personal, më lejoni të përshëndes me këtë rast të gjithë punonjësit e shtypit, të gazetave e të revistave, të radios e të Agjencisë Telegrafike Shqiptare!

Që ditën që lindi Partia, shtypi ynë revolu-

cionar u bë, ashtu siç thoshte Lenini i madh, pjesë e çështjes së përgjithshme të Partisë, pjesë e çështjes së përgjithshme të proletariatit. Traktet dhe gazetatat tona shpunë në popull fjalën e zjarhtë të Partisë dhe i ngritën njerëzit peshë në luftën kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit. Jo më pak se nga armët partizane, armiku tmerrohej nga shtypi ilegal. 20 vjet jetë e lirë, vite lufte dhe pune të palodhur, vite fitoresh mbi vështirësitë e panumërta dhe mbi armiqtë të pabesë mbajnë edhe vulën e shtypit tonë popullor të udhëhequr nga Partia.

Shtypi ynë i ka kryer detyrat e tij, pse ai është përshkuar gjithmonë nga vija e drejtë e Partisë, pse vetë Partia jonë marksiste-leniniste i ka kryer si duhet detyrat e saj nacionale dhe internacionale.

Misioni i gazetarit është sa i vështirë e delikat aq dhe fisnik. Ai më shumë se kushdo tjetër duhet të ecë me kohën dhe bile më shpejt se koha, duke përshkuar vështrimin e tij jo vetëm në të tashmen, por edhe në të ardhmen; ai duhet të jetojë me zemër dhe trup midis masave punonjëse dhe bile të jetë në krye, në pararojë të tyre; ai duhet të jetë përçues i vijës së Partisë në popull. Gazetarët revolucionarë janë arkitektë të mendimit revolucionar të masave. Duke bërë bilancin e rrugës së lavdishme të shtypit tonë të ri, populli me të drejtë krenohet me gazetarët që lindi dhe kaliti Partia jonë, me këta luftëtarë të pendës, që e kanë kryer vazhdimisht dhe po e kryejnë me nder misionin e tyre.

Shekuj kanë kaluar që kur lindi shtypi në botë. Sa qindra dhe mijëra tonelata letër dhe bojë janë harxhuar dhe harxhohen në këtë fushë! Por ndërsa një pjesë e madhe është përdorur për t'u hapur sytë masave punonjëse, një pjesë e konsiderueshme është shpenzuar dhe shpenzohet për të helmuar ndërgjegjen e tyre. Që nga fillimi i tij e deri më sot, dhe derisa në botë do të ekzistojnë shoqëri me klasa antagonistë, shtypi ka pasur, ka dhe do të ketë karakter klasor. Profkat mbi «shtypin e lirë» dhe «mbiklasor» në vendet kapitaliste, e tani dhe në vendet ku sundojnë klikat revizioniste, janë demaskuar prej kohësh nga klasikët e marksizëm-leninizmit dhe sot po i demaskon edhe një herë koha. Vetë përmbajtja borgjeze dhe anti-marksiste e shtypit imperialist e revizionist tregon se ai është armë në duart e disa klikave dhe u shërben interesave të tyre të ngushtë shfrytëzues dhe kundërrevolucionarë.

Shtypi ynë, që bën pjesë në shtypin botëror leninist, shpreh dhe mbron interesat e klasës punëtore dhe të masave të gjera të punonjësve. Ai përshkohet nga ideologjia e pavdekshme e marksizëm-leninizmit dhe i edukon masat me ndjenjat e patriotizmit popullor e të internacionalizmit proletar, ai e mobilizon popullin në luftë për triumfin e çështjes së madhe të socializmit, të paqes, të lirisë e të demokracisë dhe në luftën kundër imperializmit, me SHBA-në në krye, si dhe kundër revizionizmit modern të grupit Hrushov-Tito e pasuesve të tyre, që sot përfaqësojnë rrezikun

kryesor në lëvizjen komuniste e punëtores ndër-kombëtare.

Ashtu si vetë Partia jonë e Punës, edhe shtypin ynë aq sa është i dashur për popullin tonë dhe për popujt vëllezër të vendeve të tjera, për partitë motra marksiste-leniniste dhe për të gjithë revolucionarët në botë, aq është i urryer për armiqtë e hapët e të maskuar të Partisë e të popullit tonë. Ky, pa dyshim, është nderi dhe shpërblimi më i madh për punonjësit e shtypit të vendit tonë.

Partishmëria e lartë, principialiteti dhe vërtetësia, papajtueshmëria me armiqtë dhe me ideologjinë e tyre reaksionare, shpirti luftarak dhe sulmues — këto janë karakteristika të mrekullueshme të shtypit tonë, që i ka rrënjësuar thellë në të Partia jonë e Punës, të cilat ne duhet t'i ruajmë dhe t'i zhvillojmë më tej për ta ngritur sa më lart shtypin tonë popullor.

Gazetarët tanë e dinë mirë rolin e shtypit në ndërtimin socialist të vendit dhe influencën e tij të madhe në edukimin e masave me ndërgjegjen socialiste. Prandaj, për këto arsye ata u kushtojnë këtyre problemeve vendin kryesor në organet e shtypit. Partia e ka shtruar thjesht problemin: pa shtyp s'mund të ketë edukim të masave, pa shtyp s'mund të ketë mobilizim të tyre të ndërgjegjshëm, organizim dhe zgjidhje të problemeve të ndërtimit ekonomik e kulturor në shoqërinë e re socialiste. Ja pse jeta dhe aktiviteti i masave në qendrat e prodhimit, në kooperativat bujqësore, në fushën e arsimit, të kulturës, të artit etj., vep-

rat e njerëzve të thjeshtë, fitorja e së resë në luftë me të vjetrën, të gjitha këto përbëjnë objektin e madh të shtypit tonë.

Në luftën fisnike për të kryer sa më mirë rolin e tij, shtypi ynë është rritur e forcuar nga dita në ditë, nga viti në vit. Mbi këtë eksperiencë të pasur dhe mbi këtë bazë të shëndoshë, ekzistojnë mundësitë për ta shpënë atë akoma më përpara, për ta ngritur lart e më lart, duke synuar për të pasur kurdoherë një shtyp me përmbajtje të shëndoshë e të pastër, ashtu si është vetë Partia e populli ynë. Kjo është sot detyra e madhe që vë Partia përpara gazetarëve tanë. S'ka dyshim se në këtë drejtim do të ndihmojë shumë dhe konferenca juaj e tanishme.

Le të jetë dhe në të ardhmen shtypi ynë tribunë, ku të buçasë me forcë fjala jetëdhënëse e Partisë, ku të shkëlqejnë vija e saj e drejtë dhe mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ku të flasin dhe të shkëmbejnë eksperiencën e tyre qindra e mijëra kuadro e punonjës të tjerë të qytetit e të fshatit, ku të pasqyrohet lufta kundër vështirësive në të gjitha fushat e jetës për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste; le të bëhet ai tribunë ku të fshikullohet me ashpërsi çdo gjë që pengon ecjen përpara të shoqërisë sonë dhe ku të demaskohen pa mëshirë e të damkosen me turp armiqtë e vendit tonë, të socializmit, të paqes dhe lirisë — imperialistët dhe revizionistët modernë.

Në këtë luftë të madhe për çështjen e Partisë, të popullit e të marksizëm-leninizmit, le të pasqy-

rohen me forcë gjithnjë më të madhe, vetitë komuniste të gazetarëve tanë, aftësia e tyre për t'i parë gjërat me syrin e Partisë, shpirti luftarak, zotësia për t'u lidhur sa më ngushtë me masat e për të shprehur aspiratat e tyre.

Gazetari i tipit leninist është njeri politik, zëdhënës i Partisë dhe i popullit, edukator i masave, mjeshtër në kapjen e problemeve kyç, në interpretimin e zbërthimin e thellë dhe në zgjidhjen krijuese të tyre. Ai, para së gjithash, di të përqendrohet në çështjet më të rëndësishme, t'i ngrejë ato në kohë dhe t'i shohë kurdoherë me syrin politik. Për shtypin tonë, pra, janë të huaja kotësia dhe sensacioni, sakrifikimi i përmbajtjes për hir të formave «origjinale», prirja drejt gjërave të vogla dhe meskine. Gjithashtu ju e dini fare mirë se gazeta ose revista që merret «me të gjitha nga një çikë», që mendon vetëm «të shuajë kureshtjen e lexuesve», që nuk mendon t'i bëjë ata njëkohësisht të djersijnë, që vonohet në kapjen e problemeve jetike aktuale, ajo mbetet në bisht të masave dhe të situatës dhe, si e tillë, s'mund të luajë rolin e saj udhëheqës, të agjitorit, të propagandistit dhe të organizatorit kolektiv.

Por që shtypi të jetë sa më efektiv, krahas brendisë së lartë, ai duhet të ketë edhe paraqitje të mirë, gjuhë të pasur dhe të përdorë zhanre të ndryshme të publicistikës. Dihet se ideja e madhe i bën për vete masat, por ajo duhet t'u transmetohet atyre sa më e qartë dhe në formë tërheqëse që të mund të përvetësohet lehtë prej tyre.

Prandaj shtypi ynë duhet të jetë sintezë e përmbajtjes së lartë, me shtjellimin sa më të thjeshtë dhe me format më të përshtatshme e interesante, në përputhje me kërkesat e natyrën e lexuesve shqiptarë. Çdo gjë në shtypin tonë duhet të ruajë unitetin e plotë të qëllimit, të brendisë dhe të bukurisë. Bile dhe faqosja e gazetave ose ndërtimi i emisioneve të radios duhet të bëhen duke u nisur nga kritere që përbëjnë sumumin e qëllimeve të Partisë për edukimin e shumanshëm të masave.

Por kuptohet, shokë, se të gjitha këto do të mund të bëhen nga dita në ditë më mirë, sa më shumë që gazetarët do të punojnë për ngritjen e nivelit të tyre ideopolitik, arsimor, kulturor e profesional, sa më shumë që ata do të perfeksionojnë mjeshtërinë e tyre si gazetarë. Në këtë drejtim duhet të luajë një rol gjithnjë e më të madh organizata juaj — Bashkimi i Gazetarëve të Shqipërisë.

Partia dhe populli presin shumë nga ju. Ne sot jetojmë ngjarje të tilla, në të cilat fjala juaj, fjala e zjarrtë e Partisë sonë heroike dhe e popullit tonë revolucionar, duhet të buçasë gjithnjë e më fort në shtyp e në valët e eterit.

Le të qëndrojë penda juaj krah për krah kazmës dhe pushkës, duke nxitur mendimin krijues të masave, duke ndezur vazhdimisht zemrat e tyre për t'u hedhur nga aksioni në aksion, duke përvëluar armiqtë imperialistë dhe veglat e tyre revizionistët modernë, duke kontribuar për ta ngritur lart e më lart lavdinë e Partisë e të popullit tonë të dashur!

Le t'ju udhëheqë kurdoherë në punën tuaj  
fisnike shembulli i publicistëve të mëdhenj —  
mësuesve tanë të pavdekshëm Marks, Engels, Le-  
nin, Stalin!

Rroftë shtypi ynë popullor!

Rroftë PPSH — themeluesja e shtypit tonë  
të ri leninist!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Përshëndetje komuniste

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 26, f. 313*

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si  
gaz origjinal në qendrën  
Arhivaria Qendrore të Partisë

# **PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOLEKTIVIT TË SHTYPSHKRONJËS SË PULLAVE POSTARE**

**1 dhjetor 1964**

Shokut Sadik Dinga,

Me kënaqësi të madhe pashë seritë e pullave të prodhuara nga kolektivi i talentuar i shtypshkronjës suaj. Në to duket qartë përparimi i madh që keni bërë brenda gjashtë vjetësh në prodhimin e pullave me cilësi të lartë dhe me tematikë të pasur. Me këtë ju keni përmbushur dhe po përmbushni me nder detyrën që ju kanë ngarkuar Partia dhe shteti në sektorin tuaj të rëndësishëm. Prandaj ju përgëzoj nga zemra dhe ju uroj që në të ardhmen të korrni suksese të reja, edhe më të mëdha.

Njëkohësisht ju falënderoj me mirënjohje për dy albumet që më dhuruat.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT BEHAR SHTYLLA

Pogradec, 14 gusht 1965

Shoku Behar,

Rrugës m'u kujtua që nesër, të dielën, është festa e Vithkuqit dhe shoku Halim [Budo]<sup>1</sup> mbase do të ketë dëshirë të asistojë dhe do të kënaqet. Unë mendoj që nesër të shkoni në Vithkuq, po të doni rrini edhe të dielën mbrëma në Korçë, dhe takimin që kishim lënë, e bëjmë të hënën në po atë orë. Besoj se s'keni kundërshtim. Më lajmëro me prurësin gojarisht.

Të fala

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Shoku Halim Budo, në atë kohë përfaqësues i përhershëm i RP të Shqipërisë pranë OKB-së, kishte ardhur me shërbim në atdhe.

## **PËRSHËNDETJE DREJTUAR KONFERENCËS SË 2-TË KOMBËTARE TË VETERANËVE TË LUFTËS TË POPULLIT SHQIPTAR**

**29 shtator 1965**

Të dashur shokë, motra dhe vëllezër veteranë,

Jam shumë i gëzuar që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe në emrin tim, përshëndes sot, me respekt dhe nderim të veçantë, pjesëmarrësit e Konferencës së 2-të kombëtare të veteranëve të luftës të popullit shqiptar për liri, pavarësi kombëtare, të drejta demokratike dhe për ndërtimin e socializmit. Nëpërmjet jush unë përshëndes për zemërsisht gjithë patriotët veteranë, që janë me mijëra e qindra mijëra në të katër anët e vendit; përshëndes nënat dhe motrat, të vejat dhe bijtë e bijat e dëshmorëve të atdheut tonë.

Në këto çaste zemra dhe mendja jonë shkojnë te dhjetëra e dhjetëra mijë patriotë të flaktë që ranë duke luftuar trimërisht në fushat e betejës,

që u masakruan e u terrorizuan barbarisht në burgjet e kampet e përqendrimit, që u zhuritën me idealin e lartë të atdhedashurisë në gji për ta parë një ditë Shqipërinë të lirë, Shqipërinë të popullit. Me veneracion ne përulemi sot përpara kujtimit dhe amanetit të tyre të paharruar dhe be-tohemi se do t'i ruajmë ato si gjënë më të shtrenjtë, si burim frymëzimi e force të pashtershme për ta çuar gjithnjë përpara kauzën e tyre të pavdekshme, për të mbajtur gjithnjë lart flamurin revolucionar të popullit tonë hero, për të ndër-tuar me sukses socializmin dhe komunizmin.

Për herë të parë në historinë e lashtë të vendit tonë ndodhi që punëtorët e fshatarët, nje-rëzit e luftës, të punës e të mendimit, të bashkuar, duke ndjekur traditat e të parëve, rrokën armët për liri dhe me luftë morën në duart e tyre drejtimin e shtetit, drejtimin e vendit dhe po realizojnë me besnikëri idealet e patriotëve tanë, idealet e socializmit.

Organizata e veteranëve të luftës të popullit shqiptar, që është një organizatë e madhe patriotike në radhët e Frontit Demokratik të Shqipërisë, ka përmbushur me sukses misionin e vet për edukimin e masave punonjëse, dhe në mënyrë të veçantë të rinisë sonë të mrekullueshme, me traditat patriotike të së kaluarës, me traditat revolucionare të Luftës së madhe Nacionalçlirim-tare, me frymën e internacionalizmit proletar dhe të solidaritetit vëllazëror me punonjësit dhe popujt e shtypur të botës.

Veteranët e luftës të popullit tonë, në çdo rrethanë, kanë manifestuar frymën e lartë të patriotizmit, të ndërtimit të socializmit duke mbajtur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona. Ata kanë shprehur me vendosmëri solidaritetin e plotë dhe përkrahjen e fuqishme për luftën e drejtë çlirimtare të popullit vëlla vietnamez kundër agresorëve amerikanë, për të gjitha luftërat e drejta çlirimtare antiimperialiste të popujve të shtypur të botës.

Organizata juaj ka dhënë një kontribut të shquar edhe në arenën ndërkombëtare për popullarizimin e luftës çlirimtare antifashiste të popullit shqiptar.

Mbledhja e Konferencës së 2-të kombëtare të veteranëve të luftës të popullit shqiptar, në vitin jubilar të 20-vjetorit të fitores së popujve mbi fashizmin, është kuptimplote. Populli shqiptar mori pjesë me armë në dorë për shpartallimin e fashizmit përkrah popujve të tjerë antifashistë e në radhë të parë përkrah Ushtrisë së lavdishme të Kuqe të Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga J. V. Stalini, e cila u bë faktori i madh i shpëtimit të njerëzimit nga robëria e fashizmit. Por 20 vjet pas fitores mbi fashizmin gjerman, kv, i përkrahur e i nxitur nga imperialistët amerikanë, tok me ta, po përgatitet me shpejtësi për revansh. Imperializmi i SHBA-së mban të push-tuar Korenë e Jugut, Vietnamin e Jugut, Tajvanin, Republikën Domenikane etj. Ai ka krijuar

baza ushtarake agresive në shumë vende të tjera dhe shpërthen agresione kundër lirisë e pavarësisë së popujve, përgatit komplete dhe luftë, në radhë të parë kundër vendeve socialiste. Këto ditë bota ishte përsëri dëshmitare e luftës agresive që shpërtheu borgjezia reaksionare indiane, me nxitjen dhe përkrahjen morale e materiale të imperializmit amerikan dhe të revizionistëve hrushovianë, kundër Pakistanit, kundër luftës së drejtë të popullit të Kashmirit për vetëvendosje.

Është detyrë e luftëtarëve antifashistë, kudo në botë, të ngrihen të bashkuar për të demaskuar fuqimisht politikën e luftës e të agresionit të imperializmit amerikan, të këtij hitlerizmi të ri të ditëve tona, dhe të aleatëve të tij të ngjyrave të ndryshme, borgjeze apo revizioniste, sepse ky është armiku më i egër, më i rrezikshëm për lirinë, socializmin dhe sigurimin e popujve.

Njëzetënjëvjetori i çlirimit të atdheut, që do të festojmë së shpejti, e gjen vendin tonë në prapësi të përfundimit me sukses të pesëvjeçarit tonë të tretë, pesëvjeçar i realizuar nga populli ynë në kushte shumë të vështira, në kushtet e komplotëve e të bllokadave që imperialistët amerikanë, revizionistët hrushovianë e titistë dhe armiqtë e tjerë të Shqipërisë i krijuan e i krijojnë vendit tonë. Përvjetori i Çlirimit e gjen Shqipërinë socialiste më të fortë se kurrë politikisht, ekonomikisht e ushtarakisht, me një unitet të çeliktë të popullit rreth udhëheqjes së tij të sprovuar, Partisë heroike të Punës, me përparime të rëndësi-

shme në lëmin e ndërtimit të ekonomisë, të kulturës, të arsimit e të mirëqenies së popullit, ballë-lart e në radhët e para të frontit të luftës anti-imperialiste e antirevizioniste, me një autoritet të rritur ndërkombëtar, për të ecur përpara, gjithnjë përpara.

Perspektivat e shkëlqyera të vendit tonë nxjerrin edhe përpara jush, të dashur shokë veteranë, përgjegjësi e detyra të reja. Ju që keni luftuar për lirinë e Shqipërisë, mbani gjithnjë lart frymën revolucionare patriotike të popullit, të dashurisë për atdheun, të vigjilencës dhe të gatishmërisë për mbrojtjen e fitoreve të luftës në punën për plotësimin e detyrave të planit të shtetit për forcimin dhe lulëzimin e atdheut tonë, për t'i dhënë popullit më shumë prodhim, më shumë kulturë, më shumë dritë, arsim e qytetërim. Lufta e sotme për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut është po aq e lavdishme dhe e vështirë, kërkon po aq mobilizim e frymë luftarake, po aq disiplinë e guxim, po aq përpjekje vetëmohuese e shpirt sakrifice sa edhe epopeja e madhe e Çlirimit.

Atdheu ka nevojë për patriotizmin e bijve të tij në çdo kohë. Patriotizmi nuk ka afate e periudha të caktuara. Partia na mëson të jemi patriotë çdo ditë, në çdo punë që na ka besuar populli e atdheu, si në uzinë e në fushë, ashtu edhe në shkollë e në piramidën e kufirit. Një për të gjithë, të gjithë për një! Me këtë frymë le të shtrëngojmë kudo radhët e Frontit tonë Demo-

kratik, le të forcojmë çdo ditë bashkimin e pathyeshëm të popullit tonë rreth Partisë, për të bërë të dështojnë, si gjer tani, edhe në të ardhmen çdo komplot, intrigë e provokacion i armiqve të popullit e të atdheut.

Le ta forcojmë organizatën tonë të veteranëve të luftës të popullit shqiptar, ta bëjmë atë një vatër të madhe të edukimit patriotik të masave popullore. Për këtë qëllim shtoni dhe përmirësoni veprimtarinë tuaj dhe bëjeni atë sa më masive. Futuni në gjirin e punëtorëve e të fshatarëve, të studentëve, të nxënësve e të ushtarëve dhe tregojuni atyre me pasionin tuaj të atdashedhurisë së flaktë se si ky popull i vogël e ka çarë me pushkë në dorë rrugën e vështirë e të përgjakshme të historisë së tij përmes stuhish të padëgjjuara, si ka triumfuar mbi armiqtë, si po e ndërton sot me heroizëm të rrallë socializmin dhe mbron me vetëmohim atdheun e shtrenjtë.

Kujtojini, duajini, respektojini, ndihmojini, qëndroni gjithmonë pranë nënave, motrave, grave e bijve të dëshmorëve të luftës e të punës, të patriotëve tanë, pranë shokëve tanë invalidë dhe foluni atyre me gjuhën e Partisë, me dashurinë dhe respektin që tregon Partia për ta. Dëgjojini me vëmendje fjalët e tyre, mendimet e tyre, ndjenjat e tyre. Partia, Qeveria, atdheu dhe populli i ka ata në zemër e në shpirt dhe vlerëson lart kontributin e tyre të vazhdueshëm në dobi të atdheut e të socializmit.

Le ta mbajmë gjithnjë lart flamurin e pat-

riotizmit tradicional revolucionar të popullit tonë!  
Të bashkuar, le të marshojmë përpara për të  
shpënë gjer në fund realizimin e ëndrrave dhe të  
ideve më të guximshme e përparimtare të të parë-  
ve tanë, për të ndërtuar e mbrojtur socializmin  
këtu, në brigjet e Adriatikut.

Duke i uruar nga zemra punë të mbarë Kon-  
ferencës suaj të 2-të, shpreh bindjen e plotë se  
organizata juaj, nën udhëheqjen e Partisë, do të  
dalë gjithnjë faqebardhë në plotësimin e detyrës  
së saj të lartë patriotike.

Rrofshin veteranët e luftës së popullit shqip-  
tar për liri, pavarësi e socializëm!

Lavdi kujtimit të dëshmorëve dhe të patrio-  
tëve të atdheut tonë!

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëhe-  
qëse e lavdishme e popullit shqiptar!

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe  
Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të  
Frontit Demokratik të Shqipërisë

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 235 (5331), 1 tetor 1965*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT RITA MARKO<sup>1</sup>

10 nëntor 1965

Shokut Rita,

Tash që në kooperativa po i japim shkas një pune më të hovshme, duhet që edhe puna e Partisë të mos qëndrojë në vend, por t'i përgjigjet kësaj situatë të re. Organizatat e Partisë duhet medoemos të jenë në krye dhe në pararojë të punëve, përndryshe asgjë nuk do të ecë si duhet. Organizatat-bazë në fshat ose atje ku ka byro organizate-bazë, duhet të gjallërojnë metodën e punës së tyre, ta bëjnë atë më dinamike, me përmbajtje më revolucionare dhe të kulturar.

Duke vënë në lëvizje të madhe dhe të organizuar të gjithë njerëzit në kooperativë, të cilët duhet të aktivizohen intensivisht si në punë, ash-

---

1. Shoku Rita Marko në atë kohë ka qenë sekretar i KQ të PPSH.

tu edhe në drejtim e në kontroll, lypset medoemos që, në radhë të parë, puna e Partisë t'i përgjigjet dhe ta udhëheqë si duhet këtë aktivitet të gjerë. Udhëheqja e Partisë në kooperativa duhet jo vetëm t'u përgjigjet formave të reja të punës, por të bëhet kompetente dhe të ngrihet në një nivel të lartë teknik, dhe çdo veprim teknik të dijë ta trajtojë në aspektin politik dhe ideologjik.

Në organizatën-bazë të kooperativës ose në byronë e saj, kur ajo kishte të tillë, shokët përgjigjeshin për drejtime të ndryshme të punës, kush për punën me rininë, kush për punën politiko-ideologjike, kush për kulturën, dhe të gjithë së bashku për prodhimin dhe mbarëvajtjen e kooperativës.

Pikërisht, mendoj unë, këtë kuptim të përgjithshëm «mbi drejtimin dhe mbarëvajtjen e kooperativës» ne duhet ta detajojmë, ta zbërthejmë dhe ta vëmë më drejt në këmbët e saj të vërteta<sup>1</sup>. Në këtë drejtim nuk duhet të konfundojmë detyrat e komunistit në punë e në prodhim, që janë të njëjta me ato të kooperativistit, bile detyra me përgjegjësi, ku komunisti duhet të jetë shembull për të tjerët, me detyrat e tij njëkohësisht si komunist, si drejtues i ngarkuar nga

---

1. Për t'u prerë rrugën shfaqjeve të burokratizmit si dhe rrezikut që ato paraqitnin, dilte e nevojshme që lufta kundër burokratizmit të bëhej më e fortë e më e thellë, me metoda më të përsosura revolucionare. Çështjen e forcimit e të përsosjes së kësaj lufte Byroja Politike e KQ të Partisë e shqyrtoi në dhjetor të vitit 1965.

organizata-bazë e Partisë, detyra që u shtohen të parave.

Këto detyra të dyta komunisti do t'i ushtrojë njëkohësisht në punë e sipër, duke dhënë shembullin personal, duke këshilluar e mësuar bashkë me kooperativistët në punë e sipër, dhe në të gjitha shfaqjet e jetës, por edhe në punë në krye të ekipeve, të këshillave ose të komisioneve që do të krijohen në kooperativa. Nuk është e domosdoshme që ky komunist i caktuar nga organizata-bazë, të jetë në krye të ndonjë këshilli ose komisioni. Në krye mund të caktohet edhe ndonjë teknik ose kooperativist kompetent pa parti, por komunisti i caktuar nga organizata-bazë, i zgjedhur ose jo në krye të komisionit apo të këshillit, duhet të ndihmojë, politikisht, organizativisht, teknikisht dhe ideologjikisht, që punët të kryhen mirë, të ecin përpara, që anëtarët e komisionit ose të këshillit të bëhen të ndërgjegjshëm, të ngrihen, të diskutojnë dhe të vendosin drejt dhe kolektivisht, në bazë të vijës së Partisë, në interes të kooperativës, në drejtim të shtimit të prodhimit dhe të zbatimit më të mirë, në mënyrë krijuese të agroteknikës, të statutit dhe rregullave të vendosura nga kooperativa.

Që komunistët t'i kryejnë mirë dhe si duhet këto dy lloj detyrash, duhet të ndërtojmë një mënyrë pune më të përparuar, një stil të ri pune në organizatat e Partisë në kooperativa.

Vetëm organizata-bazë mund t'i mësojë si duhet anëtarët e saj që të ecin në vijën e Partisë

dhe të edukohen konkretisht me luftën në kooperative, me vështirësitë në kooperativë, me sukseset në kooperativë. Që të bëhet kjo, mendoj se në byronë e organizatës-bazë dhe atje ku nuk ka të tillë, në organizatën-bazë, duhet të procedojmë me një ndarje pune të re<sup>1</sup>. Përveç ndarjes së vjetër që duhet të ekzistojë, duhet të caktohen përgjegjës për këshillin e planifikimit, komisionin financiar, komisionin e ndarjes së të ardhurave etj., etj. (Për të gjitha këto komisione dhe këshilla, pasi t'i studiojmë, do të vendosim dhe do t'u rekomandojmë kooperativave që t'i krijojmë.)

Një ndarje pune e tillë nuk duhet të jetë formale, se ndryshe s'kemi pse i caktojmë fare, qoftë komisionet, qoftë komunistët.

Komunistët e caktuar do të jenë përgjegjës përpara organizatës-bazë për punën e ngarkuar dhe kjo punë në asnjë mënyrë nuk mund të ketë karakter shtetëror, por karakter partie. Puna e tyre, e kam fjalën si punë partie, në asnjë mënyrë nuk do të konsistojë vetëm nëse u bë apo nuk u bë mbledhja, diskutuan të tërë apo jo në komisione, u bë kritikë apo jo në këshilla, por puna e komunistëve përgjegjës do të konsistojë në atë që të edukojë njerëzit, që të gjitha punët të bëhen mirë, t'u shkohet deri në fund gjërave e të merren vendime të drejta. Komunisti i caktuar

---

1. Komiteti Qendror i Partisë e shikoi të domosdoshme dhe udhëzoi të bëhej një shpërndarje më e drejtë e komunistëve dhe e kuadrove, duke forcuar prodhimin e bazën me kuadro të kualifikuar.

nuk ka asnjë të drejtë më tepër se të tjerët, nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë partie ose shtetërore kundër kurrkujt, ai vetëm ka për detyrë dhe për barrë që punët të shkojnë mirë, që njerëzit të edukohen nga çdo pikëpamje, që të mbretërojë fryma revolucionare e Partisë.

Kjo nuk është një punë e lehtë dhe sidomos me nivelin e komunistëve në fshat. Këtu qëndron edhe detyra e madhe e komiteteve të Partisë të rretheve, që të ndihmojnë konkretisht.

Organizata-bazë, byroja e saj ose komiteti i Partisë në rreth nuk mund të kënaqen vetëm duke i caktuar këta shokë me përgjegjësi dhe duke u thënë «ju jeni përgjegjës përpara organizatës-bazë» dhe «oburra, forca, shkoni e livadhisni». Jo, kjo është puna më e lehtë, por pa perspektivë.

Duhet të përgatiten këta shokë, të përgatiten vetë dhe nga organizata, që të njohin në mënyrë speciale jo vetëm thelbin e problemit të punës në vendin ku caktohen, por të njohin të gjitha anët e problemeve, teknike, financiare, agroteknike, shoqërore etj. Po nuk e mësuan këtë e po nuk bënë kujdes, s'kanë si t'i mësojnë të tjerët, s'kanë si t'i edukojnë dhe t'i udhëheqin të tjerët, s'kanë si të jenë në pararojë. E gjithë kjo punë e tyre, e mësuar dhe e zhvilluar në këtë mënyrë, ka anën politike për çdo gjë. Kjo punë politike për çdo problem që nxjerr jeta, me anët e mira dhe anët e dobëta të saj, nuk mund të përgatitet ose të parapërgatitet me leksione nga

lart, të thata, pa kripë, pa shembuj nga jeta ose të bëra nëpër zyra plot formula bombastike e frazeologji të neveritshme, nga ndonjë specialist i penës, që ka marrë zakonin e keq të nxjerrë si nga furra lloj-lloj «simitesh». Jo, në asnjë mënyrë kështu. Komunistët e fshatit dhe të tjerët duhet t'i orientojmë që t'u punojë mendja vetë për çdo gjë; në bazë të vijës së Partisë të ndërtojnë punën më të përshtatshme politike për çdo problem, për çdo anë të problemit, dhe jo të presin leksionet nga lart. Nga lart bazës do t'i venë dhe duhet t'i venë leksione të përgatitura vetëm për çështje të rëndësishme, vije, t'u venë leksione ideologjike, teorike, por edhe këto të jenë të përpunuara dhe të ilustruara me shembuj nga jeta, nga lufta, nga eksperiencia e përditshme e Partisë dhe e popullit tonë.

Pra, unë mendoj se kemi një punë të madhe për të bërë në këtë drejtim, jo vetëm, siç e thashë edhe më lart, të caktojmë në mënyrë automatike ndarjen e punës në komunistët, por si t'i edukojmë dhe t'i mësojmë ata që ta kryejnë me nder këtë barrë të rëndë.

Komitetet e Partisë në rrethe të vlerësojnë mirë kohën e tyre, të mos dublojnë pushtetin, të mos administrojnë punët e brendshme të kooperativës, të mos flenë mbi disa statistika ose të merren me bulonat e traktorëve, por, në radhë të parë, të merren me njerëzit dhe t'i mësojnë këta që të punojnë me kokën e tyre, t'i kenë «bulonat» e kokës së tyre në gjendje të mirë dhe të

vajisur, të organizojnë një punë shkencërisht të lartë për këto gjëra, pse shokët e bazës nuk kanë nevojë vetëm t'u jepen urdhra, por kanë nevojë t'u hapen horizonte të gjera pune, diturie, veprimi, pastaj zbatohen urdhrat dhe vendimet.

Me dhënë vetëm urdhra është gjëja më e thjeshtë, por kjo fsheh shumë të këqija, midis të tjerash krijon tek ata që japin urdhra, idenë se ata «kanë lindur» për t'u diktuar të tjerëve, idenë e mendjemadhësisë, idenë e komandimit etj., që janë të gjitha të huaja dhe të dënueshme nga vija e Partisë sonë.

Një metodë pune e tillë e dënueshme krijon një rreth vicioz, burokratik, sepse edhe ata që marrin vetëm urdhra dhe direktiva, fillojnë të japin edhe vetë urdhra dhe direktiva. Krijohet kështu një shtresë që jep urdhra dhe një shtresë tjetër që duhet t'i zbatojë këta urdhra. Luftë e ashpër e pamëshirshme t'u bëhet këtyre pikëpamjeve dhe këtyre veprimeve, sepse këto disa herë fillojnë padashur, si pa gjë të keq, por pastaj bëhen një vijë shumë e rrezikshme.

Një metodë e tillë pune i bën njerëzit të mefshtë, i bën të frikshëm, i bën servilë përpara superiorit, përpara urdhrat, nuk mbahet qëndrim komunist, njerëzve u pritët iniciativa, aq e nevojshme, u priten me këmbët e para propozimet e tyre të vlefshme dhe, natyrisht, në këtë rast nuk mund të ketë as kritikë, as autokritikë marksiste-leniniste.

Këto shfaqje s'janë të shumta në punën e

njerëzve të Partisë sonë, por duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe vigjilenca jonë revolucionare nuk konsiston në një formulë boshe të përsëritur orë e çast me vend e pa vend, por konsiston dhe hyn në veprim si duhet kur puna e Partisë zhvillohet në një diapazon të gjerë, masiv, revolucionar, kur të gjithë komunistët dhe populli i hyjnë mirë thelbit të problemit, pra edhe anëve të mira, edhe anëve të këqija, dhe punojnë, mendojnë dhe luftojnë në vijën e Partisë si luftëtarë të vërtetë të saj.

Prandaj, shoku Rita, i shqyrtoni edhe me shokun Hysni këto sugjerime të mia dhe i shikoni edhe me bazën si të veprojmë më mirë për këtë problem të madh. Këtu e kam vënë theksin për organizatat e Partisë në kooperativat bujqësore, por kjo duhet parë, më me kujdes, edhe për ato organizata partie në fshatra që nuk janë kooperativë. Në rast se në kooperativë duhet forcuar kjo punë një herë, atje ku fshati nuk është kooperativë, forcimi i drejtimit duhet shikuar 10 herë, pse kam frikë se fshatrat jo kooperativa kanë mbetur si «të njerkes».

Një gjë e tillë, por në forma të ndryshme, mund dhe duhet bërë edhe në sektorin shtetëror të bujqësisë dhe të minierave. Këtë, gjithashtu, duhet ta shihni me kujdes. Unë kam besim se do ta forcojnë akoma më shumë punën e Partisë.

Kur t'i shikoni, t'i studioni e t'i konsultoni edhe me bazën këto mendime, mund të diskutoj-

më me njohuri më të plota dhe më të sakta, nga këto që shpejt e shpejt, po të parashtrroj në këto shënime.

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

17 janar 1988

Fort e ndërtuar dhe e dashur shpesh këtu  
nana, ...  
I etra juaj më s'kollit përse i dashurisë e laktë  
dhe ndësinë e rrethë që zemra juaj duhet të  
jen për popullin shqiptar, për vendin e shqiptar-  
tjave, sic e duajmë Shqipërinë tonë dashamirë  
saj, sic jeni ju, sic ka qenë i pabarutari bashkë-  
hori juaj, S. K. Neuman!  
Fjalët tuaja të thjeshta e të sinqerta më gë-  
uan sa më shumë. Më bëxuan dhe më prekën, sepse  
u shpesh Neumanova e sëmurë, u ngritën nga  
kivati dhe, si një trimëreshë që është e xoria të

I. S. K. Neuman (1915-1947), poet revolucionar, çetnik i  
luftës së Parë Botërore, duke qenë i mobilizuar në luftë  
të parë me armë, u bëri pjesë në Shqipëri ku qëndroi në vitet  
gjatë të Elbasanit dhe në Berat dhe të Pogradecit, të cilave  
kërkoi të bënte "Elbasani" dhe "Beratshkë", me vjetërn  
kultivim me formë të shqiptare.

# LETËR DREJTUAR MIKES SË SHQIPËRISË BOZHENA NEUMANOVA

17 janar 1966

Fort e nderuara dhe e dashura shoqe Neumanova,

Letra juaj më solli përsëri dashurinë e flaktë dhe miqësinë e rrallë që zemra juaj bujare ushqen për popullin shqiptar, për vendin e shqiponjave, siç e quajnë Shqipërinë tonë dashamirët e saj, siç jeni ju, siç ka qenë i paharruari bashkëshorti juaj, S. K. Neuman<sup>1</sup>.

Fjalët tuaja të thjeshta e të sinqerta më gëzuan pa masë. Më gëzuan dhe më prekën, sepse ju, shoqe Neumanova, e sëmurë, u ngritët nga shtrati dhe, si një trimëreshë që është e zonja të

---

1. S. K. Neuman (1875-1947), poet revolucionar çek. Gjatë Luftës së Parë Botërore, duke qenë i mobilizuar në ushtrinë austro-hungareze u dërgua në Shqipëri, ku qëndroi një vit e gjysmë në Elbasan dhe në Beragozhde të Pogradecit, të cilave u kushtoi vëllimet «Elbasani» dhe «Beragozhda», me vjersha e kujtime me tema krejt shqiptare.

# LETËR DREJTUAR MIKES SË SHQIPËRISË BOZHENA NEUMANOVA

17 janar 1966

Fort e nderuara dhe e dashura shoqe Neumanova,

Letra juaj më solli përsëri dashurinë e flaktë dhe miqësinë e rrallë që zemra juaj bujare ushqen për popullin shqiptar, për vendin e shqiponjave, siç e quajnë Shqipërinë tonë dashamirët e saj, siç jeni ju, siç ka qenë i paharruari bashkëshorti juaj, S. K. Neuman<sup>1</sup>.

Fjalët tuaja të thjeshta e të sinqerta më gëzuan pa masë. Më gëzuan dhe më prekën, sepse ju, shoqe Neumanova, e sëmurë, u ngritët nga shtrati dhe, si një trimëreshë që është e zonja të

---

1. S. K. Neuman (1875-1947), poet revolucionar çek. Gjatë Luftës së Parë Botërore, duke qenë i mobilizuar në ushtrinë austro-hungareze u dërgua në Shqipëri, ku qëndroi një vit e gjysmë në Elbasan dhe në Beragozhde të Pogradecit, të cilave u kushtoi vëllimet «Elbasani» dhe «Beragozhda», me vjersha e kujtime me tema krejt shqiptare.

mposhtë vuajtjet fizike me dashurinë për jetën, që ruan në thellësitë e shpirtit të saj, shkuat në përfaqësinë tonë në Pragë për të shprehur urimet e zjarrita, për të festuar, si të thuash në shtëpinë tonë, festën e lirisë së popullit shqiptar. Ky gjest juaji<sup>1</sup> simbolizon realitetin e madh që flet për vëllazërimin e popujve tanë, vëllazërim që nuk do ta ftohin e shuajnë dot, sado të rënda që të jenë situatat, armiqtë e përbashkët, revizionistët hrushovianë, titistë e të tjerë.

Me këtë rast, me gëzim ju njoftoj juve, si mike besnike e popullit tonë, që shoqëroni me rrahjet e zemrës suaj optimiste dhe entuziaste përparimet dhe lulëzimin e vendit tonë, se Partia dhe populli shqiptar e mbyllën me sukses planin e tretë pesëvjeçar, duke kapërcyer me vendosmëri vështirësitë e mëdha të bllokadës së tërbuar të revizionistëve hrushovianë e të imperialistëve dhe përgatitën planin e ri pesëvjeçar. oë do ta bëjë më të begatshme e më të bukur Shqipërinë. Këto ditë, më 11 janar, ne festuam 20-vietorin e Republikës sonë Popullore, e cila është bërë më e fortë e më trime. Forca e urtësia e saj qëndrojnë te besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, te populli, te miqtë e saj të shum-

---

1. Ky gjest internacionalist u bë në vitin 1965, në një kohë kur midis Partisë e vendit tonë dhe revizionistëve hrushovianë e pasuesve të tyre ekzistonin marrëdhënie të ndera dhe kur PPSH vazhdonte me vendosmëri nga pozita parimore luftën e hapët kundër revizionizmit modern me atë hrushovian në krye.

të në të gjithë botën, midis të cilëve ju zini një vend nderi.

E nderuara shoqja Neumanova,

Nexhmija, fëmijët dhe unë ju falënderojmë me gjithë zemër për urimet që na dërgonit me letrën tuaj dhe urojmë që zemra juaj të rrahë gjithmonë për gëzime. Ju urojmë si gjithnjë shëndet dhe gjithë të mirat.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 31, f. 135*

# LETËR DREJTUAR KOOPERATIVISTËVE TË KOOPERATIVËS BUJQËSORE «31 KORRIKU» BURREL

Mat

21 shkurt 1967

Të dashur shokë, vëllezër dhe motra heroike  
matjane,

Ju falënderoj nxehtësisht për letrën<sup>1</sup> që më  
dërguat, e cila është një pishtar i madh revolu-  
cionar që do të djegë mbeturinat e këqija të së  
kaluarës dhe do t'i japë një hov të madh së resë  
përparimtare, ku na udhëheq Partia jonë e ma-

---

1. Në letrën e tyre, dërguar shokut Enver Hoxha, kooperat-  
vistët e kooperativës «31 korriku» të Burrelit i shkruanin se në  
frymën e vendimeve historike të Kongresit të 5-të të Partisë,  
do të shihnin të metat e punës së tyre në drejtim të barazisë  
së plotë të gruas me burrin, do të nxirrnin burimin e këtyre  
të metave dhe do të caktonin rrugët konkrete për zgjidhjen  
e tyre.

dhe. Mëmat dhe vajzat e Shqipërisë së re do t'ju urojnë juve.

Rroftë populli heroik i Matit, i lidhur me mish e me shpirt me Partinë dhe me pushtetin popullor!

*Enver Hoxha*

Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 45 (5770), 22 shkurt 1967

## LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT TË GAZETËS «PUNA»

23 shkurt 1967

Të dashur shokë të gazetës «Puna»,

S'ka rëndësi që jeni një kolektiv i vogël, pikërisht këtu qëndron merita e punës suaj të vlefshme. Në punën tuaj ju keni mbështetjen dhe udhëzimet e drejta të Partisë, keni ndihmën dhe mbështetjen jetëdhënëse të klasës punëtore, të të gjithë punonjësve, pse gazeta «Puna» është zëri i bashkimeve profesionale të vendit. E këndoju me shumë kujdes gazetën «Puna», frymëzohem dhe mësoj kurdoherë nga eksperiencia e pafund, nga heroizmat e klasës sonë punëtore.

Me këtë rast, ju lutem, u transmetoni punëtorëve dhe gjithë punonjësve të vendit tonë përshëndetjet dhe përgëzimet e Partisë dhe të Komitetit Qendror, u transmetoni të falat dhe respektin tim të madh për veprat e tyre madhështore.

Klasa punëtore dhe punonjësit, nën udhëheqjen e Partisë, të jenë kurdoherë në ballë, në revolucion, për ta forcuar atdheun, për të ndërtuar me sukses socializmin. Për revolucionarizimin e njerëzve, klasa punëtore dhe masat revolucionare të bëjnë një luftë të përditshme e këmbëngulëse kundër të metave dhe në diskutimet e propozimet e tyre të mos ketë vetëm pyetje, por kërkesa të studiuara e të drejta, me data dhe me afat për marrjen e masave, kurse për ata që i bëjnë bisht zbatimit të detyrave, të kërkojnë heqjen ose uljen e tyre në përgjegjësi. Partia dhe Qeveria do t'i mbështetin kurdoherë propozimet e drejta dhe revolucionare të masave. Vetëm kështu kombinohen drejt direktivat dhe udhëzimet e Partisë dhe të Qeverisë, me vijën e masave dhe me kontrollin e masave.

Shumë të fala

*Enver Hoxha*

«Për Bashkimet Profesionale»  
(Përmbledhje veprash), f. 340

**LETËR DREJTUAR PUNËTOREVE,  
INXHINIERËVE, TEKNIKËVE TË NDËRTIMIT,  
TË MONTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË  
FABRIKËS SË PLEHRAVE AZOTIKE**

*Fier*

**24 shkurt 1967**

Të dashur dhe të lavdishëm punëtorë, inxhinierë, teknikë të ndërtimit, të montimit dhe të shfrytëzimit të Fabrikës së Plehrave Azotike,

Sot kishte mbledhjen e saj të zakonshme Byroja Politike e KQ, dhe një nga problemet që ajo shqyrtoi ishte «ndihma e mëtejshme e Partisë dhe e Qeverisë për kooperativat e reja bujqësore që u ngritën rishtas në malësi». Dhe pikërisht në këtë moment drejtori juaj, shoku Rahman Hanku, erdhi na solli sihariqin e madh dhe qeskat me prodhimin e parë të azotikut. E përqaftuam, e puthëm shokun Rahman Hanku, njëlloj sikur t'ju kishim përqaftuar nga ana jonë, nga ana e gjithë Partisë, nga ana e gjithë popullit të gjithë ju një nga një.

Ju lumtë shokë e shoqe heroikë, ushtarë të lavdishëm të Partisë dhe të popullit! Ju, me zotësi të madhe, ndërtuat një nga veprat më madhë-

shtore të vendit tonë, një nga veprat më të nevojshme. Vepra juaj do të revolucionarizojë bujqësinë tonë, do të shtojë prodhimet bujqësore, do të përmirësojë më tej jetën e popullit. Ju me sukses dhe para afatit e bëtë realitet ëndrrën e Partisë dhe të kooperativistëve. Ju kalitët më tej me një vepër madhështore aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë dhe fshatarësia jonë çdo ditë e më shumë sheh me fakte e me vepra se në ç'rrugë të lumtur e udhëheq atë dhe gjithë punonjësit klasa punëtore dhe Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë.

Përpara mbjelljeve pranverore dhe punëve të tjera të bujqësisë, me veprën që ju i dhatë atdheut, do të qindfishohet entuziazmi në punë i kooperativistëve dhe i rinisë sonë. Forca e popullit, në shembullin tuaj të madh, do të bëjë mrekullira, të dashur shokë punëtorë. Sot, kur të marrë vesh këtë lajm gazmor, popullit do t'i bëhet zemra mal dhe çdo zemër shqiptari do të brohorasë për Partinë dhe për ju dhe do të hidhet në sulm të pandalshëm.

Të dashur shokë punëtorë,

Edhe një herë ju urojmë nxehtësisht dhe Partia ju thotë: Përpara, se vepra dhe fitore të reja na presin!

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 48 (5773), 25 shkurt 1967*

# LETËR DREJTUAR KORRESPONDENTËVE VULLNETARË TË SHTYPIT DHE TË RADIOS NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE TË FIERSHEGANIT<sup>1</sup>

*Lushnjë*

**28 shkurt 1967**

Të dashur shokë korrespondentë vullnetarë të shtypit dhe të radios në kooperativën bujqësore të Fiersheganit,

Më gëzon shumë fakti se sa drejt i keni kuptuar ju mësimet e Leninit të madh dhe të Partisë sonë në lidhje me rolin e madh të korrespondentit vullnetar fshatar të shtypit. Jo vetëm që

---

1. Në mbledhjen e përbashkët të byrosë së organizatës-bazë të Partisë dhe të organizatave të masave, për ta bërë shtypin tribunë sa më të gjerë të masave, u vendos të ngrihen brigadat e korrespondentëve vullnetarë në të 10 fshatrat e kooperativës së bashkuar të Fiersheganit të rrethit të Lushnjës.

ju e keni kuptuar drejt këtë rol, por format e punës krijuese që keni vënë në jetë për ta kryer këtë detyrë vullnetare, duhet të ndiqen, të zbatohen dhe të zhvillohen më tej.

Është nder i madh të jesh korrespondent vullnetar i shtypit dhe i radios sonë. Pa ju ngec në vend edhe shtypi, edhe radioja, pasi ju u jepni atyre ushqimin kryesor, të shëndetshëm, pa fraza boshe stereotipe, ju jepni jetën e gjallë, eksperiencën e madhe të popullit. Shkruani thjesht, qartë dhe me guxim për çdo gjë, ashtu siç është populli, ashtu siç do populli, me atë kurajë të madhe që karakterizon popullin tonë.

Madhështia dhe efekti i shkrimeve tuaja do të qëndrojnë në brendinë, në mendimet, në këshillimet dhe jo në balancimin e frazave e të formulave bajate. Si në çdo punë, edhe në këtë ndiqni kurdoherë rrugën e Partisë, rrugën popullore.

Ju uroj shumë suksese dhe këshilloj që të ecin në këtë rrugë të gjithë korrespondentët vullnetarë të shtypit dhe të radios.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 51 (5776), 1 mars 1967*

## LETËR DREJTUAR POPULLIT TË KURVELESHIT

24 qershor 1967

Të dashura nëna, motra dhe vëllezër të Kurveleshit,

Këndova me gëzim të madh ftesën që më dërgoi komisioni për të marrë pjesë në festimin e përvjetorit të çlirimit të Kurveleshit nga push-tuesit fashistë dhe tradhtarët e atdheut dhe ju them të drejtën, të dashurit e mi, kisha dëshirë të madhe ta kaloja këtë ditë të lumtur pranë jush. Edhe pse nuk vij dot për arsye pune, në këtë ditë gëzimi unë me zemër dhe me mendje jam aty, pranë jush, pranë ish-partizaneve dhe partizanëve trima të krahinës suaj kreshnike dhe sot luftëtarë të vendosur për ndërtimin e socializmit.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Këshillit të Ministrave, të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik dhe në emrin tim, ju dërgoj me këtë rast përshëndetjet më të nxehta.

Nga vit gëzuar përvjetorin tuaj të çlirimit në Shqipërinë tonë të shtrenjtë socialiste!

Bashkë me gëzimin e madh që sjell një festë si kjo, ju dhe së toku me ju gjithë Shqipëria përkujtoni sot me respekt të thellë bijat dhe bijtë tuaj kurveleshas, të cilët, duke ndjekur me besnikëri të pakufishme mësimet e Partisë, që në thirrjen e parë të saj u hodhën në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare dhe me qindra ishin ata që ranë në fushat e betejave për nderin dhe lirinë e atdheut, për lirinë dhe lumturinë e gjithë popullit tonë, duke çimentuar kështu me gjakun e tyre të kulluar themelet e pushtetit të ri, për të cilin dhanë jetën. Kujtimi i tyre i paharruar na na përtërin dhe na shton forcat, na mban kurdoherë të freskët në kujtesën tonë detyrën e shenjtë që akoma më shumë dhe më mirë të punojmë, që kurrë të mos na zërë gjumi dhe barutin ta mbajmë kurdoherë të thatë, për ta bërë Shqipërinë tonë të dashur më të fortë e të paprekshme nga çdo armik, më të bukur, më të pasur e më të begatshme, që populli shqiptar të rrojë i lirë, i lumtur, ashtu siç e deshën dhe për të cilin ata dhanë jetën e tyre në lulen e rinisë.

Si kudo në Shqipëri, edhe në krahinën tuaj po lulëzon jeta e re socialiste. Gratë dhe burrat e Kurveleshit, të dëgjuar për trimëri e heroizma në të gjitha anët e atdheut, me ndjenjën e një patriotizmi të lartë që i ka karakterizuar në shekuj, duke vënë në jetë porositë e Partisë, me të cilën kanë qenë dhe janë të lidhur si mishi me koc-

kën, i janë përveshur sot punës për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 5-të të Partisë, për ta bërë krahinën tuaj malore, këtë çerdhe shqiptonjash syptrembur, më të bukur e më të pasur, ku të lulëzojë jeta e re socialiste dhe, kur të jetë nevoja, ashtu siç e keni zakon, edhe një mburojë të pamposhtur për mbrojtjen e atdheut nga çdo armik.

Duke jetuar me hovin e madh të paparë revolucionar që përshkon sot anakënd truallin e atdheut, populli i krahinës suaj kreshnike, me besim të pakufishëm në mësimet e Partisë sonë të lavdishme, ashtu si dje në luftë, krahas punës së palodhur për lulëzimin dhe forcimin e kooperativave tuaja bujqësore malore, që do ta bëjnë jetën tuaj më të begatshme e më të qytetëruar, me të njëjtën trimëri e vendosmëri, do të luftojë për të shkukur nga rrënjët çdo gjë të vjetër që na kanë lënë trashëgim pushtimet e huaja shekullore dhe klasat e përmbysura dhe që pengojnë ecjen më me vrull përpara të jetës së re në vendin tonë.

Ju uroj, të dashura motra dhe vëllezër, sukses gjithnjë e më të mëdha në punë, në jetë dhe shëndet e lumturi në familjet tuaja.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 153 (5878), 27 qershor 1967*

# **LETËR DREJTUAR TË REJAVE LEKBIBASE TË RRETHIT TË TROPOJËS, PJESËTARE TË BRIGADËS «GJELOSH RAMA» NË HEKURUDHËN RROGOZHINË—FIER**

26 korrik 1967

Ju falënderoj për letrën që më dërguat, për ndjenjat tuaja të pastra, fisnike e revolucionare, për besimin tuaj ndaj Partisë dhe pushtetit tonë popullor.

Mësimet dhe idetë dritëdhënëse të Partisë kanë shkëlqyer e shkëlqejnë si drita e diellit edhe në malet kreshnike të Lekbibajt. Ato kanë push-tuar mendjet dhe zemrat e atij populli trim të malësisë, që është i lidhur si mishi me kockën me Partinë dhe pushtetin e tij popullor, kanë push-tuar mendjet e zemrat e rinisë së lavdishme lekbibase dhe tuajat, prandaj ju në përgjigje të thirrjes së Partisë, ashtu si gjithë të rinjtë e vendit tonë, duke kapërcyer çdo vështirësi e pengesë, u grumbulluat një nga një si shqiponja mali,

formuat brigadën tuaj luftarake dhe, duke lënë cerdhet, u nisët në aksion, për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë—Fier.

Në aksion kundër zakoneve prapanike, besimeve fetare e mbeturinave të huaja në ndërgjegjen e njerëzve e të bashkëfshatarëve tuaj, formuat brigadën e të rejave lekbibase; në aksion për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë—Fier ju po derdhni djersën e gjithë energjitë tuaja, punoni dhe edukoheni me mësimet e Partisë si të flakni tej çdo zakon prapanik e mbeturinë të dëmshme, si të transformoni konceptet e botëkuptimit tuaj. Ashtu si bën gjithë rinia heroike e vendit tonë, e cila edukohet çdo ditë me dashurinë për punën dhe jetën, për arsimin e kulturën, për të fituar dituri, si t'u shërbejë më mirë popullit, atdheut, Partisë, çështjes së socializmit dhe komunizmit, ashtu edhe ju në aksionin për ndërtimin e hekurudhës jo vetëm punoni me vetëmohim, por mësoni, edukoheni, ushqeheni çdo ditë me mësimet e Partisë. Në këtë aksion të madh ju thoni se keni mësuar shumë gjëra për punën, shoqërinë, veshjen e mënyrën e jetesës së kulturuar, zakone e norma të reja, virtyte dhe cilësi revolucionare që karakterizojnë rininë heroike të vendit tonë. Të gjitha këto që keni mësuar në aksion më gëzojnë pa masë dhe jam i bindur se ju atje në malësi do ta vazhdoni aksionin, duke punuar me motrat, vëllezërit, shokët e bashkëfshatarët tuaj, për të vënë në jetë ato që mësuar në hekurudhë, për të zbatuar me çdo kusht e në çdo rre-

thanë vendimet dhe mësimet e Partisë sonë të lavdishme.

Partia ka bërë e po bën një punë shumë të madhe dhe ka marrë masa të rëndësishme për zhvillimin e transformimin ekonomik, kulturor e ideologjik të vendit. Vendimet historike të Kongresit të 5-të dhe dokumentet e tjera të rëndësishme të Partisë kanë pushtuar mendjet, ndjenjat, zemrat e mbarë popullit tonë, të rinisë sonë heroike. Ju e keni parë në shtypin e Partisë se si në të katër anët e vendit ka shpërthyer një vrull e entuziazëm i paparë ndonjëherë për të kryer me nder detyrat që shtron Partia. Këto vendime i frymëzuan lekbibasit e gjithë malësorët e Shqipërisë të lënë rrugën shekullore të ekonomisë së vogël private e të bashkohen në kooperativa, i bënë të mëdhenj e të vegjël të ngrihen kundër kishave, xhamive, besimeve të kota fetare e zakoneve prapanike që e mbajnë njeriun në errësirë, që e ulin dinjitetin e personalitetin e grave e të të rejave. Këto vendime i frymëzojnë punonjësit e vendit tonë që kurdoherë të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin personal, të ndërtojnë me sukses socializmin në atdheun tonë të dashur edhe në kushtet e bllokadës së egër imperialiste e revizioniste dhe ta bëjnë Shqipërinë kështjellë të pathyeshme.

Në këtë betejë të madhe e të lavdishme jeni hedhur edhe ju shoqe, luftëtare lekbibase. Kështu ju konsideron Partia, kështu ju konsiderojnë edhe prindërit, vëllezërit, motrat e të afërmit

tuaj. Të gjitha ato që keni bërë e për të cilat më raportoni, janë punë të mira, të ndershme, fisnike, në bazë të mësimeve të Partisë, prandaj të qëndroni me kokën lart dhe pishtarin e Partisë ta mbani të ndezur gjithmonë, sepse bashkëfshatarët e të afërmit tuaj, që janë me Partinë, nuk do t'ju qortojnë, përkundrazi, ata që ju kanë sjellë pengesa e lëndime do t'ju kërkojnë falje drejtpërsëdrejti apo në heshtje, sepse ju me punën dhe sjelljet tuaja keni nderuar jo vetëm ata, por gjithë krahinën tuaj, rrethin tuaj, prandaj do të gëzoni respektin e dashurinë e tyre.

Ju që keni treguar gjithë atë vrull revolucionar, guxim, trimëri e dashuri për atdheun, kur të ktheheni në fshat, të bëheni luftëtare të flakta të vijës së Partisë dhe së bashku me komunistët, me gjithë rininë të punoni e të tregoni atë që vazhdimisht ka theksuar Partia, se gratë në kushtet e vendit tonë janë nga më përparimtares e shoqërisë sonë, si në kooperativë, në fabrikë, në shtëpi, ashtu dhe në zhvillimin e revolucionit ideologjik e kulturor.

Ju takon juve të rejave të luftoni me guxim e vendosmëri kundër zakoneve të vjetra e çdo gjëje reaksionare, t'i bëni pluhur e hi ato dhe në vend të tyre të ruani e të zhvilloni më tej traditat e mira të popullit tonë të lashtë, parimet e moralit tonë proletar, heroizmin e femrës shqiptare.

Partia dhe pushteti kanë krijuar të gjitha mundësitë që ju të mësoni çdo ditë e më shumë, të ngrini nivelin tuaj kulturor e ideologjik, të le-

xoni më tepër libra e gazeta dhe të qëndroni kurdoherë në vijën e parë të luftës për realizimin e vijës së Partisë, për fitoret tona akoma më të mëdha. Krahas kazmës e librit të mbani afër edhe pushkën, të cilën shqiptarët dhe malësorët e krahinave tuaja s'e kanë lëshuar kurrë nga dorra, për të mbrojtur atdheun, lirinë, socializmin.

Ju keni shfaqur dëshirën për të vizituar kryeqytetin e atdheut tonë. Keni të drejtë. Është porositur Komiteti Qendror i Rinisë që të organizojë ekskursionet me brigadën tuaj jo vetëm për të parë kryeqytetin, por edhe qytetin e Vlorës, të Fierit, të Beratit, ku do të njiheni me fushat e bukura e pjellore, me industrinë tonë të re, me popullin e mrekullueshëm të këtyre rretheve, që, si i gjithë populli shqiptar, punon e lufton për të vënë në jetë mësimet e Partisë sonë të lavdishme.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për gruan» (Përmbledhje veprash), f. 316

## LETËR DREJTUAR SHOKUT RAKIP BAROLLIU

*Trestënik—Korçë*

**17 tetor 1967**

I dashur xha Rakip,

Letra që më dërgove më gëzoi shumë. Ju falënderoj për urimet dhe sidomos për dashurinë që gufon në gjoksin tënd për atdheun, për Partinë tonë të shtrenjtë dhe për optimizmin tuaj revolucionar.

Ashtu si të gjithë, sidomos ata që kanë jetuar periudhën e vështirë para Çlirimit, mahnitën me përparimet e mëdha që ka bërë e bën vendi ynë, ju keni të drejtë që u gëzoheni suksesteve të arritura gjatë këtyre 23 vjetëve. E si të mos na bëhet zemra mal sot kur në të katër anët e Shqipërisë, gra e burra, pleq e të rinj, në qyte e në fshatra, në fusha e në malësi janë hedhur në punë, në luftë, në revolucion, për të ndërtuar

jetën e re, për të zhdukur nga rrënjët të gjitha të këqijat e shoqërisë së vjetër, për të zhvilluar gjithnjë më shumë ekonominë dhe kulturën e vendit tonë, për t'i bërë edhe zonat malore më të përparuara dhe njëkohësisht kështjella të mbrojtjes nga çdo armik, që populli shqiptar të rrojë i lirë dhe i lumtur në shekuj si zot në atdheun e tij të dashur. Lulëzimi i pareshtur i Shqipërisë në rrugën e socializmit, ku na udhëheq Partia e Punës, na përtërin të gjithëve forcat.

Unë ju uroj, i dashur xha Rakip, pleqëri të bardhë e shëndet, që të jeni akoma në gjendje të ndihmoni që kooperativa juaj kufitare të bëhet edhe më e fortë, më e pasur dhe së bashku me forcat tona të armatosura, të qëndrojnë kurdoherë si të gjitha kooperativat e zonave tona kufitare të asaj ane një barrikadë e pakapërcyeshme për këdo që do të përpiqet të na cenojë.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR KOOPERATIVISTËVE TË BUGJONIT**

*Pukë*

**16 nëntor 1967**

**Të dashur shoqe dhe shokë kooperativistë të Bugjonit,**

Nga letra që më dërguat, mësova se ju i jeni përveshur punës me zell për ndërtimin e jetës së re socialiste. U gëzova shumë dhe ju përgëzoj nga zemra për iniciativat tuaja, sipas të cilave keni vendosur të mos merrni shpërblim nga kooperativa për kafshët që kolektivizuat, t'i jepni falas ekonomisë kolektive, sipas mundësive, kush një e kush dy kokë bagëti të imëta nga të oborrit, si dhe gjithsej 52 viça, sipas shembullit të Gorishtit. Ashtu si në kooperativat e tjera të vendit tonë, edhe ju motra e vëllezër të mi të Bugjonit, po zbatoni me besnikëri një nga mësimet më të rëndësishme të Partisë për forcimin e ekonomisë kooperativiste. Ky është një qëndrim jo vetëm patriotik, po tregon edhe sa thellë i keni kuptuar ju mësimet e Partisë se prona e përbashkët ko-

lektive është e vetmja rrugë për rritjen e pandërprerë të mirëqenies së fshatarësisë.

Masat e tjera që keni marrë për të luftuar zakonet e egra të kanunit, siç janë pabarazia e gruas në punë e në familje, besimet e kota fetare etj., që trashëguam nga e kaluara, si dhe vendimet që kanë të bëjnë me mënyrën e jetesës dhe përmirësimin e nivelit të higjienës në fshat, janë, gjithashtu, për t'u lavdëruar.

7801 Kongresi i 5-të i Partisë përcaktoi një program të madh pune për zhvillimin me një ritëm më të shpejtë të bujqësisë e blegtorisë sonë, sidomos në fshatrat malore, për ngritjen më të shpejtë të nivelit të jetës e të kulturës së malësorëve tanë heroikë. Përpjekjet për zbatimin e këtij programi ju i keni filluar mbarë në fshatin tuaj. Komiteti Qendror i Partisë dhe unë kemi bindjen se ju nuk do t'i kurseni mundin dhe djersën për zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë suaj kolektive, për të mirën tuaj dhe të atdheut tonë socialist që lulëzon çdo ditë e më shumë dhe qëndron i papërkulur përpara armiqve imperialistë dhe revizionistë modernë, hrushovianë e titistë, ndaj të cilëve të mos e shuajmë kurrë vigjilencën.

7800 Jetën e re, të lumtur e të begatshme socialiste, populli ynë po e ndërton me punën e vet të palodhur dhe kam besim se edhe populli i fshatit tuaj, i lidhur si mishi me kockën dhe me besim të plotë te Partia, me forcat, mençurinë dhe zotësinë që ju karakterizon ju, malësorëve trima, do të mobilizohet si një trup i vetëm për të zbatuar

gjer në një zotimet që ka marrë para Partisë dhe do ta kthejë shpejt fshatin e vet në një kooperativë të përparuar.

Pas ngritjes së kooperativës, tani ju bie detyra të kujdeseni për forcimin e saj të vazhdueshëm organizativ, në mënyrë që planet që vendosni vetë të realizohen, bile të tejkalohen. Në vendin tonë ligjin e bën populli që është në fuqi. Prandaj çdo ditë, e sidomos në mbledhjet e asamblesë, të këtij kuvendi të lartë të kooperativës, rrihni mendimet me njëri-tjetrin për problemet më të rëndësishme që ju dalin, diskutoni si duhet bërë puna më mirë dhe vendimet e marra bashkërisht, që shprehin dëshirën e vullnetin e anëtarëve të kooperativës, kërkoni nga organizatat-bazë e Partisë dhe kryesia e kooperativës që të zbatohen gjer në fund.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe timin ju uroj, juve, motra e vëllezër të Bugjonit dhe gjithë kooperativistëve patriotë të rrethit të Pukës, suksese gjithnjë më të mëdha në përparimin e kooperativës suaj bujqësore dhe në realizimin e plotë të iniciativave të përparuara dhe të vendimeve që keni marrë.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR FAMILJES SË AGRON ELEZIT**

**2 dhjetor 1967**

Të dashur Merushe e Mustafa Elezi,

Me hidhërim të madh mësova për rënien në krye të detyrës, nga tërmeti, të ushtarit të popullit, birit tuaj të dashur, Agronit, dhe vij me këtë rast t'ju shpreh ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Unë u preka thellë nga qëndrimi juaj prej patriotësh e revolucionarësh të vërtetë, që në çastet e vështira kur ju njoftuan për humbjen e djalit, ju nuk e qatë atë, as nuk u mposhtët nga hidhërimi, përkundrazi, me mendje të kthjellët e me ndërgegjegen e lartë që ju karakterizon, menduat menjëherë për vendin e lënë bosh në kufi, ku vigjilonte syshqiponjë biri juaj, dhe vendosët të pranoni vendimin e djalit tjetër, Mehmetit, për të kryer plotësisht detyrën e shenjtë të kufi-

tarit që nuk arriti ta çonte gjer në fund Agroniuja i paharruar.

Akti juaj dhe vendosmëria e Mehmetit janë një tjetër shembull i lartë patriotik e frymëzues për të gjithë punonjësit tanë, për rininë dhe ushtrinë tonë të lavdishme, që tregojnë se sa të gatshëm jeni ju, si i gjithë populli shqiptar, për mbrojtjen e interesave të lartë të atdheut. Njerëzit me virtyte të larta, që ndjekin me besnikëri të pakufishme mësimet e mëdha të Partisë, duken në çaste të vështira, prandaj Partia dhe gjithë populli ynë e çmojnë shumë lart qëndrimin tuaj patriotik.

Me këtë rast u uroj gjithë pjesëtarëve të familjes suaj shëndet e punë të mbarë në detyrat ku jeni duke punuar.

Juaji

*Enver Hoxha*

Gazeta «Kushtrimi», nr. 9,  
6 dhjetor 1967

**LETËR DREJTUAR  
NXËNËSVE DHE MËSUESVE TË SHKOLLËS  
PEDAGOGJIKE «SHEJNAZE JUKA»**

*Shkodër*

**7 dhjetor 1967**

Të dashur nxënës dhe mësues të shkollës  
pedagogjike «Shejnaze Juka»,

Bashkë me familjen punëtore dhe patriotë të  
Ismet Sali Bruçajt, për veprën e tij shembullore  
ndaj detyrës, keni një të drejtë të ligjshme të kre-  
noheni edhe ju, nxënësit dhe mësuesit e shkollës  
pedagogjike «Shejnaze Juka». Në shkollën tuaj, në  
gjirin tuaj, në gjirin e organizatës së Bashkimit të  
Rinisë së Punës të Shqipërisë, shoku juaj i paha-  
rruar, Ismeti, u brumos me idealet e larta patrioti-  
ke dhe revolucionare të Partisë. I frymëzuar nga  
këto ideale, megjithëse e kishte kryer me nder de-  
tyrën e mësuesit në fshatin e thellë malor Likaj

dhe përgatitej për të kryer po kështu, me nder, detyrën tjetër të lartë, atë të ushtarit të popullit, me iniciativën dhe vullnetin e hekurt që e karakterizonte, në vigjilien e festave të mëdha të Nëntorit, ai u nis për të takuar edhe një herë nxënësit e vet të dashur, për të gëzuar festat e shënuara së bashku me ta dhe për t'u çuar malësorëve trima të Likajt, si kurdoherë, edhe me këtë rast, fjalën e Partisë. Atë askush nuk e shtyu t'i hynte kësaj pune, në kushte aq të vështira, veç zërit të ndër-gjegjes së vet të lartë, idealit revolucionar të rrënjosur nga Partia në rininë heroike të vendit tonë. Vullnetin e tij të papërkulur për realizimin e këtij ideali nuk e mposhti asgjë, as furtuna e tërbuar, as paralajmërimet për rrezikun që e kërcënonte. Qëndrimi i tij ndaj detyrës është një shembull i lartë i vetive të mrekullueshme që ka edukuar dhe edukon Partia te njerëzit tanë, te brezi i ri i Shqipërisë.

Qëndrimi revolucionar i Ismet Sali Bruçajt është në vazhden e heroizmave të shumtë e të lavdishëm të mësuesve të shquar shqiptarë, që, në periudhën e gjatë të pushtimit otoman, dhanë trimërisht jetën për çështjen e gjuhës dhe të shkollës shqipe, në vazhden e aktit të madh heroik të Ndrec Ndue Gjokës dhe të komisarëve të tjerë të kuq të dritës që u bënë pishtarët e arsimit socialist dhe të fjalës së Partisë në malësitë tona. Ai është një flamur për armatën e madhe të mësuesve, që punojnë pa u lodhur për thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor në të gjitha

skajet e atdheut, nga Vermoshi në Konispol, për gjithë inteligjencien tonë popullore, që, përkrah punëtorëve dhe fshatarëve, merr pjesë aktivisht në thellimin e gjithanshëm të revolucionit tonë socialist, për gjithë rininë heroike të vendit tonë, e cila kudo është në ballë të luftës, në radhët e para të çdo aksioni revolucionar. Veçanërisht ai është një tjetër shembull i lartë frymëzimi për të gjithë ata të rinj e të reja, mësues e mësuese, punëtorë e specialistë të ndryshëm, të cilët, vullnetarisht, kanë vendosur që së bashku me malësorët tanë patriotë të luftojnë, të punojnë e të jetojnë në zonat e thella malore për transformimin e gjithanshëm revolucionar dhe socialist të të gjithë vendit.

Jam i bindur se akti i lartë patriotik i Ismet Sali Bruçajt siç ju frymëzoi juve, nxënësve dhe mësuesve të shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka», duke u treguar të gatshëm për të shkuar kudo që ta lypë nevoja, siç frymëzoi maturantin e shkollës suaj të riun Bahri Jonus Pirin, shok i ngushtë qysh në fëmëni i Ismetit që shkoi ta zëvendësojë, do të frymëzojë edhe gjithë nxënësit, studentët, mësuesit dhe pedagogët, mbarë inteligjencien popullore dhe rininë heroike të vendit tonë, gjithë popullin tonë punonjës për vepra të reja heroike, për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tonë socialist, në mënyrë të veçantë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë dhe transformimin e mëtejshëm revolucionar të malësive tona kreshnike, për të zbatuar

kudo dhe me të gjitha forcat, pa kursim, po të jetë nevoja duke dhënë edhe jetën, porositë e Partisë sonë të shtrenjtë.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për arsimin dhe edukatën»  
(Përmbledhje veprash), botim  
i dytë, f. 403

Budapë

8 dhjetor 1987

I dashur shoku Ramadan,

Nga letra nënvore për fatkeqësinë e madhe, vdekjen nga tërmeti të gruas dhe djalit tuaj çka shtëmruar dhe në këto çaste të vështira e ndiej sikur jam aty, ndaj minatorëve heroikë të Bul-pizës dhe pranë familjes suaj, së cilës i shpreh ngushëllimet e mia më të përzemëta.

S'q më shpreh, ti dhe të shtëmit e tu gjatë në vetvete formë në të përballuar me kurajë këtë goditje të rëndë familjare. Kjo është një nga karakteristikat e mrekullueshme të shpirtit e në mënyrë të veçantë të minatorëve tanë heroikë. Përpara vështirësive njerëzve e kalitit nuk mposhten, por shikojnë me optimizëm gjithnjë për-

# LETËR DREJTUAR SHOKUT RAMADAN DEDA

*Bulqizë*

8 dhjetor 1967

I dashur shoku Ramadan,

Nga letra mësova për fatkeqësinë e madhe, vdekjen nga tërmeti të gruas dhe djalit tuaj gjashtëmuajsh dhe në këto çaste të vështira e ndiej sikur jam aty, midis minatorëve heroikë të Bulqizës dhe pranë familjes suaj, së cilës i shpreh ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Siç më shkruan, ti dhe të afërmit e tu gjetët në vetvete forca për ta përballuar me kurajë këtë goditje të rëndë familjare. Kjo është një nga karakteristikat e mrekullueshme të shqiptarit e në mënyrë të veçantë të minatorëve tanë heroikë. Përpara vështirësive njerëzit e kalitur nuk mposhten, po shikojnë me optimizëm gjithnjë për-

para. Këto cilësi të çmuara të popullit, Partia i ka ngritur sot në një shkallë të paparë. Këtë e dëshmojnë aktet heroike të masave tona të fshatit e të qytetit, si heroizmi i Adem Rekës, cucës trimëshë nga Dukagjini, Shkurte Pal Vatës, trimit pa sy, Fuat Çelës, e sa e sa të tjerëve që me luftën, me punën e me qëndrimet e tyre janë bërë shembull frymëzimi e vendosmërie dhe kanë çuar peshë gjithë popullin për zbatimin e mësimëve të Partisë.

Ju humbët gruan, shoqen tuaj të jetës, dhe djalin, viktima të tërmetit të 30 nëntorit, që na shkaktoi dëme të mëdha në njerëz e materiale, si në rrethin tuaj, ashtu dhe në atë të Librazhdit. Po pikërisht në këto çaste të vështira për masat punonjëse të këtyre dy rretheve, Partia dhe Qeveria, që morën masa energjike e të menjëherëshme për t'ju ardhur në ndihmë, si dhe gjithë populli shqiptar, në këto ditë vështirimin e kishin dhe e kanë nga vëllezërit dibranë e librazhdas. Edhe një herë shpërtheu kudo në vendin tonë ndjenja e lartë e solidaritetit dhe e patriotizmit socialist. Me mijëra njerëz, nga të katër anët e atdheut, ju kanë ardhur për të qenë sa më pranë jush, për të lehtësuar dhimbjen e rëndë të atyre që humbën njerëzit e dashur të familjes, si dhe për t'ju ndihmuar me të gjitha forcat e tyre për kapërcimin sa më shpejt të dëmeve materiale. Kështu punohet e jetohet sot te ne «një për të gjithë dhe të gjithë për një».

Ju uroj, shoku im i dashur minator, të të

rrojnë vajzat dhe gjithë të dashurit e tjerë. Këtej e tutje paçi kurdoherë lumturi në familje dhe suksese në punë. E gëzofshi përjetë shtëpinë e re që po ndërtoni me ndihmën e vëllezërve vullnetarë që ju kanë ardhur nga krahinat e ndryshme, të cilëve u jepni të fala nga ana ime.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
XHEVO DHE IDAJET KOÇIUT**

*Tiranë*

**9 dhjetor 1967**

Të dashur shoqja Xhevo dhe shoku Idajet,

Ju përgëzoj nga zemra për iniciativën që morët për të shkuar në Hormovë, si dhe për vendimin që mori vëllai për të shkuar në kooperativën bujqësore të Vërzhezhës, ku do të punojë krah për krah fshatarëve patriotë dhe të riut revolucionar pa sy, Fuat Çelës. Me këtë rast ju uroj juve suksese në punën që do të bëni në fshat, ku, si komunistë dhe punonjës të shëndetësisë, do të shkrini të gjitha energjitë për ngritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të fshatit të dashur të lindjes.

Jam i bindur se me veprimtarinë tuaj të palodhur, që ditën e parë që do të mbërrini në koo-

perativë dhe vazhdimisht, ashtu si u ka hije komunistëve, ju do të punoni për ta ngritur kurdoherë lart emrin e anëtarit të Partisë sonë të lavdishme të Punës.

Ju përshëndes

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **LETËR DREJTUAR EFEKTIVIT TË REPARTIT «N» TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

**13 dhjetor 1967**

Të dashur shokë,

Krah për krah qindra e mijëra vullnetarëve të nisur nga të katër anët e atdheut, si edhe reparteve të ndryshme të forcave tona të armatosura, nga të parët që shkuan në rrethet e Peshkopisë dhe të Librazhdit për të ndihmuar popullsinë që pësoi dëme të rënda nga tërmeti, ishte edhe efektivit i repartit tuaj.

Ju përgëzoj, të dashur shokë kufitarë, për aktin tuaj të lartë patriotik, për solidaritetin vëllazëror, gatishmërinë, mobilizimin e hovin revolucionar që treguat e po tregoni gjatë punës së palodhur për zhdukjen sa më shpejt të pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore.

Falënderoj, gjithashtu, me gjithë zemër ushtarët e efektivit tuaj që, duke vënë interesat e lartë të popullit mbi gjithçka, megjithëse e plotësuan kohën e shërbimit ushtarak, shprehën vullnetin për të qëndruar edhe më në repart, së bashku me shokun e tyre Mehmet Elezin, vëllanë

e dëshmorit Agron Elezi, që ra në krye të detyrës disa ditë më parë. Partia krenohet me patriotizmin e shquar dhe vendosmërinë tuaj, por ju e dini se vendi që do të lini nuk do të mbetet bosh, sepse bij të tjerë të popullit do të vijnë t'ju zëvendësojnë. Ata do ta kryejnë ashtu si dhe ju, me ndërgjegje të lartë, shërbimin, ndërsa ju, pasi e kryet me nder detyrën e caktuar, po ju presin punë të mëdha atje ku keni familjet, në fabrika, uzina, kooperativa e kudo, ku jam i bindur se do të zbatoni me besnikëri mësimet e Partisë, do të punoni me të njëjtën frymë dhe do të shpini atje shpirtin e organizimit dhe të disiplinës ushtarake, me të cilat u mbrujtët në repart, për lulëzimin dhe forcimin e pareshtur të Republikës sonë Popullore. Partia është e sigurt se në çdo kohë që të jetë nevoja, ju si një trup i vetëm dhe menjëherë, do t'i përgjigjeni çdo thirrjeje të saj për mbrojtjen e atdheut nga cilido armik që do të guxojë të cenojë kufijtë tanë të shenjtë.

Ju uroj, të dashur shokë, suksese në detyrën fisnike të kufitarit, në punën ndërtimtare në ndihmë të zonave të dëmtuara, si dhe në punët që ju presin tani pas çmobilizimit.

Përqafime

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR FAMILJES SË TOSUN SHAHINASIT

21 dhjetor 1967

E dashur nënë Shaqe,

E dashur motër Anife,

Të dashur shokë e vëllezër të të paharruarit  
Tosun Shahinasi,

Në vrullin e solidaritetit të madh revolucionar që shprehu gjithë populli ynë për të ndihmuar motrat dhe vëllezërit e Librazhdit e të Dibrës që u dëmtuan nga tërmeti, djali juaj Tosuni, nënë Shaqe, dhe bashkëshorti juaj, shoqja Anife, bir besnik i popullit, patriot e revolucionar i vendosur për çështjen e Partisë, i dashur dhe i shtrenjtë për familjen tuaj dhe për të gjithë, shkoi nga të parët në Librazhd, ku punoi me vetëmohim, duke mos kursyer asgjë, gjersa në punë e sipër dha edhe jetën. Një ndjenjë e fortë hidhërimi përshkoi të madh e të vogël, anemba-

në Shqipërisë, prandaj në këto çaste të vështira dhe i prekur thellë nga kjo humbje e rëndë për familjen, për shokët e kolektivit ku punonte dhe për të gjithë, ju dërgoj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Familja juaj është një familje me tradita patriotike, pjesëtarët e saj janë gjakosur me armiq-të e atdheut qysh përpara kundër shovinistëve grekë dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, në të cilën morën pjesë aktive me armë në dorë. Sakri-fica e Tosunit është një akt tjetër i lartë patriotik e revolucionar në vargun e pambaruar të heroiz-mave të popullit tonë trim e legjendar.

Rënia e Tosunit në krye të detyrës do të bë-het një tjetër shembull i lartë frymëzimi dhe do t'i ndezë më shumë zemrat e fshatarëve tanë patriotë, të klasës sonë heroike punëtore, të ush-tarëve trima të Shqipërisë, të grave e të rinisë sonë, do të bëjë që të vlojë tek të gjithë, akoma më tepër, dinamizmi revolucionar për çështjen e madhe të Partisë e të popullit.

Ti, e dashur nënë Shaqe, me kurajën dhe qëndrimin tënd të papërkulur përpara humbjes së djalit, na kujton nënat heroike shqiptare, që historia i përmend me respekt për trimërinë, ur-tësinë dhe papërkulshmërinë e tyre. Ti linde dhe edukove kaq fëmijë, që u bënë partizanë dhe më pas punëtorë e kooperativistë të dalluar, si To-suni, oficerë guximtarë të ushtrisë sonë, i edu-kove ata me traditat patriotike të familjes dhe të popullit tonë, që po zhvillohen çdo ditë më lart nga Partia.

57 p. Ti, e respektuar motër Anife, bashkëshortja e Tosunit, ashtu si nëna e tij, nuk e qave shokun tënd të jetës, por, si një trimëreshë, krah për krah vëllezërve, kushërinjve e miqve të tij, pa u përkulur aspak para ngjarjes së hidhur, shkove menjëherë për të vazhduar gjer në fund punën e tij të lavdishme ndërtimore në rrethin e Librazhdit. Ky akt i lartë patriotik e revolucionar do të mbetet në historinë e lavdishme të gruas shqiptare si një shembull i lartë frymëzimi për gratë dhe vajzat e vendit tonë, për gjithë popullin tonë, për t'u hedhur me forca dhe energji të shumëfishuara në punë, në luftë, në revolucion, me një vrull akoma më të madh.

Një epokë heroike po jeton sot populli shqiptar. Mrekulli të papara po bëhen në Shqipëri. Njerëzit punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit. Disa edhe bien në fushën e nderit, por me dhjetëra, me qindra, me mijëra ngrihen. Gjithë populli është sot në këmbë dhe, nën udhëheqjen e sigurt të Partisë, po korr fitore pas fitorësh, sepse të gjithë, të bashkuar si një trup i vetëm, kanë një ideal të madh të përbashkët, lirinë dhe pavarësinë e atdheut, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë, lumturinë e këtij populli heroik, prandaj s'ka pengesa, s'ka vështirësi, s'ka e s'do të ketë asnjë fatkeqësi e hidhërim që do të na ndalë në rrugën tonë. Provë për këtë është edhe shembulli i lartë patriotik i familjes suaj.

Më lejoni, të dashura mëmë Shaqe, motër

Anife, ju pjesëtarët e familjes dhe shokë e miq të Tosunit që shkuat të kryeni atë detyrë që ai s'arriti ta çojë gjer në fund, t'ju dërgoj njëkohësisht përshëndetjet e mia revolucionare dhe t'ju uroj të gjithëve shëndet, punë të mbarë e dalshi faqebardhë!

Juaji

Enver Hoxha

«Për gruan» (Përmbledhje veprash), f. 341

## LETËR DREJTUAR POPULLIT TË ZONËS SË GORËS

Korçë

2 dhjetor 1968

Të dashur shokë të këshillit popullor,

Të dashur fshatarë të zonës heroike të Gorës,

Në punën e madhe ndërtimore që po bën populli ynë për të vënë në jetë detyrat madhështore që shtroi Kongresi i 5-të i Partisë për ndërtimin e plotë të socializmit, në luftën që ai po bën për revolucionarizimin e gjithanshëm të vendit, një entuziazëm i paparë ka pushtuar punëtorët, fshatarët dhe inteligjencien tonë për të zbatuar vendimin historik të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë për elektrifikimin e gjithë fshatrave.

Ashtu sikurse në të katër anët e Shqipërisë, një punë të palodhur keni bërë e po bëni edhe ju

malësorët trima të zonës së Gorës për elektrifikimin e fshatrave, duke arritur deri në ngritjen e ndërtesës së hidrocentralit dhe tani po pritni të vendosni makinerinë. Prandaj, për këtë qëllim, po ju dërgoj hidroturbinën me fuqi 100 kilovat, prodhuar nga duart e arta të punonjësve të kolektivit të uzinës «Enver» të Tiranës, të cilët ma patën dhuruar mua me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes.

Të dashura motra dhe vëllezër,

Jam shumë i gëzuar që kjo turbinë do t'u japë dritë elektrike fshatrave të krahinës së Gorës kreshnike, njëres nga bazat e para të Lëvizjes Nacionalçlirimtare që udhëhoqi Partia jonë e lvdishme në luftën kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit.

Ashtu si gjatë luftës për çlirimin e atdheut e të popullit ju ndatë kafshatën e bukës dhe u dhatë komunistëve e partizanëve çdo ndihmë, mbushët edhe vetë radhët e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare me bijat dhe bijtë tuaj më të mirë, edhe pas Çlirimit ju përqafuat me besim të pa-tundur vijën e drejtë të Partisë për ndërtimin e socializmit në fshat, u bashkuat në kooperativat bujqësore dhe sot jeni duke arritur sukseset e para.

Jam i bindur se ju, fshatarë të zonës heroike të Gorës, edhe në të ardhmen do të mbani si kurdoherë lart traditat e shkëlqyera të Luftës

Nacionalçlirimtare, do të forconi gjithnjë e më shumë dashurinë e besnikërinë tuaj të madhe për Partinë e Punës të Shqipërisë, organizatoren e të gjitha fitoreve tona, do të mbani ngjeshur krahas kazmës edhe pushkën e gjerdanin me fishekë për t'i dhënë përgjigjen e merituar çdo armiku të pabesë, të jashtëm apo të brendshëm, do të punoni për të arritur gjithnjë e më mirë suksese të reja në ndërtimin socialist të fshatit, në thellimin e pandërprerë të revolucionit tonë ideologjik, në luftën klasore kundër çdo shfaqjeje që pengon ecjen tonë përpara, në luftën kundër zakoneve të vjetra dhe për rrënjosjen e normave të reja socialiste.

Ju uroj, të dashura motra dhe vëllezër, kurdoherë përparim dhe suksese në punë për mbarëvajtjen e kooperativave tuaja dhe e gëzofshi përjetë e mot dritën elektrike që Partia po çon kudo në të katër anët e atdheut.

Përhëndetje revolucionare

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
TË RINJVE DHE TË REJAVE TË QYTETIT  
DHE TË LOKALITETIT TË QENDRËS  
NË RRETHIN E DIBRËS**

**12 dhjetor 1968**

Të dashur të rinj dhe të reja të qytetit dhe të lokalitetit të Qendrës në rrethin e Dibrës,

Hovi revolucionar që ka përfshirë vullnetarët e aksioneve të rinisë të rrethit tuaj, ashtu si gjithë rininë heroike të vendit tonë për të çuar deri në fund mësimet e porositë e Partisë, siç mësova nga letra që më dërguat, më gëzon shumë.

Ju, të dashur shokë dhe shoqe, jeni nga ata vullnetarë të veprave të mëdha të socializmit, që këtë vit morët pjesë në ndërtimin e Hekurudhës Rrogozhinë—Fier dhe në rrugën e Malësisë së Madhe. Tani që jeni kthyer pranë njerëzve tuaj të dashur, si bij besnikë të Partisë dhe të popullit, po punoni me vrull, dinamizëm e vendosmëri

në radhë të parë për revolucionarizimin e pandërprerë të mendjes e ndërgjegjes, që të kaliteni çdo ditë e më shumë nga ana ideologjike, politike e kulturore, të armatoseni me frymën e luftës klasore, për të qenë kështu në gjendje të kapërceni çdo vështirësi e pengesë që mund t'ju dalë në punë dhe në jetë. Kështu do të mund të realizoni si duhet detyrat që populli dhe Partia ju kanë ngarkuar për përparimin e lulëzimin e pandalshëm të vendit tonë në rrugën e socializmit, për forcimin e vazhdueshëm të fuqisë mbrojtëse të atdheut.

Të frymëzuar nga puna, veprimtaria revolucionare dhe jeta kolektive në aksionet, ju u treguat jo vetëm punëtorë të palodhur, po edhe nxënës të mirë dhe tani po i hyni me vullnet e këmbëngulje një iniciativë të re shumë të lavdërueshme, studimit të Historisë së Partisë dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme të saj. Ju përgëzoj nga zemra për këtë iniciativë, sepse duke njohur mirë e thellë rrugën e drejtë luftarake marksiste-leniniste të Partisë sonë, duke studiuar me vëmendje direktivat e porositë e saj të vazhdueshme dhe duke luftuar me këmbëngulje për t'i vënë ato në jetë, ju do të qëndroni kurdoherë në pozita revolucionare, do të mbeteni kurdoherë luftëtarë të guximshëm për shembjen e së vjetrës e për të afirmuar të renë përparimtare, do të bëheni ndërtues të denjë të shoqërisë sonë socialiste.

Më gëzon, gjithashtu, shumë këmbëngulja

juaj, sidomos e të rejave, që po tregohen të gatshme për të marrë me guxim detyra me përgjegjësi, si skuadërkomandante, llogaritare, brigadiere etj. dhe po bëni të gjitha përpjekjet për të justifikuar me punë të palodhur besimin e madh që kanë te ju Partia dhe populli.

Komiteti Qendror i Partisë ka bindjen e plotë se, duke mbajtur kurdoherë lart frymën revolucionare të aksioneve, ju do të mobilizoheni pa rezerva për t'i vënë në jetë me përpikëri zotimet që keni marrë para Partisë, për të cilat ju uroj nga zemra sukses të plotë dhe dalshi kurdoherë faqebardhë.

**Juaji**

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOQES GJELA LLESHI, DOMGJON I FANIT

*Mirditë*

**23 dhjetor 1968**

E dashur nënë Gjela,

Ju falënderoj familjarisht ty, Lizën dhe fëmijët për urimet që më dërguat me rastin e festave të mëdha të 28 e 29 Nëntorit. U gëzova shumë që jeni të gjithë mirë dhe punët në kooperativë po ju shkojnë mbarë.

Nga letra mësova se, së bashku me gjithë bashkëfshatarët e kooperativës bujqësore të Domgjonit, duke vënë në jetë mësimet e Partisë, ju i keni pritur festat e Nëntorit me përparime në mënyrën e jetesës, me rezultate më të mira në bujqësi, si dhe me përfundimin e ndërtimit të rrugës automobilistike. Mua dhe gjithë shokëve të mi na bëhet zemra mal kur shikojmë që malësorët tanë trima e punëtorë po punojnë pa u lo-

dhur, siç i mëson Partia, për ndërtimin e jetës së re socialiste në malësi, për t'i bërë edhe zonat e thella të atdheut tonë të përparuara çdo ditë e më tepër.

Me planet e ardhshme që kanë caktuar Partia dhe Qeveria, vendi ynë do të ecë edhe më shpejt në të gjitha drejtimet, sepse ne kemi një forcë të pandalshme që na shtyn të ecim gjithnjë përpara. Kjo forcë qëndron te populli ynë i mrekullueshëm heroik, pasardhës i heronjve e i dëshmorëve të shumtë të paharruar të luftërave çlirimtare e të ndërtimit të socializmit, qëndron tek të gjithë burrat, gratë, të rejtat e të rinjtë e deri te fëmijët tanë, të cilët, të frymëzuar nga mësimet e Partisë dhe nën udhëheqjen e saj të urtë, janë hedhur me një vrull të madh të paparë, që vendi ynë të bëhet më i begatshëm e i pathyeshëm, ashtu siç na e kanë lënë amanet ata që dhanë jetën për këtë truall të shtrenjtë.

Ju përgëzoj për punën e mirë që po bëni dhe ju uroj të dilni faqebardhë me zotimet që keni marrë para Partisë, për ta bërë kooperativën tuaj shembull në të gjithë malësinë, si dhe për të luftuar për zhdukjen nga rrënjët të zakoneve prapanike e mbeturinave fetare, për të zhvilluar e forcuar ekonominë e përbashkët kooperativiste, që jeta juaj aty në malësi të bëhet çdo ditë e më e mirë.

Për kërkesën që më bënit për një makinë për kooperativën tuaj, bisedova me shokët e Qeverisë, të cilët porsa më njoftuan se jua kanë si-

guruar. Punofshi me shëndet dhe paçi përherë e më shumë suksese në forcimin e ekonomisë suaj kolektive.

Së bashku me Nexhmijen dhe fëmijët ju urojmë, nënë Gjela, ty dhe Lizës shëndet të mirë dhe fëmijëve përparime në mësim dhe në detyrat shoqërore që të na rriten e të bëhen të vlefshëm për popullin dhe atdheun, për interesat e lartë të të cilëve baba i tyre, punëtor i palodhur dhe trim sypatrembur, sakrifikoi jetën në krye të detyrës.

Ju përqafoj të gjithë

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR POPULLIT TË LIBOHOVËS

Gjirokastër

28 dhjetor 1968

Të dashur shokë libohovitë,

U gëzova shumë kur mora vesh se me punën tuaj të palodhur për të vënë sa më parë në jetë vendimin e Komitetit Qendror të Partisë për elektrifikimin e gjithë vendit, këto ditë edhe qyteti juaj po merr dritë elektrike.

Gëzimin që vlon sot në zemrat tuaja e ndiejmë të gjithë ne, Partia dhe populli ynë, që me respekt mbajnë kurdoherë të gjallë kujtimin e birit të denjë të Libohovës dhe të Shqipërisë, Avni Rustemit, i cili, duke mishëruar ndjenjat patriotike e revolucionare të popullit tonë heroik, luftoi pa u përkulur kundër shtypjes e shfrytëzimit feudal dhe reaksionit të klasave sunduese, për demokracinë, tokën dhe lirinë e atdheut.

Populli trim e përparimtar i Libohovës, duke ndjekur traditat e tij patriotike revolucionare, nën udhëheqjen e Partisë mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare kundër pushtesve e tradhtarëve gjer në Çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit popullor.

Gjatë viteve të ndërtimit socialist, duke i qëndruar kurdoherë besnikë vijës së Partisë, ju keni bërë përparime të mëdha në të gjitha fushat e jetës, keni marrë pjesë aktive në zhvillimin e lëvizjeve revolucionare që kanë shpërthyer kudo në vendin tonë për thellimin e mëtejshëm të revolucionit socialist.

Me këtë rast, të dashur shoqe dhe shokë, motra e vëllezër të Libohovës, ju përgëzoj për punën që keni bërë për elektrifikimin e qytetit tuaj të bukur. E gëzofshi përjetë e mot dritën që po ju jep Partia dhe, me rastin e Vitit të Ri, ju uroj të gjithëve punë të mbarë kudo që punoni, gëzim e lumturi.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR MRIKË E LLESH SYZIUT DHE GJON LLESH SYZIUT

*Malaj—Mirditë*

**29 janar 1969**

Të dashur Mrikë e Llesh Syziu,

I dashur shoku Gjon Llesh Syziu,

Nga letra juaj mësova se, pas aksidentit të rëndë që i ndodhi në detyrë e sipër Gjonit, kur ishte duke kryer shërbimin ushtarak, tani ndodhet fare mirë me shëndet dhe për këtë u gëzova shumë. Unë u gëzova, gjithashtu, që ju, prindërit e tij, Mrikë e Llesh Syziu, jeni mirë dhe, pavarësisht nga dhimbja që ju shkaktoi ajo që ndodhi me Gjonin, nuk u ligështuat aspak, por po qëndroni të patundur si burrat dhe i jepni atij zemër që, edhe kështu siç është, me mundësitë e kufizuara fizike që i kanë mbetur, të vazhdojë

të punojë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Bile ju as ditët e para, kur akoma nuk ishit të sigurt nëse Gjoni do të shpëtonte ose jo nga vdekja, s'e dhatë veten, përkundrazi, ndiheshit krenarë që djali juaj, këtë fatkeqësi të rëndë që i ra në krye të detyrës, e përballoi gjithashtu pa u përkulur nga dhimbjet. Dhe jo vetëm kaq, të dashur miq të mi, por shumë të vendosur ju i jepni fjalën Partisë të vazhdoni të punoni kudo që të kenë nevojë atdheu dhe Partia. Ky është një qëndrim shembullor e frymëzues që, si të gjithë, edhe mua më ka entuziazmuar jashtëzakonisht shumë dhe me këtë rast vij aty pranë jush t'ju sjell përqafimet dhe të falat e mia më të përzemërta.

Në letrën aq të ngrohtë që më dërguat, ju shprehni ndjenjat më të pastra të dashurisë për Partinë, popullin dhe atdheun tonë të dashur për mbrojtjen e të cilëve çdo shqiptar i ndershëm është i gatshëm të sakrifikojë gjithçka. Partia, të dashur Mrikë, Llesh e Gjon, me qëndrime si ky juaji, që shprehin një patriotizëm të zjarrtë dhe një dashuri të madhe për atdheun dhe popullin, frymëzohet dhe i shtohen pa kufi forcat për ta udhëhequr kurdoherë e më mirë vendin tonë në rrugën e lumtur të socializmit. Prandaj unë ju përgëzoj me gjithë zemër për këtë qëndrim të lartë burror dhe patriotik.

Puna e Gjoni gjatë kryerjes së detyrës ushtarake është gjithashtu një shembull i lavdërueshëm, që u shtohet sa e sa shembujve të tjerë të

ushtarëve tanë trima dhe të gjithë bijave e bijve të vendit tonë që kudo, në ushtri, në miniera, fabrika, kantiere, në kooperativa etj., punojnë me vetëmohim e pa bujë për të ndërtuar jetën e lumtur socialiste dhe qëndrojnë ditë e natë në rojë për ruajtjen nga çdo armik të fitoreve të arritura me gjak, mund e sakrifica të panumërta.

Unë u gëzova shumë që edhe shokët e re-partit ushtarak ku shërbente, dhe personeli i spitalit ku u shtrua Gjoni, i qëndruan pranë në ditët e vështira të fatkeqësisë; shumë nga ata dhuruan edhe gjakun e tyre dhe i qëndruan ditë e natë pranë për t'i shpëtuar jetën shokut të tyre të shtrenjtë. Ata vepruan ashtu siç i ka edukuar Partia, me ndjenjën e dashurisë së thellë për shoku-shokun, dhe treguan me këtë rast se e kanë bërë të tyren parullën e Partisë: «Të gjithë për një dhe një për të gjithë», duke bërë çmos për t'ia lehtësuar vuajtjet Gjonit tuaj, shokut e vëllait të tyre të dashur dhe, sa të ishte e mundur, t'ia bënin jetën pas shërimit sa më pak të vështirë. Të tillë njerëz, me një dashuri të pakufishme për njeriun, ka edukuar dhe edukon përditë Partia në vendin tonë, pasi njeriu në socializëm është kapitali më i çmuar. Me këtë solidaritet socialist, me këtë dashuri të thellë për njëri-tjetrin, që po brumos Partia te njerëzit tanë, është çimentuar e po çimentohet dita-ditës ai unitet i çeliktë i popullit me Partinë e vet, që s'ka forcë në botë ta dëmtojë.

Ti, i dashur Gjon, më shkruan se ke ndër mend të punosh e të vazhdosh njëkohësisht shkollën. Të përgëzoj për këtë vendim tëndin të drejtë e revolucionar dhe do të porosis shokët e Partisë që të kujdesen të ta plotësojnë këtë dëshirë të ligjshme.

Në vendin tonë edhe invalidët, ashtu si dhe pensionistët, me gjithë mundësitë e tyre fizike të kufizuara, si pjesëtarë aktivë të shoqërisë sonë socialiste, gjejnë forca në veten e tyre për të dhënë edhe ata gjatë gjithë jetës kontributin e tyre për të mirën e atdheut e të popullit. I tillë si ti është invalidi Nuredin Hoxha në Elbasan, i cili, megjithëse i ka gjithashtu të dyja këmbët të prera, punon në mënyrë të lavdërueshme si mekanik dhe është bërë një racionalizator i shquar, duke dhënë një shembull të lartë frymëzues të qëndrimit socialist ndaj punës.

Shumë më gëzuan dëshira e gatishmëria që shprehni ju, prindërit e Gjonit që, me gjithë moshën tuaj, më shfaqni dëshirën të shërbeni kudo që ta kërkojë nevoja e atdheut. Unë ju falënderoj për këtë qëndrim, për këto ndjenja kaq fisnike dhe për vendosmërinë që tregoni, por dua t'ju them se në vendin tonë njeriu në çdo front të ndërtimit socialist që të jetë, kudo ku punon dhe jeton, mund t'u shërbejë njëllëj Partisë, popullit dhe atdheut, prandaj vazhdoni të punoni me ato mundësi që keni aty në Malaj, për zbukurimin e për forcimin e kooperativës suaj bujqësore, e cila, si kooperativë e re, ka me siguri nevojë për forcën

e mendjes dhe të krahut të të gjithë anëtarëve të vet.

Ju uroj të gjithëve shëndet dhe lumturi.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 25 (6377), 30 janar 1969*

**LETËR DREJTUAR LULASH  
DHE PASHKË PJETËRNIKËS NË FSHATIN  
SHËNGJERGJ TË LEKBIBAJT**

*Tropojë*

**7 maj 1969**

Të dashur Lulash dhe Pashkë,

Para disa ditësh mora letrën tuaj, në të cilën më shkruani për të kaluarën e hidhur, plot mundime e vuajtje të familjes suaj, si dhe për të tashmen e lumtur që jetoni.

Babai yt, Lulash, Beku, ashtu si shumë e shumë malësorë patriotë, luftoi me armë në dorë së bashku me heroin e Dragobisë, Bajram Currin, për të hequr qafe zgjedhën e dyfishtë që rëndonte mbi popullin tonë nga armiqtë e huaj dhe bashkëpunëtorët e tyre brenda vendit. Edhe vëllai yt Zefi, duke vazhduar traditat patriotike të babait, u lidh me Lëvizjen Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia jonë heroike, e cila i solli popullit çlirimin kombëtar dhe shoqëror.

Ju të dy nuk patët mundësi të merrnit pjesë në revolucionin popullor, pse atëherë ishit të vegjël, por, siç më kanë treguar shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit, ju ishit nga të parët që u futët në kooperativën bujqësore dhe tani jeni bërë shembull i mirë në punë. Ti Lulash ke marrë pjesë në aksione lokale e kombëtare, ndër- sa ti Pashkë, megjithëse me fëmijë të vegjël, në pranverën e vitit të kaluar ke marrë pjesë në lëvizjen e fshatarëve nga Veriu në Jug, duke qëndruar dy muaj në kooperativat e rrethit të Korçës. Prandaj ju sot jeni luftëtarë të frontit të lavdishëm të ndërtimit të socializmit.

Dashuria e zjarrtë që ushqeni për Partinë dhe studimi me zell i dokumenteve të saj, ashtu sikundër më shkruani në letër, do t'ju fisnikërojnë mendimet dhe ndjenjat, do t'ju shumëfishojnë forcat dhe do t'ju hapin perspektivat për fuqizimin e mëtejshëm të ekonomisë së përbashkët.

Ju uroj shëndet dhe gjithë të mirat juve dhe shtatë çikave tuaja.

**Juaji**

**Enver Hoxha**

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR NXËNËSVE TË SHKOLLËS «HASAN KOÇI»

*Shkozet—Durrës*

**9 maj 1969**

Shumë të dashur miq të vegjël,

U gëzova dhe njëkohësisht u preka shumë nga letra që më dërguan dy shoqet tuaja të klasës së tretë, Eleni Duro e Dhurata Bilali. Ato më shkruanin se në ekskursionin që kishte organizuar shkolla, pasi mblodhën me kujdes lule të freskëta, i vendosën ato plot dashuri e respekt mbi varrin e dëshmorit Hasan Koçi, emrin e të cilit mban shkolla juaj. Kjo tregon se të edukuar me mësimet marksiste-leniniste të Partisë sonë, ju i mbani gjithnjë në zemër dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare, të cilët nuk kursyen as jetën e tyre për çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë e tradhtarët e vendit dhe që populli ynë

të shpëtonte një herë e përgjithmonë nga shtypja e shfrytëzimi i feudalëve, bejlerëve, borgjezëve dhe të bëhej zot i fateve të veta.

Brezi që kreu revolucionin dhe ai që do ta marrë e do ta çojë më tutje stafetën e tij, që do të ndërtojë shoqërinë e plotë socialiste dhe komunizmin në vendin tonë, kurrë nuk duhet të harrojnë gjakun e atyre që dhanë jetën për ditët e bukura të pranverës socialiste që ne gëzojmë sot.

Për ju, të dashur fatosa e pionierë, është nder i madh që shkolla juaj mban emrin e një dëshmori, prandaj përpiquni të mësoni, të punoni e të silleni sa më mirë, të rriteni dhe të bëheni sa më të vlefshëm për Partinë dhe popullin.

Ju përqafoj me dashuri

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për shokët e mi pionierë»,  
f. 351

## LETËR DREJTUAR SHOKUT RESHAT SHEHU

*Tepelenë*

**Përmet, 23 maj 1969**

I dashur shoku Reshat,

U gëzova shumë për telegramin e urimit dhe fjalët aq të ngrohta që më dërgove me rastin e festës së 25-vjetorit të Kongresit të Parë Antifashist Nacionalçlirimtar të Përmetit. Nga ana tjetër u hidhërova pa masë që në këtë ditë të shënuar ndodhesh i sëmurë dhe nuk ke mundësi të marrësh edhe ti pjesë me shokët në këtë gëzim të madh.

Por unë kam bindjen se ti do ta mposhtësh sëmundjen, do të bëhesh mirë dhe përsëri do të dalësh në mes shokësh për të dhënë si kurdoherë kontributin tënd të vlefshëm në shërbim të Partisë, popullit dhe atdheut.

Me këtë rast po të dërgoj si kujtim shenjën time të 25-vjetorit të Kongresit të Parë Antifa-

shist Nacionalçlirimtar të Përmetit që m'u dha sot si gjithë shokëve delegatë që morën pjesë në atë kuvend të madh popullor.

Edhe një herë, i dashuri shoku Reshat, të uroj shërim të shpejtë, jetë të gjatë dhe gjithë të mirat në familje.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR SHOQES DRANE GJOKA NË FSHATIN ARRËZ

*Kukës*

**26 qershor 1969**

E dashur Drane Gjoka,

Ju uroj nga zemra martesën ty dhe bashkëshortit tënd Qazimit, jetë të gjatë e lumturi në familjen që ngritët të dy bashkë mbi bazën e dashurisë së pastër e në luftë të papajtueshme me zakonet e vjetra dhe mbeturinat e lëna trashëgim nga klasat shfrytëzuese dhe feja.

Malësia ku u rrite ti, e dashur Drane, ka qenë në shekuj çerdhe trimash e patriotësh. Gjyshërit e prindërit tuaj brez pas brezi s'i kanë lëshuar kurrë armët nga dora për të mbrojtur me to lirinë e tyre, truallin e shtrenjtë, traditat e bukura, nderin dhe pasurinë. Megjithatë, si për gjithë popullin tonë, edhe për malësorët trima të Mirditës skamja, padituria, shtypja e egër e pushtuesve të huaj dhe e bajraktarëve e shfrytë-

zuesve të tjerë gjakpirës nuk u ndanë asnjëherë nga vatrat e tyre. Vetëm me Luftën e madhe Nacionalçlirimtare që organizoi dhe udhëhoqi gjer në fitoren e plotë Partia e lavdishme Komuniste Shqiptare, sot Partia e Punës, lindën ditë të bardha për mbarë popullin shqiptar. Partia i siguroi popullit lirinë e atdheut, e shpëtoi atë një herë e mirë nga çdo lloj shfrytëzimi, i siguroi mirëqenien materiale dhe dita-ditës po e pastron nga shumë të këqija që rëndojnë akoma në ndërgjegjen e njerëzve tanë të mrekullueshëm, siç janë zakonet prapanike, qëndrimet jo të drejta ndaj gruas, mbeturinat e fesë etj.

Është e kuptueshme që më të vjetrit, për shkak të moshës e të formimit që kanë marrë në të kaluarën, e kanë më të vështirë se të rinjtë për ta kuptuar menjëherë e për ta përqaftuar shpejt të renë përparimtare, prandaj ti e kupton drejt edhe qëndrimin që mbajti babait yt lidhur me martesën tënde me Qazimin. Megjithatë unë jam i bindur se ai që të do aq shumë, pavarësisht se u trondit ca nga kjo ngjarje, dëshiron me mish e me shpirt që ti të jetosh e lumtur në familjen që krijove. Në qoftë se yt atë, Marku, nuk e aprovoi menjëherë martesën tënde, mendoj që së shpejti ai do të bindet, pse është burrë i ndershëm, patriot, që e do Partinë dhe ka besim në këshillat e porositë e saj, pse jeta i ka provuar atij që ato janë për të mirën e popullit, të Shqipërisë, pra edhe për të mirën e tij e të familjes suaj.

Me veprimin e guximshëm që mbajtët në të

drejtën tuaj si të rinj, ti me Qazimin dolët fitimtarë mbi të vjetrën konservatore, por ju e keni të qartë se pa përkrahjen e plotë të Partisë, pa këtë gjendje të mrekullueshme që ajo ka krijuar në vendin tonë, dashuria juaj do të ishte e pamundur të realizohej. Ti e thua edhe vetë në letërën që më dërgove se në të kaluarën një ngjarje si kjo bëhej shkak i fatkeqësive të rënda midis dy palëve, që s'mbylleshin as për shumë breza me radhë.

U gëzova shumë për sa më shkruan se do të vazhdosh të jesh aktiviste për përhapjen e së resë. Unë të uroj të dalësh faqebardhë në vendimin tënd dhe të bëhesh kurdoherë shembull i mirë në punë dhe si aktiviste shoqërore. Së bashku me Qazimin dhe me gjithë të afërmit tuaj, ju uroj gjithë të mirat, shëndet e jetë të lumtur.

Një letër unë i drejtova edhe babait tënd<sup>1</sup>, kopjen e së cilës po ta dërgoj edhe ty.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Shih: Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. 1, f. 217.

## LETËR DREJTUAR SHOKUT HAXHI ÇEMERICA

*Maliq—Korçë*

**8 dhjetor 1969**

I dashur shoku Haxhi,

Letra që më dërgove me rastin e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe fitores së revolucionit popullor më gëzoi shumë. Ajo më zgjoi një ndër kujtimet e shumta të Luftës heroike Nacional-çlirimtare, kur populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, luftoi me vetëmohim për çlirimin e atdheut dhe vendosjen e pushtetit popullor.

Takimi ynë para 25 vjetësh në Qafën e Martës dhe shumë herë pas Çlirimit, më kujtohen si sot. Tek ti, shoku im i vjetër, si tek të gjithë njerëzit e thjeshtë të popullit që kishin rrokur armët për lirinë e popullit, unë pashë besimin e pafund të Partia dhe bindjen e patundur në fitoren e çështjes sonë të madhe. Tani pas 25 vjetësh,

çdo shqiptar patriot e revolucionar, me një ndjenjë kënaqësie dhe krenarie të ligjshme, shikon se ëndrrat shekullore të popullit tonë i bëri realitet Partia. Shumë nga realizimet e mëdha, fryt i punës së palodhur të popullit tonë, siç më shkruan në letër, ti i ke parë edhe vetë me vizitat që ke bërë në shumë krahina të atdheut, por vepra më e madhe e Partisë është njeriu që ajo edukoi dhe edukon në rrugën e saj për t'i shërbyer me të gjitha forcat atdheut, popullit të vet dhe fitores së marksizëm-leninizmit. Mësimet jetëdhënëse të Partisë na kanë përtërirë të gjithë, i dashur Haxhi, ato, siç më shkruan, të kanë frymëzuar e të kanë shumëfishuar forcat edhe ty për t'i shërbyer asaj si patriot dhe revolucionar i papërkulur, pavarësisht nga vjetët që të rëndojnë mbi supe, akoma më i vendosur se kurdoherë.

Me këtë rast të uroj nga zemra shëndet ty dhe gjithë pjesëtarëve të familjes, për t'i shërbyer në të ardhmen deri në fund, në rrugën e Partisë, atdheut dhe popullit tonë heroik.

Përqafime

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT ABAZ HOXHA  
NË FSHATIN ZGËRBONJË TË RRETHIT  
TË BERATIT**

**25 dhjetor 1969**

I dashur xha Abaz,

Letra jote, në të cilën shpreh gëzimin e madh që ndien për jetën e re që ka lindur e po lulëzon në vendin tonë nën udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe optimizmi yt revolucionar për të ardhmen akoma më të bukur që e pret popullin shqiptar, më ka prekur thellë.

Ke shumë të drejtë për ato që më shkruan, i dashur xha Abaz, pasi gjatë jetës tënde 90-vjeçare ti ke parë e dëgjuar shumë, ke jetuar e ndier mbi shpatulla periudhën e rëndë të sundimit otoman, pushtimin e Shqipërisë nga fqinjët grabitqarë e ushtritë imperialiste, regjimin shtypës feudal të Ahmet Zogut dhe pushtimin barbar fashist italo-gjerman, por ti ke jetuar gjithashtu

edhe përpjekjet me armë në dorë të popullit tonë për liri e pavarësi, veçanërisht Luftën heroike Nacionalçlirimtare, që i solli popullit lirinë e vërtetë, si dhe përpjekjet e tij titanike për ndërtimin me sukses të socializmit e mbrojtjen e atdheut nga çdo armik, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme.

Në këto ditë të lumtura plot vrull revolucionar, kur mbarë populli shqiptar porsa festoi me gëzim të papërshkruar 25-vjetorin e Çlirimit, duke i bërë thirrje kujtesës, ti solle ndër mend gjithë të kaluarën e zezë të vendit tonë për të krahasuar më mirë realitetin e sotëm madhështor të atdheut, që e ndërtuam vetë me duart tona mbi gërmadhat e asaj bote që për ne ka perënduar një herë e përgjithmonë. Në këto momente ngazëllimi, ty nuk t'u durua, por i diktove birit tënd letrën që më dërgove për t'i shprehur Partisë, me ato fjalë të thjeshta që të burojnë nga thellësia e shpirtit, ndjenjat e tua të dashurisë e të mirënjohjes për sa ajo ka bërë për popullin.

Çdo ditë, i dashur xha Abaz, marr letra të shumta që më dërgojnë njerëzit e thjeshtë të popullit tonë nga të katër anët e Shqipërisë. Në secilën prej tyre bëhen propozime për zgjidhjen e çështjeve nga më të ndryshmet, shprehen ndjenja e mendime nga më të pastrat me fjalët më të ngrohta për Partinë tonë heroike. Dhe të gjithë kanë plotësisht të drejtë, pasi vetëm Partia i bëri

realitet ëndrrat më të bukura të popullit për një Shqipëri të lirë, të fuqishme e të lulëzuar, për një jetë të begatshme e të lumtur për popullin, pa shkelës të huaj, shtypës e tradhtarë. Partia e bëri popullin zot në vendin e tij, i dha mundësi ta përmirësojë jetën e të zbukurojë mendjen e shpirtin e njerëzve, ajo ka krijuar në vendin tonë një atmosferë gëzimi, pune ndërtimtare e vrulli të paparë revolucionar. Me Partinë janë lidhur gjithë fitoret dhe gjithë gëzimet e popullit tonë, nderi, forca, begatia dhe prestigji i madh ndërkombëtar i Shqipërisë sonë socialiste. Për këtë arsye janë krijuar lidhje të çelikta midis Partisë e popullit dhe te këto lidhje qëndron forca jonë e madhe, që na bën të korrim vazhdimisht suksese, të përballojmë çdo pengesë e të mposhtim çdo armik. Me një popull të mrekullueshëm si ky yni, i udhëhequr me kaq urtësi e guxim nga Partia jonë heroike, atdheu ynë i dashur, si kurdoherë gjatë historisë, do të çajë vetëm përpara.

Për dëshirën që më shpreh për t'u pjekur me mua, të jap fjalën se kur të vij andej nga Berati, do ta rregulloj punën që të takohemi një herë e të kuvendojmë së toku gju më gju.

Të gjithë shokët dhe unë të urojmë shëndet të mirë, të rrosh akoma edhe shumë vjet të tjerë për të gëzuar jetën e re që ka sjellë në vendin tonë Partia jonë e dashur.

Me këtë rast, bashkë me letrën, po të dërgoj edhe një radio të vogël, e cila le të të shërbejë

për të dëgjuar çdo ditë zërin e fuqishëm të Partisë dhe lajme mbi punën e vrullshme që bëhet në të katër anët e Shqipërisë.

Juaji

*Enver Hoxha*

Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 308 (6660), 26 dhjetor 1969

# LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË NDËRMARRJES PYJORE

*Dibër*

26 dhjetor 1969

Të dashur shokë,

Së bashku me letrat e shumta, që masat punonjëse të vendit u dërgojnë Partisë dhe mua, për të njoftuar se si po i realizojnë me sukses detyrat e caktuara nga Kongresi i 5-të i Partisë, lexova me gëzim edhe letrën tuaj. Krahas mbarë popullit heroik dhe të talentuar dibran, që me aksionet e tij revolucionare me goditje të përqendruara ngriti peshë gjithë masat punonjëse të Shqipërisë, edhe ju, si bij të asaj krahine kreshnike, arritët të mbillni këtë vit për herë të parë 80 hektarë pyll me farë dhe të realizoni më së miri e para afatit treguesit kryesorë të planit tuaj të katërt pesëvjeçar.

Këto suksese u arritën në sajë të kuptimit të drejtë ideopolitik të detyrës nga ana juaj. Pikërisht aty e kanë burimin disiplina proletare e kolektivitetit, ndërjegjja e lartë socialiste, puna e palodhur e këmbëngulëse që keni bërë dhe bëni ju, kujdesi i vazhdueshëm që tregoni për edukimin marksist-leninist, për studimin e Historisë së Partisë, për ndjekjen e shkollave dhe ngritjen tuaj tekniko-profesionale. Ju arritët kudo rezultate, sepse e keni të qartë që pa iu kushtuar me të gjitha forcat përvetësimit të mësimeve të Partisë, pa vënë në plan të parë politikën proletare në çdo çështje dhe pa zotëruar si duhet profesionin, nuk mund të flaken tej mbeturinat e ideologjisë së huaj dhe të korren rezultatet e dëshiruara në punë.

Unë kam besim se punonjësit e kolektivitetit tuaj, me vrullin e shkëlqyer që karakterizon gjithë punonjësit e rrethit të Dibrës, dhe duke e bërë metodë aksionin revolucionar, nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, do të mobilizohen akoma më shumë, me rastin e fushatës së zgjedhjeve në Parti, për të kryer sa më mirë, me frymë e disiplinë proletare detyrat e ngarkuara, me qëllim që të meritoni, sikundër thoni në letër, titullin e nderit si ndërmarrje sulmuese e pesëvjeçarit të katërt.

Në këto ditë gëzimi, kur mbarë populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme, po e mbyll me rezultate të mëdha vitin 1969, i uroj

kolektivit tuaj revolucionar të gjitha të mirat,  
suksese akoma më të mëdha në punë dhe gëzuar  
Vitin e Ri 1970!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Ushtima e maleve»,  
nr. 105 (150), 31 dhjetor 1969*

# PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË AGJENCISË TELEGRAFIKE SHQIPTARE

29 dhjetor 1969

Të dashur shokë e shoqe,

Me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe në emrin tim personal ju përshëndes nxehetësisht ju, gazetarët dhe gjithë punonjësit e tjerë të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, dhe ju uroj suksese të mëtejshme në detyrën e rëndësishme që ju ka ngarkuar Partia.

E themeluar 25 vjet më parë, fill pas Çlirimit të Shqipërisë dhe fitores së revolucionit tonë popullor, Agjencia Telegrafike Shqiptare, si një nga repartet pararojë të propagandës së Partisë, ka milituar kurdoherë me partishmëri të lartë, ka bërë e po bën një punë të madhe e shumë të vlefshme për të çuar te masat puno-

njëse vijën e Partisë e për t'i mobilizuar ato në rrugën e transformimeve të mëdha socialiste.

Siglat e ATSH-së që u dukën në faqet e shtypit tonë që në ditët e para të Çlirimit, njoftonin për fitoren e arritur me punën vetëmohuese të popullit tonë që, pa hequr nga krahu pushkën, rrëmbeu kazmën për rindërtimin e fshatrave të djegura e qyteteve të rrënuara, për vendimet historike të Partisë e të pushtetit popullor, të cilat ishin lajmëtalet e një epoke të re që po agonte në vendin tonë. Në të njëjtën kohë ATSH-ja u bë një zë i fuqishëm që i komunikonte botës jo vetëm ekzistencën e shtetit tonë të ri socialist, por edhe këmbënguljen e vullnetin e paepur të një populli që kishte marrë në dorë fatet e tij dhe ishte i vendosur t'i mbrojë ato deri në fund, kundrejt çdo sakrifice.

Rruga e lavdishme dhe heroike që kanë kaluar Partia dhe populli ynë gjatë këtyre 25 vjetëve, është njëkohësisht edhe rruga e shtypit tonë. Agjencia Telegrafike Shqiptare, si zëdhënëse e Partisë dhe e shtetit tonë, si burim informacioni për të gjithë shtypin e propagandën e Partisë për brenda dhe për botën e jashtme, ka pasqyruar gjerësisht dhe me shkathësi realitetin madhështor të vendit tonë në marshim të pandërprerë, guximin, vendosmërinë, vrullin krijues dhe optimizmin revolucionar të masave tona punonjëse në ndërtimin dhe mbrojtjen e atdheut tonë socialist, si dhe politikën e drejtë marksist-leniniste të Partisë sonë në fushën ndërkombë-

tare. Në të njëjtën kohë, ajo ka kryer e kryen detyrën e rëndësishme për të informuar popullin tonë mbi zhvillimin e ngjarjeve në botë, sidomos të luftës së forcave marksiste-leniniste, të klasës punëtore dhe popujve liridashës kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Në kohën e sotme kur roli dhe autoriteti i Republikës Popullore të Shqipërisë në fushën ndërkombëtare janë rritur si asnjëherë, është rritur edhe roli i ATSH-së. Emisionet e saj, me anën e të cilave ajo bën të njohur në gjithë botën politikën e drejtë të Partisë dhe të Qeverisë sonë në ndërtimin e socializmit e në përkrahje të luftës së popujve për çlirim kombëtar e shoqëror, si dhe luftën parimore që Partia jonë ka bërë e bën kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, gëzojnë një popullaritet e përkrahje të fuqishme në vendet e huaja.

Të dashur shokë e shoqe,

Partia dhe Qeveria ju kanë ngarkuar detyra të rëndësishme. Hovi i pashembullt që ka shpërthyer anembanë atdheut për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit në bazë të mësimëve të Partisë, fitoret e njëpasnjëshme në ndërtimin e socializmit në Shqipëri, si dhe zhvillimi i gjendjes ndërkombëtare, kërkojnë nga ju që të perfeksiononi vazhdimisht punën. Duke jetuar akoma më afër me klasën tonë punëtore

dhe me masat e tjera punonjëse, në shkrimet tuaja duhet të pasqyroni e të përgjithësoni sa më qartë dhe sa më mirë eksperiencën e madhe të popullit tonë trim e të talentuar, fitoret që arrin ai në çdo skaj të atdheut; të ngrini gjithnjë e më shumë dijet e njohuritë tuaja ideopolitike e profesionale, të mësoni e të përvetësoni sa më thellë Historinë e Partisë sonë, këtë thesar shumë të çmuar për cilindo dhe për çdo kohë, të zbërtheni e të përvetësoni sa më mirë vendimet e direktivat e Partisë e të Qeverisë, ta bëni sa më të shkathët e të frytshme punën tuaj për të propaganduar në botën e jashtme vijën marksiste-leniniste të Partisë, fitoret e mëdha në ndërtimin e socializmit te ne, luftën e Partisë dhe të popullit tonë në mbrojtje të pastërtisë së marksizëm-leninizmit ngadhënjimtar, të demaskoni veprimet dhe komplotet djallëzore të koalicionit kundër-revolucionar imperialisto-revizionist.

Ju përgëzoj edhe një herë me këtë rast dhe shpreh besimin se kolektivi juaj, gazetarë, përkthyes, radistë e gjithë punonjësit e tjerë edhe në të ardhmen do të kryejnë kurdoherë me nder detyrat që u janë ngarkuar në këtë fushë të rëndësishme të propagandës së Partisë.

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 311 (6663), 30 dhjetor 1969*

**LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT  
TË STUDENTËVE DHE PEDAGOGËVE  
TË FAKULTETIT TË INXHINIERISË**

*Tiranë*

**6 janar 1970**

Të dashur studentë dhe pedagogë,

Mora letrën me të cilën më njoftonit që kolektivi juaj, duke vënë në jetë mësimet e Partisë, po punon me hov revolucionar për të zbatuar me sukses vendimin e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të PPSH për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë dhe se, duke u përfshirë aktivisht në aksionet me goditje të përqendruara, 300 studentë e pedagogë të degëve elektrike dhe mekanike plotësuan me sukses, brenda një dite, aksionin që ndërmorën për instalimet e brendshme elektrike në fshatrat Kastriot, Kukaj, Kander dhe Brest i Poshtëm të rrethit të Dibrës.

Duke gjykuar nga punët dhe veprimet tuaja duket që ju, të dashur studentë dhe pedagogë, keni kuptuar drejt detyrat e mëdha që Partia dhe populli kanë shtruar para shkollave tona të larta lidhur me përmirësimin dhe revolucionarizimin e punës për përgatitjen e specialistëve të rinj nga ana politike dhe ideologjike, shkencore dhe profesionale, teorike dhe praktike për punë dhe për mbrojtjen e atdheut.

Mua më gëzon shumë fakti që ju, si të gjithë studentët dhe pedagogët e fakulteteve të tjera, po përpiqeni me tërë vrullin tuaj që të studioni me pasion për t'u bërë kuadro të denjë të viteve të ardhshme, të veprave madhështore që na presin, kur teknika dhe shkenca në vendin tonë do të kenë arritur në një nivel më të lartë nga ky i sotmi.

Pjesëmarrja në aksionin për të cilin bëni fjalë në letër, ka rëndësi, veç të tjerave, sidomos për kalitjen tuaj të gjithanshme dhe lidhjet e ngushta që duhet të mbani me fshatarësinë kooperativiste, për njohjen e thellë të punës dhe jetës së saj. Inteligjencia jonë e re, e dalë nga gjiri i popullit dhe e edukuar nga Partia, gjithnjë e më tepër po shkrihet në punë me punëtorët dhe kooperativistët.

Ju, të dashur studentë, dhe një pjesë e pedagogëve tuaj jeni të rinj dhe rinia jonë revolucionare është thesari më i madh i atdheut, ajo është përtëritja e popullit të pavdekshëm. Sa më mirë të mësoni e të edukoheni ju, aq më i fortë do të

bëhet atdheu dhe aq më shpejt do të ndërtohet socializmi në Shqipëri. Prandaj Partia i ka vënë rëndësi të dorës së parë rritjes dhe edukimit të një rinie revolucionare, të pastër, të ndershme, të thjeshtë, punëtore dhe trime, që t'i dojë me tërë hovin e shpirtit të saj atdheun, Partinë, popullin.

Ne mund të krenohemi për karakteristikat fisnike që ka kultivuar Partia në të rinjtë dhe të rejtat tona, në gjithë inteligjencien tonë e cila, e lidhur ngushtë me popullin, rritet dhe zhvillohet në gjirin e popullit, ushqehet nga gjenia e popullit dhe lufton për të mirën e popullit.

Në letrën tuaj më shkruani se jeni entuziazuar që në rrethin e Dibrës ju kanë pritur shumë mirë dhe shtabi i elektrifikimit të rrethit ju ka nderuar me flamurin e kuq, se shokët dibranë punuan bashkë me ju dhe së toku festuat fitoren që arritët. Ky gjest i lartë dashurie dhe mirënjohjeje shquan mbarë popullin tonë, që e do me gjithë shpirt rininë, çmon shumë punën e saj dhe e inkurajon në vepra të mira. Këto virtyte të larta të popullit, Partia i ka zhvilluar më tej, me një përmbajtje të re socialiste, prandaj edhe në të ardhmen, kudo që do të shkoni për të punuar, do të keni ndihmën, përkrahjen dhe dashurinë e zjarrtë të masave tona punonjëse.

Në frymën e aksionit, me vrull revolucionar mposhtni pengesat që ju dalin në rrugë, plotësoni me nder detyrat që ju janë ngarkuar: mësoni me këmbëngulje që të bëheni sa më të aftë për t'i shërbyer popullit, atdheut tuaj, jetoni përherë

pranë popullit, punoni tok me të dhe lidheni kësh-  
tu mësimin nga librat me mësimin nga jeta; për-  
gatituni sa më mirë fizikisht dhe ushtarakisht për  
të qenë mbrojtës të pamposhtur të atdheut; jini  
të gatshëm që, kur të mbaroni mësimet, të shkoni  
pa hezitim atje ku do t'ju kërkojë atdheu, ku  
do t'ju dërgojë Partia; merrni pjesë gjallërisht  
dhe bëjeni sa më luftarake organizatën tuaj të  
rinisë, ja, këto mund të ishin disa këshilla për  
ju shokë studentë, që desha t'ju theksoja me këtë  
rast.

Ju uroj përzemërsisht për rezultatet që keni  
arritur dhe për sukseset e mëtejshme, akoma më  
të mëdha që do të arrini në kryerjen me nder të  
detyrave tuaja, për t'u bërë kuadro të vlefshëm,  
inxhinierë të aftë dhe besnikë deri në fund për  
çështjen e madhe të Partisë e të atdheut.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Studenti», 8 janar 1970*

# LETËR DREJTUAR SHOQES LULË BEQIRI NË FSHATIN SHËNGJERGJ TË LEKBIBAJT

*Tropojë*

**24 janar 1970**

E dashur motër Lulë,

U gëzova kur këndova letrën e shkruar me aq kujdes me dorën tënde, ca më shumë për vullnetin tënd të madh, pse në moshën 65-vjeçare ti iu vure punës me këmbëngulje dhe arrite që brenda një viti të mësosh shkrim e këndim. Ti u dhe kështu dritë syve të tu që është drita e Partisë, e cila shkëlqen në të gjitha skajet e atdheut, në çdo vatër shqiptare. Të lumtë, motër trime, që me shembullin tënd u ke treguar të gjithëve se njeriun e vendosur në rrugën e Partisë s'ka forcë që ta pengojë, bile as vitet e shumta që mund ta rëndojnë, kur është çështja për zbatimin e një detyre të rëndësishme.

Gjithashtu u gëzova shumë që verën e kallar, gjatë qitjes me armë, arrite ta shkrehësh çarkun e pushkës drejt e në nishan. Ashtu si more në tabelë 24 pikë me tri të shtëna, jam i bindur se nesër, në rast rreziku nga armiqtë, si gjithë malësoret trime të Tropojës e mbarë populli ynë, edhe ti burrnësja e Lekbibajt me gjithë pjesëtarët e familjes do të dish t'i qëllosh hasmët në lule të ballit, sepse nuk ndien kurrë pleqëri, zemrën e ke flakë dhe syrin pishë.

Populli shqiptar në shekuj ka luftuar i vetëm për lirinë e atdheut, edhe pse në rrethana shumë të vështira e i rraskapitur nga një varfëri e prapambetje e madhe. Ai është sot në kushte krejt të ndryshme dhe jeton i lumtur në Republikën e tij Popullore që po e zbukuron dhe e forcon vetë nga dita në ditë me mendjen e tij të ndritur nga mësimet e Partisë, me punën dhe duart e tij të shkathëta. Për këtë arsye popullit tonë i ka dalë zëri e i dëgjohet fjala kudo dhe gëzon admirimin e përkrahjen e miqve të shumtë e besnikë në të gjithë botën. Për të gjitha këto populli ynë e shikon me besim të patundur dhe siguri të ardhmen e tij të bukur.

Jeta e re që ka lindur e po zhvillohet te ne, që është kaq shumë e pasur në veprimtari të gjithanshme politike, shoqërore dhe ekonomike, kaq shumë e lumtur dhe e gëzuar për njerëzit tanë që jetojnë në vëllazërim të vërtetë e në unitet të çeliktë si asnjëherë rreth Partisë që na udhëheq kurdoherë përpara, u shumëfishon for-

cat njerëzve tanë, deri edhe të shkuarit nga mo-  
sha i frymëzon dhe i nxit të veprojnë krahas të  
gjithëve, duke mbajtur si kurdoherë kazmën në  
një dorë dhe pushkën në tjetrën, që flamuri i  
kuq i socializmit në atdheun tonë të valojë i  
pastër në shekuj.

Unë të përgëzoj, motër e dashur Lulë, për  
sukseset që ke arritur, ju uroj shëndet dhe gjithë  
të mirat ty dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes  
dhe punë të mbarë në lulëzimin e kooperativës  
suaj. U bëni shumë të fala nga ana ime gjithë  
fshatarëve trima të Shëngjergjit dhe ju dëgjofsha  
kurdoherë zërin e mirë.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **PËRSHËNDETJE DËRGUAR KOLEKTIVIT TË GAZETËS «LLAIKO VIMA»**

**23 maj 1970**

Të dashur shokë,

Me rastin e 25-vjetorit të botimit të gazetës «Llaiko Vima» në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në emrin tim personal ju dërgoj juve dhe gjithë bashkëpunëtorëve e korrespondentëve vullnetarë të saj, përshëndetjet më të nxehta dhe të përziermërta.

Njëzet e pesë vjet më parë, Partia jonë e lavdishme, duke zbatuar me vendosmëri vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste në të gjitha fushat, zgjidhi me sukses edhe problemet që kishin të bënin me të drejtat e pakicës kombëtare greke në Shqipëri. Ashtu si për të gjithë popullin shqiptar, nën kujdesin e Partisë, asaj iu siguruan të gjitha të drejtat demokratike dhe barazi e plotë, si: e

drejta e gjuhës, e punës, e arsimit dhe e kulturës në gjuhën amtare etj. Në këtë kuadër, me porosi të Komitetit Qendror të Partisë, filloi botimin edhe gazeta «Llaiko Vima», si organ i Frontit Demokratik të Rrethit të Gjirokastrës.

Ne konstatojmë me kënaqësi se gjatë këtyre 25 vjetëve, gazeta «Llaiko Vima» është bërë një tribunë e gjallë luftarake për masat punonjëse të minoritetit, në faqet e saj zberthehen vija dhe direktivat e Partisë e të Qeverisë, zien mendimi dhe puna krijuese e masave, pasqyrohet jeta e re e lumtur që po ndërtohet e shkëlqen nga dielli i socializmit në krahinat ku jetojnë, punojnë, luftojnë e veprojnë motrat dhe vëllezërit tanë të shtrenjtë të minoritetit.

Në gazetën «Llaiko Vima» ka gjetur pasqyrim të gjerë uniteti i çeliktë i popullit të minoritetit me gjithë popullin vëlla shqiptar, qëndrimi dhe vepra e tij revolucionare e patriotike në luftën e përbashkët për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut tonë të dashur. Në faqet e gazetës suaj shkruan dropulliti, të cilit i ishte djegur buza për një pikë ujë dhe flet për dhuratat e shumta të Partisë — që nga buka që i mungonte e gjer te gjuha e nënës që mësohet në shkollë, që nga bonifikimi i fushës e gjer tek uji i kulluar dhe dritat elektrike, që zbukurojnë aq shumë atë luginë; shkruan pogoniti për ditët e bardha që gëzon, për tokat e reja që çel në mal, për rrugët automobilistike që po ndërtohen në këtë zonë të thellë, për veprat socialkulturore;

shkruan vurgari për kanalet e shumta që kullojnë e ujin tokën e tij, deri dje vatër mushkonjash e mjerimi, për shtëpitë e reja që zëvendësuan kasollet; shkruan fshatari i thjeshtë i zonës «Partizani» për kulturën dhe artin e tij, për njeriun e ri që ka edukuar Partia, — shkruajnë shumë shokë e shoqe të minoritetit për ato që u këndon zemra, për të mirat e socializmit që jetojnë dhe fjalët e vargjet më të bukura i thurin për Partinë, që i nxori nga errësira në dritë ashtu si gjithë popullin shqiptar.

Në këtë çerek shekulli gazeta «Llaiko Vima», bashkë me të gjitha organet e tjera të shtypit tonë popullor, ka luajtur një rol të madh në edukimin revolucionar të popullsisë minoritare. Emri i saj tani njihet bile edhe jashtë kufijve të atdheut tonë socialist.

Unë shpreh bindjen, se edhe në të ardhmen, ju, shokë të redaksisë, korrespondentë e bashkëpunëtorë të gazetës «Llaiko Vima», do të vazhdoni të propagandoni vijën e drejtë të Partisë, idetë e saj dritëdhënëse, politikën e saj marksiste-leniniste, punën e vazhdueshme dhe sukseset që populli i mrekullueshëm, heroik, punëtor e i talentuar i minoritetit do të korrë nën udhëheqjen e Partisë.

Me rastin e kësaj dite jubilarë ju përgëzoj dhe ju dërgoj urimet më të mira që në të ardhmen ta bëni gazetën «Llaiko Vima» gjithmonë e më luftarake, më të pasur në përmbajtje e më

të bukur në formë, më të pastër në gjuhë, më të dobishme e më të dashur për lexuesit e saj.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

«Dy popuj miq», f. 166

## LETËR DREJTUAR SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

SI TË SHKRUANËT

22 tetor 1970

Të dashur shokë e shoqe,

Komiteti Qendror i Partisë ju dërgon përsëritet më të zjarrta dhe urimet më të përzemërta për festën tuaj jubilarë, 25-vjetorin e themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

Ky Jubile është një ngjarje me rëndësi të madhe për jetën e vendit e të popullit tonë. Në këtë ditë të shënuar, së bashku me ju shkrimtarët dhe artistët tanë të talentuar, që keni bërë e bëni një punë kaq të lavdishme e fisnike për edukimin komunist të punonjësve, për nderin dhe lavdinë e atdheut, gëzohen të gjithë, që nga kalamani e deri te më plaku, gëzohen punëtorët, kooperativistët, intelektualët, ushtarakët, gëzohen mbarë populli dhe Partia.

Një çerek shekulli më parë, me kujdesin e

Partisë, u themelua lidhja juaj. Në ato vite të vështira populli ynë artdashës, që vuante nga plagët e luftës e që akoma s'kishte bukë për të ngrënë, ëndërronte, mendonte e shqetësohej seriozisht edhe për fatet e zhvillimit të artit, pse artin ai tërë jetën e ka pasur dhe e ka në zemër. Me shëllirë e ka ngjyer kafshatën në të kaluarën populli ynë, por pjatën e drunjtë e kishte të skalitur si s'ka më bukur. Ndjenja e hollë për të bukurën dhe shija e tij e lartë estetike kanë spikatur kudo, në rapsoditë e mrekuallueshme, në kostumet fantastike, në vallet e mahnitshme, në shkrimet e rilindësve apo në këngët «rebele» e të ndritshme partizane. Shkurt, gjenia artistike e popullit tonë duket ngado që të hedhësh vështrimin, ngado që të vësh dorën.

Artin populli ynë e ka konsideruar dhe e konsideron pjesë të pandarë të jetës së tij, prandaj ai e përshëndeti me entuziazëm lindjen e organizatës suaj. Dhe shpresat e tij, si kudo, nuk shkuan kot. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve u bë ashtu siç tha Partia, ashtu siç dëshironte populli, një organizatë luftarake, militante. Shkrimtarët dhe artistët, të udhëhequr vazhdimisht nga mësimet dhe nga porositë e Partisë, e lidhën ngushtë krijimtarinë e tyre me jetën e masave punonjëse, me përpjekjet dhe luftën e tyre heroike për ndërtimin dhe për mbrojtjen e atdheut socialist.

Gjatë këtyre 25 vjetëve, e veçanërisht pas Kongresit të 5-të të PPSH, arti ynë i realizmit

socialist ka pësuar e po pëson ndryshime të pappara sasiore dhe cilësore. Në luftë të pamëshirshme me çdo lloj ndikimi të huaj të ideologjisë borgjeze e revizioniste, si dhe patriarkale e konservatore, letërsia, teatri, muzika, kinematografia, piktura, skulptura dhe të gjitha gjinitë e tjera, të frymëzuara nga ideologjia dritëdhënëse e Partisë, nga heroizmi i pashembullt revolucionar i klasës punëtore dhe i mbarë masave punonjëse, si dhe të ushqyera vazhdimisht nga gurra e pashtershme e krijimtarisë popullore, ndikojnë drejtpërdrejt në edukimin e njeriut të ri me ideallet e mëdha të socializmit e të komunizmit, me tiparet e moralit komunist, me shije të shëndosha dhe revolucionare.

Në pjesën më të madhe të krijimtarisë sonë letraro-artistike, që karakterizohet nga niveli i lartë ideor e artistik, njeriu ynë i ri gjen vetveten, sheh vitalitetin e popullit dhe të atdheut tonë socialist, dëgjon fjalën e dashur e të zjarrtë të Partisë dhe mbushet me kurajë e guxim për t'i ngjitur kurdoherë e më lart shkallët e jetës. Kjo ngjet sepse arti ynë revolucionar frymëzimet i merr nga populli dhe ia kthen ato prapë atij, të përgjithësuara e në format më të bukura artistike, sepse shkrimtarët dhe artistët tanë kanë përvetësuar këshillat e Partisë për të qenë njëherësh nxënës e mësues të masave punonjëse.

Partia ndjek me vëmendje e interes të madh krijimtarinë frymëzuese të letrarëve, muzikantëve, aktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë.

Ajo përshëndet punën e këmbënguljen tuaj vetëmohuese për t'i revolucionarizuar më tej letërsinë e artet, për të futur në to atë çka është më e çmueshme — mendimin dhe emocionin popullor, botëkuptimin e klasës punëtore, zjarrin shqiptar. Sot arti ynë është bërë më i madhërishëm si për nga përsosmëria e bukuria ideoartistike, ashtu edhe për nga forca e madhe edukative. Kjo dëshmon se ai ecën në rrugë të mbarë, në rrugën e lavdishme që i ka caktuar Partia.

Të gjitha këto garantojnë se arti ynë, që ndodhet në duart e sigurta të shkrimtarëve, artistëve, kritikëve dhe studiuesve tanë të partishëm, edhe në të ardhmen do të dijë t'i përmbushë me sukses detyrat e rëndësishme që do t'i caktojë Partia.

Tanimë që letërsia dhe artet tona kanë arritur kaq shumë suksese, sa zëri e fjala u dëgjohet me admirim të madh si brenda ashtu edhe jashtë atdheut, tani pikërisht rritet edhe më tepër përgjegjësia e tyre ndaj çështjes së socializmit e komunizmit. Në këto kushte detyrat revolucionare që shtron Partia para krijimtarisë letraro-artistike janë të mëdha, ndoshta shumë më të mëdha se ç'mund të pandehen. Realizimi i tyre kërkon që socializmi dhe mendimi proletar marksist-leninist të ndihen dhe të përshkojnë fund e krye çdo libër, çdo pikturë, çdo varg, çdo notë muzikore, çdo kënd e qelizë të veprës artistike. Partia ka besim të thellë se shkrimtarët dhe artistët tanë, si kurdoherë, do ta kryejnë me nder këtë detyrë.

Po për këtë është e nevojshme që, krahas punës këmbëngulëse për edukimin e gjithanshëm e të thellë marksist-leninist të shkrimtarëve dhe të artistëve, të rriten pa ndërprerje kërkesat për ngritjen e nivelit ideor të veprave artistike dhe për përsosjen e mëtejshme të mjeshtërisë artistike. Vitaliteti i jetës sonë socialiste, shpirti sulmues e transformues i masave punonjëse dhe madhështia e ideve të Partisë sonë nuk mund të pasqyrohen e të trupëzohen ashtu siç janë në të vërtetë veçse në një art me nivel shumë të lartë ideoartistik. Që të arrihet kjo, artisti ynë novator lypset të kërkojë, gjithmonë të kërkojë, duke u nisur nga pozitat e ideologjisë sonë, duke u mbështetur fort në truallin tonë kombëtar, në traditat dhe në përvojën tonë artistike më të avancuar, si dhe në eksperiencën përparimtare botërore. Të kërkosh, do të thotë të përpiqesh të zbulosh fenomenet thelbësore të realitetit tonë, të zbulosh ato elemente të reja të jetës sonë që përbëjnë filizat e së nesërme. Kjo e re, pra, që kërkohet të hyjë në art, duhet jo vetëm të njihet mirë, por edhe të shndërrohet në fenomen artistik. Në këtë mënyrë letërsia dhe artet do të ecin me hapin e masave punonjëse dhe përherë e më tepër do të bëhen një mjet i fuqishëm ideologjik për edukimin e tyre.

Bartëse e ideve revolucionare, farkëtuese e filizave të rinj të komunizmit, është në radhë të parë klasa jonë punëtore. Ajo është rinia e përjetshme e artit revolucionar të realizmit socialist.

Duke qenë kështu, figura, vepra dhe botëkuptimi i klasës punëtore në krijimtari duhet të bëhen akoma më zotërues. Kjo duhet bërë jo vetëm sepse klasa punëtore, si klasa më revolucionare e kohës sonë, e meriton plotësisht këtë, por edhe për faktin se sot revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, sido që bëjnë be e rrufe se «krijojnë» në emër të klasës punëtore, në të vërtetë po bëjnë çmos që figurën e saj ta dëbojnë përfundimisht nga letërsia dhe nga arti.

Me zhvillimin e vrullshëm të revolucionit socialist të ne shtohen kërkesat dhe etja e masave punonjëse për krijime letraro-artistike të përsosura. Prandaj, detyra juaj është që t'i njihni mirë këto kërkesa të masave punonjëse dhe t'u përgjigjeni atyre me vepra të frymëzuara të një niveli të lartë ideoartistik. Prandaj Partia ju bën thirrje edhe një herë që të shkoni në masa e të jetoni vazhdimisht pranë tyre. Duke shkuar vazhdimisht në masa ju, nga njëra anë, do të mësoni prej tyre, do të dëgjoni me vëmendje vërejtjet e kritikave të tyre dhe në të njëjtën kohë do të propagandoni veprat artistike, do të ndihmoni më nga afër në edukimin ideoestetik të masave, do të shtoni dashurinë e tyre për artin.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se ju, si kurdoherë, do t'i realizoni me nder detyrat që ju shtron Partia dhe do t'i jepni popullit gjithnjë e më shumë vepra artistike që të mishërojnë idealet revolucionare të Partisë, tiparet e mrekullueshme revolucionare të popullit tonë, ho-

vin e tij të pandalshëm në rrugën e revolucionit e të socializmit.

Lavdi artit tonë revolucionar të realizmit socialist!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Në emër të Komitetit Qendror të PPSH  
Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

«Mbi letërsinë dhe artin» (Përmbledhje veprash), f. 313

**LETËR DREJTUAR NJËZET  
TRAKTORISTEVE TË PARA TË SMT-SË  
TË LIBRAZHBIT**

**2 dhjetor 1970**

**Të dashura shoqe,**

Më gëzoi jashtëzakonisht shumë letra, me të cilën më njoftoni se përfunduat me sukses kursin gjashtëmuor, duke fituar profesionin e nderuar të traktoristes. Kjo është një ngjarje me rëndësi jo vetëm për krahinat e Çermenikës, të Bërzesh-tës, të Polisit etj., po për gjithë rrethin e Librazh-dit, për mbarë vendin tonë, pse iu bëtë një hap të fuqishëm përpara, mësuat, dolët traktoriste dhe morët në dorë timonin e traktorit.

Kur mbaruat shkollën 7 e 8-vjeçare ju ishit akoma të reja, megjithatë menduat me pjekuri dhe shfaqët dëshirën për të marrë pjesë aktive në punën prodhuese. Mendimi juaj përparimtar ju çoi në një veprim revolucionar, që tronditi kon-

servatorët me koncepte të vjetra, të cilët, për t'ju prerë hovin, s'munguan të veprojnë, duke ju thënë se s'qenka për femrën puna e traktoristes. Juve, krahas vështirësive me të cilat u ndeshët gjatë mësimeve teorike në kurs dhe vështirësive të tjera gjatë praktikës në terrenin e thyer të rrethit tuaj, ju është dashur të luftoni edhe me konceptet e qëndrimet jo të drejta të disa njerëzve prapanikë. Kështu, në sajë të vullnetit tuaj të papërkulur, duke zbatuar drejt në jetë direktivat e Partisë, çatë përpara me traktor për të punuar e lulëzuar ato kodra e male, ku të parët tanë kanë jetuar e luftuar kundër armiqve të huaj dhe ku lindët e jeni rritur edhe vetë dhe dolët faqebardhë. Ju lumtë për fitoren që arritët, të dashura shoqe traktoriste!

Unë kam bindje të plotë se ju nuk do t'ju dehë kio fitore e parë që korrët, por me vullnet e punë këmbëngulëse do të përpiqeni të ecni kurdoherë përpara, në radhë të parë për ngritjen e nivelit tuaj ideopolitik e kulturor, si dhe për përvetësimin e dijeve e perfeksionimin e vazhdueshëm në profesionin tuaj, që të bëheni traktoriste të pararojës të SMT-ve të vendit tonë, të cilat janë një faktor me rëndësi për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste, baza shoqërore e pushtetit tonë popullor.

Të jeni të sigurta se shembullin tuaj të mirë kanë për ta ndjekur edhe vajza e gra të tjera të vendit tonë që, ashtu si ju, janë të ndërgjegjshme

se pa pjesëmarrjen aktive të gruas në punën prodhuese dhe në jetën politike e kulturore të vendit, nuk mund të ndërtohet socializmi, nuk mund të realizohet në jetë emancipimi i plotë i gruas.

Duke ju përshëndetur nxehtësisht, ju uroj nga zemra shëndet, kurdoherë punë të mbarë si traktoriste dhe lumturi në familjet tuaja.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT LEONIDHA KRISTAQI, FSHATI I RI  
«ANDON POÇI»**

*Gjirokastër*

**16 shkurt 1971**

Shoku Leonidha,

Ndjeva një gëzim kur lexova letrën tënde, që më erdhi nga një fshat i ri, emri i të cilit ka disa vjet që i është shtuar hartës së vendit tonë. Unë nuk kam ndier kënaqësinë të vizitohesh ndonjëherë fshatin tuaj, po kur kam shkuar në Gjirokastër, e kam parë atë nga Votucat, se si po lulëzon në brinjë të kodrave të gjelbëruara.

Ju, vllhtë, keni një histori të tërë vuajtjesh e mundimesh, keni hequr në të kaluarën të zitë e ullirit, keni qenë të shtypur e të përbuzur. Çelnikët ju kanë pirë gjakun; ata, megjithëse s'punonin, hanin gjalpë, ajkë qumështi e djathë, ndërse vllhtë, që i prodhonin ato, mezi siguronin një

kothere bukë, herë me dhallë e herë me qepë. Pleqtë e gjorë vllah vdisnin rrugëve, sa sot varret e tyre s'dihet ku janë. Në rrugë lindte edhe fëmija që lidhej në djepin e drunjtë, të cilin nëna e robtuar e ngarkonte në kurrizin e saj me plagë.

Ne, të moshuarve, na kujtohen mirë vllehtë e asaj kohe, që shtegtonin varg njëri pas tjetrit: burra të veshur me gunë, gra me furkë e bosht në duar, fëmijë të vegjël në këmbë. Disa hynin në qytete për të blerë një dorë misër, pak kripë dhe ca potkonj mushkash, të tjerët uleshin për të pushtuar monopateve dhe përsëri ngriheshin e merrnin rrugën e gjatë të shtegtimimit. Të gjitha këto ju i keni thurur aq bukur në këngën tuaj:

*Kush e njihie vllah mavrinë?*

*Përmbi mushkën e kish shtëpinë*

*Jet' e tij posht' e përtpjetë,*

*Dyshek malet, mbulesë retë...*

Por ato ditë të zeza, siç shkruan edhe ti në letër, morën fund. Partia e lavdishme e Punës ju nxori nga errësira në dritë edhe ju, vllehtë. Tani ju nuk endeni më maleve, nuk jetoni më në kolibe me kashtë thekre, por në shtëpi të bukura, të cilat i ndërtuat në një vend ku toka është pjellore, lumi Drinos kalon pranë dhe mbi fshat ngrihen kodrat që ju vetë po i tarraconi.

Kur kam ardhur me shërbim në Gjirokastrë, shokët e Partisë dhe të pushtetit në rreth janë shprehur për ju me fjalët më të mira. Ju jeni

blegtorë me eksperiencë të pasur, gratë dhe vajzat tuaja janë punëtore të shquara, ato janë nga mjelëset më të dalluara në rreth. Por tani ju jeni bërë edhe bujq të mirë. Pemët që po mbillni janë një iniciativë e lavdërueshme. Gjithashtu, përparime keni bërë edhe në ngritjen e nivelit arsimor, kulturor e shëndetësor. Nga radhët tuaja dolën kuadrot e parë me shkollë të lartë, shumë të rinj dhe të reja vazhdojnë të mësojnë në shkolla të ndryshme; fejesat po i bëni sipas mësimëve të Partisë; në qendër të fshatit ngritët një kompleks socialkulturor dhe tani po ndërtoni shtëpinë e kulturës etj. Ju lumtë dhe ju përgëzoj për të gjitha sukseset e arritura! Unë me gjithë zemër dëshiroj të arrini suksese akoma më të mëdha edhe në të ardhmen.

Fshati juaj përbën një brigadë të fortë të ndërmarrjes bujqësore shtetërore. Jam në dijeni se ju u keni hapur garë brigadave të tjera të ndërmarrjes dhe të të gjitha kooperativave bujqësore të rrethit të Gjirokastrës për rendimente të larta në prodhimet bujqësore e blegtorale. Këni vepruar shumë mirë dhe kam besim e uroj që garën ta fitoni.

Me letrat që po shkëmbejmë së bashku, më duket sikur jetoj disa çaste me ju, vllëhtë patriotë të fshatit të ri, që mban emrin e të paharruarit Andon Poçi, këtij dëshmori trim, i cili, bashkë me miëra vëllezër të tjerë shqiptarë, nuk kurseu gjakun e tij të kulluar për çlirimin e atdheut tonë të dashur.

Të fala shumë ty dhe familjes. Të fala gjithë bashkëfshatarëve të tu.

Kur të kesh rastin, të lutem jepu të falat e mia më të përzemërta gjithë motrave dhe vëllezërve tanë vllëh në Palokastër, Humelicë, Skore, Ndëran. Me këtë rast përshëndes të gjithë shokët, motrat dhe vëllezërit tanë vllëh kudo që janë dhe u uroj atyre jetë të lumtur e të gëzuar në atdheun e tyre të shtrenjtë, Shqipërinë socialiste.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 40 (7017), 17 shkurt 1971*

**LETËR DREJTUAR NXËNËSVE  
DHE MËSUESVE TË SHKOLLËS  
SË FSHATIT MERTUR**

*Pukë*

**19 qershor 1971**

Të dashur nxënës dhe mësues,

E ndiej veten të lumtur që po ju çoj sot përshëndetjet e zemrës juve, nxënësve dhe mësuesve të fshatit Mertur dhe ju falënderoj për letrën që më dërguat.

Ashtu si ju, edhe unë ruaj kujtime të paharruara nga vizita që bëra vjet në rrethin tuaj. Duke lexuar letrën, solla edhe një herë ndër mend me përmallim ato ditë kur u poqa e kuvendova me pukjanet e pukjanët trima të shquar e punëtorë të palodhur dhe kuptojeni, miqtë e mi, sa shumë u gëzova që edhe në Mertur, si në gjithë rrethin tuaj, po arrihen suksese në zbatimin e

detyrave që ju dhe fshatarësia patriotë e asaj kooperative i keni caktuar vetes.

Nuk kam qenë ndonjëherë në Mertur, por më kanë thënë se ai ndodhet në një terren të thyer, mbi të cilin duket madhështor shkëmbi i Çllumit, dëshmitar i heshtur i shtypjes dhe i shfrytëzimit të atij populli, por edhe i luftërave të tij të paprera për liri e drejtësi, për një jetë më të mirë. Në atë fshat të thellë e shkëmbor, ku njerëzit vuanin përpara nga uria dhe mjerimi, tani u arrit që bukën ta prodhoni vetë në vend, pasi me punë të palodhur, të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, keni çelur tokë të re edhe në shkëmb, duke dyfishuar sipërfaqen arë të mbjellë sidomos me misër, rendimentin mesatar të të cilit e keni ngritur në 33 kuintalë për hektar, ndërsa në parcelën eksperimentale deri në 72 kuintalë për hektar. Sot edhe në Merturin krenar, por të varfër në të kaluarën, ka perënduar e s'kthehet më ajo kohë kur Migjeni zemërzjarrtë me gjithë dufin e shpirtit të tij të revoltuar ligjëronte:

*«Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,  
kafshatë që të mbetë në fyt dhe të zë trishtimi».*

Tani kanë ardhur kohë të reja, jetojmë në epokën e Partisë, kur në atdheun tonë të lirë lulëzon pranvera socialiste dhe jeta e njerëzve tanë bëhet çdo vit e më e mirë.

Prindërit tuaj, të dashur fatosa e pionierë, kanë qenë analfabetë, kurse për ju Partia dhe pushteti popullor kanë ndërtuar shkollë të re 8-vje-

çare, ku në mbrëmje mësojnë edhe shumë vajza e djem të rritur; për ju janë ndërtuar shtëpia e kulturës, çerdhja, kopshti, furra, ambulanca, infirmieria etj. Ditë të reja, më të bukura, e presin popullin tonë, pasi Partia mendon dhe punon për një të ardhme akoma më të bukur. Prandaj ju keni të drejtë të shprehni për të fjalët më të mira të zemrave tuaja dhe të luftoni që të zbatoni në jetë porositë e saj duke mbajtur në një dorë kazmën, në tjetrën pushkën dhe me librat e Partisë në gji mësoni, punoni e vigjiloni aty në atë skaj verior të atdheut, ku jeton një popull trim, i zgjuar, punëtor e i talentuar, nga gjiri i të cilit kanë dalë punëtorë të shquar sharrëxhinj, mura-torë dhe gurskalitës duarartë, gjeologë e të tjerë.

I uroj kolektivit tuaj shëndet e suksese në mësimet dhe ju lutem t'u jepni të falat e mia të përzemërta prindërve e të afërmve tuaj, gjithë malësoreve e malësorëve trima të Merturit, që punojnë pa u lodhur për ta bërë kooperativën më të begatshme, më të bukur, më të lulëzuar e më të fortë, ashtu siç po bëhet gjithë atdheu ynë socialist, i cili po i pret ballëllart e duarplot 30-vje-torin e themelimit të Partisë dhe Kongresin e 6-të të saj.

Ju përqafoj me mall  
Juaji

*Enver Hoxha*

«Për shokët e mi pionierë»,

f. 361

# LETËR DREJTUAR GJYLE DHE SADUSH VRAPIT

Fier

4 shtator 1971

Të dashur Sadush dhe Gjyle,

Ju falënderoj për letrën që më dërguat. Fjalët që më shkruani sollën tek unë një gëzim të veçantë, që m'u shtua edhe më tepër nga fotografia, ku pashë një për një të katërmbëdhjetë fëmijët tuaj plot shëndet.

Me këtë rast dëshiroj t'ju përqafoj të gjithë dhe t'ju uroj punë të mbarë dhe jetë të lumtur e të gëzuar. Fëmijëve ju uroj të jenë edhe nxënës të zellshëm dhe kur të rriten të bëhen punëtorë të mirë e ushtarë besnikë deri në fund të çështjes së Partisë, ashtu si dhe prindërit e tyre, për lulëzimin dhe mbrojtjen e atdheut tonë të dashur.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR SHOQES KOSTANDINA BUZO NË FSHATIN PEVELAN

Pogradec

22 shkurt 1972

E dashur nënë Kostandinë,

Letra që më dërgove këto ditë me rastin e 22-vjetorit të rënies dëshmor të birit tënd Bendo<sup>1</sup>, anëtarit të Partisë sonë, zgjoi tek unë shumë kujtime të çmuara për krahinën e Mokrës,

---

1. Bendo Buzo, nga fshati Pevelan i Pogradecit, ra në përpjekje me armiqtë për mbrojtjen e kufijve të atdheut më 18 shkurt 1950. Megjithëse ishte liruar dhe të nesërmen do të nisej për të shkuar pranë familjes, ai zëvendësoi në shërbim një shokun e tij të sëmurë. Gjatë kryerjes së detyrës, njësitit që kryesonte ai u ndesh me armiqtë që kishin hyrë në tokën tonë, luftoi heroikisht duke i asgjësuar e zbrapsur ata. Komunisti trim Bendo Buzo në çastet e fundit të jetës së tij shkroi me gjakun e vet mbi një gur inicialet «P. E.» [Parti—Enver] dhe fshehu nën atë gur taserën e Partisë që të mos binte në duart e armikut.

për njerëzit e saj luftëtarë, për familjen tuaj patriote dhe veçanërisht për ty, nënë Kostandinë, që rrite dhe edukove bij të denjë për Partinë, njëri nga të cilët, Bendoja, luftoi me trimëri dhe ra në mbrojtje të kufijve të shenjtë të atdheut.

Duke përkujtuar 22-vjetorin e rënies së tij në krye të detyrës, ne sjellim edhe një herë në mend të gjithë ata bij dhe bija të popullit tonë, që luftuan pa kursyer as jetën për çlirimin e Shqipërisë, si dhe ata që sot luftojnë me të njëjtin heroizëm për mbrojtjen e saj nga çdo armik. I tillë qe edhe Bendoja, emri dhe vepra e të cilit do të rrojnë gjithmonë në zemrat e të gjithëve.

Bendoja ishte një komunist i vendosur. Ai gjendej gjithnjë në vijën e parë për realizimin e çdo detyre, sado e vështirë dhe e rrezikshme të ishte kjo. Ai i donte shumë atdheun, Partinë, popullin, prandaj bëri fli jetën dhe ra me ëndrrën e bukur për ta parë Shqipërinë të lulëzuar e plot dritë. Dhe sot është një gëzim e krenari e madhe për të gjithë që dëshirën dhe porosinë e Bendor dhe të mijëra dëshmorëve si ai, që luftuan dhe sakrifikuan për lumturinë e popullit, Partia, masat punonjëse, rinia jonë heroike po i realizojnë hap pas hapi, duke e bërë vendin tonë të paprekshëm nga armiqtë dhe çdo ditë më të bukur e të lulëzuar.

E dashur nënë Kostandinë,

Duke mbyllur këto pak radhë, dua të të uroj jetë të gjatë, t'i gëzosh sa më shumë këto ditë të

lumtura që solli Partia, që të kënaqesh me fëmijët e tjerë, nipërit e mbesat e shumta, që me siguri do të rriten po aq patriotë dhe trima si Bendoja, djali yt i shtrenjtë dhe shoku ynë i armëve!

Të përqafoj me dashuri

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR NXËNËSES  
KLEMENTINA HASKA**

*Paskuqan—Tiranë*

**6 mars 1972**

**E dashur Klementina,**

Edhe unë të përqafoj. Nga letra të njoha si nxënëse të dalluar. Mamaja të flet të vërtetën kur të thotë se do të shihemi më 1 Maj. Kur të parakalosh përpara tribunës, më përshëndet me dorë, se edhe unë do të të përshëndes.

Të uroj shëndet, suksese në mësim dhe jepu prindërve të tu të mirë të fala nga unë.

Të puth

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TELEGRAM URIMI DËRGUAR MUSTAFA XHANI DHE VERA LLESHIT

16 prill 1972

I dashuri Mustafa,

E dashura Verë,

Me rastin e martesës suaj ju uroj nga zemra jetë të lumtur, plot shëndet, suksese në punë e gëzime në familje. Jam i bindur se ju të dy, si dy bij të denjë të dy familjeve patriote, partizane e komuniste, do të vini gjithë energjitë tuaja të reja për të shpurë përpara kauzën e madhe të Partisë, ndërtimin e një jete gjithnjë më të lumtur e të begatshme për popullin tonë, për të cilën luftuan me heroizëm baballarët tuaj, shokët Mustafa Xhani dhe Haxhi Lleshi, do të edukoni fëmijët tuaj në frymën e një vigjilence e gatishmërie të lartë revolucionare për të mbrojtur fitoret e popullit, lirinë e pavarësinë e atdheut tonë të shtrenjtë socialist, ashtu siç bëri babai ju-

aj, shoku ynë i paharruar, Heroi i Popullit, Baba  
Faja Martaneshi.

Marr pjesë në gëzimin tuaj.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT RIZA KODHELI

*Korçë*

**14 dhjetor 1972**

Bijve, mbesave dhe nipërve të Riza Kodhelit,

Më preku thellë vdekja e babait dhe gjyshit tuaj të dashur, shokut tonë të armëve, mikut tim të vjetër, xha Rizait. Ai u nda nga ne, po kujtimi i tij si patriot, veteran, luftëtar i guximshëm dhe bir besnik i Partisë e i popullit, për të cilët nuk kurseu asgjë gjatë gjithë jetës, do të mbetet i paharruar. Me këtë rast, ju dërgoj juve ngushëllimet e mia.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
ZOTIT MUSTAFA KEMAL PASHA,  
KRYETAR I SHOQATËS SË MIQËSISË  
PAKISTAN—SHQIPËRI**

**30 prill 1973**

I nderuari zoti Mustafa Kemal Pasha,

Me kënaqësi të veçantë mora mesazhin tuaj të datës 15 prill 1973 që patët mirësinë të më dërgoni në emër të Shoqatës së Miqësisë Pakistan—Shqipëri që ju kryesoni dhe ju falënderoj për fjalët e ngrohta miqësore dhe për simpatinë që shprehni ndaj popullit shqiptar dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Dëshiroj t'ju siguroj se populli shqiptar ushqen për popullin liridashës pakistanez një respekt të thellë dhe ndjenja miqësore vëllazërore. Popujt e të dy vendeve tona janë të lidhur me një miqësi që rritet e forcohet vazhdimisht në luftën e përbashkët kundër imperializmit për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së popujve.

Populli shqiptar ka ndjekur me vëmendje përpjekjet e vazhdueshme që populli pakistanez ka bërë për kapërcimin e pasojave të rënda të trashëguara nga sundimi i egër kolonial, për mbrojtjen, përparimin e begatinë e vendit të vet dhe gëzohet sinqerisht për çdo sukses të arritur prej tij. Republika Popullore e Shqipërisë ka përkrahur dhe do të përkrahë kurdoherë luftën e drejtë të popullit pakistanez kundër intrigave dhe planeve hegjemoniste të imperializmit për copëtimin e atdheut të tij.

Duke ju dërguar përshëndetjet e mia të përzemërta juve dhe nëpërmjet jush Kryesisë së Shoqatës së Miqësisë Pakistan—Shqipëri si dhe gjithë anëtarëve të saj, ju uroj nga zemra suksese në punën tuaj fisnike për forcimin e mëtejshëm të miqësisë midis dy popujve dhe dy vendeve tona. Formuloj urimet më të mira për mirëqenien dhe lumturinë e popullit mik të Pakistanit.

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
DR. IBRAHIM EL TAHAVI, KRYETAR  
I SHOQATËS EGJIPT—SHQIPËRI**

*Kajro*

**17 mars 1973**

Me gëzim mësova mbi mbledhjen e parë të Shoqatës së Miqësisë Egjipt—Shqipëri, e cila do të kontribuojë për forcimin e mëtejshëm të miqësisë tradicionale midis popullit shqiptar dhe popullit vëlla egjiptian.

Si gjithnjë, populli shqiptar do të përkrahë me vendosmëri luftën e drejtë të popujve vëllezër arabë kundër agresorëve izraelitë, imperia-lizmit amerikan dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Shprehim bindjen tonë të thellë se kjo luftë, e mbështetur në radhë të parë në forcat e pashtershme dhe në unitetin e popujve arabë, si dhe në solidaritetin e gjithë popujve liridashës, do të përfundojë me fitoren mbi agresorët.

Pranoni përshëndetjet tona të përzemërta dhe urimet më të mira për Shoqatën e Miqësisë Egjipt—Shqipëri, si dhe për ju personalisht.

*Enver Hoxha*

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1973

17 mars 1973

Me gëzim mësova nga tabloshja e parë të Shoqatës së Miqësisë Egjipt—Shqipëri, e cila do të kontabtojë për forcimin e miqësisë tradicionale midis popullit shqiptar dhe popullit vëllë egjiptian.

Si gjithnjë, populli shqiptar do të përparojë me vendosmëri luftën e drejtë të popujve vëllë-krahë kundër agresorëve imperialistë, imperialist amerikan dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Shprehim bindjen tonë të thellë se kjo luftë e mbështetur në radhë të parë në forcat e bashkësive dhe në unitetin e popujve arabë, si dhe në solidaritetin e gjithë popujve lindasë, do të përmbajë me fitonë miqësinë.

# **LETËR DREJTUAR GJITHË VULLNETARËVE QË MORËN PJESE NË NDËRTIMIN E HEKURUDHËS ELBASAN—PËRRENJAS<sup>1</sup>**

**8 mars 1974**

Të dashur shoqe dhe shokë,

Me shumë kënaqësi mësova lajmin e gëzuar të përfundimit me sukses të aksionit tuaj të madh, ndërtimit të Hekurudhës Elbasan—Përrenjas. Kjo është një fitore tjetër e shkëlqyer e rinisë sonë të mrekullueshme, e punëtorëve, e inxhinierëve dhe e teknikëve tanë të ndërtimit, është një tjetër realizim i madh i pushtetit tonë popullor. Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, Këshillit të Ministrave dhe të mbarë popullit, ju përgëzoj dhe ju dërgoj përshëndetjet më të nxehta dhe revolucionare.

Ndërtimi i Hekurudhës Elbasan—Përrenjas është një shfaqje e re e patriotizmit të flaktë të rinisë sonë, e cila ka vënë tërë energjitë e saj,

---

1. Hekurudha Elbasan—Përrenjas u përrua më 10 mars 1974.

mendore e fizike, në shërbim të atdheut socialist, të popullit tonë heroik. Vepra të tilla në terren të thepisur, në një grykë të ngushtë lumi, ku duhen çarë shkëmbinj e sheshuar gërxhe, ku duhen zgjidhur probleme të rënda teknike e që janë të rralla edhe në vende të tjera që zotërojnë mjete të shumta teknike e fuqi të mëdha punëtore, u bë e mundur të ndërtohen edhe te ne, pasi udhëheq një Parti marksiste-leniniste, pasi i tërë populli është ngritur në këmbë dhe, me djersën e ballit, ndërton lumturinë e vet.

Puna juaj vullnetare, shokë dhe shoqe, është një kontribut i madh në ndërtimin e socializmit, ajo është një punë e nderuar nga shoqëria, është një punë komuniste. Të punosh vullnetarisht do të thotë të fuqizosh socializmin, të ndërtosh të ardhmen komuniste. Dhe kjo e ardhme ju përket, në radhë të parë, juve, të rinjve e të rejave, prandaj ndërtojeni atë me mendjen tuaj të kthjellët, me duart tuaja të arta.

Aksionet janë bërë jetë e dytë e rinisë. Në vargun e gjatë të tyre shquhen sidomos hekurudhat, që përbëjnë një element tepër të rëndësishëm të transportit kombëtar, një arter të fuqishëm të tij. Këto hekurudha i keni ndërtuar ju, të dashur të rinj e të reja, ato mbajnë vulën e entuziazmit tuaj, të hovit revolucionar dhe të patriotizmit tuaj të lartë. Dhe ja, tani ju mbaruat edhe Hekurudhën Elbasan—Përrenjas e cila ka jo vetëm një rëndësi të madhe ekonomike, por edhe politike. Ajo do ta sjellë hekur-nikelin në

kombinatin gjigant metalurgjik që po ngrihet madhështor në Elbasan. Kjo hekurudhë do të luajë edhe një rol të rëndësishëm për përparimin e gjithanshëm të krahinave të Librazhdit e të Elbasanit, ku do të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, bujqësisë, arsimit e kulturës.

Shumë lodhje, shumë mund e sakrifica u deshën për ta ndërtuar këtë hekurudhë. Por rinia jonë trime pranoi me vullnet e ndërgjegje çdo vështirësi dhe luftoi me vetëmohim për kapërcimin e tyre. Lugina e bukur e Shkumbinit dhe fusha e Përrenjasit, që janë dëshmitare të ngjarjeve historike shekullore, që nga rruga Egnatia, beteja legjendare e Domosdovës, ku luftoi kundër turqve Heroi Kombëtar, Skënderbeu, e deri te betejat e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, tani u bënë edhe dëshmitare të punës kolosale që u zhvillua në ndërtimin e kësaj hekurudhe, e cila për tunelet, urat dhe veprat e shumta të artit do të mbetet kurdoherë një vepër monumentale.

Hekurudha Elbasan—Përrenjas u bë një shkollë e madhe e edukimit revolucionar, e kalitjes së fuqishme politike, ideologjike dhe fizike të 140 000 të rinjve e të rejave punëtorë, kooperativistë, nxënës e studentë që morën pjesë në ndërtimin e saj. Ardhja e tyre nga të katër anët e vendit në këtë aksion u hoqi sektorëve të ekonomisë një forcë të madhe punëtore. Por kjo nuk u ndie sepse kudo puna e vullnetarëve që shkuan në hekurudhë, u zëvendësua nga punonjësit e tjerë,

të cilët e ngritën akoma më lart frymën e mobilizimit, të organizimit e të disiplinës në zbatimin e detyrave. Kjo tregoi edhe një herë patriotizmin e lartë, frymën e vetëmohimit dhe gatishmërinë e madhe të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore për t'ua kushtuar gjithçka interesave të lartë të popullit. Kjo vuri edhe një herë në dukje vetitë e larta të moralit komunist të njeriut tonë të ri, përvetësimin dhe vënien në jetë të mësimëve dhe të vijës së drejtë të Partisë.

Bashkë me ju, vullnetarët e rinisë, punuan në këtë aksion edhe të moshuar, burra, gra, veteranë e pensionistë. Ky ishte një shkëlqim tjetër i unitetit të çeliktë të popullit tonë, që është kalitur në llogoret e Luftës Nacionalçlirimtare dhe vazhdon të kalitet më shumë edhe sot në kudhrën e luftës për ndërtimin socialist të vendit.

Të gjithë ju, shokë dhe shoqe vullnetarë të Hekurudhës Elbasan—Përrenjas, përbëni një armatë të tërë aktivistësh shoqërorë. Fryma juaj e lartë patriotike dhe revolucionare ka depërtuar në shkolla, në fabrika, në fshat, në institucione kulturore e kudo. Në luftën e madhe që zhvillon Partia për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit, ju keni dhënë dhe jepni një kontribut të shquar. Rinia jonë stafetën e kuqe të revolucionit, nën udhëheqjen e Partisë, do ta çojë gjithnjë përpara, drejt majave të larta të socializmit.

Puna dhe lufta e rinisë sonë duken jo vetëm në ndërtimin e veprave të mëdha, por në të gj-

tha fushat e jetës e të veprimtarisë shoqërore, një nga të cilat është edhe ajo e ideologjisë. Në këtë fushë rinia përbën një forcë të madhe sulmuese. E brumosur me ideologjinë e Partisë, ajo lufton vazhdimisht kundër mbeturinave të vjetra, kundër ndikimeve të sotme të ideologjisë borgjezo-revizioniste. Shigjetave plot helm të armiqve rinia jonë u kundërvë ideologjinë revolucionare të nënës së saj, Partisë së Punës.

Ndërsa vendi ynë ndodhet në një situatë të shkëlqyer të hovit revolucionar dhe të punës ndërtimore, ku jeta e punonjësve bëhet më e lumtur dhe më e begatshme, botën kapitaliste e kanë përfshirë kriza të shumta nga më të rëndat, një degjenerim i madh, konflikte klasore të fuqishme dhe një rënie e përgjithshme. Mjafton ky krahasim për të treguar forcën e socializmit, drejtësinë e vijës së Partisë sonë të lavdishme, që e udhëheq popullin në rrugën e sigurt, drejt së ardhmes së ndritur. Shqipëria socialiste, edhe pse jeton e punon në një rrethim të egër imperialisto-revizionist, ecën përpara pa u ndalur, ngrë çdo ditë mirëqenien e popullit të vet. Në forcën tonë të çeliktë, në unitetin monolit të popullit rreth Partisë, kanë thyer e do të thyejnë kurdoherë kokën armiqtë tanë, imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe satelitët e tyre kudo që janë.

Ne ndërtojmë hekurudha dhe një sërë vep-rash të tjera të mëdha e të vogla në industri, bujqësi, shëndetësi, arsim, kulturë etj. Por, mbi

të gjitha, në vendin tonë farkëtohet njeriu i ri, me moral e veti komuniste, i aftë të ndërtojë socializmin dhe t'i mbrojë fitoret e tij deri në fund. Në punë, në shkollë, në aksione, në ndërtimin e veprave të pesëvjeçarëve ju, të rinj e të reja, kaliteni si hekuri në zjarr, bëheni më të ndërgjegjshëm që, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë, të luftoni pa u lodhur për lulëzimin dhe mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

Partia dhe Qeveria po përgatitin tani planin e ri pesëvjeçar për realizimin e të cilit juve do t'ju takojë një rol i madh. Në letrën që më dërguat, ju zotoheni se do të kaloni nga aksioni në aksion. Duke i njohur mirë patriotizmin dhe gatishmërinë tuaj të lartë, Partia dhe Qeveria mendojnë që për vitin 1974 t'i besojnë rinisë së lavdishme të Shqipërisë socialiste ndërtimin e hekurudhës së re Fier—Ballsh.

Shpreh bindjen e plotë të Partisë dhe të popullit se ju, si kurdoherë, do ta kryeni me sukses edhe këtë aksion.

Sot sirena e trenit gjëmon në Përrenjas, nesër le të buçasë në pellgun e Mallakastrës trime!

Rroftë Partia!

Rroftë rinia jonë e lavdishme!

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për rininë» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 391

## **PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOLEKTIVIT TË FABRIKËS SË CIGAREVE «TELAT NOGA»**

*Durrës*

**4 maj 1974**

Të dashur shokë dhe shoqe punëtorë, teknikë dhe inxhinierë,

Ju kërkoj të falur që, për arsye pune, nuk po i përgjigjem dot ftesës për të marrë pjesë në festën e gëzueshme të 50-vjetorit të fabrikës suaj. Këtë mungesë po përpiqem ta plotësoj nëpërmjet kësaj letre, duke ju dërguar përshëndetjet më të nxehta revolucionare të Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat personale. Me këtë rast, më lejoni t'ju uroj nga zemra të gjithëve ju, shoqe dhe shokë, shëndet e lumturi në familjet tuaja. E kalofshi sa më të gëzuar këtë festë të ndërmarrjes që mban emrin e punëtorit trim, dëshmorit të mirënjohur të Luftës Nacionalçlirimtare, shokut tonë të paharruar, Telat Noga.

Fabrika juaj është një nga më të vjetrat e vendit tonë, kolektivi luftarak i së cilës ka kaluar

nëpër një rrugë të lavdishme, është rritur e zhvilluar bashkë me gjithë klasën tonë punëtore.

Para Çlirimit, vëllezërit dhe motrat tuaja të klasës, që kanë punuar aty qysh në moshë fare të njomë, janë shfrytëzuar në palcë nga pronarët borgjezë dhe tregtarët e pangopur. Punëtorët, si kudo në Shqipëri, edhe aty rropateshin e cfiliteshin në punë për të fituar një krodhë bukë, që u nevojitej pjesëtarëve të familjeve të tyre të shumëvujtura për të mbajtur frymën. Kur lindi Partia, vija e së cilës u bë që në fillim program lufte për çlirimin e atdheut dhe për një jetë më të mirë të të gjithë popullit, u hapën perspektiva edhe për kolektivin e asaj fabrike, që në atë kohë përqafoi dhe ndoqi me besim të patundur mësimet e saj shpëtimtare.

Ju, të reja e të rinj punëtorë, teknikë dhe inxhinierë që punoni sot aty, keni mësuar se nga radhët e paraardhësve tuaj, në kohën kur atdheu dhe populli vuanin nën zgjedhën e rëndë të pushtuesve fashistë italianë e gjermanë dhe të tradhtarëve shqiptarë të shitur, iu përgjigjën me entuziazëm thirrjes së Partisë, dolën malit dhe luftuan me armë në dorë 50 partizanë heroikë, midis të cilëve 16 dëshmorë, që ranë në fushën e nderit për çlirimin e atdheut dhe vendosjen e pushtetit popullor. Një ndihmë të çmuar në favor të Luftës Nacionalçlirimtare dha edhe shumica e punëtorëve që mbetën aty, duke shfrytëzuar format e ndryshme të luftës, legale dhe ilegale, kundër armiqve të jashtëm e të brend-

shëm. Kolektivi i fabrikës suaj u bë kështu një vatër e zjarrtë revolucionare i frymëzuar nga mësimet e Partisë Komuniste Shqiptare dhe i lidhur ngushtë si mishi me thoin me të. Dhe gjaku e sakrificat e motrave e të vëllezërve tuaj të asaj kohe nuk shkuan kot, Shqipëria u çlirua, populli u bë zot i vendit dhe iu përvesh punës me të gjitha forcat për ndërtimin e socializmit.

Këto tradita të shkëlqyera të luftës dhe të punës të mbarë popullit shqiptar, si kudo, edhe ju i ruani si një pasuri të shtrenjtë dhe po i pasuroni më tej. Nën udhëheqjen e Partisë ju ndërtoat një pallat të madh e të bukur, ku prodhon fabrika juaj, e cila ndryshon si dita me natën me fabrikën e dikurshme të ish-shoqërisë «STAMLES». E pajisur me makineri moderne, ajo është një nga ndërmarrjet e rëndësishme të industrisë sonë socialiste. Prodhimet që mbajnë markën e saj njihen tashmë edhe jashtë atdheut për cilësinë dhe bukurinë e tyre.

Më gëzuar shumë, shoqe dhe shokë punëtorë, me sukseset e arritura. Ju jeni një kolektiv revolucionar, që luftoni për rezultate të larta në prodhim, për realizimin e planit në të gjithë treguesit e tij, për ruajtjen e pronës socialiste, për sa më shumë kursime. Na bëhet zemra mal kur dëgjojmë edhe se ju po përpiqeni me të gjitha forcat për rritjen e nivelit politik e ideologjik, për rritjen e nivelit arsimor e teknik në shkollat dhe kurset e ngritura pranë ndërmarrjes, për të zhvilluar më tej revolucionin tekniko-shkencor

etj. Me vrullin tuaj luftarak, me shpirtin krijues, duke zhvilluar iniciativat revolucionare dhe emulacionin socialist, ju merituat titullin e lartë «Sulmues i vitit 1973 dhe i pesëvjeçarit të pestë». Jam në dijeni edhe të zotimeve të guximshme që keni marrë për nder të 30-vjetorit të Çlirimit. Ju lumtë, shoqe dhe shokë punëtorë të fabrikës «Telat Noga», që jeni një nga kolektivat para-rojë të vendit tonë dhe luftoni kurdoherë me këmbëngulje si gjithë klasa punëtore për lulëzimin dhe mbrojtjen e atdheut.

Unë kam besim të plotë se edhe në të ardhmen kolektivi juaj do të mbajë lart emrin e mirë të ndërmarrjes dhe do të realizojë me nder të gjitha zotimet që ka marrë para popullit dhe Partisë.

Duke ju përgëzuar me gjithë zemër për sukseset e arritura në të gjitha drejtimet, ju uroj, të dashur shokë dhe shoqe, fitore të reja në realizimin e të gjitha detyrave dhe të planit të këtij viti, që është viti vendimtar i pesëvjeçarit të pestë. Prandaj, me forca të shumëfishuara, le ta presim duarplot e ballëlart festën e madhe të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Adriatiku», nr. 37 (730),*

*9 maj 1974*

**LETËR DREJTUAR VAJZAVE  
VOLEJBOLLISTE TË KLUBIT SPORTIV  
«DINAMO»**

**14 maj 1974**

Të dashura shoqe volejbolliste,

Ju përgëzoj nga zemra për të gjitha ato suksese që keni arritur gjatë këtij viti në lojën e bukur të volejbollit. Duke merituar Kupën e Republikës, ekipi i vajzave të rritura u vu në krye të klasifikimit të kampionatit kombëtar për kategorinë e parë. Me këtë rast dëshiroj t'ju uroj fitore të reja sportive në kuadrin e Spartakiadës së 3-të Kombëtare që zhvillohet për nder të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Kur po këndoja letrën që më dërguat, më dolën përpara vitet e rinisë sime. Ç'dëshirë të zjarrtë kishim edhe ne në atë kohë për të ushtruar fizkulturën dhe sportin! Po atëherë ne s'kishim kushtet që janë krijuar sot për mbarë

rininë e vendit tonë. Luanim në ndonjë shesh të vogël që e pastronim nga zallishtet, sajonim vetë nga një top prej lecke, rrëshqitnim te lukurama e lagjes mbi një pllakë të lëmuar guri derisa na griseshin edhe pantallonat, zhvillonim lojëra popullore etj. Sa për vajzat, as që mund të bëhej fjalë, shumë prej tyre pengoheshin të venin edhe në shkollën fillore, pa lëre të merreshin me sport e fizkulturë. Në moshën më të bukur të jetës ato ishin të detyruara të mbylleshin brenda mureve të shtëpisë, ku, pasi bënë punët e përditshme, qepnin e qëndisnin. E kush të kujdesej për to? Regjimet antipopullore, që e kishin lënë popullin tonë në errësirë, pa liri, pa bukë, pa arsim e pa kulturë? Një regjim që s'kujdesej as për kafshatën e gojës të punonjësve, si mund të mendonte për zhvillimin e sportit e të fizkulturës për ta dhe fëmijët e tyre?

Por edhe pse klasat shfrytëzuese nuk interesoheshin për masat punonjëse, populli dhe rinia zhvillonin lloj-lloj lojërash. Edhe në këtë drejtim ka vepruar fantazia krijuese e tyre. Në këngët e rapsoditë popullore gjejmë tablo të bukura ku përshkruhen lojërat e garat e larmishme sportive, përmes të cilave njerëzit e thjeshtë jo vetëm zbaviteshin, por dhe edukoheshin për të qenë të fortë që të përballonin me sukses e heroizëm vështirësitë e jetës së rëndë të asaj kohe.

Krejt ndryshe është sot, kur ju i keni të gjitha mundësitë të punoni, të mësoni, të kaliteni e

të çlodheni në mënyrë të kulturuar. Vlerësimi i madh për edukimin fizik është sintetizuar në shprehjen e urtë të njohur në shekuj «Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë». Njerëzimi ua ka ndier prej kohësh dobinë e madhe sportive e fizkulturës si burim force e shëndeti, burim gëzimi dhe optimizmi. Ato, përveç që mbajnë të freskët trupin, zhvillojnë te njeriu shkathtësinë e guximin, vullnetin e këmbënguljen, ndjenjën e shoqërisë e të kolektivitetit.

Prandaj Partia dhe pushteti popullor kanë krijuar kushte të shumta për zhvillimin e gjithëanshëm e harmonik, mendor e fizik të brezit të ri e të të gjitha masave. Dhe rezultatet nuk mungojnë as në të gjitha llojet e sportit, një nga të cilat është voleybolli, kjo lojë aq e bukur, që ju e dashuroni shumë.

Shembulli juaj, të dashura shoqe të klubit sportiv «Dinamo», le të vlejë për t'i dhënë një hov akoma më të madh lëvizjes masive fizkulturore e sportive nga të gjithë punonjësit, sidomos nga rinia. Pa një lëvizje masive fizkulturore e sportive nuk mund të ketë as rritje të cilësisë sportive. Unë shpreh bindjen se paskëtaj do të ndërmerren kudo iniciativa e aksione për një zhvillim akoma më të gjerë se deri më sot të fizkulturës e të sportive në vendin tonë, duke filluar që nga gjimnastika e mëtuesit. Për këtë është e domosdoshme të krijohet një opinion i shëndoshë kudo në familje, në shkollë, në qendra

pune e në shoqëri për ta vlerësuar politikisht rolin e madh të edukimit fizik të mbarë punonjësve e, në radhë të parë, të rinisë. Kalitja fizike, natyrisht në përshtatje me moshën dhe me seksin, do ta bëjë njeriun tonë të ri më të fortë e të shëndetshëm, luftëtar të shkathët për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut. Ta bëjmë, pra, sportin, pjesë të rëndësishme të jetës sonë.

Sot te ne zhvillohen të gjitha llojet e sporteve. Futbollit është një lojë e mirë, por edhe lojërat me dorë e sportet e tjera duhen praktikuar gjithnjë më shumë e në mënyrë sa më masive. A nuk janë, gjithashtu, të bukura atletika, olimpiadat e marshimet, alpinizmi e turizmi, noti e qitja, lojërat popullore etj.? Shqipëria ka një natyrë nga më të bukurat në botë dhe klimë shumë të shëndetshme. Ne kemi kudo ajër të pastër, ujë të freskët dhe në përgjithësi ditë të kthjellëta me diell, që janë tre mjekët tanë më të mirë. Po të shfrytëzohen si duhet këta faktorë objektivë, do të ndihmojnë shumë për kalitjen fizike të njerëzve tanë, për zbukurimin e zgjatjen e jetës së tyre.

Duke ju shprehur edhe një herë përgëzimet e mia, ju uroj, të dashura shoqe, shëndet e suksese të mëtejshme si sportiste, njëkohësisht edhe si mësuese dhe edukatore të qindra e qindra të rejave të tjera, që me siguri në të ardhmen do të përfshihen akoma më tepër në lëvizjen masive

fizkulturore e sportive të vendit tonë, i cili po e pret duarplot festën e madhe të 30-vjetorit të Çlirimit.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për rininë» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 396

**LETËR DREJTUAR TË REJAVE  
DHE TË RINJVE TË KOOPERATIVËS  
BUJQËSORE «ENVER HOXHA» TË BUJANIT**

*Tropojë*

**22 mars 1975**

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Me letrën që më dërguat, ju më jepni një tog sihariqesh: bashkë me kooperativistët e tjerë realizuat planin e hapjes së tokave të reja për pesëvjeçarin e pestë dhe tani ju, të rinj e të reja, jeni hedhur në aksion për krijimin e një blloku me vreshta e, në të njëjtën kohë, keni dalë vullnetarë për të marrë pjesë në ndërtimin e hekurudhës Përrenjas—Guri i Kuq dhe të linjës hekurudhore brenda Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Me këto sihariqe ju më gëzuat shumë dhe ma bëtë zemrën mal. Ju përgëzoj ngrohtësisht për punën e palodhur që keni bërë e vazhdoni të bëni për të forcuar e lulëzuar kooperativën tuaj buj-

**LETËR DREJTUAR TË REJAVE  
DHE TË RINJVE TË KOOPERATIVËS  
BUJQËSORE «ENVER HOXHA» TË BUJANIT**

*Tropojë*

**22 mars 1975**

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Me letrën që më dërguat, ju më jepni një tog sihariqesh: bashkë me kooperativistët e tjerë realizuat planin e hapjes së tokave të reja për pesëvjeçarin e pestë dhe tani ju, të rinj e të reja, jeni hedhur në aksion për krijimin e një blloku me vreshta e, në të njëjtën kohë, keni dalë vullnetarë për të marrë pjesë në ndërtimin e hekurudhës Përrenjas—Guri i Kuq dhe të linjës hekurudhore brenda Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Me këto sihariqe ju më gëzuat shumë dhe ma bëtë zemrën mal. Ju përgëzoj ngrohtësisht për punën e palodhur që keni bërë e vazhdoni të bëni për të forcuar e lulëzuar kooperativën tuaj buj-

qësore si dhe për kontributin që do të jepni, krahas gjithë rinisë së vendit tonë, me pjesëmarrjen tuaj në veprat e mëdha me rëndësi kombëtare, për ta bërë gjithnjë më të gëzuar e më të begatshme jetën e malësorëve trima të atyre anëve dhe të të gjithë popullit tonë heroik.

Duke kaluar nga njëri aksion në tjetrin, ju po tregoni një shembull të lartë gatishmërie e patriotizmi të zjarrtë socialist. Kjo është karakteristikë për gjithë rininë e vendit tonë, që ecën kurdoherë e vendosur në rrugën revolucionare të Partisë. Me të rinj e të reja sulmues si ju, atdheu ynë bëhet përherë e më tepër i pamposhtur nga çdo armik, populli i pathyeshëm, Partia jonë më e çeliktë dhe familjet tuaja krenare dhe të lumtura.

Ju uroj shëndet dhe suksese të reja në frontet e punës, të mësimit dhe të kalitjes ushtarake.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM DËRGUAR SHOQES  
HYRIE HENA, PESHTAN—MOGLICE**

*Korçë*

**4 qershor 1975**

E dashur motër Hyrie,

Këndova me kënaqësi letrën që më dërgove, ku ti, veterane e Luftës Nacionalçlirimtare, u gëzohesh me gjithë zemër realizimeve të mëdha që janë bërë pas Çlirimit në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë. Të falënderoj për ndjenjat e tua patriotike dhe të uroj tok me bashkëshortin, shokun tonë partizan të luftës, shëndet, gëzime dhe një jetë plot aktivitete në frymëzimin e punonjësve dhe të rinisë së kooperativës për përparimin dhe begatinë e fshatrave tuaja. U bëni

shumë të fala nga unë të gjitha motrave e vëllezërve kooperativistë të Moglicës.

LETËR DITUAR ZONËS  
DREJTIMI ARMIK  
Juaji

1771, qershor 1972

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR ZONJËS  
JOZEFINA LAMBERC**

7 qershor 1975

Shumë e nderuara zonja Jozefina Lamberc,

Me kënaqësi të veçantë mora materialin për jetëshkrimin e Profesorit të nderuar, Maksimilian Lamberc, që ju patët mirësinë të më dërgoni dhe ju falënderoj me mirënjohje të thellë për kujdesin tuaj.

E lexova me interesim të madh këtë material ku, midis të tjerash, shkruhet edhe për veprën e paçmueshme të bashkëshortit tuaj, albanologut të shquar Profesor Maksimilian Lamberc, emri i të cilit do të mbetet gjithmonë i dashur dhe i paharruar për të gjithë lëvruesit e gjuhës dhe të letërsisë shqipe.

Ju uroj nga zemra shëndet të mirë dhe lumturi.

Me respekt

*Enver Hoxha*

«Për shkencën» (Përmbledhje  
veprash), vëll. I, f. 548

**LETËR DREJTUAR**  
**SHOQES LLAMBRINI MANASTIRLIU**

*Tiranë*

**20 qershor 1975**

E dashur motër Llambrini,

Më gëzoi shumë letra jotë e ngrohtë dhe e përzemërt. Duke të shkruar këto radhë, m'u kujtua diçka e shtrenjtë nga e kaluara, kur 31 vjet më parë, vetëm dy muaj pas vrasjes së Kleanthit, pushtuesit e huaj, në bashkëpunim me tradhtarët e vendit, në gusht të vitit 1944 vranë edhe Dionisin. Brenda dy muajve ti, nënë trime dhe patriotë, i dhe çështjes së çlirimit të Shqipërisë dy djem si dy yje, dy nga shokët tanë të paharruar të Luftës së madhe Nacionalçlirimtare. Dhe atëherë urrejtja kundër armiqve t'u rrit edhe më shumë dhe the me krenari «Të rrojë Partia, se nëna djemtë për Shqipëri i ka».

Kështu u fliste zemra gjithë nënave trimëresha shqiptare, bijat dhe bijtë e të cilave, nën

udhëheqjen e Partisë, luftonin e sakrifikonin deri edhe jetën për lirinë dhe të mirat që gëzon sot populli ynë. Këto nuk erdhën vetë, por u fituan me luftë e sakrifica të panumërta. Prapë me punë të palodhur e me luftë të pandërprerë e sakrifica fitoret e arritura tani duhen ruajtur e shumëfishuar, prandaj, e dashur motër, edhe ti, si gjithë veteranët e vendit tonë, pavarësisht nga mosha, përpiqesh të japësh akoma kontributin në edukimin e brezit të ri me idealet e mëdha të Partisë, që Shqipëria e re socialiste të rrojë, të përparojë e të bëhet e pathyeshme.

Të falënderoj për fjalët e mira që shkruan për Partinë dhe për popullin, të cilët, të bashkuar si një trup i vetëm, punojnë për ndërtimin e socializmit dhe luftojnë pandërprerë kundër armiqve të klasës, të brendshëm e të jashtëm.

Të uroj shëndet dhe jetë të gjatë.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR POPULLIT TË FSHATIT MASHKULLORË

*Gjirokastër*

**13 mars 1976**

Të dashura nëna, motra, të dashur vëllezër mashkulloritë,

Ju falemnderit shumë për ftesën që më bëtë për të marrë pjesë në festën e 68-vjetorit të përpjekjeve me armë të çetës heroike të Çerçiz Topullit, këtij patrioti të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare, me asqerët e pushtuesve turq.

Do të ishte një gëzim i madh për mua që në këtë ditë të shënuar të isha aty, të ulesha pajdash së bashku me ju pranë rrapit të moçëm historik të bisedoja me ju, motra dhe vëllezër mashkulloritë, për të kaluarën e lavdishme të të parëve tanë, për Luftën e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare që udhëhoqi Partia, e cila i solli popullit tonë trim e patriot lirinë aq të dë-

shiruar gjatë gjithë historisë së tij shekullore, për të gjitha ato të mira që gëzon sot mbarë populli shqiptar. Me këtë rast do të dëshiroja t'ia thoshim së toku asaj kënge të fuqishme, me të cilën populli ka përjetësuar këtë përpjekje të paharruar të një grushti heronjsh, me Çeçon në ballë, kundër një armiku të madh në numër e të armatosur gjer në dhëmbë. Por duke qenë i zënë me punë, nuk mund ta plotësoj këtë dëshirë të përbashkët. Megjithatë, e ndiej veten aty, në mes jush, përfytyroj ato orë të gëzueshme të një atmosfere plot zjarr patriotik e revolucionar që do të kaloni dhe së largu vij t'ju përshëndes nga zemra: Gëzuar nga mot festën tradicionale të 18 marsit!

Jam gëzuar gjithashtu shumë që krahas arritjeve e përparimeve të tjera të shumta në Mashkullorë, sot do të inauguroni edhe ujësjellësin e ri. E gëzofshi përjetë ujët e kulluar që ju vjen nga burimet e ftohta të Hosit dhe shpreh dëshirën që ai t'ju sjellë shëndet gjithë familjeve të fshatit tuaj. Ujët përmirëson higjienën, jep mundësi për një pastërti më të madhe në familje, që juve s'ju ka munguar, ai sjell kënaqësi e lumturi për njerëzit tanë, që i kthejnë të gjitha këto të mira në forca për të ecur gjithnjë më përpara në rrugën e ndritur të socializmit. Shpreh bindjen se edhe ju, ashtu si gjithë populli, si patriotë të vendosur, i jeni përveshur punës më shumë se kurdoherë për realizimin dhe tejkalimin e detyrave të vitit të parë të pesëvjeçarit,

që është njëkohësisht edhe viti i 35-të i themelimit të Partisë sonë të dashur, viti i diskutimit të madh popullor për aprovimin e Kushtetutës së re; për të dhënë kështu kontributin tuaj në lulëzimin dhe mbrojtjen e atdheut socialist, në begatinë e forcimin e kooperativës.

Duke përfunduar ju bëj të gjithëve ju, mostra dhe vëllezër të dashur, të falat e mia më të përzemërta.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Pararoja», nr. 22 (929),  
17 mars 1976*

**LETËR DREJTUAR GJITHË VULLNETARËVE  
TË RINISË QË MORËN PJESË NË NDËRTIMIN  
E LINJËS HEKURUDHORE TË KOMBINATIT  
METALURGIK**

**20 gusht 1976**

Të dashur shokë dhe shoqe vullnetarë,

Mbarë populli ynë, para pak ditësh, mori lajmin e gëzuar mbi përfundimin e linjës së re hekurudhore brenda territorit të Kombinatit Metalurgjik, për të cilën më njoftuat edhe me letër të veçantë. Kjo është një tjetër dhuratë e bukur e rinisë, një tjetër vepër me vlerë të madhe e ndërtimit socialist, që, ashtu si damarët e fuqishëm të një zemre të shëndoshë, që rreh fort e pa pushim, u shtohet hekurudhave të tjera, nëpërmjet të cilave çdo ditë transportohet për në drejtime të ndryshme gjithçka e domosdoshme për nevojat e atdheut. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe timin, unë ju përshëndes

dhe ju përgëzoj për këtë sukses tjetër të madh që arritët me punën tuaj të palodhur.

Partia kishte besim të plotë se, ashtu si në çdo vepër tjetër, ju, shoqe dhe shokë të rinisë, do t'ia dilnit në krye me sukses dhe do të kapërcenit çdo pengesë e vështirësi, sepse jeni një forcë e madhe revolucionare e pashtershme. Këtë forcë ju e gjeni në mësimet e marksizëm-leninizmit, në mësimet e Partisë sonë heroike të Punës, në realitetin tonë socialist, në perspektivat e mëdha, të qarta e të sigurta që Partia ka hapur para rinisë dhe mbarë popullit tonë.

Çdo vepër e rinisë sot lidhet me veprat e aksionet e mëparshme, është një vazhdim i traditës së lavdishme të aksioneve që ajo ka ndër-marrë dhe ka çuar deri në fund me sukses. Aksionet janë në natyrën e rinisë, jeta e së cilës nuk mund të mendohet pa to. Me aksione rinia nuk ndërton vetëm vepra të rëndësishme ekonomike. Ato shërbejnë, në radhë të parë, si një shkollë e madhe për kalitjen e brezit të ri dhe për edukimin e tij me koncepte revolucionare për punën dhe për jetën, për të ngulitur në të rinjtë e të rejtat frymën e kolektivizmit e të luftës për kapërcimin e vështirësive, të dashurisë për shokun, të miqësisë së pastër, të vendosmërisë revolucionare.

Zotimin që keni marrë për t'i shërbyer atdheut atje ku ka nevojë e në frontet më të vështira, kam besim të patundur se ju, ashtu si kurdoherë, do ta bëni realitet. Është nder i madh

të punosh e të mbrosh atdheun në çdo pëllëmbë të tij, atje ku është më vështirë, të derdhësh djersën e, po ta lypin interesat e përgjithshëm të Partisë dhe të socializmit, të japësh edhe jetën, ashtu siç e dha heroikisht para pak kohësh i riu patriot Ilia Dashi e të tjerë më parë, të cilët do të rrojnë e do të nderohen në shekuj nga Partia, nga populli dhe rinia jonë.

I takon pikërisht rinisë që, për nder të 35-vjetorit të themelimit të Partisë e të Kongresit të 7-të të saj, si dhe të 35-vjetorit të themelimit të organizatës suaj luftarake, në shembullin e klasës punëtore, të ndër marrë aksione e lëvizje të reja në dobi të ndërtimit e të mbrojtjes së socializmit me forcat e veta, në kushtet e rrethimit të egër imperialist e revizionist, të manifestojë fuqishëm vetitë e moralit komunist, të shënojë faqe të reja lavdie e heroizmi në çdo drejtim. Kjo përbën një provë e dëshmi tjetër të brezit tonë të ri që, i bashkuar në organizatën e tij të BRPSH-së, qëndron i patundur në pozita revolucionare, i denjë dhe i aftë për të marrë në duart e veta dhe për ta çuar më tej stafetën e revolucionit e të socializmit.

Duke ju falënderuar nga zemra për letrën që më dërguat, ju uroj me këtë rast punë të mbarë e suksese të mëtejshme juve dhe gjithë shokëve e shoqeve të rinisë që punojnë për ndërtimin e hekurudhës Përrenjas—Guri i Kuq, nëpërmjet së cilës do të furnizohet me lëndë të parë Kombinati Metalurgjik, gjithë vullnetarëve të

tjerë të rinisë, që punojnë e derdhin djersën pa kursim në veprat ujitëse të vendit, si dhe gjithë rinisë sonë heroike që, anembanë Shqipërisë, në të gjitha frontet e ndërtimit socialist, punon, vigjilon, tregon pjekuri, heroizëm e besnikëri të pakufishme ndaj Partisë dhe popullit. Ju uroj gjithashtu të gjithëve ju shëndet, gëzim e lumturi.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 200 (8743), 21 gusht 1976*

**LETËR DREJTUAR TË RINJVE  
DHE TË REJAVE TË RRETHIT TË BERATIT,  
INICIATORË TË LËVIZJES PËR TË PUNUAR  
E JETUAR NË FSHAT**

**1 dhjetor 1976**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Arritjet tuaja të gjertanishme në lëvizjen patriotike e revolucionare për të punuar e jetuar në fshatin tonë socialist, fjalët e zemrës që shkruani ju për Partinë në letrën që më dërguat dhe besimi që keni për kapërcimin e vështirësive të punës, më gëzuan shumë. Ju përgëzoj për iniciativën që morët me përqafimin e kësaj lëvizjeje dhe ju uroj punë të mbarë e suksese gjithnjë më të mëdha në të ardhmen për zbatimin e detyrave që ju kanë ngarkuar Partia dhe organizata juaj e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, 35-vjetorin e së cilës festuam para disa ditësh.

Unë i kuptoj vështirësitë e fillimit të punës

suaj në fshat, por kam pasur dhe kam kurdoherë bindjen e patundur se rinia jonë e mrekullueshme bën çdo gjë të mundur për të kapërcyer me sukses çdo vështirësi, sado e madhe që të jetë. Ajo asnjëherë nuk u është trembur atyre, por gjithnjë ka shkuar për të luftuar e për të punuar atje ku e ka kërkuar interesi i atdheut. Si në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe sot në luftën e madhe për ndërtimin e socializmit, në kushtet e rrethimit të egër imperialist e revizionist, rinia jonë ecën përpara e vendosur, e pamposhtur e revolucionare, sepse të tillë e frymëzon, e edukon dhe e kalit çdo ditë Partia jonë e lavdishme e Punës.

Kapërcimi i pengesave, realizimi i detyrave dhe gëzimi i fitores arrihen dhe shijohen me punë të palodhur, me djersë, me sakrifica, me guxim e vendosmëri. Nesër ju do të ndieni më shumë gëzim për realizimin me sukses të çdo detyre që do të kryeni së bashku me fshatarët, nën udhëheqjen e organizatave-bazë të Partisë. Duke punuar me këmbëngulje, ju do të bëheni të gjithë si shoqet dhe shokët tuaj më të mirë kooperativistë. Shembulli juaj do të jetë njëkohësisht një nxitje e madhe për të gjithë ata që kanë pretendime për të jetuar vetëm në qytet dhe që kërkojnë punë të lehta. Duke e kuptuar dhe ndier se atdheu ynë nuk përbëhet vetëm nga qytetet, se socializmi nuk ndërtohet vetëm në qytet, me siguri, të tillë të rinj që edhe këta i duan popullin, Partinë dhe atdheun (por që, tani

për tani, i pengon ndonjë mbeturinë e së kaluarës për ta parë më drejt të mirën e përgjithshme), nuk do të mungojnë të ndjekin rrugën tuaj dhe radhët e lëvizjes për të punuar e jetuar në fshat do të shtohen vazhdimisht.

Kooperativistët gëzohen shumë kur shohin se rinia, e ardhmja e atdheut, e do bujqësinë dhe punon që ajo të përparojë siç dëshirojnë Partia dhe populli. Dhe në fakt fshati ynë, të cilit me aq dashuri e zjarr patriotik i ka kënduar poeti ynë i pavdekshëm Naim Frashëri në veprën e famshme «Bagëti e Bujqësi», nën kujdesin e Partisë, me punën e palodhur të kooperativistëve, është bërë shumë më i bukur se përpara, ai lulëzon çdo ditë, çdo vit e më shumë po krijohen atje kushte që e afrojnë me qytetin. Duke punuar e jetuar me kooperativistët ju do të çoni midis tyre frymën dhe ideologjinë e klasës punëtore, do të njiheni me traditat luftarake, revolucionare e përparimtare të fshatarësisë sonë, do të ndihmoni me punën tuaj përparimin e fshatit tonë të ri në rrugën e socializmit. Ky do të jetë një kontribut tjetër konkret për forcimin e mëtejshëm të aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë dhe do të shërbejë për rrënjosjen e mendimit se në Shqipërinë e re kudo mund të punosh, të krijosh, të luftosh e të jetosh si revolucionar dhe i lumtur.

Më gëzoi shumë qëndrimi pranë jush i kuadrove të kooperativave bujqësore të rrethit tuaj dhe ndihma që ata ju kanë dhënë për realizimin

e detyrave. Kuadrot tanë janë bij të popullit dhe besnikë të Partisë, që, bashkë me punëtorët e fshatarët, punojnë pa u lodhur gjithashtu kudo për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut. Jam i sigurt se ata, duke kuptuar drejt orientimet e Partisë, do të vazhdojnë t'ju ndihmojnë, gjithashtu, në të ardhmen në çdo drejtim, sidomos për t'ju krijuar kushte banimi të përshtatshme, që ju, të rinj e të reja të pararojës, që keni shkuar atje nga fabrikat e qyteteve dhe nga shkollat, të punoni e të kontribuoni më mirë në përparimin e fshatit.

Shpreh bindjen se materialet e Kongresit të 7-të të Partisë, që po studioni tani me vëmendje të madhe, si gjithë punonjësit e rinia e mbarë vendit, do të çlirojnë nga gjiri juaj energji e forca të reja dhe, të frymëzuar prej tyre, do të mobilizoheni me të gjitha forcat për realizimin e detyrave që vihen në to për zhvillimin e bujqësisë për ta bërë fshatin tonë socialist më të begatshëm e më të bukur për të mirën e popullit dhe të mbarë atdheut.

Edhe një herë ju uroj nga zemra punë të mbarë, gëzim e lumturi bashkë me motrat dhe vëllezërit kooperativistë.

**Juaji**

**Enver Hoxha**

Gazeta «Kushtrimi», nr. 97  
(1950), 4 dhjetor 1976

## LETËR DREJTUAR NXËNËSEVE LAURETA DHE ALMA SHEHU

*Elbasan*

**31 dhjetor 1976**

Të dashura Laureta dhe Alma,

Letra juaj e ngrohtë dhe e dashur, që më erdhi në prag të Vitit të Ri, më gëzoi shumë.

U gëzova, gjithashtu, për vjershat e Lauretës që ndjenjat e saj të pastra ua kushton Partisë, fshatit socialist dhe aksioneve të pionierëve vullnetarë. Të dhënat fillestare i ka të mira dhe jam i bindur që ajo do të punojë me pasion, që kur të rritet, krahas punës që do të kryejë në çdo sektor të ndërtimit socialist ku të jetë nevoja, të bëhet edhe poete e talentuar që t'u këndojë Partisë dhe popullit tonë heroik.

Me këtë rast, të dashura Laureta dhe Alma,

ju uroj gëzuar Vitin e Ri, shëndet dhe shumë  
suksese në mësim.

Ju përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT  
TË TIPOGRAFËVE**

*Gjirokastër*

**16 shkurt 1977**

Të dashur shokë,

Ju falemnderit shumë për dhuratën e çmueshme që më bëtë, duke më dërguar dy kopje të raportit «Mbi veprimtarinë e KQ të PPSH», mbajtur në Kongresin e 7-të të Partisë<sup>1</sup>, që pasi u përkthye në gjuhën e bukur greke, ju e shtypët në tipografinë tuaj. Me këtë më gëzuat shumë se i bëtë një shërbim të madh Partisë, duke krijuar kështu mundësinë që motrat dhe vëllezërit e dashur të minoritetit ta këndojnë edhe në gjuhën amtare këtë dokument të rëndësishëm.

---

1. Raport i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha.

Ky botim në greqisht, pa dyshim, do të shërbejë për mobilizimin dhe edukimin e mëtejshëm patriotik e revolucionar të popullsisë minoritare, e cila rron e lumtur dhe e bashkuar si një trup i vetëm me motrat dhe me vëllezërit shqiptarë në atdheun e përbashkët, Shqipërinë socialiste, duke gëzuar efektivisht njëlloj të mirat dhe të drejtat që u ka siguruar gjithë nënshtetasve, pa asnjë dallim, pushteti ynë popullor.

Me këtë rast, të dashur shokë, jam i bindur që në të ardhmen, me vendosmërinë që ju karakterizon, ju do të punoni si kurdoherë pa u lodhur, që për motrat dhe vëllezërit e minoritetit të nxirrni edhe më shumë botime në gjuhën greke dhe, në rast se për këtë qëllim do t'ju nevojitet ndonjë ndihmë materiale, ju lutem më lajmëroni.

Ju uroj me gjithë zemër shëndet dhe suksese përherë më të mëdha në punën tuaj të nderuar.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË TUNELIT TATZAT—SASAJ**

*Sarandë*

**1 qershor 1977**

Të dashur shokë punëtorë, minatorë, teknikë dhe inxhinierë,

Më gëzoi pa masë lajmi që më dhatë për kurorëzimin me sukses të hapjes së tunelit të gjatë të Tatzat—Sasajt, për të cilin ju punuat pa u lodhur dhe derdhët për kaq kohë mundin dhe djersën tuaj.

Nuk ishte punë e lehtë të bindje lumin e Kalliasës të ndërronte drejtimin e tij shekullor dhe ta detyroje atë të kalonte mes për mes malit të Tatzatit, por mençuria e vendosmëria juaj, dashuria që ju ushqeni për Partinë dhe për popullin, patriotizmi juaj i lartë për forcimin e ekonomisë sonë socialiste dhe të fuqisë mbrojtëse të vendit, ju nxitën të kryenit këtë vepër të rë-

ndësishme që do të zbukurojë më tej pamjen e bregdetit tonë të Jonit, do t'ia shtojë atij akoma më shumë pjellorinë.

Tashti uji i këtij lumi do të lagë përgjithmonë brigjet e tarracuara të Lukovës, Piqerasit e Borshit që shtrihen përballë detit, ashtu siç do të lagë në një të ardhme të afërt edhe masivin tjetër të madh me agrume e pemë të tjera frutore, që do të hapet në brendësi të rrethit nga Përparimi në Nivicë e gjer në Qafën e Gjashtës, në Sarandë. Këtej e tutje portokallet, mandarinat, limonët dhe ullinj të me gjelbërim të përherëshëm, si dhe fiqtë, pjeshkët, dardhat, rrushtë aq të ëmbël, dhe gjithë pemët e tjera të atyre anëve, do të rriten akoma më mirë, duke dhënë prodhime të shumta jo vetëm për banorët patriotë e punëtorë të krahinës suaj me bukuri të rrallë por edhe për gjithë popullin. Dihet se në të kaluarën e hidhur bregdetasit tanë, e veçanërisht gratë dhe vajzat, rropateshin atyre maleve me bucela në krahë për të siguruar një komb ujë sa për vete, prandaj as që mund të mendohej për të ujitur gjithë ato brigje të përthyerë që sot lulëzojnë nga plantacionet që të mahnitin me bukurinë e tyre.

Si të gjitha arritjet e tjera, edhe ky tunel u ndërtua në sajë të politikës së drejtë të Partisë që mendon dhe punon ditë dhe natë për mirëqenien e mbarë popullit, prandaj, si kudo në Shqipëri, jeta në ato fshatra po lulëzon dita-ditës. Tashti që u arrit të çahet barku i malit, uji jetë-

dhënës do të përshkojë tarracat e do t'i gjallërojë akoma më shumë pemët nga më të vlefshmet që do ta shtojnë prodhimin dhe do të rritin këshitu më shumë begatinë e bregdetit tonë jugor dhe frutat e tyre të bollshme e plot vlera ushqimore do të shpërndahen në të gjitha anët e atdheut socialist.

Duke përfunduar letrën, ju uroj nga zemra juve dhe nëpërmjet jush motrave dhe vëllezërve të zonës së Bregut gjithë të mirat për këtë fitore të re që arritët. Dalshi kurdoherë faqebardhë në punët e reja e të mëdha që ju presin!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Fitorja», nr. 23 (306),  
10 qershor 1977*

**LETËR DREJTUAR**  
**SHOKUT PERTEF BADIVUKU**

**30 dhjetor 1977**

I dashur si vëlla Pertef,

Letra që më dërguat me rastin e pjesëmarrjes suaj në varrimin në Kukës të eshtrave të patriotit të shquar shqiptar dhe dajës suaj të nderuar, Hasan Prishtinës, më ka emocionuar shumë. Në mënyrë të veçantë më ka prekur dashuria e respekti që keni për vëllezërit tuaj të Shqipërisë socialiste, për historinë e lavdishme e luftërat heroike të popullit tonë.

Hasan Prishtina ka qenë një nga patriotët më të shquar që ka nxjerrë trualli shqiptar. Jeta dhe veprimtaria e tij janë shembull i dashurisë e i devotshmërisë së pafund ndaj atdheut, i guximit e i trimërisë së rrallë, i luftës deri në vdekje për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, për

çlirimin e tyre nga zgjedha e huaj, për bashkim kombëtar, për ruajtjen e gjuhës amtare e të traditave të tyre.

Hasan Prishtina bën pjesë në atë plejadë të ndritur patriotësh e luftëtarësh heroikë, që, së bashku me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Isa Boletinin e shumë të tjerë, ngritën flamurin kombëtar në Vlorë më 1912 dhe i treguan botës se popullin shqiptar askush nuk mund ta mbante nën zgjedhë, se ai kishte vendosur të rronte i lirë në trojet e tij të lashta që për shekuj me radhë i kishte vaditur me gjak e me djersë.

Si bir besnik e i denjë i Kosovës kreshnike, Hasan Prishtina luftoi me pushkë e me penë kundër copëtimit të Shqipërisë, kundër shovinizmit të monarkive fqinje, kundër pazarllëqeve të ulëta të fuqive të mëdha imperialiste në kurriz të popullit shqiptar. Diplomat e orator, publicist e politikan i zoti, ai luftoi me tërë zjarrin e shpirtit, që zëri i popullit shqiptar për të drejtat e tij të dëgjohej në të gjithë botën.

Të parët tanë, patriotët e luftëtarët e lirisë kanë ushqyer në zemrat e popullit shqiptar një dashuri të zjarrtë për lirinë e sovranitetin e atdheut. Partia jonë e Punës këto ndjenja të pastra i ka zhvilluar akoma më shumë. Ajo ka rrënjosur në popullin tonë një frymë të lartë patriotike, një respekt të veçantë për traditat më të mira të kombit, një vendosmëri e guxim për të luftuar për lulëzimin e përparimin e tij.

Duke ju falënderuar edhe një herë për le-

trën që më dërguat, ju uroj shëndet e jetë të gjatë, gëzim e lumturi familjes suaj.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR 10 TË RINJVE PUNËTORË TË QYTETIT TË DURRËSIT**

**23 janar 1978**

Të dashur shokë të rinj punëtorë të qytetit të Durrësit,

Më gëzoi shumë letra juaj, me të cilën më njoftoni për sukseset e lavdërueshme që keni arritur kohët e fundit në punën tuaj.

Ju, dhjetë të rinj punëtorë nga ndërmarrje të ndryshme të Durrësit, me iniciativën tuaj, u mblodhët dhe vendosët që jashtë orarit të punës të projektonit e të ndërtonit batiskafin e parë të markës shqiptare. Kjo qe një punë shumë e vështirë e delikate, që kërkonte dije dhe eksperiencë të madhe. Por frymëzimi që kanë ngjallur në mendjet e zemrat tuaja të reja mësimet e Partisë dhe vendimet historike të Kongresit të 7-të të saj, pjekuria juaj ideopolitike, kuptimi i thellë i luftës për të çarë e shpartalluar bllokadën e egër imperialisto-revizioniste, bënë që vështirësitë t'i kapërceni njëhënë pas tjetrës.

Me vendosmërinë dhe vrullin tuaj rinor, me një punë të gjithanshme e të pandërprerë, duke pasur kurdoherë pranë ndihmën dhe përkrahjen e organeve të Partisë e të pushtetit në rreth, si dhe të kolektivave ku punoni, ju e realizuat zotimin e marrë, ashtu siç e ka zakon rinia jonë. Batiskafi i prodhuar nga duart tuaja i përballoi me sukses të gjitha provat. Tani ju, siç më shkruani në letër, me besim e forca të shumëfishuara keni nisur punën për projekte e vepra të reja në favor të zhvillimit të ekonomisë e të mbrojtjes së atdheut.

Për të gjitha këto unë ju përgëzoj e ju falënderoj me gjithë zemër dhe ju këshilloj: ecni gjithnjë përpara, djem të vlefshëm të Partisë e të popullit, mësoni e punoni me të gjitha forcat për lulëzimin, begatinë dhe mbrojtjen e atdheut, për realizimin me nder të të gjitha detyrave, për arritjen e majave më të larta në revolucionin tekniko-shkencor. Partia dhe pushteti popullor kurdoherë do t'ju përkrahin, ndihmojnë e inkurajojnë me të gjitha forcat për t'i shërbyer sa më mirë çështjes së atdheut e të socializmit.

Suksese në punë e dalshi faqebardhë!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR VETERANËVE  
DHE PENSIONISTËVE TË MINIERËS  
SË BITUMIT NË SELENICË**

*Vlorë*

**13 maj 1978**

**Të dashur shokë,**

Më gëzoi shumë telegrami juaj. Nëpërmjet tij, me pak fjalë, ju treguat se ç'forca kenë akoma për t'i shërbyer shoqërisë, megjithëse jeni të moshuar. Kur ju gëzoni shëndet të mirë, ka dobi shoqëria jonë socialiste, së cilës jeni të gatshëm si kurdoherë t'i gjendeni në çdo çast në këmbë. Shumë nga të moshuarit në vendin tonë, megjithëse nuk janë më drejtpërdrejt në frontin e prodhimit, se ligjet e shtetit socialist u kanë siguruar atyre mjetet e jetesës, në frontin e luftës klasore dhe të edukimit të brezit të ri ata janë një thesar i vyer.

Karakteristikë dalluese e njeriut të shoqërisë sonë socialiste është se, edhe kur arrin në moshën e pensionit, ai nuk tërhiqet për t'u marrë vetëm me problemet familjare e personale, por me mendje, me zemër e me trup rron kurdoherë pranë popullit e me problemet e vendit, bile me vullnetin e tij të papërkulur dëshiron të jetë me kazmë e pushkë në dorë derisa të rrojë, ashtu siç jeni ju, ish-minatorë dhe veteranë të nderuar të Minierës së Bitumit të Selenicës. Dhe këtë e vërteton edhe fakti konkret, vendimi që keni marrë ju për të punuar për një kohë me vullnetarët që do të ndërtojnë hekurudhën e re Fier—Vlorë. Unë ju përgëzoj dhe ju falënderoj për këtë iniciativë revolucionare.

Kur jeton dhe punon midis brezit të ri, që merr përsipër punë të mëdha për atdheun, domosdo të ripërtërihen forcat. Por edhe të rinjtë, me të cilët do të punoni, kanë shumë nevojë për ju. Midis jush ka ish-minatorë që dikur kanë punuar në shoqërinë sipërmarrëse italiane të shfrytëzimit të bitumit, ish-partizanë, të cilët do t'u tregojnë të rinjve për të kaluarën dhe luftën tuaj, do t'u thonë se kur sheshet e rrugët e qyteteve më në zë të Evropës asfaltoheshin me ziftin e Minierës së Selenicës, minatorët tanë jo vetëm që nuk panë ndonjëherë në atdheun e vet asfaltin e nxjerrë nga nëntoka jonë, por nuk kishin as këpucë në këmbë e fëmijët e tyre të rrecosur nuk ngopnin barkun me bukë, do t'u shpjegojnë atyre me ç'egërsi e shfrytëzonte forcën e

krahut të minatorëve sipërmarrësi kapitalist etj. Ju, shokë veteranë e pensionistë, mund t'u flisni, gjithashtu, të rinjve, ashtu si dini vetë, për atë luftë legjendare që bëri populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, kundër okupatorëve fashistë italo-gjermanë e tradhtarëve të popullit, për heronjtë dhe dëshmorët e shumtë që keni njohur e që ishin në moshën e këtyre të rinjve që sot do të ndërtojnë hekurudhën. Kështu të rinjve do t'u shtohet akoma më shumë dashuria dhe respekti për sakrificat dhe heroizmat e brezit paraardhës, do t'u shtohen më shumë forcat për ndërtimin e forcimin e atdheut tonë të bukur, do të kuptojnë më mirë se socializmi kërkon punë, djersë e dituri, njerëz të përgatitur për punë të tjera më të mëdha që na presin në pesëvjeçarët e ardhshëm në kantieret tona të ndërtimeve, në minierat, fabrikat e uzinat, në arat, në shkollat e në fushat e stërvitjes për mbrojtjen.

Ju uroj shëndet të mirë dhe jetë të gjatë që të mbeteni kurdoherë luftëtarë aktivë të çështjes së madhe të Partisë dhe të popullit.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOQEVE  
PJESËMARRËSE NË AKTIVIN E MJELËSEVE  
TË DALLUARA TË RRETHIT TË KRUIJËS**

**6 qershor 1978**

Të dashura shoqe,

Në atmosferën revolucionare që ngjallën në të katër anët e vendit tonë përgatitjet për Kongresin e 8-të të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, që këto ditë përfundoi punimet me sukses, mora letrën tuaj, u njoha me punën që keni bërë dhe me zotimet që keni marrë ju për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë e sidomos të lopëve në rrethin tuaj.

Ju përgëzoj për këto zotime që morët, pasi analizuat mundësitë reale, duke u mbështetur në përvojën e përparuar e në shembujt më të mirë në radhët e të gjitha mjelëseve të rrethit të Krujës. Siç më shkruani, për këto probleme ju paska folur edhe shoqja juaj, Heroina e Punës Socialiste Gjyze Mara, e cila merr 5 600 litra qumësht në

vit për çdo lopë. Gjyza nuk ka diplomë, megjithatë ajo punon dhe arrin rezultate si një shkencëtare e vërtetë, pse ka kuptuar politikisht rëndësinë e detyrës që kryen, i është futur asaj me zell e pasion dhe ka arritur të njohë e të zbatojë mirë ligjet e shkencës zooteknike. Detyra e mjelëses kërkon jo vetëm punë të palodhur e të ndërgjegjshme, por edhe dituri të thella që të njohë nevojat e kafshëve, rregullat e mbarështimit dhe teknikën e të ushqyerit të tyre. Ja, pra, ku qëndron «sekreti» i Gjyzes dhe i mjelëseve të tjera të dalluara, të cilin mund ta mësojë e ta përdorë çdo mjelëse, mjafton që të ketë ndërgjegje të lartë socialiste, vullnet e pasion si ato.

Kongresi i 7-të i Partisë ka shtruar detyra të mëdha lidhur me modernizimin e intensifikimin e blegtorisë, duke theksuar sidomos nevojën e sigurimit të plotë të ushqimeve, sepse pa një bazë të fuqishme e të qëndrueshme ushqimore, nuk mund të ketë blegtori të zhvilluar e të përparuar. Ju më informoni se në rrethin e Krujës po bëhet një punë e mirë në këtë drejtim, se atje po futen në masë kulturat e reja foragjere, po zgjerohen linjat e përpunimit të ushqimeve të ashpra të koncentreve dhe po punohet seriozisht për mekanizimin. Ju lumtë! Kjo punë të vazhdohet, sepse, po t'i ushqesh e t'u shërbesh mirë kafshëve ato janë «mirënjohëse» dhe na i shpërblejnë përpjekjet që bëjmë.

Zotimet që morët në aktiv janë me rëndësi. Ato flasin edhe për rezervat e mëdha që ekzis-

tojnë e që duhen zbuluar e shfrytëzuar vazhdimisht për shtimin e prodhimeve blegtorale. Krahas këtyre, së bashku me specialistët e blegtorisë kujdes të veçantë duhet të tregoni ju edhe për përmirësimin e racës.

Partia ka besim se me mobilizim e punë këmbëngulëse ju do të arrini e do t'i tejkaloni objektivat e caktuar. Prandaj ju uroj nga zemra sukses e dalshi faqebardhë në plotësimin e tyre. Unë do t'i porosis shokët e Partisë në rreth që t'ju qëndrojnë afër e t'ju ndihmojnë për t'i vënë ato në jetë.

29 qershor 1978

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Kastrioti», nr. 36 (386),  
9 qershor 1978*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT HAZMI HASHORVA**

*Tiranë*

**29 qershor 1978**

I dashur shoku Hazmi,

Më gëzove shumë me fotografinë e vitit 1921 që më dërgove, e cila më solli ndër mend rininë tonë të hershme. M'u përtëritën në çast me forcë ngjarjet e fëminisë dhe të rinisë shkollëre që më dilnin përpara vazhdimisht me mall, sidomos në ato ditë aq të gëzueshme për mua, kur shkova në mars në qytetin tonë të dashur të lindjes, në Gjirokastër. Atje unë u takova, veç të tjerëve, edhe me shokë moshatarë të shkollës, biseduam së toku edhe për jetën tonë shkollëre të asaj periudhe, për shumë nga shokët, si dhe për mësuesit tanë aq të dashur e të nderuar që në ato periudha të vështira që kalonte vendi ynë na mësuan t'i duam dhe t'u shërbejmë me të gjitha

forcat atdheut dhe popullit, prandaj kurdoherë ushqej për ta një respekt të pakufishëm. Qoftë në ato ditë në Gjirokastër, por edhe herë të tjera, sa herë e sjell rasti, si gjithë shokët e asaj kohe, të sjell ndër mend edhe ty, pse kujtimet e rinisë janë të shtrenjta për mua.

Prandaj të falënderoj nga zemra për foto-grafinë që më dërgove, që flet për shoqërinë tonë të vjetër shkollore dhe që më solli një kënaqësi të madhe kur e pashë. Unë do ta ruaj atë në albumet e mia si një kujtim të vlefshëm.

Duke përfunduar, të uroj shëndet dhe lumturi në familje.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **FALËNDERIM PËR URIMET E DËRGUARA ME RASTIN E 70-VJETORIT TË DITËLINDJES**

**20 tetor 1978**

Me ndjenjat e një mirënjohjeje të thellë e me përzemërsinë më të madhe falënderoj gjithë kolektivat punonjës në qendra pune e prodhimi, kooperativa bujqësore, organizata shoqërore, institucione arsimore e kulturore, reparte ushtarake e të organeve të Punëve të Brendshme, si dhe persona të veçantë, miq dhe shokë të mi të luftës e të ndërtimit të socializmit, familje dëshmorësh e patriotë, të rinj e të reja, pionierë e fatosa, bashkatdhetarë jashtë atdheut, që me telegrame, letra e mesazhe më kanë uruar me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes sime.

Urimet e përzemërta, përsëritjet shumë të ngrohta e revolucionare të tyre, bashkë me gëzimin e papërshekruar që më sollën, më kanë prekur shumë. Ato i përkasin në radhë të parë Partisë së lavdishme të Punës dhe janë shprehje

e unitetit të pathyeshëm të popullit rreth Partisë, e dashurisë së pakufishme të të gjithë punonjësve tanë për të, e mbështetjes pa rezerva të vijës dhe të luftës së saj të drejtë e konsekuente marksiste-leniniste. Puna dhe lufta ime është pjesë e pandarë e punës dhe e luftës heroike të të gjithë Partisë, të të gjithë popullit tonë me zemër të zjarrtë, që në shekuj ka rezistuar kundër çdo stuhie si shkëmb graniti i rrahur nga valët e tmerrshme të historisë, por që asgjë s'e ka mposhtur. Kurdoherë e në çdo situatë unë kam ndier afër rrahjet e zemrës trime të popullit tonë të mrekullueshëm.

Lajmet e gëzuara që përmbajnë letrat e telegramet që kam marrë, të cilat më njoftojnë edhe për fitore e zotime të reja në të gjitha fushat, në zbatim të detyrave historike të Kongresit të 7-të të Partisë e të plotësimit të detyrave të planit të gjashtë pesëvjeçar, më japin forca të reja, vullnet e inkurajim të mëtejshëm për t'i shërbyer si kurdoherë me besnikëri të pakufishme, me ndërgjegje të lartë e me vetëmohim popullit dhe Partisë sonë të lavdishme, organizatores, frymëzueses dhe udhëheqëses të të gjitha fitoreve dhe të ecjes sonë të sigurt përpara në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Edhe unë nga ana ime u dërgoj të gjithëve, me këtë rast, përshëndetjet më të përzemërta dhe u uroj shëndet e suksese në jetë e në punë për përparimin e pandërprerë dhe mbrojtjen e atdheut tonë socialist, për fitore gjithnjë më të

mëdha në luftën tonë kundër vështirësive të rritjes e kundër rrethimit imperialisto-revizionist, për triumfin e marksizëm-leninizmit. Siguroj Partinë dhe popullin se derisa të rroj, do të jem një ushtar besnik, i thjeshtë dhe i guximshëm në shërbim të popullit e të atdheut tonë të dashur, të ndërtimit të socializmit dhe të fitores së revolucionit.

Letra, mesazhe, telegrame urimi e përshëndetje shumë të nxehta më kanë ardhur edhe nga parti motra marksiste-leniniste, nga revolucionarë, personalitete përparimtare, miq e dashamirë të Shqipërisë socialiste nga vende të ndryshme të botës. Ndjenjat e miqësisë së tyre të pastër e të sinqertë i drejtohen popullit tonë, bir i të cilit jam edhe unë.

Përfitoj nga ky rast që edhe unë t'u dërgoj të gjithëve urimet e mia më të mira, përshëndetjet revolucionare, si dhe sigurimin se, së bashku me popullin shqiptar dhe i udhëhequr nga parimet e pavdekshme e gjithmonë fitimtare të mësuesve të mëdhenj të proletariatit botëror, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, do të qëndroj i patundur në radhët e vëllezërve të mi të të njëjtit ideal, proletarëve heroikë, marksistë-leninistëve, popujve liridashës, shokëve e miqve të shumtë me ndjenja revolucionare e ide përparimtare në luftën e tyre të lavdishme për përparimin shoqëror, për forcimin e unitetit e të kompaktësisë

midis partive marksiste-leniniste, për triumfin e revolucionit, të demokracisë së vërtetë, çlirimit kombëtar e socializmit.

## *Enver Hoxha*

Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 253 (9426), 20 tetor 1978

27 tetor 1978

I dashur shoku Zhoao Amazonas,

Falënderoj nga zemra ju dhe Komitetin Qendror të Partisë suaj për përshëndetjet dhe urimet e ngrohta e vëllazërore që më dërguat me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes sime.

Përfilloj nga ky rast t'ju dërgoj juve dhe tëpërmjet juaj Komitetit Qendror, gjithë miqtarëve të Partisë Komuniste të Brazilit dhe proletarëve brazilian përshëndetjet revolucionare dhe urimet e mia më të mira për sukses gjithnjë e më të mëdha në luftën revolucionare kundër diktaturës fashiste e shlytyje e shlytyezimit shpëror në Brazil që mbështet e mbrohet në mënyrë të gjithanshme nga imperializmi i SHBA-së e nga imperializmi botëror në tërësi. si dhe në luftën kundër socialimperializmit, revizionizmit

**TELEGRAM DËRGUAR  
KOMITETIT QENDROR TË PARTISË  
KOMUNISTE TË BRAZILIT**

**27 tetor 1978**

I dashur shoku Zhoao Amazonas,

Falënderoj nga zemra ju dhe Komitetin Qendror të Partisë suaj për përshëndetjet dhe urimet e ngrohta e vëllazërore që më dërguat me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes sime.

Përfitoj nga ky rast t'ju dërgoj juve dhe nëpërmjet jush Komitetit Qendror, gjithë militantëve të Partisë Komuniste të Brazilit dhe proletariatit brazilian përshëndetjet revolucionare dhe urimet e mia më të mira për suksese gjithnjë e më të mëdha në luftën revolucionare kundër diktaturës fashiste e shtypjes e shfrytëzimit shoqëror në Brazil që mbështetet e mbrohet në mënyrë të gjithanshme nga imperializmi i SHBA-së e nga imperializmi botëror në tërësi, si dhe në luftën kundër socialimperializmit, revizionizmit

modern të të gjitha ngjyrave, për fitoren e socializmit dhe të komunizmit.

Le të forcohen gjithnjë më shumë marrëdhëniet e ngushta dhe bashkëpunimi vëllazëror midis dy partive tona, mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar.

Përshëndetje revolucionare.

LETËR DRELTUAR QYTETARIT ANGLEZ  
ENVER HOXHA

27 tetor 1978  
Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

I bashkuar shokut Ais Pulson,  
Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

# LETËR DREJTUAR QYTETARIT ANGLEZ AJS PULSON<sup>1</sup>

27 tetor 1978

I dashur shoku Ajs Pulson,

Ju falënderoj nga zemra për letrën që më dërguat dhe për vlerësimin që i bëni ju qëndrimit marksist-leninist të Partisë sonë në luftën dhëmb për dhëmb me armiqtë e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzimit.

Dëshirën tuaj të madhe për të ardhur në Shqipëri e për të dhënë kontributin tuaj në ndërtimin e socializmit në vendin tonë e konsideroj si një shprehje të ndjenjave të internacionalizmit proletar në mbështetje të popullit tonë që lufton ndershëmrisht dhe pa u përkulur nga asnjë armik për konsolidimin e fitoreve të arritura në vendin e vet dhe për triumfin e revolucionit proletar

---

1. Mik i Shqipërisë dhe i PPSH, në Quarnford Buxton Derbyshire, Angli.

në të gjithë botën. Gatishmëria juaj si dhe solidariteti i gjithë vëllezërve të klasës dhe i miqve të shumtë të Shqipërisë socialiste kudo në botë e inkurajojnë dhe e frymëzojnë popullin tonë në luftën e vet titanike për ndërtimin e socializmit, duke u mbështetur në forcat e veta.

Për ta njohur nga afër vendin tonë, për të parë me sytë tuaj ato suksese modeste që janë arritur në një vend të vogël si Shqipëria, ku në fuqi është klasa punëtore, ju ftoj së bashku me bashkëshorten që të na vini 15 ditë jo për të punuar, por për vizitë.

Me këtë letër po ju dërgoj dhe katër fotografite e klasikëve të marksizëm-leninizmit, si dhe një album me fotografi.

Me respekt

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOOPERATIVISTËVE  
TË KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË TIPIT  
TË LARTË TË PERONDISË**

*Berät*

**17 nëntor 1978**

Të dashur vëllezër dhe motra kooperativistë të kooperativës bujqësore të tipit të lartë «Enver Hoxha»,

Rezultatet e mira të këtij viti në rendimentet e grurit e të kulturave të tjera bujqësore, si dhe një numër i rëndësishëm përparimesh ekonomiko-shoqërore në jetën tuaj dhe zotimet që keni marrë për vitin 1979, siç më bëtë të ditur me letrën tuaj të 6 nëntorit, më gëzuan shumë.

Pas tri dekadash pune të përbashkët ju, me komunistët në ballë, e keni bërë kooperativën tuaj një ekonomi bujqësore të fuqishme të pro-

dhimit të zgjeruar socialist. Arritjet tuaja në të gjitha fushat dëshmojnë më së miri për drejtësinë e vijës së Partisë në kolektivizimin e bujqësisë, për epërsinë e padiskutueshme të rendit kooperativist dhe për zhvillimin e mëtejshëm të tij me organizimin e kooperativave të tipit të lartë. Ato, siç na mësojnë Lenini dhe Stalini, tregojnë se rendi kooperativist është për fshatarësinë e vetmja rrugë për jetën e lumtur dhe të gëzuar të ndërtuar me punë, me djersë, me ndershmeri e me dashuri të singërtë për njëri-tjetrin.

Tani në fshatin tonë socialist çdo gjë ka ndryshuar rrënjësisht. Asnjë krahasim nuk mund të bëhet me atë gjendje të mjerë e të prapambetur jo vetëm të fshatarësisë, por të mbarë popullit tonë para Çlirimit. Ashtu siç shkruani në letrën tuaj, sot fshatari nuk falet më si atëherë shtatë herë në ditë për një kokërr misër. Jo. Përkundrazi, çdo familje gëzon të mirat që i solli socializmi, punën, bukën, arsimin e kulturën, lumturinë. Edhe jashtë familjes bëhet sot një tjetër jetë me të vërtetë e bukur, e gëzuar dhe e sigurt. Si çdo kooperativë bujqësore në vendin tonë, ashtu edhe juaja ka sot shkolla, çerdhe e kopshte fëmijësh, qendrën e vet shëndetësore e shtëpinë e lindjes, rrjetin e shërbimeve tregtare, radio e televizorë e gjithçka tjetër që nevojitet për një jetë të mirë e të denjë për njeriun. S'ka dyshim se akoma më e bukur dhe më e mirë do të jetë e ardhmja.

Shokë dhe shoqe kooperativistë,

Çdo ditë e më shumë bujqësia merr një rëndësi të madhe për vendin tonë. Në situatat aktuale të rrethimit të egër imperialisto-revizionist dhe të krizës së përgjithshme që ka mbërthyer botën kapitalisto-revizioniste, interesat e atdheut kërkojnë që të sigurohen vazhdimisht e gjithnjë më mirë nevojat e popullit, të ekonomisë dhe ato të mbrojtjes jo vetëm me drithëra buke, por edhe me prodhime të tjera bujqësore e blegtorale. Dhe për këtë ne i kemi të gjitha mundësitë dhe kushtet e nevojshme. Udhëheqja marksiste-leniniste e Partisë sonë, ndihma e shtetit, zhvillimi i gjithanshëm i kooperativave, rritja e vazhdueshme e rendimenteve të prodhimeve bujqësore e blegtorale, zbatimi me këmbëngulje i shkencës moderne agroteknike dhe i disiplinës proletare në punë, përvoja e përparuar shumë e vlefshme e sektorëve, brigadave, bujqve e blegtorëve të veçantë të pararojës, që sot janë me shumicë, si të ju ashtu edhe në mbarë vendin tonë, patriotizmi i flaktë e revolucionar i fshatarësisë sonë kooperativiste përbëjnë garancitë që sigurojnë realizimin e çdo detyre.

Tokën si ta trajtosh ashtu të jep. Jo vetëm në ato parcela ku sot merren rendimente të mira, por edhe në tokat e quajtura «të varfra» mund dhe duhet të merren akoma më shumë prodhime. Kemi akoma sipërfaqe toke në male, bile edhe në kodra, të përshtatshme për t'u vënë nën kulturë.

Ato presin nga ne të hapen dhe të mbillen me drithëra, me bimë industriale e me perime, me dru frutorë, si ullinj e pemë të tjera dhe vreshta; kemi livadhe që nuk i kultivojmë sa duhet për të marrë prej tyre shumë më tepër foragjere sesa sot për t'i ushqyer si duhet bagëtitë tona, kemi pyje e shkurre ku, me një kujdes më të madh, mund të rriten e të kultivohen më mirë shumë bimë të florës spontane e deri kafshë të egra, për të shtuar prodhimin e grumbullimin e tyre etj. Këto janë vetëm disa mundësi që, me punë këmbëngulëse e të organizuar, kooperativat bujqësore duhet dhe për këtë unë kam besim se ato do t'i kthejnë në realitet.

Të dashur shokë e shoqe kooperativistë, kua-dro e specialistë të kooperativës së tipit të lartë të Perondisë,

Ju falënderoj nga zemra për letrën që më bëtë dhe ju dërgoj, me këtë rast, urimet e mia më të ngrohta për 30-vjetorin e krijimit të kooperativës, që ju festuat disa ditë më parë. Arrifshi suksese akoma më të mëdha në realizimin e detyrave që ju janë ngarkuar për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për të mirën dhe begatinë e kooperativës, për të mirën tuaj, të të gjithë popullit dhe të mbarë ekonomisë së vendit për çelikosjen e mëtejshme të aleancës me

klasën tonë heroike punëtores, për forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë të dashur socialist!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 278 (9451), 18 nëntor 1978*

Të dashur shokë e shpesh kooperativistë, kua dro e specialiste të kooperativës së tipit të lartë të Peronisë,

Ju falënderoj nga zemra për letërnën që më bëtë dhe ju dërgoj me këtë rast urimet e mi me të ngrohta për 30-vjetorin e krijimit të kooperativës, që ju festuat disa ditë më parë. Arritsh sukseset sikoma me të mëdha në realizimin e detyrave që ju janë ngarkuar për shtimin e prodhimit dhe bujqësorisë dhe përgatitjen për të mirën dhe përgatitjen e kooperativës për të mirën tuaj, të gjithë popullit dhe të mbarë ekonomisë së vendit për çelikesjen e mëtejshme të aliancës mi

## LETËR DREJTUAR SHOQES SUZANË MARTI

21 nëntor 1978

E dashura dhe e nderuara shoqja Suzanë Marti,

Mora letrën tuaj të ngrohtë, me anën e së cilës më dërgonit urime miqësore e të sinçerta për 70-vjetorin e lindjes dhe për to ju falënderoj nga zemra. Me kënaqësi përfitoj nga rasti për t'ju dërguar edhe unë, në emrin tim dhe të shoqes Nexhmije, juve, shoqja Suzanë, urimet më të mira për shëndet të plotë, për të qenë ashtu si deri më sot aktive e revolucionare në të mirën e proletariatit e të popullit francez e për të vazhduar me sukses punën e frytshme që zhvillonin në rrethin e miqve të Shqipërisë socialiste në Francë për forcimin e miqësisë midis popujve të të dy vendeve tona.

Letra juaj më ringjalli kujtimet e pashlyera nga mendja dhe nga zemra, për takimet e mia me bashkëshortin tuaj të nderuar, shokun e mi-kun tonë dhe timin personalisht, të paharruarin Fransua Marti. Emri i tij te ne ruhet me dashuri e respekt të madh, sepse ishte një komunist in-


ternacionalist i shquar, komandant sypatrembur dhe i talentuar i partizanëve heroikë francezë. Unë, ashtu sikurse edhe ju, jam i bindur se, pavarësisht nga deviacioni i Zh. Zhyrkesë, vepra e Fransuasë, idealet e larta marksiste-leniniste që çuan në themelimin e Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Francës, flamuri i marksizëm-leninizmit, për të cilat ai luftonte e i mbronte me aq zjarr, përsëri do të triumfojnë në atdheun tuaj. Proletariati dhe marksistë-leninistët e vërtetë francezë, nuk do ta lënë kauzën e tyre të madhe në gjendjen e vështirë ku e kanë çuar revizionistët e ngjyrave e të rrymave të ndryshme.

Ne ruajmë kujtimet më të mira personalisht edhe për ju, shoqja jonë komuniste, luftëtare e vendosur e kurajoze në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, të ideve të shokut tuaj të jetës e të luftës, Fransuait, si dhe të miqësisë me Partinë e Punës të Shqipërisë e me popullin shqiptar. Ne do të dëshironim që ju ta konsideroni Shqipërinë socialiste si atdheun tuaj të dytë e të na vini që ta shikoni atë sa herë e kurdoherë që të doni dhe të rroni këtu si në vendin tuaj të dashur.

Përshëndetjet e mia miqësore e revolucionare

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



Faksimile e radiogramit të shokut Enver Hoxha dërguar shokut Hysni Kapo në Paris

## RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË PARIS

4 dhjetor 1978

I dashur shoku Hysni,

Të përqafoj me shumë mall. Nuk mund të ta përshkruaj sa i gëzuar dhe i lumtur jam që u bëre mirë. Shokët aty na vënë në korent dy herë në ditë për gjendjen tënde shëndetësore, që është vazhdimisht në përmirësim. Tash që do të marrësh radiogramin tim, do të jesh në këmbë duke shëtitur. Çdo gjë do të kalojë me sukses. Gëzimi ynë do të jetë shumë i madh kur të kthehesh në gjirin e ngrohtë të Partisë, plot shëndet, dhe të fillosh punën me ngarkesë të plotë, pse kështu do të ngjasë, na thonë mjekët që të kurojnë në Paris.

Të gjithë shokët janë mirë dhe të gëzuar për përmirësimin e shëndetit tënd. Nafta e Cakranit ecën për bukuri, 110-120 tonë në ditë vetëm

naftë, kurse me gazin e konvertuar në naftë i kalon të 200 tonët. Çdo gjë ecën mirë.

Nexhmija të bën shumë të fala dhe të përqafo ty, Viton dhe fëmijët. Të vegjlit e tu këtu i ke shumë mirë. Fëmijët e mi të gjithë të bëjnë shumë të fala e të puthin. Viton veçanërisht e përqafo nga unë. Shokëve aty dhe mjekëve u jep të fala dhe i falëndero nga unë.

Duke të puthur e të përqaftuar,

Yti

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT HYSNI KAPO NË PARIS**

**16 dhjetor 1978**

I dashur shoku Hysni,

Të përqafoj e të puth me mall. Jemi shumë të gëzuar kur dimë që je mirë me shëndet.

Çdo ditë ne shohim se ti ke përmirësime të dukshme, shohim gjithashtu kthimin tënd, me siguri të afërt, plot shëndet e gjallëri.

Ne e dimë se ty të ha merak për punën, kurse ne, Partinë, na ha merak për shëndetin tënd. Prandaj që Partia dhe ne të jemi të qetë, dhe ti këtë do, mos u bëj merak për punën, pse ajo shkon për bukuri. Mungesën tënde e ndiejmë shumë, s'ka asnjë dyshim, por vetëm kur të të thonë doktorët: «Shoku Hysni, u çel drita jeshile» edhe ne do të të themi: «Shkelja gazit».

Tash, për të mirën e Partisë, mos mendo veçse të ndjekësh këshillat e mjekëve, se sa për punën, shokët që kemi janë aq të mirë, të zotë dhe të shumtë saqë neve, po të mos jemi mirë me shëndet, na lejohet të mos punojmë edhe një muaj apo dy muaj. Prandaj mos u bëj merak, se kur të kthehesh plot shëndet do t'i futesh punës përsëri.

Këtej punët ecin mirë. Prodhimet bujqësore

po grumbullohen, gruri gati ka mbaruar së mbjelli, nafta ecën mirë. Planin e vitit 1978 dhe atë të vitit të ardhshëm i shqyrtuam në mbledhjen e Byrosë. Më 25 të këtij muaji do të mbledhet Kuvendi Popullor, ku do të paraqitet përbërja e Qeverisë së re dhe e Kryesisë së Kuvendit dhe e Presidiumit.

Viton e përqafoj me mall; më vjen shumë mirë që ajo është e gëzuar, dhe ka pse të jetë.

Sa mirë që ke dalë shëtitje jo vetëm në korridor, por edhe në oborr; shpejt do të vijë dita që t'ia hipësh avionit për Tiranë.

Të uroj nga zemra çdo ditë e përparime në përmirësimin tënd, çdo ditë e shëndet të mirë. Fëmijët i puth të gjithë.

Shokët janë mirë, të gëzuar dhe të bëjnë shumë të fala, unë të përqafoj e të puth.

Yti

Enver

P.S. Më fal për shkrimin e keq, do të mërzitesh ca kur ta deshifrosh, por le të të punojë ca imagjinata edhe në deshifrim.

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR LLAMBRINI SILËS DHE JORGJI DHAMOS

*Fier*

**22 mars 1979**

Të dashur Llambrini dhe Jorgji,

Me kënaqësi mësova për ngjarjen shumë të lumtur në familjen tuaj, lindjen e njëkohshme të tre djemve dhe që vetë ti, shoqja Llambrini, je mirë, gjithashtu, që edhe djemtë janë që të tre plot shëndet. Në këtë gëzim tuaj familjar marr pjesë edhe unë dhe me këtë rast ju dërgoj urimet më të mira, shëndet e suksese në punë ju, prindërve, dhe djemve jetë të gjatë. Le të rriten ata plot energji për t'u bërë, nën kujdesin tuaj dhe ashtu siç dëshiron Partia, njerëz të ndershëm e patriotë, punëtorë të palodhur për ndërtimin e socializmit dhe ushtarë të denjë për mbrojtjen e atdheut tonë të dashur socialist dhe të revolucionit.

Duke shprehur gëzimin për këtë ngjarje të lumtur në familjen tuaj, si dhe dëshirën për t'ia vënë unë emrin njërit prej djemve të porsalindur, nëse do të jeni të të njëjtit mendim me mua, le të marrë ai emrin e bukur shqip GËZIM.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## RADIOGRAM DËRGUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË PARIS

11 shtator 1979

I shtrenjti shoku Hysni,

Të përqafoj fort e të puth me mall. Jemi gëzuar shumë që të ra temperatura, që ha gjithë ushqimin dhe që fillove përsëri të ulesh në kolltuk. Me siguri do të fillosh edhe të shëtitesh e të marrësh të gjitha forcat, për t'u kthyer në gjirin tonë, kur doktorët dhe ti vetë ta ndieni këtë gjë të mundur.

Ne kemi shpresa të mëdha, i dashuri Hysni, se shërimi yt do të jetë i shpejtë<sup>1</sup>. Vetëm ti mos

---

1. Shoku Enver Hoxha ndiqte çdo ditë e çdo orë gjendjen shëndetësore të shokut Hysni Kapo dhe ishte në dijeni të sëmundjes së tij të pashërueshme, por i drejtohet me fjalë inkurajuese e me optimizëm për t'i lehtësuar vuajtjet e për t'i dhënë forca. (Shih në këtë vëllim, f. 346.)

u mërzit, megjithëqë ne e njohim vendosmërinë tënde shembullore që çdo pengesë në jetë dhe në luftë e ke kapërcyer si bolshevik leninist stalinian. Ne e dimë se spitali është i mërzitshëm, por po të vjen aty edhe shoku Ramiz, që do të çmallet me ty edhe për të gjithë ne që na ke pasur e na ke kurdoherë afër teje edhe në këto situata të vështira, të cilat me durim, me siguri do të kalojnë.

Shoku Ramiz do të të vërë në korent më mirë gojarisht për punët e Partisë dhe të shtetit, për mbarëvajtjen dhe sukseset e të cilave, në çdo moment, ditë e natë, ti ke vënë dhe do të vësh edhe në të ardhmen të gjitha forcat e zemrës dhe të shpirtit tënd, vendosmërinë e çeliktë dhe zotësinë e madhe e pjekurinë tënde shembullore për të gjithë Partinë, që të detyrohet shumë.

Unë e di huqin tënd për punë, por Ramizi nuk do të t'i bëjë informacionet përnjëherë, pse nuk duhet të lodhesh. Ty të intereson çdo gjë nga jeta e Partisë dhe e popullit, por në këto momente na intereson shumë shërimi yt.

Prandaj, për të qenë konsekuent me këto që po të shkruaj, nuk të flas gjë për punë, çdo gjë do të ta thotë Ramizi.

Vetëm po të them se Anja dhe Kreshniku (që të ngjet shumë ty) janë mirë me gjithë Sonilën.

Viton dhe ty të përqafojmë e të përqafojmë  
me shumë mall si Nexhmija dhe unë.

Me shumë dashuri  
Përherë yti

*Enver*  
SHOQËS VITO KAPO NE PARIS

21 shtator 1979

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

E shtrenjta shode dhe motra ime Vito,

S'të kam shkruar ty vecanerisht, por radio-  
gramet për Hysniun kanë qenë edhe për ty.  
Ne i ndiejmë vujtjet e tua të mëdha spiri-  
tore për sëmundjen dhe gjendjen e rëndë të  
Hysniut tonë të shtrenjtë.  
Edhe ne këtu vujmë dhe na dhemb zemra  
sa edhe ty, por ti me gjithë lëminë i jeni pranë,  
kurse ne jemi larg, duke qenë ditë e natë me  
zemër e me shpirt aër tij.  
Por të gjithë jemi ushtarë të çelikut të Par-  
tisë, prandaj ashtu si na ka mësuar Partia dhe  
sic është kurdobërisë dhe Hysniut, ti lëminjtë  
e tu dhe ne, shokët e tij, duhet të jemi të fortë  
e të pamposhtur përpara çfarëdo vështirësie. Të  
marim shembull Hysniun tonë të dashur, që për-  
par vujtjeve përdron si shkëmb graniti.

**RADIOGRAM DËRGUAR  
SHOQES VITO KAPO NË PARIS**

**21 shtator 1979**

E shtrenjta shoqe dhe motra ime Vito,

S'të kam shkruar ty veçanërisht, por radiogramet për Hysniun kanë qenë edhe për ty.

Ne i ndiejmë vuajtjet e tua të mëdha shpirtërore për sëmundjen dhe gjendjen e rëndë të Hysniut tonë të shtrenjtë.

Edhe ne këtu vuajmë dhe na dhemb zemra sa edhe ty, por ti me gjithë fëmijë i jeni pranë, kurse ne jemi larg, duke qenë ditë e natë me zemër e me shpirt afër tij.

Por të gjithë jemi ushtarë të çeliktë të Partisë, prandaj ashtu si na ka mësuar Partia dhe siç është kurdoherë dëshira e Hysniut, ti, fëmijët e tu dhe ne, shokët e tij, duhet të jemi të fortë e të pamposhtur përpara çfarëdo vështirësie. Të marrim shembull Hysniun tonë të dashur, që përpara vuajtjeve qëndron si shkëmb graniti.

Të gjitha përpjekjet, siç e sheh vetë, po i bëjmë dhe do t'i bëjmë deri në fund, që Hysniu të na vijë në këmbë në atdhe, në gjirin e Partisë.

Ne jemi në korent, tri-katër herë në ditë, për gjithë evolucionin e sëmundjes së tij, mendjen e kemi tek ai, në radhë të parë, po edhe tek ti.

Qëndro e fortë si komuniste, Hysniu asnjëherë mos të të shohë të brengosur, pse në asnjë mënyrë nuk duhet t'ia shtojmë mërzinë. T'i vëmë atij përpara shpresën, durimin, optimizmin, pse kështu do të kontribuojmë që Hysniu ynë i dashur të mund të ngrihet në këmbë dhe të ktheheni në atdhe.

Hysniun puthe fort, fort nga ana ime, i thuaj se ne e gjithë Partinë na ka afër tij. I urojmë kthesë pozitive e të shpejtë të shëndetit.

Ty, e dashura Vito, të përqafojmë tok me Nexhmijen dhe të lutem të jesh e fortë, Verën e Besnikun, po ashtu, i përqafoj.

Yti

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT NILS ANDERSON**

**Suedi**

**21 dhjetor 1979**

**I dashur shoku Nils Anderson,**

Ju falënderoj nga zemra për letrën që më dërguat me rastin e 35-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë socialiste, për ndjenjat tuaja të miqësisë së pastër e të çiltër për popullin shqiptar, për Partinë e Punës e Komitetin e saj Qendror, si dhe për urimet vëllazërore e komuniste të familjes suaj të nderuar.

Ju falënderoj, gjithashtu, për konsideratat tuaja ndaj personit tim, të cilat, në radhë të parë, u takojnë Partisë dhe popullit shqiptar. Në luftën për çështjen e popullit, ashtu si çdo komunist i ndershëm, si çdo proletar, si çdo njeri përparimtar, që u do të mirën popullit të vet dhe popujve të tjerë të shtypur e të grabitur egërsisht

nga kapitalizmi barbar, unë, siç më ka mësuar e më mëson Partia, kurdoherë jam frymëzuar e frymëzohem nga idetë e mëdha e të pavdekshme të marksizëm-leninizmit, si dhe nga lufta vigane e proletariatit botëror dhe e njerëzve të pararojës e revolucionarë, kudo në botë.

I dashur shoku Nils,

Si miq të ngushtë të vendit tonë, ju dhe bashkëshortja juaj René keni bërë shumë për popullarizimin e Shqipërisë socialiste e të fitoreve të arritura prej saj te populli mik suedez e popujt e tjerë skandinavë. Këta dy vjetët e fundit ju personalisht bëtë një punë shumë të vëmendshme, të kujdesshme e të palodhur edhe për kontrollin dhe saktësimin e përkthimit frëngjisht të librave «Imperializmi dhe revolucioni» dhe «Shënime për Kinën». Unë përfitoj nga rasti për t'ju falënderuar e për t'ju thënë se e çmoj lart këtë punë të kualifikuar.

Populli shqiptar, të cilin ju e njihni dhe e doni, e respekton miqësinë e sinqertë dhe miqtë e besës i konsideron vëllezër. Bile, sipas një zakoni të lashtë, i cili në ditët tona ka marrë forcë e vitalitet akoma më të madh, shqiptari në tryezën e vet ruan gjithmonë vendin e vëllezërve që ndodhen larg. Ju keni qenë dhe mbeteni një mik i tillë për të.

Duke përfunduar këtë letër me ndjenjat e

miqësisë sime të thellë, juve dhe familjes suaj ju dërgoj përhëndetjet më të mira, si dhe urimet e mia e të Nexhmijes për Vitin e Ri 1980. Le të jetë ky një vit i gëzuar e i lumtur për familjen tuaj, një vit i forcimit të mëtejshëm të miqësisë suaj militante me popullin shqiptar, një vit fitoresh të reja për kauzën e proletariatit, për lirinë dhe pavarësinë e vërtetë të popujve.

Ju uroj shëndet të mirë, lumturi në familje e suksese në punë,

**Përhëndetje revolucionare**

**Juaji**

**Enver Hoxha**

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT TALAT SHEHU**

*SHBA*

**25 dhjetor 1979**

Shumë i dashuri Talat,

Nga letra që më dërgove mora lajme të mira për ty dhe për fëmijët e tu dhe u gëzova shumë. U gëzova sidomos për atë që më shkruan që ke punuar e vazhdon të punosh edhe me fëmijët për të rrënjosur në ndërgjegjen e tyre ndjenjat e dashurisë së pastër për Shqipërinë tonë të dashur.

Në familje jemi të gjithë shumë mirë. Ajri i pastër, uji i dëborës e i burimeve tona të freskëta, toka dhe buka e ëmbël e mëmëdheut, nuk të lënë kurrë të plakesh. Po edhe ti nuk je plakur, — shqiptari jeton gjatë.

Të kujtoj vazhdimisht e të përqafoj me mall

së largu. Shumë të fala ke edhe nga bashkëshor-  
tja ime, Nexhmija, si dhe nga fëmijët e mi,  
nipërit e mbesat.

Yti

*Enver Hoxha*

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

## LETËR DREJTUAR SHOKUT GEGË MARUBI

*Shkodër*

25 janar 1980

I dashur Gegë,

Nga letra jote mësova me gëzim për dhuratat që i fale muzeut të qytetit, veglat e punës të babait, si dhe një flamur shqiptar të qëndisur nga motra jote që në vitin 1912. Të përgëzoj me gjithë zemër për këtë gjest të ri patriotik e të lavdërueshëm.

Objektet me kaq vlerë, edhe pse janë personale, kur mblidhen e ruhen me kujdes, përbëjnë një thesar të paçmuar në shkallë kombëtare. Po sa gjëra të tilla, dokumente, relike të vjetra arti, armë, veshje trimash e patriotësh etj., etj., që nga kohët e kaluara e deri më sot «flenë» ende nëpër sirtaret apo sënduqet që na kanë lënë nënat dhe baballarët, që, ç'është e vërteta, i kanë ruajtur me dashuri e kujdes të madh, pse në të kaluarën nuk kishte asnjë interesim për to. Por

sot, ashtu të vetmuara, të mbyllura e jashtë çdo trajtimi shkencor, ato mbeten shoqërisht të padobishme, bile me kalimin e kohës rrezikohen të humbasin vlerën e vërtetë, në mos të zhduken fare. Prandaj, sa mirë do të ishte sikur ata që ruajnë të tilla objekte të vepronin si ti dhe familja jote, siç kanë vepruar e veprojnë shumë komunistë e patriotë të tjerë, duke ua dorëzuar muzeve tona për ruajtje, restaurim dhe për pa-surimin e shkencave tona historike, etnografike etj. me dokumente të reja akoma të panjohura, që flasin për luftërat heroike për liri e pavarësi të popullit tonë, për kulturën e tij të lashtë etj., etj. Ky do të ishte një kontribut i madh në thesarin e kulturës së vendit tonë.

Gëzohem shumë, i dashur Gegë, që vazhdon t'i kushtosh një pjesë të mirë të veprimtarisë tënde profesionit shumë të bukur dhe të dobishëm të fotografit. Të uroj shëndet dhe jetë gjithnjë aktive në të mirën e popullit të rrethit të Shkodrës e të gjithë Shqipërisë. U bëj shumë të fala nga unë gjithë pjesëtarëve të familjes.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT SHYQYRI KANAPARI

*Kavajë*

**22 maj 1980**

I dashur shoku dhe miku im i vjetër, Shyqyri,

Mësova se në punë e sipër, duke drejtuar traktorin tënd aq të dashur që e ke pasur dhe vazhdon ta quash si shokun tënd të jetës, u godite nga një infarkt i miokardit. Megjithatë sëmundja nuk e mposhti dot vullnetin tënd të çeliktë dhe organizmin e kalitur gjatë një pune të palodhur e shembullore dhjetëravjeçare në shërbim të popullit dhe të atdheut. Letra që më dërgove më siguroi se tani çdo rrezik ka kaluar dhe je duke rimarrë forcat. Sidoqoftë, ti duhet të zbatosh akoma me kujdes e rigorozitet porositë

e mjekëve që të arrish të shërohesh shpejt dhe plotësisht.

Për sa i përket punës, ashtu siç të ka mësuar Partia, ti ke përgatitur tashmë një numër traktoristësh të vendosur e me ndërgjegje të lartë socialiste që ecin në gjurmët e tua, gjithnjë në pararojë e faqebardhë përpara popullit. Prandaj për asgjë mos u shqetëso. Do të vijë shpejt koha që, pa dëmtuar shëndetin, të vesh të bisedosh me shokët dhe miqtë e tu, të vjetër e të rinj dhe t'i frymëzosh e t'i nxitësh ata me fjalën dhe eksperiencën tënde të vlefshme që të punojnë siç ke punuar ti, duke realizuar e tejkaluar detyrat si komunist e punonjës revolucionar. Punëtorë të pararojës e aq të vendosur si ti janë një thesar i paçmuar për Partinë.

Letra jote, i dashur Shyqyri, më gëzoi shumë. Në të më shkruan se ke dëshirë të takohemi para se të dalësh në pension. Edhe unë kam të njëjtën dëshirë, pse, ashtu si çdo herë që jemi takuar, dua të shtrëngoj fort duart e tua me kallo dhe të kuvendojmë shtruar së toku. Me kënaqësi të madhe do të të pres, por pasi të forcohesh edhe ca e kur të të këshillojnë mjekët të lëvizësh. Do të të lajmëroj vetë për të ardhur dhe do të të çoj automobilin tim të të marrë.

Bashkë me Nexhmijen ty, bashkëshortes, djalit e nuses së tij, ju dërgojmë të falat tona më të përzemërta. Të uroj shërim të shpejtë, gëzim e lumturi në familje dhe shëndet që të vazhdosh

të japësh akoma për shoqërinë tonë socialiste me  
fjalët e këshillat e tua të çmuara.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

Tirana

28 qershi 1980

Më preku shumë vdekja e papritur dhe e  
parashikuar e shokut Kolë Papatisto, bashkë-  
shokit dhe prijnit tuaj të dashur.  
E kam njohur Kolën që gjatë Luftës Nacio-  
nalçlirimtare, sidomos kur ai punoi për ca kohë  
që në Shtetit të Përgjithshëm. Vazhdimisht, ku-  
do që e ka caktuar Partia, si patriot, revolucio-  
nar, si një komunist e kuadër me ndërgjegje të  
lartë, gjithë aftësitë dhe djet e tij ua kushtoi çli-  
rimit të atdheut, si dhe zhvillimit e përparimit të  
arsimit dhe të shkencës sonë të re, duke dhënë  
kështu kontributin e tij të vlefshëm në ndërti-  
min socialist të vendit.  
Ju ngushëloj nga zemra ju dhe të afërmit

**TELEGRAM DËRGUAR FAMILJES  
SË SHOKUT KOLË PAPARISTO**

*Tiranë*

**28 gusht 1980**

Më preku shumë vdekja e papritur dhe e parakohshme e shokut Kolë Paparisto, bashkëshortit dhe prindit tuaj të dashur.

E kam njohur Kolën që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, sidomos kur ai punoi për ca kohë pranë Shtabit të Përgjithshëm. Vazhdimisht, kudo që e ka caktuar Partia, si patriot, revolucionar, si një komunist e kuadër me ndërgjegje të lartë, gjithë aftësitë dhe dijet e tij ua kushtoi çlirimit të atdheut, si dhe zhvillimit e përparimit të arsimit dhe të shkencës sonë të re, duke dhënë kështu kontributin e tij të vlefshëm në ndërtimin socialist të vendit.

Ju ngushëlloj nga zemra ju dhe të afërmit

e tjerë të familjes për vdekjen e shokut tonë të paharruar, Profesor Kolë Paparistos.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

Korçë

10 tetor 1981

Të përgëzoj për punën kërkuese e grupmbuluese që ke bërë e vazhdon të bësh mbi historinë e lashtë të qytetit të Korçës, punë kjo e mirë në shërbim të edukimit patriotik e revolucionar të popullit e të rinisë sonë.

Të falënderoj gjithashtu për urtimet që më bërëve me rastin e ditëlindjes sime. Edhe unë të urtoj jete të gjatë, shëndet, lumturë dhe sukses në punën e dobishme e patriotike që po bërë.

Juaj

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

**TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT  
EMIN SELENICA, PUNONJËS I MUZEVE**

*Korçë*

**10 tetor 1980**

Të përgëzoj për punën kërkuese e grumbulluese që ke bërë e vazhdon të bësh mbi historinë e lashtë të qytetit të Korçës, punë kjo e mirë në shërbim të edukimit patriotik e revolucionar të popullit e të rinisë sonë.

Të falënderoj, gjithashtu, për urimet që më dërgove me rastin e ditëlindjes sime. Edhe unë të uroj jetë të gjatë, shëndet, lumturi dhe suksese në punën e dobishme e patriotike që po bën.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR ZOTIT LLAMBRO MALLAMA<sup>1</sup>

30 dhjetor 1980

I nderuari zoti Llambro Mallama,

Ju falënderoj për librin mirëdashës për Shqipërinë që më dërguat kohët e fundit<sup>2</sup>. Ai është një kujtim i çmuar për mua nga ana e një miku të sinqertë të popullit shqiptar, është një gur i ri në themelin e miqësisë tradicionale midis dy vendeve tona, për të cilën kanë punuar si në të kaluarën dhe vazhdojnë të punojnë edhe sot njerëzit më përparimtarë e patriotë, bij besnikë të popullit vëlla grek.

Me këtë rast, së bashku me shoqen time Nexhmije, ju dërgojmë përgëzimet tona më të mira. Ju uroj me rastin e Vitit të Ri 1981 shëndet, lumturi në jetë e suksese të vazhdueshme në

---

1. Shkrimtar grek.

2. Është fjala për librin «Shqipëria, nuse e shqipeve».

**punën krijuese! I bëni shumë të fala nga ne të dy  
edhe bashkëshortes suaj të nderuar.**

*Enver Hoxha*

«*Dy popuj miq*», f. 327

LETËR DRELTUAR  
ZOTIT ILIAM BRO MALLAMA

30 dhjetor 1980

I nderuari zoti Ilambro Mallama,

Ju falënderoj për librin mirëdashës për Shqipëri dhe më dërguat kopje të librit. Ai është një kujtim i çmuar për mua nga ana e një mikut të sinqertë të popullit shqiptar, është një gur i ri në themelin e mëdha të traditave më të vjetra të vendit tonë, për të cilën kanë punuar si në të kaluarën dhe vazhdojnë të punojnë edhe sot një-ve të mëdha përparimtare e patriotike, bij besnikë të popullit vëllezë.

Me këtë rast, së bashku me shpenjime të mëdha, ju dërgojmë përkëzimet tona më të mira. Ju uroj me rastin e Vitit të Ri 1981 shëndet, lumturi në jetë e sukses të vazhdueshme në

I Shënimet grek.

I kështu jeta për librin - Shqipëria, tona e shqipërisë.

## LETËR DREJTUAR SHOKUT JASHAR MENZELXHIU

*Sarandë*

**10 janar 1981**

I dashur shoku Jashar,

Nexhmija më lexoi letrën që i kishe dërguar me rastin e Vitit të Ri 1981. Të faleminderit për urimet dhe uroj që edhe ti familjarisht e bashkë me shokë ta kaloni këtë vit me shëndet dhe me suksese sa më të mëdha në detyrat me përgjegjësi që ju ka ngarkuar Partia.

Jam i gëzuar se shoh që, nën drejtimin e organizatës së Partisë, rrethi i Sarandës këto kohët e fundit ka bërë një kthesë të kënaqshme në zhvillimin e tij ekonomik e kulturor. Rezultate të mira, siç na informoje në letër, kanë arritur në mënyrë të veçantë punonjësit e sektorit të Ksamilit jo vetëm në shtimin e sipërfaqeve të mbjella me agrume e ullinj, por edhe në rritjen

e llojeve më të mira e disa prej tyre me cikël prodhimi në sezone më të vonshme.

Vizita që bëra para tre vjetësh në Ksamil<sup>1</sup>, një nga rajonet me peizazhe nga më të bukurat të vendit tonë, por i braktisur e vend ku në të kaluarën rriteshin vetëm egërsirat, më ka lënë një përshtypje të paharruar. Bisedat e zjarra me punëtorët, të rinjtë e të rejat, të ardhur atje nga krahina të ndryshme të atdheut, më forcuan bindjen se planet e ndërtuara nga Partia e pushteti ynë popullor për ta kthyer këtë rajon në një vend të begatshëm përbri rrënojave të një vendi të kulturuar, siç është Butrinti i lashtë, shpejt do të bëheshin realitet. Mua më gëzon shumë edhe fakti që sot jo vetëm është zgjeruar plantacioni i agrumeve e i ullinjve, por që aty, në ato kodra të bukura, që rrihen aq mirë nga rrezet e diellit jetëdhënës, po bëhet një punë e gjerë mjaft e kujdesshme edhe në drejtimin shkencor.

Të krijosh një «kopsht» kaq të madh e të begatshëm, një plantacion të mrekullueshëm, siç është bërë sot Ksamili, do të thotë të duash e të kesh përvetësuar shkencën agroteknike, të kesh kuptuar rëndësinë e direktivës së Partisë, veçanërisht për zhvillimin e frutikulturës, ta kesh thelluar e ta zbatosh atë në mënyrë krijuese.

Me këtë rast, të lutem shoku Jashar, i përgëzo nga ana ime gjithë punëtorët e punëtoret, të rinjtë e të rejat, si dhe drejtuesit e specialistët

---

1. Shoku Enver Hoxha vizitoi Ksamilin më 26 mars 1978.

e Ksamilit për punën e dobishme që kanë bërë, për realizimet e mira që kanë arritur, si dhe për planet e tyre perspektive për ta zbukuruar akoma më shumë në të ardhmen këtë zonë kaq të bukur të bregut jugor të atdheut.

Mund të themi se përpjekjet e Partisë për zhvillimin e frutikulturës sot janë vënë kudo në rrugë të mbarë. Dhe duhet kuptuar nga të gjithë se frutikultura është një pasuri e madhe dhe, në qoftë se e zhvillojmë sistematikisht e në mënyrë të kulturuar, ky si sektor me rëndësi, do t'i sjellë të ardhura të shumta vendit e do të kontribuojë edhe në përmirësimin e forcimin e shëndetit të punonjësve tanë. Prandaj organizata e Partisë dhe punonjësit e bujqësisë të rrethit tuaj, pa e larguar aspak vëmendjen nga sektorët e tjerë të bujqësisë, duhet të mos e lënë mënjanë në asnjë rast frutikulturën.

Është kënaqësi e madhe për secilin prej nesh kur konstatojmë se thirrjes që u ka bërë Partia të rinjve e të rejave për të shkuar e punuar në kooperativat e në ndërmarrjet bujqësore, ata po i përgjigjen çdo ditë e më shumë. Ksamili është një shembull midis shumë të tjerësh në këtë drejtim. Atje, ku përpara s'kishte asnjë shtëpi banimi, sot është ngritur një qytezë e bukur me apartamente komode e me banorë të rinj.

Ca më mirë e më me shumicë do të sulmojnë në të ardhmen të rejtat e të rinjtë tanë revolucionarë drejt kooperativave e ndërmarrjeve bujqësore për ta bërë çdo skaj të atdheut akoma më

pjellor, për të vënë në zbatim të rejat e shkencës agroteknike e zooteknike, të cilat duhen futur e përvetësuar sa më thellë në shkolla e në kurse të ndryshme.

Me këtë rast u uroj gjithë komunistëve e punonjësve të Sarandës suksese të mëtejshme në punën për realizimin e detyrave që i dalin përpara rrethit tuaj. Jam i bindur se, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, masat punonjëse të rrethit tuaj do ta presin 40-vjetorin e themelimit të Partisë me suksese të reja në të gjitha fushat.

**Juaji**

**Enver**

*Gazeta «Fitorja», nr. 5 (598),  
18 janar 1981*

## **LETËR DREJTUAR SHOQES NEDRET HOXHA**

*Tiranë*

**3 shkurt 1981**

**E dashur motër Nedret,**

U dëshpërova shumë kur më dhanë lajmin e vdekjes së Gjylfos tonë të dashur. Me këtë rast kaq të dhimbshëm për ne përshkova nëpër mend gjithë jetën e familjes sonë, dashurinë e madhe të anesë tënde me anenë time, respektin dhe dashurinë e baba Çenit dhe të xhaxhait ndaj Gjylfos dhe atë kujdes e dashuri të veçantë që ka treguar ajo vazhdimisht për mua. Në këto çaste hidhërimi të madh për ty dhe për të gjithë ne e ndiej veten aty, pranë teje, si vëlla që më ke pasur dhe që do të më kesh kurdoherë.

E kam dashur shumë Gjylfon dhe kam çmuar gjithnjë te personi i saj një grua me kurajë të madhe në jetë, me virtyte të veçanta dhe me zgjuarsi të mprehtë. Për ty ajo ishte nënë, baba e gjithçka. Për të gjithë ne të familjes ajo ishte një këshilluese e urtë dhe e shtrenjtë.

Megjithëse Gjylfua jetoi në kohë të vështira, kur regjimet antipopullore obskurantiste pengonin gratë dhe vajzat shqiptare të merrnin pjesë si edhe burrat në jetën politike, shoqërore e kulturore të vendit, ajo e tregoi kurdoherë veten si një grua e guximshme e përparimtare të atyre kohëve, mbështetje e fortë e Urani Rumbos dhe e Naxhijes<sup>1</sup>.

Edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Gjylfua nuk ngurroi asnjë çast si luftëtare me ndjenja të zjarrta patriotike e me një dashuri të pastër për Partinë dhe popullin, cilësi këto që i ruajti e i zhvilloi gjithnjë më lart gjatë gjithë jetës së saj. Ajo, siç e dimë, ishte një grua e rreptë kundër çdo shkeljeje të parimeve të Partisë dhe të normave të moralit të saj, si një mëmë, një motër.

Ne e kemi njohur atë kurdoherë si një grua të dashur, të mençur, të drejtë e të guximshme, prandaj kujtimi i saj do të rrojë kurdoherë i pashlyer në zemrat tona.

Të përqafoj me dashuri

*Enveri*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Naxhije Hoxha një nga mësueset e para të Gjirokastrës, që punoi pa u lodhur, krahas Urani Rumbos, për arsimimin dhe emancipimin e vajzave gjirokastrite.

# LETËR DREJTUAR SHOKUT KUJTIM BUZA -SEKRETAR I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

Tiranë

29 prill 1981

I dashuri shoku Kujtim,

Të falënderoj për dhuratën aq të çmuar që më dërgove, tablonë «Shtëpia-muze» e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që e ke punuar bukur jo vetëm me frymëzim e mjeshtëri artistike, por edhe me dashuri e respekt për veprën e shquar e të paharruar në shekuj për gjithë popullin tonë të patriotëve të mëdhenj të Rilindjes sonë Kombëtare.

Unë kam parë edhe vepra e tablo të tjera të tuat dhe kurdoherë ato më kanë sjellë kënaqësi. Por tabloja «Shtëpia-muze» e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më ringjalli në këto çaste respektin e thellë për frymën e lartë patriotike,

sakrificat e panumërta, luftërat heroike dhe guximin shembullor, debatet dhe përleshjet e stuhishme diplomatike në arenën ndërkombëtare të Abdyllit e të Ymerit, të Sulejmanit e të Isait, të Micit e të dhjetëra e qindra bijve e bijave të pavdekshëm të mbarë popullit tonë për mbrojtjen e trojeve të Shqipërisë nga copëtimi dhe grabitja nga armiqtë e egër imperialistë dhe nga shovinistët fqinj; ajo më solli, gjithashtu, ndër mend popullin patriot, trim e me tradita atdhedashurie të Prizrenit e të të gjithë Kosovës, që i strehoi, i ushqeu dhe i mbrojti udhëheqësit e shquar e luftëtarët heroikë të Lidhjes në ditët historike të betejave që e ngritën edhe më lart dinjitetin kombëtar dhe personalitetin e shqiptarit.

Të uroj suksese në punën krijuese me vlera të mëdha edukative artistike e njëherësh edhe patriotike e revolucionare për brezin tonë të ri.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR ZOTIT KOSTIS PAPANONGOS

8 maj 1981

I nderuari zoti Kostis Papanongos,

Ditët e fundit mora librin e çmuar të shkruar nga ju, me titullin «Kapedan Aris», së bashku me dedikimin shumë të përzemërt që më bëni në të, për të cilët ju shpreh falënderimet e mia.

Kapedanin trim Aris Veluhiotis, personalisht nuk kam arritur ta njihja, por kam qenë në dijeni të veprimtarisë së tij politike dhe të luftës që ka zhvilluar kundër armiqve okupatorë e bashkëpunëtorëve të tyre grekë, prandaj e kam dashur dhe e kam konsideruar si një bashkëluftëtar, që luftoi heroikisht, deri në sakrificën e tij të fundit për çlirimin e popullit vëlla grek. Mëndimet e mia për personalitetin dhe për figurën e kapedan Arisit ia kam shfaqur edhe J.V. Stalinit. E kam vlerësuar lart veprën e tij revolucionare, besnikërinë që ushqente ndaj popullit grek e ko-

munizmit dhe kam dënuar me indinjatë ata që u përpoqën ta njollosin këtë luftëtar të shquar të rezistencës greke.

Zoti Kostis Papakongos,

Libri juaj është një kontribut i rëndësishëm i patriotëve dhe i revolucionarëve grekë, pse ndihmon për të hedhur dritë rreth së vërtetës mbi lëvizjen e rezistencës dhe luftën e popullit heroik të Greqisë gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër pushtuesve nazifashistë e tradhtarëve të brendshëm. Atë do ta lexoj me kënaqësi, porsa të ma përkthejnë shokët e mi minoritarë grekë, që jetojnë me popullin shqiptar në vëllazëri e në unitet të çeliktë, siç thotë populli ynë, shkuar vëllai vëllait, dhe atëherë do ta kem më të plotë jetën prej revolucionari të madh të këtij biri të lavdishëm të popullit tuaj trim, liridashës e përpërimtar.

Edhe një herë ju falënderoj nga zemra që më kujtuat, si dhe për librin me vlerë që më dërguat.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Dy popuj miq», f. 329

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT GURI MADHI**

*Tiranë*

**29 qershor 1981**

I dashur shoku Guri,

E prita me kënaqësi të madhe tablonë «Malet tona» që më dërgove, të cilën do ta ruaj si një dhuratë shumë të çmuar, ashtu sikundër ruaj me dashuri edhe tablonë tjetër tënden në Komitetin Qendror të Partisë, atë të Heroit të Popullit. trimit tonë të pavdekshëm në shekuj, Bajram Currit.

Duke ndjekur me vëmendje zhvillimin e artit tonë të realizmit socialist, personalisht jam në dijeni edhe për krijimtarinë tënde të gjatë e të pasur në vepra të bukura me nivel të lartë jo vetëm artistik, por sidomos edhe me qartësi ideore e partishmëri.

Me rastin e 60-vjetorit që pate para disa di-

tësh, dëshiroj të të uroj nga zemra shëndet, jetë të gjatë dhe arritje të reja në veprimtarinë tënde të palodhur dhe shpreh bindjen se, si piktor i talentuar që je, do t'i japësh popullit vepra të reja me vlerë për edukimin komunist të punonjësve tanë.

Duke të shprehur gëzimin e madh për dhuratën e çmuar që më bërë, edhe unë po të dërgoj me këtë rast librin tim të fundit me kujtime nga periudha e Luftës Nacionalçlirimtare «Kur lindi Partia».

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR KRYETARIT TË BASHKISË SË GOLXHYSKUT

8 shtator 1981

I nderuari zoti kryetar i bashkisë së Golxhykut,

Të nderuar zotërinj anëtarë të bashkisë,

Me kënaqësi të veçantë mora portretin në bronz të udhëheqësit tuaj të dashur, Mustafa Kemal Atatürkut, që ju ma dërguat me anën e ansamblit tonë të këngëve e të valleve popullore «Rozafa». Dëshiroj t'ju falënderoj me gjithë zemër për këtë dhuratë me vlerë historike, që shpreh ndjenjat e miqësisë e të dashurisë suaj për Shqipërinë dhe për popullin shqiptar. Edhe populli ynë ushqen të njëjtat ndjenja të miqësisë e të respektit reciprok për popullin vëlla turk.

Mustafa Kemal Atatürku ka qenë një udhëheqës i madh shtetëror e personalitet i shquar politik, i njohur kudo për mendimet demokra-

tike dhe veprën e tij të guximshme, që kishin për synim ta çonin popullin turk në rrugën e përparimit e të modernizimit, si dhe për besimin e madh që ai kishte në mënyrë të veçantë te brezi i ri për të ardhmen e Turqisë. Ataturku ka ushqyer ndjenja dashamirësie edhe ndaj popullit shqiptar, të cilat ai i pati shprehur në raste të ndryshme, prandaj është i njohur dhe emri i tij kujtohet kurdoherë me respekt nga populli ynë.

Të nderuar zotërinj,

Ju lutem pranoni me këtë rast urimet e mia më të mira për shëndetin tuaj, si dhe për mirëqenien e prosperitetin e popullit të qytetit të Golxhykut.

U forcoftë gjithnjë e më shumë miqësia midis dy popujve e dy vendeve tona.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOQES**  
**SEJADE BALLA, LUBALESH—GJORICË**

*Dibër*

**9 tetor 1981**

Nga letra që më dërgove, mësova me kënaqësi se ti, Sejade, në moshën 32-vjeçare, nënë e 6 fëmijëve, pa u shkëputur nga punët e tjera të familjes e të kooperativës, mbarove me sukses shkollën e mesme. Në jetën tënde 11-vjeçare në gjirin e Partisë kjo përbën një ngjarje të shënuar që do të të japë mundësi t'i shërbesh më mirë çështjes së ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së atdheut. Prandaj të përgëzoj për vullnetin dhe këmbënguljen shembullore që ke treguar për ngritjen e nivelit tënd arsimor e kulturor.

Me këtë rast të uroj gëzime e lumturi në familje, suksese të mëtejshme në jetën e Partisë

dhe në punët për mbarëvajtjen e përparimin e kooperativës.

Juaji

*Enver Hoxha*

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

Dibër

9 tetor 1981

Nga letra që më dërgove mësova me kënaqësi se ti, Sëjda, në moshën 32-vjeçare, nënë e të fëmijëve, pa u shqëputur nga punët e tjera të familjes e të kooperativës, mbarove me sukses shkollën e mesme. Në jetën tënde 11-vjeçare në gjirin e Partisë kjo përben një ngjarje të shënuar që do të të japë mundësi të shprehësh më mirë qeshitjes së ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së shtetit. Prandaj të përgëzoj për vullnetin dhe këmbënguljen shembullore që ke treguar për ngritjen e nivelit tënd arsimor e kulturor.

Më këtë rast të uroj gëzime e lumturi në familje, sukses të mëtejshme në jetën e Partisë

## **LETËR DREJTUAR INSTITUTIT TË LARTË BUJQËSOR**

**10 tetor 1981**

Të dashur shokë e shoqe, pedagogë e kuadro drejtues,

Të dashur studentë e studente,

Me rastin e ngjarjes së shënuar për kolektivin tuaj, 30-vjetorit të themelimit të Institutit, ju përshëndes nga zemra dhe ju dërgoj urimet e mia më të mira.

Sot, së bashku me ju, këtë ditë të gëzuar jubilare e festojnë me mijëra kuadro të bujqësisë në të gjithë vendin, që janë mësuar dhe janë edukuar në bankat e institutit tuaj, e festojnë anëtarët e kooperativave bujqësore, punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore, e festojnë gjithë Partia dhe populli ynë.

Instituti i Lartë Bujqësor prej 30 vjetësh, nën kujdesin, udhëheqjen dhe ndihmën e vazh-

dueshme të Partisë dhe duke zbatuar orientimet e direktivat e saj, ka bërë hapa shumë të mëdhenj përpara. Nga një kolektiv i kufizuar në fillim, sot ai është bërë një qendër e rëndësishme edukimi për përgatitjen e specialistëve të bujqësisë e të blegtorisë, i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme laboratoriko-shkencore.

Në Institutin e Lartë Bujqësor japin sot mësim dhe drejtojnë me aftësi punën pedagogjike e shkencore me dhjetëra pedagogë e specialistë të tjerë të devotshëm, me nivel të lartë e me vullnet për përvetësimin gjithnjë e më thellë të shkencave agroteknike e zooveterinare dhe për zbatimin e tyre në bujqësinë e vendit tonë. Nga bankat e institutit tuaj kanë dalë disa mijëra kuadro, agronomë, veterinerë, zooteknikë, inxhinierë pyjesh, ekonomistë agrarë e të tjerë, një armatë e tërë, nga të cilët një numër i madh janë shoqe, që sot derdhin djersën pa u lodhur në të katër anët e vendit. Ata, përkrah kooperativistëve dhe punëtorëve të bujqësisë, vënë në shërbim dijet e fituara për rritjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për lulëzimin e atdheut tonë socialist, për ta bërë gjithnjë e më të begatshme jetën e punonjësve tanë.

Të dashur shokë e shoqe,

Atdheu ynë socialist, si rezultat i zbatimit në jetë të vijës së drejtë marksiste-leniniste, të Partisë, po përparon me hapa viganë në të gjitha

drejtimet. Sukseset janë të dukshme e të kapshme nga cilido. Në fushën e zhvillimit bujqësor, ngado që të hedhësh sytë, shikon ndryshime rrënjësore e shumë të mëdha, që të gjithë i jetojmë ditë-ditës dhe na gëzojnë. Ato janë të lidhura edhe me punën e madhe frytdhënëse që po bëjnë kudo në vendin tonë kuadrot e dalë nga bankat e fushat eksperimentale të institutit tuaj, i cili me të drejtë ka një meritë të veçantë në këtë drejtim.

Por, detyra madhështore do të shtrojë Partia në Kongresin e 8-të të saj, për bujqësinë e vendit tonë gjatë pesëvjeçarit të shtatë. Këto detyra kanë të bëjnë jo vetëm me fushën e rritjes së prodhimit bujqësor e blegtoral, por edhe me atë të zhvillimit shkencor, të intensifikimit e të modernizimit të pandërprerë të bujqësisë, mbështetur në karakterin shumëdegësh të saj, të thellimit të mëtejshëm të përqendrim-specializimit etj. Kjo kërkon që Instituti i Lartë Bujqësor të kthehet gjithnjë e më shumë në një vatër të madhe për përhapjen e përvojës së përparuar, për zbatimin në jetë të studimeve shkencore etj. në masat e gjera të punonjësve të bujqësisë.

Shkenca bujqësore është shumë e gjerë dhe e vështirë dhe detyrat që shtron Partia, sot e në perspektivë, nuk mund të arrihen pa e njohur e pa e zotëruar atë mirë. Prandaj ju, të dashur studentë e studente, që nesër do të bëheni kuadro të prodhimit, duke fituar me kohë edhe përvojën e praktikës, do të jeni edhe pedagogë e shkencëtarë të ardhshëm të vendit tonë. Prandaj, sa më

shumë të studioni e sa më shumë dije të fitoni sot, aq më të vlefshëm do të bëheni nesër për popullin që ju ka rritur, për Partinë që ju do si nëna fëmijën e vet, për atdheun tonë të dashur e të shtrenjtë socialist.

Edhe një herë të gjithë juve, pedagogë e studentë, që punoni e mësoni sot në atë Institut të Lartë, si dhe atyre që, për arsye të moshës kanë dalë në pension, puna e të cilëve në shërbim të vendit do të mbetet kurdoherë e paharruar, si dhe gjithë kuadrove që kanë mbaruar institutin, janë shpërndarë në të katër anët e vendit dhe punojnë pa u lodhur për zbatimin e porosive të Partisë në këtë sektor jetik të ekonomisë së vendit, ju dërgoj përgëzimet e mia më të mira. Ju uroj nga zemra të kryeni gjithnjë e më mirë detyrat që ju kanë ngarkuar populli dhe Partia. Në të njëjtën kohë shpreh bindjen e thellë se të gjithë ju, pedagogë e studentë, kuadro e specialistë të ndryshëm, tërë kolektivi i institutit, ashtu si deri më sot, do të punoni pa u lodhur e do të përvetësoni me ndërgjegje të lartë direktivën e Partisë për të forcuar gjithnjë e më shumë rendin kooperativist e për ta çuar vazhdimisht përpara bujqësinë tonë socialiste.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për rininë» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 545

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
KOLEKTIVIT PUNONJËS TË KOMBINATIT  
TË TEKSTILEVE «STALIN»**

*Tiranë*

**9 nëntor 1981**

Të dashur shoqe e shokë tekstilistë, inxhinierë e specialistë dhe kuadro të kombinatit,

Me rastin e 30-vjetorit të inaugurimit të kombinatit të tekstileve «Stalin», një ndër veprat e para të industrializimit socialist të vendit, ju përshëndes nga zemra për arritjet e deritanishme dhe ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj të frytshme në plotësimin me veshmbathje të masave tona punonjëse e në fuqizimin e ekonomisë sonë popullore.

Kanë kaluar 30 vjet nga dita kur, për nder

të 10-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme, ju filluat punën në këtë kombinat pa asnjë përvojë e njohuri të thellë në mjeshtërinë e re të tekstilistit. Gjatë kësaj kohe, me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë dhe me punën tuaj të palodhur, kombinati juaj u bë një nga qendrat më të mëdha e më të rëndësishme të atdheut tonë socialist për shtimin e radhëve të klasës sonë të re punëtore, për kalitjen e saj proletare dhe edukimin marksist-leninist, u bë një shkollë e madhe e edukimit profesional të industrisë tekstile që Partia mendonte dhe punonte për të ngritur në vendin tonë.

Nga vajzat e dikurshme të mbyllura në ferexhe, të shtypura e të lëna në prapambetje kulturore e arsimore nga regjimet e egra antipopullore dhe nga feja, të cilat, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, morën në dorë tezgjahet dhe makinat e para në kombinatin tuaj, sot kanë dalë tezgjahiste, filaturiste, endëse e ngjyrosëse me duar të arta, të shkathëta e plot krijimtari, me arsim profesional e të përgjithshëm të të gjitha kategorive, mjeshtre të prodhimit, punëtore të kualifikuara, specialiste e inxhinierë të nderuara. Nga gjiri juaj kanë dalë heroina të punës socialiste, si dhe dhjetëra e qindra kuadro që punojnë jo vetëm në kombinate e fabrika të tjera të tekstileve të vendit, por edhe në institucione qendrore, në organe të Partisë e të pushtetit e kudo.

Në krahasim me prodhimet e para tani ju i

jepni popullit 9 herë më shumë tekstile të pambukta e të leshta të një cilësie të mirë, me larmi ngjyrash e vizatimesh të bukura. Arritjet tuaja tregojnë se ju jeni bërë tani një kolektiv luftarak, krijues e kërkues ndaj vetes, duke plotësuar kështu me nder detyrat e planeve vjetore e pesëvjeçare.

Punimet e Kongresit të 8-të të Partisë si dhe direktivat e planit të ri pesëvjeçar 1981-1985, shtrojnë edhe para jush detyra shumë të mëdha për thellimin e mëtejshëm të punës së Partisë, për edukimin ideologjik dhe kualifikimin e punonjësve për rritjen e prodhimit, zgjerimin e asortimentit dhe përmirësimin e cilësisë, për rritjen e rendimentit të punës, forcimin e regjimit të kursimit dhe sidomos për futjen më shumë në tekstilet tona të fibrave sintetike. Shpreh besimin e plotë se ju, punonjës të kombinatit, me komunistët në ballë, ashtu si gjithnjë, edhe këto detyra të mëdha do t'i bëni realitet, do t'i jepni popullit basma e stofra të bukura, ashtu siç është vetë jeta jonë socialiste.

Ju dërgoj, me rastin e kësaj feste të gëzueshme për kolektivin tuaj, përgëzimet më të nxehura si juve, punëtorëve, specialistëve e kuadrove që vazhdoni të punoni, ashtu edhe veteranëve të kombinatit që për arsye moshe kanë dalë në pension.

Ju uroj nga zemra që edhe në të ardhmen të qëndroni në pararojë, të plotësoni dhe të tejkaloni detyrat dhe të mbani gjithnjë lart flamurin

e Partisë sonë të lavdishme, si dhe emrin e nderuar e të pavdekshëm të Stalinit të madh.

**Juaji**

**Enver Hoxha**

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **PËRSHËNDETJE DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË BASHKIMIT TË RINISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

**23 nëntor 1981**

Të dashur shokë e shoqe të rinisë,

Është gëzim i veçantë për mua që sot t'ju dërgoj juve, përfaqësuesve të brezit të ri, dhe nëpërmjet jush gjithë rinisë së vendit tonë, përshëndetjet e zjarra dhe urimet më të mira të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Komitetit të saj Qendror dhe të miat, me rastin e përvjetorit të themelimit të organizatës suaj luftarake.

Sot mbushen plot 40 vjet që nga 23 nëntori i vitit 1941, kur, me porosi të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më takoi nderi të merrja pjesë në themelimin e Organizatës së Rinisë Komuniste Shqiptare, ndihmëses besnike të Partisë sonë. Prandaj sot në gëzimin tuaj të madh me zemër dhe me mendje jam midis jush.

Në këto katër dekada, në luftë dhe në punë për çështjen e madhe të çlirimit të atdheut të ro-bëruar, për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga pushtuesit e huaj, për ndërtimin e socializmit dhe forcimin e pushtetit popullor, për zbatimin dhe mbrojtjen e vijës së drejtë e të urtë të Partisë sonë, brezi i ri heroik i vendit tonë ka dhënë një kontribut shumë të madh. Nga radhët e rinisë, gjatë këtyre vjetëve, kanë dalë qindra mijë luftëtarë të pararojës, të luftës e të ndërtimit socialist, ushtarë besnikë të Partisë, shembuj të trimërisë, të punës ndërtuese e të dijes. Vepra e tyre, e gjithë rinisë sonë të lavdishme, është materializuar në fitoret që ka arritur atdheu ynë socialist në industrinë tonë të re, në bujqësinë e kolektivizuar, në ndërtimin e hekurudhave të vendit tonë, të cilat janë ndërtuar të gjitha me punën vullnetare të të rinjve dhe të rejave tona, në shkollat e institucionet e shumta, në çdo sektor të jetës, sepse kudo është edhe mendja e mprehtë, edhe djersa e mudi i rinisë shqiptare. Rinia jonë është fidanishtja e Partisë, prej saj vijnë në Parti vazhdimisht filiza të rinj të pastër e besnikë ndaj çështjes së socializmit.

Partia dhe populli, të dashur shokë dhe shoqe, krenohen me djemtë e vajzat e vendit tonë, të cilët, të grumbulluar në Bashkimin e Rinisë së Punës të Shqipërisë, ecin të vendosur në rrugën e Partisë, që është rruga e socializmit, rruga e përparimit dhe e forcimit të gjithanshëm të atdheut tonë të dashur.

Shokë e shoqe të rinisë,

Pak ditë më parë përfundoi punimet Kongresi i 8-të i Partisë. Ai ishte një kuvend i madh ku u caktuan detyra dhe u miratua një program madhështor për zhvillimin perspektiv të vendit tonë. Punimet e Kongresit u karakterizuan nga ndjenja e përgjegjësisë ndaj popullit e çështjes së socializmit, nga uniteti i radhëve të Partisë dhe besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, nga trajtimi në një nivel të lartë ideopolitik e shkencor të çështjeve që u diskutuan.

Kongresi, siç jeni në dijeni, ka ngjallur një entuziazëm jashtëzakonisht të madh në të katër anët e vendit. Masat punonjëse në këto ditët e para pas kësaj ngjarjeje të rëndësishme historike janë mobilizuar si kurrë ndonjëherë tjetër për të vënë në jetë me hov të madh revolucionar vendimet e tij, për të realizuar e tejkaluar detyrat e planit të vitit 1981 në të gjithë sektorët dhe për të marrë masa përgatitore që të garantohet realizimi e tejkalimi i planeve edhe për vitet e tjera të pesëvjeçarit të shtatë. Ndien një gëzim të madh kur sheh se në këtë mobilizim të gjithanshëm, ashtu si kurdoherë, spikat në radhë të parë veprimtaria krijuese dhe puna vetëmohuese e rinisë sonë heroike. Ju, shoqe e shokë të rinisë, me shpirt novator e sulmues, me vrull luftarak e optimizëm qëndroni në ballë të iniciativave të përparuara e të aksioneve që po ndërmerren kudo, për të realizuar detyrat që caktoi Partia në këtë

Kongres. Ju ju karakterizon si kurdoherë veprimi energjik në kryerjen e detyrave, papajtueshmëria me rutinën, me burokratizmin dhe me javashllëkun në çdo punë.

Të mëdha e shumë të rëndësishme janë objektivat që caktoi Kongresi i 8-të për zhvillimin me forcat e veta dhe me ritme të shpejta të ekonomisë e të kulturës, për futjen e teknikës e të teknologjisë së përparuar në industri, në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë. Shumë të mëdha e të rëndësishme janë, gjithashtu, objektivat e caktuar për rendiment e cilësi të lartë, për efektivitet e rentabilitet më të madh në prodhim. Të gjitha këto, vetë ndërtimi i socializmit, në kushtet e rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste, shtrojnë përpara çdo punonjësi nevojën e domosdoshme të armatosjes me botëkuptimin dhe metodologjinë marksiste, me mësimet e Partisë sonë, si dhe ngritjen e mëtejshme të nivelit arsimor e kulturor, aftësimin e gjithanshëm tekniko-profesional të secilit.

Shpreh bindjen se në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë ju, shokë e shoqe të rinisë, që ushqeni një dashuri të pakufishme për Partinë, duke përvetësuar akoma më thellë mësimet e saj, do t'i futeni akoma më me këmbëngulje mësimin për zotërimin gjithnjë e më shumë të shkencave të të gjitha fushave. Kështu do t'i shërbeni edhe më mirë atdheut dhe popullit, që, nën udhëheqjen e Partisë, po ju rrit dhe ju edukon me kujdes të madh.

Pjesëmarrja aktive në luftën për ndërtimin socialist dhe forcimin e mbrojtjes së atdheut, puna për të rritur pandërprerë nivelin e dijes e të kulturës, është rruga e sprovuar që rinia jonë të kalitet me ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë, me dashurinë për popullin e socializmin, që ajo të jetë kurdoherë e paepur në luftën klasore kundër armiqve imperialistë e revizionistë, kundër çdo shfaqjeje e mbeturine të huaj që pengon ecjen përpara drejt të ardhmes komuniste.

Shoqe e shokë të rinisë,

Që gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Partia i ka besuar vazhdimisht rinisë detyra me shumë përgjegjësi e në të gjitha drejtimet dhe ajo, sado të vështira që kanë qenë, i ka kryer ato gjithnjë e deri në fund me devotshmëri të madhe për popullin e atdheun. Partia krenohet për këtë dhe unë, në emër të saj, ju përgëzoj e ju falënderoj dhe, në të njëjtën kohë, shpreh bindjen e thellë se rinia jonë e lavdishme, së cilës socializmi i ka dhënë jetën e lumtur, sigurinë e së sotmes dhe perspektivën e ndritur për të ardhmen, duke mbajtur gjithnjë lart flamurin ngadhënjimtar të Partisë së Punës, do të ndjekë të njëjtën rrugë, me syrin pishë e ballin lart.

Rroftë rinia jonë heroike!

Rroftë Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqi-

përisë, organizata luftarake, ndihmësja e Partisë,  
40-vjetorin e krijimit të së cilës festojmë sot!

Juaji

*Enver Hoxha*

Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 282 (10 395), 24 nëntor 1981

Shpode e shokë të rinisë,

Që gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirim-  
tare Partia i ka besuar vazhdimisht rinisë detyrë  
me shumë përgjegjësi e në të gjitha drejtimet dhe  
ajo, sado të vështira që kanë qenë, i ka kryer ato  
gjithnjë e beri në fund me devotshmëri të madhe  
për popullin e atdheun. Partia kërenohet për këtë  
dhe unë, në emër të saj, ju përgëzoj e ju falë-  
nderoj dhe, në të njëjtën kohë, shpreh bindjen  
e thellë se rinia jonë e lavdishme, së cilës socia-  
lizmi i ka dhënë jetën e lumtur, sigurinë e së  
sotmes dhe perspektivën e ndritur për të ardh-  
men, duke mbajtur gjithnjë hartë lamurnë ngadhë-  
njëmtar të Partisë së Punës, do të ndjekë të njëj-  
tën rrugë, me syrin pjeshë e ballin iart.

Profie rinia jonë heroike!

Profie Bashkimi i Rinisë së Punës të Shpi-

# LETËR DREJTUAR SHOKUT VELIKO TAFIL DERRAJ<sup>1</sup>, LEZHAN—KOTË

Vlorë

30 dhjetor 1981

I dashur xha Veliko,

Më gëzoi letra jote, pse më kujtoi ngjarjet e paharruara që kam kaluar tok me shokun tonë të shtrenjtë Hysni Kapo dhe të tjerë në gjirin e popullit trim të Labërisë në ditët e zjarra të Luftës Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia, si dhe qëndrimin në shtëpinë tënde, prandaj të faleminderit shumë. Unë kujtoj me dashuri mikpritjen dhe bujarinë e gjithë pjesëtarëve të familjes tënde dhe të të gjithë fshatarëve patriotë që pata rastin të takoja e të bisedonim në atë kohë.

---

1. Veliko Tafil Derraj në moshën 105 vjeç i dërgoi një letër shokut Enver Hoxha, ku i shkruan për takimin e paharruar në maj të vitit 1943 dhe për ditët e lumtura që jeton në epokën e Partisë.

Të falënderoj edhe për urimet e Vitit të Ri. Përfitoj nga ky rast për të të dërguar ty e gjithashtu edhe familjes urimet e mia më të mira.

Jam i bindur se me gjithë moshën, si njeri besnik i Partisë, do të vazhdoj ashtu si gjithnjë t'u flasësh, sidomos të rinjve, për veprën e madhe të Partisë dhe atdheun socialist. Të uroj shëndet, gëzime e lumturi.

Yti

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË TË DAJÇIT

*Shkodër*

**27 janar 1982**

Të dashur shokë e shoqe kooperativistë e kooperativiste, specialistë e kuadro drejtues të kooperativës së tipit të lartë të Dajçit,

Mora letrën me të cilën më bëtë të ditur për rezultatet e mira që keni arritur në realizimin e tejkalimit të treguesve të prodhimeve bujqësore e blegtorale e në ato financiare, si dhe për arritjet e tjera të rëndësishme tuajat në fushën e mirëqenies materiale e kulturore për vitin 1981, viti i parë i pesëvjeçarit të shtatë. Këto arritje janë rezultat i këmbënguljes e ndërgjegjes së lartë socialiste, i punës së frytshme politike dhe udhëheqjes së drejtë e të vazhdueshme të organizatës së Partisë, i organizimit të punës, i zbatimit të agroteknikës etj.

Në këto drejtime ju jeni bërë nga shembujt më të mirë jo vetëm për kooperativat e rrethit të Shkodrës, por edhe të mbarë vendit tonë. Prandaj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, ju përgëzoj për të gjitha arritjet dhe për punën që vazhdoni të bëni për zhvillimin e pandërprerë ekonomik e kulturor të kooperativës suaj.

LETËR DREJTUAR KOOPERATIVËS  
SË TIPIT TË LARTË TË DALCIT

Të dashur shokë e shoqe kooperativistë,

Ju tashmë keni grumbulluar një përvojë të mirë në trajtimin e tokës e zbatimin në praktikë të arritjeve të shkencës bujqësore, po njihni gjithnjë e më mirë sekretet e prodhimit bujqësor e blegtoral për të siguruar rendimente të larta e prodhime të bollshme. Por ato nuk janë kulmi i arritjeve. Ashtu siç më shkruani në letër, rendimentet që keni marrë janë vetëm fillimi dhe një mbështetje e fuqishme për arritje akoma më të larta në të ardhmen. Prandaj përpara jush dhe gjithë kooperativistëve të vendit dalin detyra të mëdha në këtë drejtim.

Krahas përpjekjeve për zotërimin e njohurive shkencore agroteknike e zooveterinere dhe zbatimit të tyre me pasion e këmbëngulje nga gjithë punonjësit e bujqësisë, rëndësi vendimtare për realizimin e për kapërcimin e objektivave që përcaktoi Kongresi i 8-të i Partisë kanë drejtimi e organizimi shkencor i punëve dhe ndjekja sistematike e realizimit në kohë të çdo detyre. Ju

keni dhënë një shembull të mirë dhe unë shpreh bindjen se përvoja juaj, si dhe ajo e kooperativave të tjera të përparuara, do të shërbejë si nxitje për të realizuar me sukses detyrat që ka përpara bujqësia jonë socialiste.

Tani ekonomia juaj, ashtu si gjithë bujqësia e vendit, ndodhet në pragun e një aksioni shumë të madh, siç është fushata e mbjelljeve të pranverës dhe kryerja e shërbimeve bimëve të arave dhe frutikuturës. Përfundimi me sukses i kësaj fushate përbën një domosdoshmëri për kurorëzimin me sukses edhe të fushatave të tjera që vijnë njëra pas tjetrës, siç është ajo e korrje-shirjes dhe e grumbullimit etj. Për këtë qëllim nga të gjithë, duhet shfrytëzuar përvoja e mirë që keni grumbulluar ju dhe ekonomi të tjera të përparuara, duke marrë masa për një organizim sa më të përsosur të punëve, për t'i dalë përpara me kohë kryerjes së çdo detyre. Për fushata të tilla, si mbjelljet e pranverës, rëndësi vendimtare ka veprimtaria e çdo njësie prodhimi e sidomos e shtabeve drejtuese që, ashtu siç veprojnë në kohë lufte shtabet ushtarake, është e domosdoshme të bashkërendojnë, të organizojnë dhe të kontrollojnë me kujdes çdo gjë, që nga përgatitja e mirë e tokës, zgjedhja e sigurimi i farës me cilësi të lartë, grumbullimi e shpërndarja e plehut, hapja dhe pastrimi i kanaleve kulluese e ujitëse, mbajtja në gatishmëri e mjeteve e të mekanikës bujqësore, si dhe gjithë bazës materialo-teknike të domosdoshme etj. Organizimi i mirë i punës,

kryerja e detyrave nga secili e me përgjegjësi të plotë, vendosja e kontrollit të nevojshëm dhe forcimi i punës edukative të Partisë me kooperativistët e thjeshtë, me specialistët e kuadrot drejtues, një përgatitje e drejtim i tillë i përsosur, bën të mundshëm përfundimin me sukses të çdo pune, me cilësi e në afatet e parashikuara.

Bujqësia jonë socialiste e fuqishme nuk mund të ecë përpara pa një organizim të shëndoshë e drejtim shkencor në nivelin e kërkesave të kohës, ashtu sikundër nuk mund të ecë pa u udhëhequr nga shkenca e përparuar agroteknike. Kjo duhet kuptuar mirë nga të gjithë, pa përjashtim, në mënyrë të veçantë nga drejtuesit e prodhimit bujqësor e blegtoral, nga brigadierët, agronomët, zooteknikët, veterinerët, ekonomistët, institucionet kërkimore e shkencore etj.

Të dashur shokë e shoqe,

Kongresi i 8-të i Partisë ka caktuar detyra të rëndësishme e të mëdha në fushën e zhvillimit e të intensifikimit të pandërprerë të bujqësisë e të blegtorisë së vendit tonë, plotësimi i të cilave do të çojë në fuqizimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë socialiste, në rritjen e mirëqenies së mbarë punonjësve dhe në forcimin gjithnjë e më shumë të mbrojtjes së atdheut.

Le të bëhet viti 1982 viti i mobilizimit të përgjithshëm për të realizuar e tejkaluar detyrat

e mëdha të caktuara nga Kongresi i 8-të në fuqishën e zhvillimit e të përparimit në sektorin e bujqësisë dhe në të gjithë sektorët e tjerë. Partia është e bindur se fshatarësia jonë patriote, gjithë punonjësit e bujqësisë, kuadrot e specialistët, nën udhëheqjen e organizatave të Partisë e me komunistët në ballë dhe duke punuar sipas përvojës së përparuar të individëve, brigadave, sektorëve dhe të kooperativave e ndërmarrjeve pararojë, do të vënë në jetë detyrat e këtij viti dhe ato në perspektivë.

Edhe një herë ju përgëzoj për sukseset tuaja dhe ju uroj arritje akoma më të mëdha në interes të fuqizimit të ekonomisë suaj të përbashkët, të ekonomisë së rrethit dhe në atë të të gjithë atdheut.

**Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë**

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 23 (10 450), 28 janar 1982*

## **PËRSHËNDETJE DREJTUAR PIONIERËVE DHE PIONIEREVE TË SHQIPËRISË**

**10 shkurt 1982**

Shumë të dashur pionierë e pioniere,

Ju falënderoj nga zemra për mesazhin që më dërguat me rastin e 40-vjetorit të themelimit të organizatës suaj luftarake të pionierit. Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe në emrin tim, ju dërgoj përshëndetjet e zjarra dhe urimet më të mira.

Duke lexuar mesazhin tuaj, m'u ringjallën kujtime të paharruara të akteve heroike, të guximit e të zgjuarsisë shembullore të shumë pionierëve, të cilët në ditët e Luftës Nacionalçlirimtare, në përgjigje të thirrjes së Partisë, punuan e luftuan përkrah nesh e si ne për çlirimin e Shqipërisë sonë të shtrenjtë. Brezi juaj i mëparshëm debatikas e kreu me nder e lavdi detyrën e vet, prandaj dhe mbetet shembull i ndritur për të gjithë moshatarët e tij sot.

Ju, të dashur pionierë, jetoni të lumtur në atdheun tuaj socialist, por Shqipëria nuk ka qenë kështu siç është sot e me tërë këto të mira që gëzojmë. Vetëm duke njohur të kaluarën plot vuajtje e mjerim, kuptohet më mirë madhështia e veprës së Partisë dhe të popullit, socializmi, që po ndërtojmë me forcat tona.

Kujdesi i madh i Partisë ndaj jush nuk rresht kurrë, se te ju ajo shikon punëtorët e bujqit, inxhinierët e agronomët, mjekët e pedagogët, artistët e shkencëtarët e ardhshëm, që do ta çojnë gjithnjë përpara Shqipërinë socialiste dhe do të mbrojnë fitoret e saj.

Partia ka besim se ju, pionierë dhe pioniere, do të përvetësoni me vullnet e pasion dijet që ju jep shkolla e do t'i vini ato në jetë, kudo që ta kërkojnë interesat e lartë të atdheut, se do të bëheni patriotë të zjarrtë e revolucionarë të vendosur për çështjen e madhe të Partisë e të popullit.

Organizata juaj e pionierit, nën kujdesin dhe ndihmën e drejtpërdrejtë të organizatës së rinisë, është si një familje e madhe, ku edukoheni si luftëtarë të ardhshëm për ndërtimin socialist e mbrojtjen e vendit, ku forconi lidhjet shoqërore e dashurinë për njëri-tjetrin. Forcojeni dhe kaliteni këtë frymë të shëndoshë të organizatës suaj. Ruani dhe shtoni respektin që keni për prindërit tuaj, të cilët ju ushqejnë që në vogëli me dashurinë për atdheun e për Partinë, për mësuesit tuaj që ju mësojnë gjuhën tonë të bukur, që tok me fjalën e Partisë ju futin në mendje dituritë.

Të dashur pionierë e pioniere,

Ju sot jeni shumë të gëzuar se festoni 40-vjetorin e themelimit të organizatës suaj. Po sot shumë të gëzuar jemi dhe ne gjyshërit e gjyshet, baballarët e nënat, motrat e vëllezërit tuaj, sepse kjo ditë është edhe festa jonë, festa e gjithë popullit. Ju jeni pranvera e atdheut socialist, jeni ata që do të përtërinin radhët e çelikut të Partisë sonë të lavdishme.

Edhe një herë ju përshëndes me dashuri dhe ju uroj gëzuar festën tuaj të madhe, festën e themelimit të organizatës revolucionare të pionierëve.

Ju përqafoj

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 35 (10 462), 11 shkurt 1982*

## LETËR DREJTUAR DREJTORISË SË MUZEVE

*Gjirokastër*

**10 shkurt 1982**

65 vjet më parë, më 10 shkurt të vitit 1917, në qytetin tonë të lashtë të Gjirokastrës, si një akt politikohistorik me rëndësi të madhe, u çel shkollat qendrore shqipe «Drita». Në kohë shumë të vështira të brendshme e të jashtme për popullin tonë, kjo shkollë, ashtu si simotrat e saj në qytetet e tjera, dha një kontribut të çmuar për përhapjen e gjuhës së ëmbël shqipe, të kulturës sonë kombëtare e të përparimit midis rinisë gjirokastrite dhe për edukimin e saj me ndjenjat e pastra të patriotizmit.

Si bir e si nxënës shkolle i atij qyteti, sot kujtoj me respekt të madh themeluesit, mësuesit e talentuar patriotë e të guximshëm, nxënësit e zellshëm të shkollës qendrore shqipe «Drita» dhe të shkollave të tjera që, krahas mësimin e për-

hapjes së diturisë, në kushte të rënda të pushtimit italian, punuan pa u lodhur e me guxim për të çuar përpara lëvizjet patriotike e demokratike të popullit tonë.

U dërgoj me këtë rast urimet dhe përshëndetjet më të ngrohta e më të përzemërta të gjithë atyre që e presin dhe e përkujtojnë këtë përvjetor me tregimet e tyre nga puna e jeta e kësaj vatre të zjarrtë atdhedashurie, të cilat janë shumë të shtrenjta e të dashura për masat tona punonjëse dhe brezin tonë të ri që Partia i edukon me shumë kujdes edhe me traditat e lavdishme të paraardhësve tanë trima e mendjendritur.

### *Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOQES MARIE BIBA**

*Rrëshen—Mirditë*

**Pogradec, 14 gusht 1982**

E dashura Marie,

Jam shumë i gëzuar sot që të shkruaj këtë letër me rastin e martesës tënde me shokun Zef Prenga. Ju uroj nga zemra të trashëgoheni, të kaloni një jetë të gëzuar e të lumtur, plot suksese në punën tuaj dhe në detyrat që ju kanë ngarkuar Partia e populli.

Po ashtu jam shumë i gëzuar për Mrikën, e cila si burrneshë mirditore dhe shoqe e denjë e shokut tim të paharruar, Heroit të Popullit, Bardhok Bibës, të rriti dhe të edukoi me frymën e besnikërisë ndaj popullit, për të cilin ra babai yt i shtrenjtë.

Partia dhe unë s'e harrojmë kurrë sakrificën e madhe dhe kontributin e Bardhokut në ngritjen

e mirditorëve trima në luftën çlirimtare kundër pushtuesve e bajraktarëve kriminelë.

I pashlyeshëm do të jetë kujtimi im kur erdha e u takova me gjyshin tënd. Ishin kohë të vështira, por ai më shtrëngoi në kraharor dhe më tha se më kishte si Bardhokun. Duke ndenjtur afër njëri-tjetrit, ti në atë kohë ishe shumë e vogël, të mora në prehër dhe, kur dolëm jashtë me plakun e Mrikën, të mora në krahë dhe bëmë fotografi. Do të jetë një kënaqësi e madhe për mua që, ashtu siç të mora ty në krah, kur të vij herë tjetër në Mirditë të përkëdhel fëmijët e tu.

Do të merrja pjesë me gëzim në dasmën tënde, por duke qenë larg, po të dërgoj djalin tim të madh me gruan e tij.

Shumë të fala Mrikës, dhe ju, çiftin e ri, ju përqafoj.

Juaji

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË TIPIT TË LARTË TË SOFRATIKËS

*Gjirokastër*

**27 janar 1983**

Të dashur shokë kooperativistë e kooperativiste, specialistë e kuadro,

S'janë mbushur akoma 5 vjet nga vizita që bëra në Dropull dhe kam dëshirë të madhe të vij përsëri pranë jush, të çmalle me njerëzit aq të dashur e patriotë minoritarë, të shoh fshatrat e bukura të krahinës suaj dhe realizimet, për të cilat më shkruani gjerësisht në letrën që më dërguat. I kam ndjekur dhe i ndjek vazhdimisht me interesim arritjet tuaja dhe sa shumë gëzohem kur dëgjoj që gjithë vëllezërit e motrat minoritarë dhe ata dropullitë, realizojnë e tejkalojnë planet, shtojnë të ardhurat, ngrënë nivelin e jetesës e të kulturës, jetojnë të lumtur në atdheun tonë

socialist. Këto arritje dhe zotimet që keni marrë ju, motra e vëllezër të kooperativës bujqësore të tipit të lartë të Sofratikës për këtë vit, janë fryt i mençurisë dhe i punës suaj të palodhur, i mobilizimit të gjithanshëm për të kryer detyrat e mëdha që shtroi Kongresi i 8-të i Partisë. Përparimet tuaja, jeta e re dhe optimizmi revolucionar që ju karakterizon, e kanë burimin te besimi i patundur që keni ju në vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë.

Sukseset dhe fitoret tuaja, ashtu si të mbarë popullit tonë, janë arritur nën udhëheqjen e urtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, ato janë dëshmi e gjallë e vijës dhe e qëndrimit të saj internacionalist marksist-leninist, janë rezultat i qenies së popullit në pushtet. Si gjithë populli ynë edhe ju, motra e vëllezër të Sofratikës, jeni në pushtet. Dihet se pa popullin në fuqi s'ka jetë të lumtur, nuk ka liri, nuk ka demokraci proletare, nuk mund të mbrohen të drejtat e njeriut. Kujtdo që do të përpiqet t'i prekë këto, i bini pa frikë, se keni kurdoherë pranë Partinë e Punës, udhëheqësen e mençur të mbarë popullit shqiptar dhe tuajën, e cila mendon e vigjilon për të mirën e përgjithshme. Këtë të gjithë ju e dini dhe e shihni përditë, prandaj forcojeni organizatën tuaj të Partisë në kooperativë me njerëzit më të vendosur e më trima, më të zgjuar, më punëtorë e më të zotë, mbushini këshillat popullore dhe kryesitë e kooperativave me vajza dhe djem nga më të mirët e minoritetit, pse kështu

punët do t'ju ecin më mirë, Partia e pushteti do të forcohen, ekonomia juaj kooperativiste do të shënojë nivele më të larta zhvillimi.

Partia vazhdimisht është kujdesur që ju të mësoni mirë e ta zhvilloni gjuhën e bukur greke, që është gjuha juaj amtare. Të gjithë ju, kooperativistë e kooperativiste, kuadro e specialistë, mësues e nxënës vazhdoni të punoni pa u lodhur për të njohur e përsosur më tej krahas gjuhës edhe zakonet e mira, këngët e vallet aq të bukura, folklorin e pasur dhe gjithçka të mirë që ka krijuar e krijon, si kudo në vendin tonë, populli i talentuar i minoritetit. Për çdo gjë që ka të bëjë me zhvillimin e gjuhës suaj amtare, të traditave e të folklorit, të nevojave tuaja arsimore e kulturore, për botimin e këtyre pasurive me vlerë, ju do të keni si kurdoherë ndihmën dhe përkrahjen e pakursyer të Partisë dhe të pushtetit popullor. Gjëra çdo ditë e më të bukura, begati më të mëdha do të krijojë në të ardhmen Partia si për mbarë popullin, edhe për ju.

E hidhur ka qenë jeta e punonjësve tanë në të kaluarën, të cilën ju, për të mos e harruar, me të drejtë, e keni futur në muze. Ajo tanimë i takon historisë, prandaj çdo orvatje e armiqve të klasës, të brendshëm e të jashtëm, për ta ringjallur, do të dështojë. Megjithatë ne e dimë se armiqtë nuk do të pajtohen kurrë me realitetin tonë socialist dhe s'do të heqin dorë asnjëherë nga synimi për të na përçarë e dobësuar, prandaj e mbajmë të fortë diktaturën e proletariatit, kur-

doherë i mbajmë sytë hapur dhe barutin të thatë. Nuk do të lejojmë të rikthehet kurrë më e kaluara e zezë në vendin tonë. Garanci për këtë janë populli dhe Partia, tek uniteti i të cilëve do të thyejë kokën, si ka ndodhur gjer tani, çdo armik.

Luftërat kundër armiqve të përbashkët, pushtuesve të huaj dhe klasave sunduese, që na pinin gjakun, i kanë lidhur ngushtë si mishi me thoin, popullin shqiptar dhe atë minoritar grek. Kjo dashuri e singertë vëllazërore është kalitur e çelikosur gjithnjë më lart nga Partia, si gjatë Luftës së madhe Nacionalçlirimtare, ashtu edhe gjatë këtyre gati katër dekadave të ndërtimit të socializmit. Bashkë luftuan dhe bashkë fituan lirinë, shqiptarë e minoritarë, morën në duart pushtetin, siguruan lirinë e pavarësinë e atdheut, jetën e lumtur socialiste.

Forconi unitetin me njëri-tjetrin, duajeni kurdoherë Shqipërinë dhe popullin shqiptar me po atë dashuri të zjarrtë që ju karakterizon, se dhe ai ju do gjithashtu me po atë zjarr e dashuri, shtrëngoni radhët, shqiptarë e minoritarë, sepse, duke ecur krah për krah njëri-tjetrit, përparon e lulëzon mbarë vendi ynë, ndërtohet socializmi, zbukurohet shpirti i njerëzve, Shqipëria bëhet e pamposhtur. Duajeni popullin vëlla grek, të cilin edhe populli shqiptar e do dhe e respekton. Ne si kurdoherë ia duam të mirën popullit grek, ashtu siç na e do dhe ai.

Edhe një herë ju përgëzoj për sukseset e arritura dhe për objektivat që i keni vënë vetes

për këtë vit. Kam bindjen se ju, që e keni tre-  
guar vazhdimisht me prova patriotizmin socialist  
dhe dashurinë e vullnetin e pamposhtur për punë  
e jetë gjithnjë më të mirë, me mendjen e punën  
tuaj të palodhur, do ta renditni kooperativën tuaj  
ndër më të dalluarat në republikë. Dalshi gjith-  
monë faqebardhë!

LETËR DRELTUAR  
SHOKUT ALEKS ÇAQI

Juaj

*Enver Hoxha*

Tirana

18 mars 1983

«Dy popuj miq», f. 353

I dashur shoku Aleks,

Të falënderoj për letrën që më dërgove këto  
ditë. U gëzova shumë që vazhdon ai kurdoherë i  
palodhur t'u japësh popullit dhe Partisë sonë të  
dashur krijime me vlerë.

Më shkruan se flokët të janë zbardhur, me-  
gjithatë zemrën e ke njiëlloj si në ditët e rinisë.  
Kjo ka rëndësi se zemra na jep jo vetëm gjakun e  
domosdoshëm për jetën, por edhe na frymëzon me  
xjarrin e pashuar të atdhedashurisë, me besnikë-  
rinë ndaj popullit që na lindi.

Ti, Aleks, si një poet i atimuar e i dashur i  
Partisë, i popullit, i atdheut dhe i socializmit,  
përsëri gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, përveç pu-  
shkës, në shërbim të popullit e të Partisë, vure

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT ALEKS ÇAÇI**

*Tiranë*

**18 mars 1983**

I dashuri shoku Aleks,

Të falënderoj për letrën që më dërgove këto ditë. U gëzova shumë që vazhdon si kurdoherë i palodhur t'u japësh popullit dhe Partisë sonë të dashur krijime me vlerë.

Më shkruan se flokët të janë zbardhur, megjithatë zemrën e ke njëlloj si në ditët e rinisë. Kjo ka rëndësi se zemra na jep jo vetëm gjakun e domosdoshëm për jetën, por edhe na frymëzon me zjarrin e pashuar të atdhedashurisë, me besnikërinë ndaj popullit që na lindi.

Ti, Aleks, si një poet i afirmuar e i dashur i Partisë, i popullit, i atdheut dhe i socializmit, qysh gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, përveç pushkës, në shërbim të popullit e të Partisë, vure

edhe penën dhe shkrove vjersha të bukura. Me të njëjtën forcë, me të njëjtën dashuri, me të njëjtën rrahje të zemrës shkrove dhe vazhdon të shkruash edhe sot, siç e tregon edhe tufëza me vjersha të pabotuara, «Bisedë me diellin», që më dërgove.

Kam bindjen se mellani yt do të vazhdojë, ashtu si deri më sot, të radhisë edhe në të ardhmen vargje pas vargjesh të shkurtra, por të fuqishme e të bukura, që do ta pasurojnë akoma krijimtarinë tënde për edukimin revolucionar të punonjësve dhe të brezit tonë të ri.

Të uroj shëndet dhe zemra të këndoftë si kurdoherë.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT NIKOLLA BEROVSKI**

*Tiranë*

**25 mars 1983**

I dashur Nikolla,

E mora përkthimin e librit «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë» që ke bërë në gjuhën maqedonase. Jam shumë i gëzuar që këtë punë e ke bërë ti, një nënshtetas shqiptar me kombësi maqedonase. Për këtë të përgëzoj nga zemra, në të njëjtën kohë shpreh bindjen se edhe në të ardhmen, vëllezërve e motrave të tu të së njëjtës gjuhë do t'u shërbesh duke përkthyer vepra të tjera politike e letrare.

Maqedonasit, që jetojnë me shqiptarët në atdheun e tyre të përbashkët socialist, kurdoherë janë gjendur e gjenden pranë njëri-tjetrit. Partia jonë, duke zbatuar me vendosmëri marksizëm-leninizmin, kurrë nuk i ka parë ata si njerëz të

huaj e të përbuzur, por i ka konsideruar si vëllezër të shqiptarëve me të drejta plotësisht të barabarta. Prandaj midis shqiptarëve e maqedonasve sot në epokën e Partisë ekzistojnë lidhje të tilla të thella, të cilat nuk mund t'i prishë asnjë armik.

Me kujdesin e Partisë dhe me përkrahjen e gjithë popullit shqiptar, fshatrat maqedonase, dikur të prapambetura e të mjeruara, kanë përparuar. Jeta në to ka ndryshuar rrënjësisht. Fshatarët me punën e djersën e tyre kanë ndërtuar shtëpi të reja, ndërsa shteti ka ngritur shkolla, qendra shëndetësore e kulturore, një rrjet të gjerë tregtar etj. Shumë bij e bija maqedonase janë në udhëheqje të organeve të Partisë e të pushtetit, sa e sa të tjerë, krah për krah me shqiptarët, japin ndihmën e tyre në të katër anët e atdheut, ecin e do të ecin përpara në rrugën e ndritur të socializmit, të përparimit e të begatisë së mbarë atdheut tonë dhe të mirëqenies personale të secilit.

Duke përfunduar, i dashur Nikolla, të uroj shëndet, gëzime e lumturi në jetën familjare dhe suksese në punë.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR KOOPERATIVISTËVE DHE PUNËTORËVE TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE**

**16 korrik 1983**

Të dashur shokë dhe shoqe, kooperativistë e punëtorë të ndërmarrjeve bujqësore, mekanizatorë, kuadro e specialistë të bujqësisë,

Nga plenumet e aktivet e komiteteve të Partisë të shumë rretheve këto ditë kam marrë mjaft letra e telegrame për plotësimin dhe tejkalimin e planit të prodhimit të grurit për këtë vit dhe për të tre vjetët e këtij pesëvjeçari të marrë së bashku. Këto arritje na gëzojnë pa masë të gjithë, ju dhe mua, popullin dhe Partinë dhe na mbushin me besim për arritje akoma më të mëdha, edhe në të gjitha prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju përgëzoj për këtë fitore dhe ju uroj nga zemra

suksese të reja në plotësimin e detyrave të mëdha që shtroi Kongresi i 8-të i Partisë.

Rezultatet e arritura në prodhimin e grurit dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme për vijën revolucionare që ka ndjekur dhe ndjek Partia, për politikën e drejtë agrare që ajo ka përpunuar dhe zbatuar prej vitesh, për epërsinë e plotë të rendit kooperativist, që çoi fshatarësinë tonë në rrugën e gjerë dhe të ndritur të socializmit.

Partia kurdoherë e ka parë bujqësinë si bazë të ekonomisë sonë socialiste. Ajo ka treguar kujdes të veçantë e të vazhdueshëm për fuqizimin e bujqësisë me njerëz të shkolluar e të përgatitur për zhvillimin e shpejtë e të gjithanshëm të saj dhe për një bazë të fuqishme materiale e teknike, që t'u përgjigjet sa më mirë detyrave. Edhe në të ardhmen ky kujdes do të jetë akoma më i madh, sepse dhe detyrat do të jenë më të mëdha për prodhimin e gjerë socialist të bujqësisë.

Rendimentet mesatare prej 50, 60, 70 e më shumë kuintalë grurë për hektar që arritët ju këtë vit në zonën fushore, veçanërisht në atë me intensifikim me përparësi, janë shumë të larta dhe të nivelit më të përparuar botëror. Ato flasin qartë për mobilizimin e lartë të të gjithë punonjësve të bujqësisë, të udhëhequr nga Partia, për zbatimin e gjerë e të kujdesshëm të shkencës e të agroteknikës në bujqësi, për punën intensive të kërkuesve e shkencëtarëve tanë, të specialistëve e të mjeshtërve të përparuar të prodhimit të grurit.

Nga njoftimet që na vijnë, sivjet pritet të merret një prodhim më i madh se vitin e kaluar e nga planifikimi i këtij viti, jo vetëm për grurin, por edhe për misrin, për fasulen, për luledielli, për ullirin, për pataten, për foragjeret, për perimet, për frutat etj., sepse për të gjitha kulturat është punuar dhe punohet me ndjenjë të lartë përgjegjësie, me organizim e mobilizim më të mirë, me vëmendje të posaçme për realizimin e kërkesave agroteknike e shkencore në bujqësi, për të zbatuar përvojën e përparuar që e kemi kudo e për çdo kulturë. Ky prodhim i mbarë nxjerr detyra të veçanta për administrimin, tregtimin dhe industrializimin e këtyre prodhimeve.

Në të gjitha këto arritje një rol të veçantë kanë pasur dhe kanë organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe të ekonomisë në rreth, si dhe Ministria e Bujqësisë dhe institucionet e saj, të cilat, me këtë rast i përgëzoj dhe shpreh bindjen se do ta ngrenë akoma më lart punën e tyre organizuese e drejtuese, për rritjen e vazhdueshme të prodhimeve bujqësore e blegtorale, që të plotësohen e të tejkalohen, sipas vendimeve të Kongresit të 8-të të Partisë, të gjitha detyrat e planifikuara për vitin 1983 dhe për të tre vjetët e pesëvjeçarit të shtatë.

Të dashur punonjës të bujqësisë,

Nga puna dhe rezultatet e këtij viti ju, Partia, organet drejtuese të shtetit dhe të ekonomisë,

kërkuesit dhe shkencëtarët, specialistët e të gjitha profileve në bujqësi e në blegtori, duhet të nxjerrin mësimë të rëndësishme që të na vlejné për ta çuar gjithmonë përpara prodhimin e zgjeruar socialist në bujqësi.

Kujdesi dhe mbështetja e Partisë asnjëherë nuk do t'ju mungojné. Të ecim përpara, gjithmonë përpara në rrugën ku na udhëheq Partia, për ta bërë jetën tonë sa më të gëzueshme e të begatë, për ta bërë atdheun tonë sa më të fuqishëm e të pathyeshëm.

Duke përfunduar edhe një herë ju përgëzoj për fitoret e arritura dhe ju uroj të mbyllni me sukses detyrat e këtij viti.

12 Gusht 1983

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,*

*nr. 172 (10 914), 17 korrik 1983*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
ISH-PARTIZANËVE E KUADROVE  
TË BRIGADËS SË PARË SULMUESE  
E PJESEMARRËSVE NGA KRAHINA E  
VITHKUQIT DHE E RRETHIT TË KORÇËS**

**12 gusht 1983**

Të dashur shokë e shoqe,

Ndiej një kënaqësi të veçantë t'ju përshëndes nga zemra në këtë ditë të shënuar, kur ju jeni mbledhur për të festuar 40-vjetorin e krijimit të Brigadës së Parë Sulmuese. Më duket sikur jam edhe unë aty, në gjirin tuaj dhe i urojmë njëri-tjetrit gëzuar festën e brigadës.

Të dyzet vjetët që kanë kaluar qysh atëherë, nuk e kanë shlyer nga kujtesa ime atë ditë gëzimi kur në gjirin e popullit heroik të krahinës së Vithkuqit, nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të

Partisë u inaugurua Brigada e Parë, e përbërë nga bij e bija të zgjedhur nga e gjithë Shqipëria. Atë ditë fusha e Makërzës gjëmoi nga kënga e partizanëve, por shpejt do të gjëmonte edhe nga pushka e tyre kundër fashi-nazizmit. Që kur lindi, brigada u pagëzua në zjarrin e luftës së pabarabartë me armikun, asnjëherë s'u përkul dhe shkroi në historinë e saj faqe të lavdishme. Krahas reparteve e njëjstive të tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dha kontributin e saj të madh në luftën kundër pushtuesve të huaj dhe shërbëtorëve të tyre vendës e deri në triumfin e revolucionit popullor. Në këtë 40-vjetor të saj ne kujtojmë heroizmin dhe sakrificat e efektivit të brigadës, shokët dhe shoqet tona që dhanë jetën e tyre për çlirimin e Shqipërisë. Me dashuri e me respekt të thellë përulemi sot përpara kujtimit të tyre të paharruar.

Të dashur shokë e shoqe,

Armiku i popullit e i Partisë, armiku i atdheut tonë socialist, agjenti i shumëfishtë, Mehmet Shehu, përveç që dëmtoi e sabotoi luftën e Brigadës së Parë, duke vepruar në kundërshtim me urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm, punoi në mënyrë të djallëzuar e me të gjitha mundësitë që të përvetësonte e ta përdorte për qëllimet e veta armiqësore e të egra heroizmin dhe lavdinë tuaj

në luftë. Luftën madhështore të Brigadës së Parë, për shumë kohë ai e paraqiti si veprën e tij personale. Por ajo është në të vërtetë, vepër e trimërisë, e zgjuarsisë, e besnikërisë ndaj Partisë, e devotshmërisë ndaj popullit e atdheut e partizanëve dhe e kuadrove të saj të vërtetë, vepra juaj të dashur shokë e shoqe. Prandaj sot me rastin e 40-vjetorit të krijimit të Brigadës së Parë populli ju kujton me respekt dhe ju përshëndet me gjithë zemër.

Populli ynë i mrekullueshëm, si gjithmonë në unitet të çeliktë rreth Partisë, po bën gjithnjë e më tepër realitet idealet për të cilat luftuan bijtë e tij nga më të mirët, forcon ekonominë socialiste dhe mbrojtjen e atdheut duke realizuar e tejkaluar planet, duke u bërë ballë me heroizëm armiqve të vjetër e të rinj, të brendshëm e të jashtëm, imperialistëve, socialimperialistëve, revizionistëve modernë e agjentëve të tyre në vendin tonë. Si një trup i vetëm ai vigjilon për të mbrojtur fitoret e arritura me shumë sakrifica dhe me gjakun e bijve të vet që u derdh për lirinë dhe për këto ditë të lumtura që gëzojmë sot.

Në emër të Partisë, të Komitetit të saj Qendror dhe në emrin tim, ju dërgoj urimet më të mira, ju përshëndes dhe ju përqafoj të gjithë me mall e dashuri. Qofshi gjithmonë me shëndet të mirë, me zemrën zjarr ashtu si gjatë ditëve të lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, edukatore e frymëzues revolucionarë të atdhedashurisë e

të besnikërisë ndaj popullit e Partisë për brezat  
e ardhshëm.

Rrofshin partizanët dhe kuadrot e ish-Bri-  
gadës së Parë Sulmuese!

Rroftë populli luftëtar i rrethit të Korçës!

Lavdi Partisë sonë të shtrenjtë!

SHQIPTAR

Juaji

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT  
PUNONJËS TË RADIOTELEVISIONIT  
SHQIPTAR**

*Tiranë*

**21 tetor 1983**

Të dashur shokë,

Këto ditë që u zhvillua Festivali Folklorik Kombëtar, megjithëse nuk pata rastin të jem edhe vetë atje, ju më dhatë mundësinë që, nëpërmjet televizionit të jetoja me Gjirokastrën aq të dashur për mua, me sheshin e kalasë, ku arti ynë popullor për 6-7 ditë me radhë manifestoi bukurinë e vitalitetin e vet. Nga ekrani i vogël pashë të shpalosej para syve bota e artit tonë të madh, me të cilin populli ynë, në shekuj, tok me pushkën, ka ruajtur gjuhën, truallin e kombin, ka luftuar e ka fituar.

Bashkë me përgëzimet e përzemërta dhe mirënjohjen e thellë për muzikantët, valltarët e

këngëtarët, për kërkuesit e studiuesit e pasionuar të folklorit tonë, për organizatorët e palodhur të kësaj feste të bukur shqiptare, unë sot dëshiroj t'ju përgëzoj e t'ju falënderoj edhe ju, shokë të Televizionit Shqiptar që, duke mbetur vetë të padukshëm, na sollët në shtëpitë tona e na e bëtë të dukshme atë bukuri tingujsh, ngjyrash e lëvizjesh.

Televizioni, si çdo gjë tjetër në Shqipërinë socialiste, është vepër e Partisë. Ai eci në rrugën dhe në përvojën e pasur të Radio Tiranës, veteranes së nderuar të propagandës sonë, e cila, që nga ditët e para të Çlirimit e vazhdimisht, ka bërë e po bën një punë të lavdëruar për pasqyrimin dhe përhapjen, brenda vendit dhe në botën e jashtme, të luftës dhe të punës sonë, të zërit marksist-leninist të Partisë e të popullit shqiptar.

Ashtu si Radio Tiranës, edhe Televizionit Partia i ka kushtuar kujdes dhe vëmendje të veçantë, nuk ka kursyer dhe nuk do të kursejë asgjë për rritjen e zhvillimin e tij, për perfeksionimin teknik e për ngritjen e nivelit ideoestetik të kuadrove e të programeve televizive. Por mbi të gjitha, në sukseset e televizionit qëndron puna juaj, pasioni, fantazia krijuese artistike, përpjekjet dhe mobilizimi juaj, të cilat kanë bërë e bëjnë që, nëpërmjet ekranit, brenda ditës, të shohim e të njihemi nga afër me punën e madhe, përpjekjet e gjithanshme dhe jetën e bukur e të larmishme të popullit tonë.

Tek ju shkruaj këto pak radhë, nuk mund

të mos kujtoj ato vite pas Çlirimit të atdheut, kur me gëzim të madh lexonim në shtyp ose na raportohej se në atë apo këtë fshat malor vajtën kaq radio me bateri e me vajguri, se u shfaqën kaq filma nga kinematë ambulante që transportohehin me kafshë.

Me luftë e përpjekje përparuam në çdo fushë dhe prej vitesh Partia e socializmi kanë krijuar kushte të tilla, që jo më në qytete, por edhe në çdo fshat të ketë radio me korrent, kinema, shtëpi kulture, librari etj. Në mënyrë të veçantë, sukses i madh është futja kudo e televizorit, nëpërmjet të cilit kushdo mëson ç'bëhet në atdheun tonë e ç'ndodh në botë, shikon filma, koncerte, aktivitete sportive etj. Tash edhe në skajet më të largëta të vendit, në Shishtavec apo Lekbibaj, fshatari brenda ditës sheh grupin artistik të fshatit të tij të japë koncert në Gjirokastër, të gjithë në ekranin e televizorit shohim Shqipërinë tonë të dashur me një bukuri të rrallë natyrore, që dora e mendja e njerëzve tanë po e bëjnë një mrekulli. Ky realitet na frymëzon e na bën optimistë, i mbush me krenari bashkatdhetarët tanë kudo që janë, gëzon miqtë e dashamirët e shumtë të Shqipërisë socialiste.

Siç kam bërë e bëj me Radio Tiranën, çdo ditë ndjek programe të ndryshme që transmetoni dhe kam konstatuar që në shumicën e tyre pasqyrohet me nivel të mirë realiteti ynë socialist, bota e bukur dhe e pasur materiale e shpirtërore e popullit tonë. Në emisionet tuaja pasqyrohet jeta jonë

plot punë krijuese e përpjekje entuziaste, historia heroike e popullit shqiptar, lufta e tij për liri kombëtare e shoqërore, rruga e lavdishme e Partisë sonë të dashur, transformimet kolosale që janë bërë e bëhen çdo ditë nga puna e popullit të udhëhequr me urtësi e largpamësi nga Partia.

Duke ju përgëzuar edhe një herë për punën e sukseset tuaja, shpreh bindjen e thellë se, edhe tash e tutje, ju, punonjësit e Televizionit Shqiptar, do të punoni pa u lodhur për të rritur nivelin ideologjik e politik, shkencor e artistik të programeve tuaja. Të jeni gjithnjë në lartësinë e detyrave që ju ka vënë Partia në edukimin komunist të masave, të ndiqni e të pasqyroni hap pas hapi zhvillimin e vrullshëm të ekonomisë, kulturës, shkencës e artit tonë.

Ju uroj suksese në punën tuaj!

Juaji

Enver

Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 256 (10 998), 23 tetor 1983

**TELEGRAM DËRGUAR  
SHOQES ELIMA LIBOHOVA (SELFO)**

*Tiranë*

**5 nëntor 1983**

E nderuara shoqja Elima,

Është një ngjarje nga më të hidhurat për mua lajmi i vdekjes së Aqifit, bashkëshortit tënd të respektuar, njëkohësisht edhe shokut e mikut tim të vjetër shumë të dashur. Me Aqifin jemi lidhur në shoqëri të ngushtë qysh në vitet e hershme të rinisë në shkollë në Gjirokastrë, në Korçë e vazhdimisht dhe kjo nuk ishte një shoqëri e rastit dhe e përkohshme, po e mbrujtur me ideallet e përbashkëta që na bashkoi tërë jetën, dashuria e thellë që kemi ushqyer për popullin dhe atdheun që kur ishim të rinj, me dëshirë e vendosmëri për t'u shërbyer atyre si në kohën e vështirë të regjimit obskurantist të Ahmet Zogut, më vonë nën shtypjen e egër të okupatorëve të

huaj, ashtu edhe gjatë gjithë periudhës pas Çlirimit të atdheut. Shumë kujtime ruaj e do të ruaj për Aqifin. Ai si patriot i vendosur ishte dhe mbeti nga ata bij të denjë që ia kushtoi të gjitha energjitë çështjes së popullit dhe të atdheut. Ai luftoi tërë jetën në mënyrë të veçantë për edukimin e brezit të ri të Shqipërisë. Plejada të tëra nxënësish nuk do ta harrojnë kurrë edukatorin e papërtuar e të talentuar të tyre, prandaj Partia dhe populli për të cilët ai ushqente një dashuri të madhe, ia çmuan lart meritat e tij në këtë fushë dhe e nderuan me titullin e lartë të «Mësuesit të Popullit».

Marr pjesë në hidhërimin e madh dhe shpreh bindjen se ti do të qëndrosh e fortë për të mposhtur këtë dhimbje të rëndë. Ne, shokët e tij, do të na kesh gjithmonë pranë.

Juaji

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **PËRSHËNDETJE DREJTUAR ISH-PARTIZANËVE E PARTIZANEVE, KUADROVE TË ISH-BRIGADËS V SULMUESE**

Vlorë

19 janar 1984

Të dashur shokë e shoqe,

Ju po përkujtoni 40-vjetorin e Brigadës V Sulmuese, ngjarje kjo me rëndësi të madhe në historinë e Luftës e të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Në këto çaste të gëzuara e prekëse për të gjithë ju, duke sjellë ndër mend shumë gjëra që më lidhin me datën e krijimit të kësaj brigade dhe me gjithë jetën e saj, shpirtërisht e ndiej veten sikur ndodhem edhe unë aty, në mes jush, shoqe dhe shokë veteranë. Me këtë rast ju dërgoj përsëritetjet më të nxehta dhe urimet e Partisë së Punës të Shqipërisë, të Komitetit të saj Qendror dhe të miat.

Brigada V Sulmuese, një nga formacionet e mëdha heroike të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, u mbulua me lavdi në të gjitha luftërat që zhvilloi kundër pushtuesve të huaj e forcave tradhtare vendëse në krahina të Vlorës, të Kurveleshit, të Gjirokastrës, të Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Të gjitha betejat që ka bërë ajo kundër

forcave naziste gjermane, janë një shembull i shpirtit të saj të lartë luftarak.

Në gjirin e Brigadës V Sulmuese kanë bërë pjesë djem e vajza nga më të mirët e Vlorës e të Labërisë, ish-partizane të «Çetës plakë të Vlorës» e të shumë njësive të tjera. Midis tyre ndriti figura e komunistit, e patriotit të flaktë revolucionar, e udhëheqësit të shquar të Partisë e të shtetit tonë, shokut të paharruar Hysni Kapo. Heroi i Popullit Abaz Shehu nuk arriti ta komandojë Brigadën V, ashtu siç ishte vendosur, se ra duke luftuar në këmbë, por Partia komandën ia dha një biri tjetër heroik të Labërisë, shokut Shefqet Peçi. Gjithë brigada njohu, gjithashtu, punëtorin e Partisë, birin e shquar të Vlorës, shokun Manush Myftiu. Nga radhët e saj u ndanë me lavdi heronjtë e popullit Dervish Hekali, Kastriot Muço, Zonja Çurre, Nimete Progonati, Zaho Koka, Laze Nuro, Llambro Andoni, Hysen Cino e dhjetëra e dhjetëra trima e trimëresha të tjerë përpara kujtimit të të cilëve ne përulemi me respekt e mirënjohje të thellë.

Me ndjenja të larta internacionaliste, me të cilat e brumosi Partia Komuniste e populli shqiptar, efektivit i brigadës suaj u hodh me guxim e vrull të papërmbajtur përtej kufijve veriorë të vendit për të luftuar tok me popujt e Jugosllavisë për çlirimin e tyre. Me luftën heroike e gjakun e derdhur nga bijtë e bijat e Brigadës V, të Brigadës VI dhe të brigadave të tjera të Ushtrisë sonë të lavdishme Nacionalçlirimtare, që përbë-

nin dy divizione të plota, u çliruan Kosova dhe krahina në Mal të Zi e Maqedoni. Me luftë ajo ndoqi pushtuesit gjermanë deri në thellësitë e Malit të Zi e në territoret e Sanxhakut të Bosnjës.

Heroizmi dhe internacionalizmi i Brigadës V dhe i brigadave të tjera shqiptare ngriti në këmbë popullin e Kosovës. Me mijëra bij të saj u bashkuan me brigadat tona partizane dhe së toku ndihmuan në krijimin e brigadave të tjera partizane nacionalçlirimtare. Përkrah heroizmit tuaj shkëlqeu dhe heroizmi i gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi.

Në luftërat e përbashkëta, në mes popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë u farkëtua një miqësi që këta nuk do ta harrojnë kurrë, nuk do të harrojnë sakrificat që bëri populli ynë. Ndoskush mund të dojë të hedhë në harresë gjithë ato luftëra e sakrifica të popullit shqiptar, por historia mbetet histori dhe s'të lejon ta injorosh.

Të dashur shokë e shoqe,

Sot, së bashku me ju, sjell ndër mend gjithë atë luftë e sakrifica të popullit heroik të Vlorës e të Labërisë, kujtoj me nderim gjithë ata luftëtarë të shquar, mendoj me respekt për rininë e asaj kohe, të Luftës Nacionalçlirimtare dhe për rininë e sotme, që çelikos çdo ditë e më shumë themelet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Shqipëria socialiste, e udhëhequr nga Partia,

në unitet të plotë me popullin, ka korrur fitore në të gjitha fushat dhe ecën përpara me besim të patundur për një jetë të lumtur. Të gjitha këto fitore janë arritur me sakrifica të panumërta, me punë e djersë, si dhe me luftë të vazhdueshme që nuk do të ndërpritet kurrë kundër armiqve, të jashtëm e të brendshëm, imperialistëve amerikanë, socialimperialistëve sovjetikë, revizionistëve e forcave shoviniste e reaksionare, si dhe shërbëtorëve e veglave të tyre agjenturore brenda vendit, tradhtarë të popullit, të Partisë e të atdheut.

Duke përfunduar, ju them juve, shokë e shoqe të Brigadës V heroike: të jeni kurdoherë në krye të punëve e në sulm në vendet ku ju ka ngarkuar Partia; të jeni besnikë ndaj Partisë e popullit deri në fund të jetës; të jeni të lidhur ngushtë e të dëgjoni me kujdesin më të madh mendimet e dëshirat e popullit. Ky është një mësim i madh që na jep marksizëm-leninizmi, që Partia duhet ta mbajë vazhdimisht të shkruar në mendje e në zemër dhe ta zbatojë çdo ditë.

Ju përqafoj fort

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 20 (11 077), 24 janar 1984*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
ISH-PARTIZANËVE E PARTIZANEVE,  
KUADROVE TË ISH-BRIGADËS VI  
SULMUESE**

*Përmet*

**25 janar 1984**

Të dashur shokë e shoqe,

Me rastin e 40-vjetorit të përrurimit të Brigadës VI Sulmuese, që po e festoni në mes një atmosfere të gëzuar revolucionare, ju dërgoj juve përshëndetjet më të përzemërta të Partisë, të Komitetit të saj Qendror dhe të miat e nëpërmjet jush edhe popullit atdhetar e luftëtar të Përmetit.

Brigada VI Sulmuese u formua nga reparte e njësi luftarake partizane, siç ishin batalionet: «Asim Zeneli», «Abaz Shehu», «Baba Abazi», «Naim Frashëri» e «Zaho Koka» të kalitur në përvojën e betejave të përgjakshme kundër ushtrive pushtuese fashiste italiane e më vonë atyre

gjermane shumë herë më të armatosura e më të mëdha në numër. Shembull trimërie e guximi do të mbeten luftimet që kurorëzoi me sukses brigada juaj për çlirimin e Luginës së Vjosës, të krahinës së Lunxhërisë, Rrëzomës, Tepelenës, Kurveleshit, Mavrovës e Patosit e shumë beteja të tjera në Shqipërinë e Mesme dhe në atë të Veriut.

Brigadës suaj Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, tok me njësi të tjera, i ngarkuan edhe detyrën shumë të rëndësishme ushtarako-politike: të mbronte Përmetin në kohën kur aty zhvilloi punimet Kongresi i Parë historik Antifashist, detyrë, që, ashtu si gjithë të tjerat, ajo e plotësoi me heroizëm e vetëmohim, duke dhënë kështu ndihmën e saj të çmuar për mbrojtjen që në hapat e parë të pushtetit tonë popullor.

Populli ynë i kujton me nderim ish-partizanët e partizanet e Brigadës VI që bënë sakrifica të panumërta e heroizma, shumë prej të cilëve derdhën dhe gjakun për fitoren e lirisë e të revolucionit popullor. Ai kujton me respekt komandantin e saj sypatrembur, Heroin e Popullit, Labin e Kuçe, Jaho Gjolikun, komisarin e revolucionarin trim, Heroin e Popullit Mustafa Matohitin, zëvendëskomisarin dhe punëtorin e shquar të Partisë për një periudhë shumë të gjatë anëtar i Byrosë Politike shokun Haki Toska, bijtë e nënave, heronj të popullit si: Çelo Sinani, Persefoni Kokëdhima, Meleq Gosnishti, Mitro Xhani,

Lefter Talo, Fato Berberi e sa e sa dëshmorë të tjerë.

Bashkë me njësi të tjera të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, edhe efektiv i brigadës suaj, i inkuadruar në gjirin e Divizionit VI, plotësoi me ndërgjegje të lartë e ndjenja të pastra internacionaliste detyrën që i caktoi Partia për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë nga armiku ynë i përbashkët nazizmi gjerman e shërbëtorët e tij.

Të dashur shokë e shoqe,

Për të fituar lirinë dhe vendosjen e pushtetit të vet, popullit tonë i është dashur të bënte shumë sakrifica e të derdhte lumenj gjaku. Sot, për të mbrojtur atdheun socialist e fitoret e arritura nga synimet e armiqve të jashtëm, imperialistët, socialimperialistët e reaksioni ndërkombëtar, si dhe nga shërbëtorët e tyre të brendshëm, tradhtarë të Partisë e të atdheut, atij i duhet të punojë me ndërgjegje të lartë revolucionare në rrugën ku e udhëheq me urtësi Partia jonë e lavdishme e Punës, të mbajë kurdoherë lart vigjilencën revolucionare dhe të forcojë pa ndërprerje fuqinë mbrojtëse të vendit. Në këto drejtime shembulli i lartë i heroizmit dhe i vetëmohimit i partizanëve e i partizaneve heroike, siç kanë qenë edhe ata të brigadës suaj, ka qenë e mbetet burim i pashtershëm frymëzimi.

Le të mobilizojmë të gjitha forcat për ta

pritur 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut me arritje të reja në të gjitha fushat, të bashkuar si grusht celiku rreth Partisë e Komitetit të saj Qendror.

Edhe një herë, shokë e shoqe, gëzuar festën e 40-vjetorit të Brigadës VI.

Ju përshëndes e ju përqafoj të gjithë

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 26 (11 083), 31 janar 1984*

## **PËRSHËNDETJE DREJTUAR EFEKTIVIT TË GARDËS SË REPUBLIKËS**

**12 shkurt 1984**

Të dashur shokë ushtarë, nënoficerë e oficerë të Gardës së Republikës,

Jam shumë i gëzuar që me rastin e 40-vjetorit të krijimit të repartit tuaj, të Gardës së Republikës, t'ju dërgoj sot, në këtë ditë të shënuar për ju, përshëndetjet e zjarrta dhe urimet më të mira të Partisë, të Komitetit Qendror dhe të miat.

Garda e Republikës, pjesëtare e denjë e forcave të armatosura të vendit tonë, e krijuar në zjarrin e Luftës së madhe Nacionalçlirimtare nga bij trima e të vendosur në betejat fitimtare kundër pushtuesve nazifashistë e tradhtarëve të vendit, gjatë këtyre 40 vjetëve ka kryer me besnikëri detyrën fisnike me shumë përgjegjësi që i është ngarkuar, sigurimin e organeve udhëheqëse të Partisë së Punës e të shtetit tonë socialist.

Fitorja e madhe historike mbi pushtuesit nazifashistë, përmbysja e klasave shfrytëzuese dhe vendosja e pushtetit popullor në vendin tonë, i tërbuan armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, që donin ta kishin Shqipërinë si bazë për qëllimet

e tyre reaksionare e kundërrevolucionare. Për këto arsye si imperialistët, socialimperialistët, revizionistët e gjithë forcat e tjera reaksionare, nuk e kanë pushuar kurrë luftën për të thurur e organizuar gjithfarë intrigash e komplotesh, duke filluar që nga ato të drejtuara nga agjenti i ulët i titistëve jugosllavë, Koçi Xoxe e deri tek tradhtarët e urryer, në shërbim të disa agjenturave imperialisto-revizioniste, Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu e të tjerë. Por përpjekjet e tyre nuk i shpëtuan asnjëherë syrit vigjilent të Partisë. Ajo në unitet bashkë me popullin tonë patriot e liri-dashës e bijtë e tij, siç jeni ju, bëri të dështojnë gjithë planet e tyre djallëzore për të goditur udhëheqjen e Partisë e të shtetit tonë, për të rikthyer rendin borgjezo-kapitalist në Shqipëri.

Të dashur shokë ushtarë e kuadro të Gardës së Republikës,

Në këto situata, kur imperialistët e të gjitha ngjyrave, në radhë të parë të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, si dhe shtete të tjera imperialiste, kërcënojnë botën me shpërthimin e një lufte të re, ju, ashtu si mbarë ushtria e forcat tona të armatosura, si gjithë populli ynë ushtar, po punoni çdo ditë me këmbëngulje për edukimin tuaj ideologjik e politik me mësimet e Partisë, për rritjen e vigjilencës revolucionare, për kalitjen fizike dhe gatishmërinë ushtarake.

Për Unë, personalisht, prej një kohe të gjatë jam dëshmitar i vetëmohimit dhe i vendosmërisë suaj që ditën dhe natën, në kohë të mirë e të keqe, në të ftohtit e dimrit e zhegun e vapës, vigjiloni e zbatoni me ndërgjegje të lartë detyrat, duke shprehur me këtë besnikërinë e pakufishme ndaj Partisë, dashurinë e thellë për atdheun e për popullin, duke qëndruar të gatshëm e sypafjetur në çdo kohë, për të dhënë edhe jetën në mbrojtje të interesave të tyre të lartë. Prandaj Partia dhe udhëheqja e saj i çmon lart këto virtyte që ju karakterizojnë dhe shpreh bindjen se ju, si kurdoherë, do të punoni e do të luftoni edhe në të ardhmen për të kryer me përpikëri detyrat që ju ngarkojnë Partia dhe komanda.

Gëzuar, shokë, festën e 40-vjetorit të krijimit të Gardës së Republikës! Ju uroj suksese në detyrat e ngarkuara.

Ju përshëndes

Juaji

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i KQ të PPSH  
dhe Komandant i Përgjithshëm  
i Forcave të Armatosura të RPSSH

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË SHOKUT VASIL NATHANAILI**

*Tiranë*

**13 prill 1984**

E dashur shoqe Kleopatra,

Lajmi i vdekjes së bashkëshortit tuaj të dashur, babait të Petritit e të Zanës, shokut besnik e mikut tim të vjetër të luftës, Vasilit, më hidhëroi shumë. Ty dhe fëmijëve ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta.

Vasili njihet si një nga komunistët militantë të vendosur të organizatës luftarake të Partisë për Tiranën në periudhat e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare që ka kryer me besnikëri detyrat me përgjegjësi që i qenë ngarkuar. Pas Çlirimit ai punoi gjithashtu pa u lodhur me ndërgjegje të lartë e devotshmëri. Në çdo rast ai ka përfaqësuar me dinjitet shtetin tonë dhe ka mbrojtur me vendosmëri vijën marksiste-leni-

niste të Partisë. Ai do të jetë i paharruar jo vetëm për ju, po për gjithë ne, shokët e tij të luftës e të ndërtimit të socializmit.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
PJESËMARRËSVE NË FESTIMIN  
E 40-VJETORIT TË KONGRESIT  
TË PËRMETIT**

**23 maj 1984**

Të dashur shokë e shoqe, vëllezër e motra,

Me mendje e me zemër sot jam pranë jush, përmetarëve trima, atdhetarë e punëtorë, në mes ish-delegatëve që populli e Partia 40 vjet më parë na dërguan atje me një mision të lartë historik; në mes ish-partizanëve heroikë që ato ditë e kthyen Përmetin në kala të pakapërcyeshme. Me këtë rast ju përshëndes me mall dhe ju ftoj të brohorasim përsëri si në 24 majin e paharruar të 1944-ës:

Rroftë Kongresi historik i Përmetit! Rroftë Shqipëria jonë e shtrenjtë! Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Jeta e re që ndërtojmë dhe gëzojmë, socializmi që marshon fitimtar në Shqipëri, prestigji

dhe autoriteti i lartë që gëzon atdheu ynë kudo në botë, i kanë themelet e veta te lufta e madhe popullore që udhëhoqi Partia, pjesë e së cilës ishte edhe Kongresi i Parë Antifashist Nacional-çlirimtar i popullit shqiptar, emri i të cilit do të jetë përherë i lidhur me emrin e qytetit tuaj.

Në Përmetin martir, të djegur tri herë nga gjermano-fashistët, por tashmë të lirë, në Përmetin e luftëtarëve të penës e të pushkës, Frashërlinjve të shquar Samiut, Naimit e Abdylit, përfaqësuesit e ligjshëm të popullit shqiptar, të ardhur drejt e nga betejat e përgjakshme për çlirimin e atdheut, vulosën dhe shpallën botërisht vullnetin e popullit për krijimin e Shtetit Shqiptar të Demokracisë Popullore dhe e pajisën këtë me Qeverinë e vet të ligjshme.

Kjo fitore e jashtëzakonshme, e paparë kurrë në historinë shekullore të popullit shqiptar, kurorëzoi një herë e përgjithmonë politikën largpamëse e shpëtimtare të Partisë sonë Komuniste, e cila, luftën për çlirimin e atdheut e kishte lidhur e shkrirë në një me luftën për përmbysjen e pushtetit të vjetër dhe krijimin e pushtetit të ri. Në Përmet populli erdhi në fuqi, u bë zot i fateve të veta, hapi një epokë të re, epokën e socializmit. Shqipëria e re, me vendimet historike të Kongresit të Përmetit dhe me të drejtën e saj sovrane, përmbysi të kaluarën e hidhur të mbretërve e të feudalëve, grisi e vërviti në Vjosë traktatet e marrëveshjet skllavëruese të së kaluarës, u tha «ndal» një herë e përgjithmonë lakmive të atyre

që kishin synuar për të zhvatur nga një copë Shqipëri, u tha «ndal» atyre që në kurriz të Shqipërisë synonin të luanin politikën e zonave të influencës, të turbullirave e të armiqësisë me popujt. Në Shqipërinë e re këto s'do të shkonin më kurrë, se tash ajo kishte zot popullin, në krye kishte Partinë e vet të lavdishme, në komandë kishte sjellë bijat dhe bijtë e vet legjitimë, trima e revolucionarë.

Me emocione të thella e me krenari të ligjshme, tash, nga lartësia e 40 vjetëve, ne shohim se gjithçka u vendos e u nis në majin e 1944-ës në Përmet, është zbatuar, mbrojtur e zhvilluar më tej me konsekuencë, me mençuri e me heroizëm të përditshëm. Janë bërë këto me djersë, përpjekje e sakrifica të mëdha, pa i shtrirë dorën askujt, pa i rënë në qafë askujt dhe pa lejuar asnjëherë dhe askënd, armik të brendshëm apo të jashtëm, fuqi të madhe ose të vogël, imperialiste, socialimperialiste apo shoviniste, të na prekë fitoret e arritura, të na devijojë nga rruga jonë revolucionare. 40 vjetët që kaluan janë në këtë drejtim edhe një shkollë e lavdishme e revolucionit tonë fitimtar, edhe një garanci e madhe se kështu do të ecim sot, nesër e kurdoherë ne, bijat e bijtë tanë, gjithë populli ynë i mreku llueshëm.

Prandaj le të vazhdojmë kurdoherë ballë-lart, shokë e bashkëluftëtarë të mi të shtrenjtë, ish-delegatë të Kongresit të Parë Antifashist të Përmetit, ta forcojmë e ta çojmë më përpara

veprën e madhe e të pavdekshme që nisëm më 24 maj 1944.

S'ka gjë se na kanë mbuluar thinjat e rru-dhat. Ne mbetemi të rinj, se jetojmë, punojmë e gëzojmë në mes rinisë së përjetshme të atdheut, se të reja janë e do të jenë idealet dhe vepra jonë, se e re është e do të jetë kurdoherë Shqipë-ria socialiste!

Ju përshëndes të gjithë!

Gëzuar festën e Kongresit historik të Për-metit!

Rroftë populli!

Rroftë Partia!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 125 (11 182), 25 maj 1984*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
ISH-DELEGATËVE TË KONGRESIT TË PARË  
TË BRASH-IT**

**7 gusht 1984**

Të dashur shokë e shoqe, ish-delegatë të Kongresit të Parë të BRASH-it,

Gëzuar festën e 40-vjetorit të Kongresit të Parë të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare!

Ju përshëndes ju, ish-delegatët e delegatet në këtë Kongres, si dhe përfaqësuesit e brezave të rinj që bashkë me ju kanë ardhur në Helmës të marrin pjesë në këtë festë të shënuar. Do të dëshiroja shumë të isha edhe unë në mes tuaj atje, ku 40 vjet më parë punuam për disa muaj në gjirin e popullit trim, patriot e bujar jo vetëm të këtij fshati, por të të gjitha atyre anëve të rrethit të Skraparit.

Ju kam zili që jeni mbledhur në fushën e

bukur të Lirëzës. Kam në sy dhe në mendje ato çadra të bardha të mbira nëpër fusha, «sallën» e Kongresit, që ndonëse nuk ishte si sallat e sotme të pallateve të sportit, kishte bukurinë e vet me ata drunj, stola e tavolina që mbanin akoma aromën e këndshme të atyre maleve. Por e ndiej dhe gëzohem me gëzimin tuaj. Qofshi përherë të gëzuar, sepse gëzimin e lumturinë i meritoni si ju, ish-delegatët dhe delegatet, ashtu dhe gjithë rinia jonë e mrekullueshme.

Ju vinit në atë gusht të paharruar në Kongresin tuaj, raportoni për luftërat heroike që kishit zhvilluar dhe zotoheshit se do t'i çonit gjer në fund betejat për çlirimin e plotë të vendit dhe ndërtimin e Shqipërisë së re. Fjalën e mbajtët: në atdheun e lirë ndërtuat hekurudha e uzina, ngritët e drejtuat shkolla, u bëtë kuadro dhe shërbyet në frontet e ndryshme për forcimin e Partisë, të pushtetit popullor dhe të ushtrisë sonë.

Qindra mijë të rinj të tjerë kanë ecur e po ecin sot në rrugën që udhëheq Partia, në rrugët që hapët ju dhe shokët tuaj heroikë si: Qemal Stafa e Misto Mame, Manush Alimani e Kastriot Muço, Margarita Tutulani, Ajet Xhindoli e shumë të tjerë që dhanë jetën për këto ditë të lumtura.

Nga Kongresi në Kongres Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë ka ardhur me realizime të reja në fushën e zhvillimit industrial, bujqësor, arsimor, politiko-ideologjik dhe kulturor-shkençor. Ne jemi krenarë për rininë tonë gjithmonë

të guximshme, këmbëngulëse në punë e në mësim, vigjilente në mbrojtjen e fitoreve të socializmit e të marksizëm-leninizmit. Ne kemi një rini të pastër si ajri dhe ujët e kristaltë të maleve ku jeni mbledhur. E tillë do të mbetesh përherë ti, rini e mrekullueshme e Shqipërisë, e shëndoshë, energjike dhe revolucionare, e imunizuar nga çdo sëmundje që ka kapërthyer kontingjente të tëra të rinisë së vendeve kapitaliste e revizioniste.

Shokë dhe shoqe,

Ju festoni 40-vjetorin e Kongresit të Parë të organizatës suaj luftarake në atmosferën revolucionare që ka përfshirë klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste, rininë, gratë, të madh e të vogël në vendin tonë, për ta pritur 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut e të vendosjes së pushtetit popullor me arritje sa më të mëdha. E bashkuar më shumë se kurrë rreth Partisë, rinia jonë shkon në festën e madhe të 40-vjetorit të Çlirimit krenare e me plot fitore, e gatshme për t'iu futur betejave të tjera të mëdha. Partia i ka besuar rinisë detyrën historike: stafetën e revolucionit e të socializmit, të mbrojtjes me vigjilencë e me gjak të atdheut socialist. Jam i bindur që ju do të qëndroni si gjithnjë luftëtarë të radhëve të para, të lidhur grusht me popullin, trim, të mençur e të papërkulur për zbatimin e mbrojtjen me besnikëri të vijës së Partisë për

ndërtimin e socializmit dhe lumturinë e brezave të rinisë së përzetshme.

Duke ju përqaftuar me dashuri ju uroj të gjithëve shëndet, vullnet në punë dhe në mësim, lumturi në jetë!

Rroftë rinia jonë heroike dhe organizata e saj luftarake e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë!

Juaji

*Enver Hoxha*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
ME RASTIN E 40-VJETORIT TË MBLEDHJES  
SË DYTË TË KËSHILLIT ANTIFASHIST  
NACIONALÇLIRIMTAR**

**21 tetor 1984**

Të dashur shoqe dhe shokë, motra e vëllezër,

Sot, bashkë me ju, ish-anëtarët e Këshillit Antifashist dhe popullin patriot, trim e bujar të rrethit të Beratit, mbarë populli ynë feston 40-vjetorin e Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar që i dha Shqipërisë Qeverinë e Parë Demokratike. Me rastin e këtij përvjetori, nga më të shënuarit në historinë e Luftës së madhe Nacionalçlirimtare të vendit tonë, ju përshëndes dhe ju uroj me gjithë zemër, gëzuar festën.

Katër dekada kanë kaluar nga ajo ngjarje e paharruar historike, por në kujtesë më kanë mbetur të pashlyeshme mbërritja jonë natën vonë në Berat pas dy ditë udhëtimi nëpër malet e Skraparit heroik, mikpritja dhe entuziazmi i pa-

përshkruar i popullit të qytetit tuaj e të fshatrave përreth që mori vesh ardhjen e Komitetit Antifashist dhe të Shtabit të Përgjithshëm, entuziazmi i papërshkruar e brohoritjet e tij të zjarrta për Partinë, për Qeverinë Demokratike, për Shqipërinë e lirë dhe për Ushtrinë tonë të lavdishme Nacionalçlirimtare që na shoqëronin në çdo hap. Në gëzimin e popullit, në këngët, në takimet, në fjalët e përshëndetjet e zjarrta që na drejtoheshin neve, bijve të tij, në ato ditë ngazëllimi të madh, shprehej besimi i patundur tek udhëheqja e Partisë dhe te shteti i ri shqiptar, që i kishte hedhur themelet në Kongresin e Përmetit disa muaj më parë. Ky besim lindi dhe u kalit në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare, në përpjekjet titanike të popullit të udhëhequr me mençuri e guxim revolucionar nga Partia për çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit të ri popullor.

Atmosfera festive e atyre ditëve të zjarrta në Berat reflektohej më mirë se kudo në sallën e thjeshtë të zbukuruar me flamurë, me lule të freskëta e me kurora dafinash, ku zhvilloi punimet mbledhja historike. Entuziazmi dhe brohoritjet e vazhdueshme që shoqëronin diskutimet e shokëve është vështirë të përshkruhen. Ato arritën kulmin kur anëtarët e Këshillit Antifashist, të zgjedhur demokratikisht në Përmet, së bashku me popullin, që mbushte gjysmën e sallës, lozhat dhe galerinë, votuan njëzëri me grushtin lart për shndërrimin e Komitetit Antifa-

shist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike. Kjo ishte shprehje e miratimit të mbarë popullit tonë për veprën e pavdekshme të Partisë, kuro-rëzimi i dëshirave dhe i aspiratave që ai shikonte se ishin duke u bërë realitet në prag të Çlirimit të plotë të atdheut. Ky manifestim i paparë dhe shumë prekës i unitetit të popullit rreth Partisë u tregoi edhe jugosllavëve, anglezëve dhe ameri-kanëve, që në atë kohë fshiheshin nën maskën e shokëve, të miqve dhe aleatëve, se sa të lidhur ngushtë ishin me njëri-tjetrin populli me Par-tinë, prandaj ishte shumë e vështirë, bile e pamun-dur të sabotoheshin fitoret e revolucionit po-pullor në Shqipëri me intrigat, prapaskenat, kër-cënimet, lajkat e premtimet e tyre boshe.

Vendimet historike të Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar përbënin një fitore të madhe politike të popullit tonë, që me gjak e sakrifica, nën udhëheqjen e Partisë, kishte çliruar deri në atë kohë mbi tri të katërtat e Shqipërisë dhe ishin bërë bazë e shëndoshë për fitoren e afërt përfundimtare mbi pushtuesit na-zistë dhe reaksionin e brendshëm. Mbledhja e Beratit vulosi marrjen e pushtetit politik nga ma-sat tona punonjëse, ajo ligjëroi Qeverinë e Parë Demokratike të Shqipërisë së re. Brezat e ardh-shëm nuk do t'i harrojnë kurrë vendimet e saj historike, që forcuan akoma më shumë bazat e pushtetit të ri të lindur në zjarrin e luftës heroike që bëri populli ynë kundër armiqve të egër nazi-fashistë dhe veglave të tyre, borgjezëve, bejle-

rëve, bajraktarëve e agallarëve që kishin tradhtuar interesat e lartë të popullit e të atdheut.

Programi i Qeverisë ishte i ngjeshur me detyra të shumta në kushtet e vështira të asaj kohe, ndaj të gjithë iu përveshëm menjëherë punës për vënien e tyre në jetë. Sa larg jemi sot nga ajo kohë, kur çdo dikaster zinte vetëm një dhomë në shtëpinë në krah të lagjes «Mangalem», por sa të afërta dhe të pashlyera nga kujtesa janë për ne netët pa gjumë, shqetësimet dhe përpjekjet për ta çuar deri në fund luftën për çlirimin e atdheut, për të rimëkëmbur qytetet dhe fshatrat e djegura, ekonominë e shkatërruar nga armiqtë. Na mungonin kuadrot e specialistët, fondet e mjetet, por mbështetja e gjithanshme e popullit dhe vija e drejtë e Partisë na dhanë besim e forcë për të kapërcyer çdo vështirësi, për të zbatuar me sukses brenda një kohe të shkurtër programin e Qeverisë dhe për të bërë realitet, siç ka ndodhur kurdoherë në Shqipërinë socialiste, premtimet e dhëna.

Populli e fitoi, e mbrojti dhe vazhdimisht e ka përsosur pushtetin e vet me luftë. Orvatje të shumta kanë bërë armiqtë e jashtëm, imperialistë e revizionistë, për ta përmbysur ose për ta degjeneruar pushtetin tonë, por buzëqeshjet, kërcënimet e bandat terroriste të dërguara nga jashtë dhe agjentët e infiltruar në radhët tona, të gjithë armiqtë kanë dështuar në përpjekjet e qëllimet e tyre. Pushteti ynë është i pamposhtur, sepse në rojë të tij qëndrojnë vigjilentë dhe në unitet

të çeliktë Partia dhe populli. Nën kujdesin dhe udhëheqjen e drejtë të Partisë ai është demokratizuar, duke luftuar pa ndërprerje çdo shfaqje burokratizmi, liberalizmi e lëshimesh ndaj armiqve të klasës.

Me pushtetin të fortë, me Partinë në ballë, duke zbatuar kurdoherë me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizimit, populli ynë ka bërë realitet amanetin e të rënëve. Për fitoret tona në të gjitha lëmet e jetës, në ekonomi, në arsim, kulturë, shkencë, shëndetësi e mbrojtje e mbi të gjitha në drejtim të formimit të njeriut tonë të ri, ne shkojmë krenarë e duarplot në 40-vjetorin e Çlirimit të Atdheut, që do ta festojmë me madhështi muajin e ardhshëm. Arritjet e Shqipërisë 40-vjeçare socialiste në forcimin dhe revolucionarizimin e Partisë dhe të pushtetit janë baza e fuqishme dhe garancia e sigurt për suksese të reja më të mëdha në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

**Rroftë populli ynë heroik!**

**Rroftë pushteti popullor dhe Partia jonë e lavdishme që na udhëheq nga fitorja në fitore!**

**Juaji**

**Enver Hoxha**

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 254 (11 311), 23 tetor 1984*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
ISH-DELEGATEVE TË KONGRESIT TË PARË  
TË BASHKIMIT TË GRAVE ANTIFASHISTE  
TË SHQIPËRISË**

**3 nëntor 1984**

Të dashura shoqe, nëna dhe motra, ish-delegate të Kongresit të Parë të Bashkimit të Grave Antifashiste të Shqipërisë,

Ju përshëndes me gjithë zemër me rastin e festës së shënuar, 40-vjetorit të Kongresit tuaj të Parë!

Ju, përfaqësueset e grave të të gjithë Shqipërisë, që vinit nga flakët e betejave partizane, nga lufta ilegale dhe nga fshatrat e qytetet e çliruara, u mblodhët 40 vjet më parë në qytetin e Beratit që të konfirmonit edhe një herë me zë të plotë vendosmërinë për të ndjekur me besnikëri deri në fund rrugën e ndriçuar nga Partia e për të shpallur objektivat e organizatës suaj

revolucionare, çlirimin e plotë dhe ndërtimin e atdheut të shkatërruar nga lufta e ashpër me pushtuesit e huaj e tradhtarët e vendit.

Me thirrjen e Partisë ju, luftëtarët e radhëve të para të nënave dhe të grave të vuajtura por heroike shqiptare, u ngritët kundër shtypjes shekullore dhe luftuat përkrah burrave, bijve e vëllezërve tuaj në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare. Kjo luftë legjendare, e udhëhequr nga Partia, që përmbysi botën e vjetër e i solli popullit lirinë, çliroi edhe gruan shqiptare, bëri realitet amanetin e bijave të rëna në altarin e lirisë, të Zonjës, Margaritës, Bules e Persefonit, Shejnazës, Mine Pezës e sa e sa grave e vajzave të tjera, idealin e gjithë nënave dhe motrave tona, që mes terrorit e dhunës së egër të armiqve hapën dyert e shtëpive e i bënë ato strehë për luftëtarët e lirisë, rrokën armët, mbushën rreshtat partizanë dhe u hodhën në sulm kundër pushtuesve nazifashistë e tradhtarëve të vendit.

Mbledhja e Kongresit të Parë të Bashkimit të Grave Antifashiste të Shqipërisë, pas shpalljes së Qeverisë së Përkohshme Demokratike, e cila ligjëroi të drejtat e barabarta të gruas me burrin në jetën politike e shoqërore, pati rëndësi jo vetëm për gruan, por për mbarë popullin tonë. Ky ishte i pari kuvend kombëtar i gruas në historinë tonë mijëra vjeçare, ku kumboi i fuqishëm zëri juaj.

Pas punimeve të Kongresit, ju shoqe ish-delegate, u shpërndatë si shkëndijat anembanë at-

dheut për të vënë në jetë vendimet që u morën, për të hedhur masën e grave e të vajzave në luftën për çlirimin e plotë, rindërtimin e vendit dhe ndërtimin e shoqërisë së re. Me përkrahjen e gjithanshme të Partisë e të pushtetit ju u ngritët me forcë kundër errësirës shekullore e analfabetizmit, kundër çdo pengese e ferre dhe ecët në udhën e ndritur që ju printe Partia, u bëtë luftëtare të jetës së re për tërheqjen e masës së grave në frontin e prodhimit e në veprimtarinë politiko-shoqërore. Figura juaj u rrit e u lartësua me hapat viganë të shoqërisë socialiste që la pas shekujt, sepse në mendjet dhe në zemrat tuaja janë rrënjosur mësimet e Partisë, ka mbetur i shenjtë amaneti i të rënëve.

Sot, pas 40 vjet luftërash e përpjekjesh madhështore për ndërtimin e socializmit, Partia me të drejtë krenohet me gruan shqiptare, që militon, mendon e derdh djersë në të gjitha frontet e punës e të prodhimit, në industri e bujqësi, në shkencë e kulturë, duke vënë të gjitha forcat për jetën e re e të lumtur të ndërtuar me forcat tona. Në luftë për emancipimin e mëtejshëm të saj, gruaja shqiptare po afirmon çdo ditë e më shumë personalitetin e vet në çdo fushë e sektor të veprimtarisë politike e shoqërore të vendit. Me punën e aftësitë e saj ajo, jo vetëm merr pjesë aktive në ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut, por është dhe një nënë e mrekullueshme dhe edukatore e brezit tonë të ri me mësimet e Partisë.

Shoqe të dashura,

Pak ditë na ndajnë nga 40-vjetori i Çlirimit të Atdheut, për të cilin i madh e i vogël janë mobilizuar për ta pritur me sa më shumë arritje, ndaj të rritim shpirtin sulmues e luftarak për të realizuar detyrat e ngarkuara në të gjitha frontet e jetës.

Ju dërgoj me këtë rast të gëzueshëm urimet e mia më të ngrohta për festën tuaj!

8 nëntor 1988

Juaji

*Enver Hoxha*

Gazeta «Zëri i popullit»,

nr. 265 (11 322), 4 nëntor 1984

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
EFEKTIVIT TË SHKOLLËS SË LARTË  
TË BASHKUAR TË OFICERËVE  
«ENVER HOXHA»**

6 nëntor 1984

Të dashur studentë, pedagogë dhe kuadro të Shkollës së Lartë të Oficerëve,

Me rastin e 40-vjetorit të krijimit të shkollës suaj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe timin personal ju përshëndes!

Kanë kaluar 40 vjet nga dita kur në vendin tonë u ngrit kursi i parë i perfeksionimit të oficerëve me kuadro që vinin nga radhët e njëjësive partizane e nga zjarri i Luftës Nacionalçlirimtare, në atë kohë pa shkolla e dije të mirëfillta ushtarake, por me përvojën e pasur të betejave të ashpra e me gëzimin e fitoreve mbi njësitë e mëdha ushtarake të pushtuesve fashistë e nazistë dhe të bandave të tradhtarëve vendës. Ata u bënë kuadrot e parë me arsim ushtarak, që

u vunë në krye të njërive të Ushtrisë sonë të rregullt Popullore.

Partia konstaton me kënaqësi të madhe e me krenari të ligjshme se Shkolla e Bashkuar e Oficerëve, pasardhësja e denjë e atij kursi, si dhe shkollat e tjera ushtarake, janë bërë burimi kryesor i furnizimit të Ushtrisë sonë Popullore me kuadro me përgatitje të lartë ideologjike dhe ushtarake, që njohin mirë kërkesat e Artit Usharak Popullor dhe përdorimin e teknikës luftarake, me disiplinë të fortë e me besnikëri të pafund ndaj popullit e atdheut socialist, të gatshëm për të kryer me ndërgjegje revolucionare çdo detyrë që u ngarkohet. Oficerët që dalin nga këto shkolla kanë dhënë e po japin një ndihmesë të rëndësishme në edukimin ideopolitik, në përgatitjen ushtarake e në modernizimin e forcave tona të armatosura, të pajisura me të gjitha cilësitë e nevojshme, kudo e kurdoherë roja të papërkulura dhe të pamposhtura të kufijve të shenjtë të atdheut, të lirisë e pavarësisë së vendit dhe të pushtetit popullor. Si bij e bija të denja të popullit që i lindi e i rriti, kuadrot e përgatitur në shkollën tuaj punojnë pa u lodhur për çelikosjen e marrëdhënieve kuadro-ushtarë, duke vënë në jetë me këmbëngulje porositë e vazhdueshme të Partisë për të pasur një ushtri të popullit e për popullin në kundërshtim me dëshirën dhe përpjekjet armiqësore e kundërrevolucionare të grupeve puçiste e tradhtarë që kërkonin të krijonin kasta, t'i shkëputnin forcat tona të armatosura

nga Partia e populli dhe t'i hidhnin kundër tyre. Në shkollën tuaj dhe shkollat e tjera ushtarake të vendit tonë, përgatiten kuadro politikë e ushtarakë që stërviten dhe jetojnë krah për krah me ushtarët, pranë qendrave të prodhimit, në shkollat e lira ushtarake, atje ku punojnë, jetojnë e stërviten vetë masat punonjëse.

Shokë e shoqe,

Situatat ndërkombëtare në të cilat jetojmë, komplotet dhe përpjekjet luftënxitëse të imperialistëve, socialimperialistëve dhe të qarqeve të ndryshme reaksionare, kërkojnë nga të gjithë që të rriten vigjilenca revolucionare, gatishmëria ushtarake dhe aftësitë luftarake, për të përballuar e mposhtur çdo armik, ngado që të vijë, për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë, fitoret dhe arritjet në ndërtimin e jetës sonë të re socialiste.

Në këto kushte përpara jush shtrohet detyra të ngrihet në një shkallë akoma më të lartë puna edukativo-mësimore në shkollë, me qëllim që nga auditoret e saj të dalin kuadro të pajisur me mësimet e Partisë e me dijet e shkencës ushtarake marksiste-leniniste dhe të Artit tonë Ushtarak Popullor. Në të njëjtën kohë, përdorimi me efektivitet më të madh i bazave materiale që Partia ju ka vënë në dispozicion, t'ju shërbejë për t'i aftësuar kuadrot e ardhshëm, që të veprojnë më me shkathtësi e zgjuarsi në kushtet e veçanta të terrenit e të motit, të kaliten fizikisht për të

qenë në gjendje të përballojnë çdo vështirësi dhe kërkesë të luftës moderne.

Partia kërkon që të përgatiten kuadro të denjë të Ushtrisë sonë heroike Popullore, të meritojnë besimin që u është dhënë dhe respektin e dashurinë e madhe të masave punonjëse. Ajo është e bindur se shkolla juaj do të vazhdojë edhe në të ardhmen ta kryejë si duhet e me gjithë përgjegjësinë që i takon detyrën shumë të rëndësishme që i është ngarkuar, në përputhje me direktivat e Komitetit Qendror të Partisë e Këshillit të Mbrojtjes dhe në përshtatje me kërkesat e kohës për një ushtri moderne.

Ju uroj gëzuar festën e 40-vjetorit të krijimit të shkollës, suksese në punë, në mësim e në stërvitje, shëndet dhe lumturi në jetë.

Gëzuar gjithashtu jubileun e 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor që do të kremtojmë së shpejti.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Zëri i popullit»,  
nr. 268 (11 325), 8 nëntor 1984*

## **TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË FILE MUSAIT**

*Elbasan*

**15 dhjetor 1984**

Shumë të dashur Kadri, Sefer, Shkëlqim, Shyqyri, Kujtim, Xhevdet, Xhevahire e Behare,

Me hidhërim të madh mësova për vdekjen e mikut e shokut tim të dashur të luftës, babait tuaj të nderuar, trimit të Kishtës, File Musait. Ju dërgoj ngushëllimet më të ngrohta juve dhe të afërmeve të tjerë të familjes. Të rroni vetë, t'ju rrojnë nipërit e mbesat e tij të shumtë, që ai i donte aq shumë dhe i edukoi me dashuri të madhe për Partinë dhe popullin.

Për vete ruaj në mendje kujtime të shumta. Unë nuk do të harroj kurrë mikpritjen, bujarinë dhe zgjuarsinë e këtij burri të urtë e atdhetar të zjarrtë, që gjithë jetën ia kushtoi çështjes së madhe të lirisë e pavarësisë së atdheut, që familjen

dhe gjithë ç'kishte, pa marrë parasysh sakrificat dhe terrorin e egër të pushtuesve të huaj e bandave të tradhtarëve vendës, i vuri në shërbim të Luftës Nacionalçlirimtare dhe deri në fund të jetës i qëndroi besnik Partisë së tij të Punës dhe ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Për patriotizmin e flaktë, urtësinë e ndershmerinë që e karakterizonin, Filja gëzoi kurdoherë dashurinë dhe respektin e merituar të njerëzve të thjeshtë të krahinës së vet e të gjithë Elbasanit, të shokëve e miqve të tij të shumtë, dashurinë dhe respektin tim të veçantë. Prandaj ishte e do të mbetet she-mbull frymëzimi për të gjithë.

Në këto çaste të rënda hidhërimi me zemër ndihem pranë jush dhe marr pjesë në dhimbjen që ju solli vdekja e babait tuaj të dashur. Edhe një herë ju ngushëlloj dhe shpreh bindjen se këtë dhimbje ju do ta ktheni në forcë.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR**  
**NJË ISH-PARTIZANI GREK,**  
**ZOTIT DH. KREMOS**  
**29 dhjetor 1984**

I dashuri mik,

Shoku juaj, Heroi i mirënjohur Kombëtar i rezistencës greke, personalitet shoqëror dhe miku im i nderuar, Manolis Glezos, kur erdhi për të marrë pjesë në festën e 40-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, na dorëzoi një fotografi tuajën dhe studimin me titullin «Shqipja (gjuha dhe shkrimi)».

Fotografia juaj e kohës së luftës, që patët mirësinë të ma dërgonit në shenjë kujtimi, më nxiti të rikujtoja me mall shokët partizanë grekë që pata rastin të takoja në ato kohë të vështira për popujt tanë, që luftuan heroikisht secili në truallin e vet kundër pushtuesve nazifashistë e bandave tradhtare vendëse për çlirimin e tyre. Dashuria e mirëkuptimi që tregonin me njëri-

-tjetrin në këto takime e biseda të përzemërta partizanët grekë dhe shqiptarë më kanë mbetur të paharruara. Lidhjet e lashta të krijuara me gjakun e derdhur bashkërisht gjatë shekujve kundër armiqve të përbashkët, e sidomos në Revolucionin Grek të vitit 1821, u forcuan më tej në këtë luftë të madhe.

Me kënaqësi vëmë re se kohët e fundit marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis Shqipërisë dhe Greqisë, në sajë të dëshirës së popujve e vullnetit të mirë të qeverive të të dy vendeve tona, po ecin drejt zgjerimit e forcimit të tyre. Kam bindjen se miqësia e marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë do të vijë duke u forcuar, sepse kjo është dëshira e popujve tanë dhe u shërben interesave të të dy vendeve tona dhe stabilitetit në zonën e Ballkanit.

Më lejoni me këtë rast t'ju përgëzoj për punën që keni ndërmarrë për gjuhën shqipe dhe lashtësinë e saj. Kjo është shprehje e interesit dhe e dashurisë që tregoni ju, personalisht, për vendin e për popullin tonë, që ndihmon në forcimin e mirëkuptimit e të miqësisë sonë.

Me rastin e Vitit të Ri 1985 ju shpreh urremet më të mira, shëndet dhe prosperitet!

Ju përshëndes

*Enver Hoxha*

«Dy popuj miq», f. 411

## LETËR DREJTUAR SHOKUT SAMI FERIZI

Kukës

28 janar 1985

I dashur shoku Sami,

Zëri i shqiptarit të vërtetë, kudo e sa herë që është fjala për mbrojtjen e të drejtave e të lirisë së kombit të vet, ka qenë kurdoherë i mbushur tërë flakë e barut. Mbi atdheun e lirinë ai kurrë s'ka vënë e nuk vë gjë tjetër. Këtë trashëgimi atdhetarie të zjarhtë shekullore shpreh edhe vjersha që ti ke shkruar me aq dashuri e patos për atdheun, për popullin, për Partinë e Punës, mëmën e të gjitha fitoreve të deritashme dhe atyre të ardhshme, për të më uruar Vitin e Ri 1985.

Zemrën shqiptari e ka të fortë, të pastër si kristali, si gurrat e rrëmbyera e të pashtershme

---

1. Sami Ferizi me rastin e Vitit të Ri 1985 i dërgoi shokut Enver Hoxha një rapsodi kushtuar Atij, të shkruar plot frymëzim e dashuri.

të maleve tona të patundshme, në Veri e në Jug të Shqipërisë, kurse mendjen të kthjellët e të matur, prandaj nuk e kanë thyer e dobësuar as rrebeshet e mizoritë e hordhive të huaja në lashtësi, në mesjetë e më vonë, as ato të kohëve moderne, as shtypja e regjimeve antipopullore, sidomos ato të shovinistëve të egër antishqiptarë. Rrebeshet e përleshjet me armiqtë në beteja të panumërta për liri e kanë çelikosur dhe kalitur atë. Sot, pas fitores së revolucionit popullor, shqiptarin Partia e ka bërë të pathyeshëm para asgjë e para asgjëje. Këtë e vërtetoi më së miri edhe qëndrimi i popullit të rretheve të Kukësit, Tropojës, Pukës e Dibrës, që përballoi e kapërceu me heroizëm vështirësitë e shumta dhe pasojat e rënda, që sollën reshjet e mëdha të dëborës në ditët e para të këtij viti.

Të falënderoj për urimet shumë të ngrohta që më dërgove ti, bir i Kosovës kreshnike e i popullit të saj trim e fisnik. Edhe unë të uroj nga zemra suksese në veprimtarinë tënde si arsimtar dhe aktivist në edukimin e brezit të ri me mësimet e Partisë, gëzime e lumturi në jetën familjare e shëndet të mirë.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# LETËR DREJTUAR MËSUESIT TË MERITUAR, ILIA GAZHGA BULARAT

Gjirokastër

6 mars 1985

I dashur Ilia,

Të uroj nga zemra 7 marsin, Ditën e Mësuesit.

Në këtë festë të shënuar, bashkë me të gjithë mësuesit e mbarë popullin tonë, gëzon edhe ti, mësues i palodhur, komunist i vendosur. Megjithëse u bënë shumë vjet që ke humbur dritën e syve, ti ke vazhduar me vullnet të çeliktë detyrën fisnike të mësuesit, pse dritë të japin mësimet e Partisë, që ti e do aq shumë.

Është kënaqësi për mua kur dëgjoj se shtëpia jote gumëzhin çdo ditë nga tingujt e mandolinës, që ti ua mëson me pasion fëmijëve. Ajo është kthyer në një shkollëz muzike, ku shumë

vogëlushë janë bërë të aftë të përdorin këtë vegël të bukur. Dhe kur ata rriten, kudo që punojnë, në Dropull, në Gjirokastrë ose në çdo skaj të Shqipërisë socialiste, krah për krah me vëllezërit shqiptarë, të kujtojnë me respekt të veçantë edhe ty, që bashkë me këngët melodioze të shoqëruara me mandolinë, u ke futur thellë në mendje e në zemër idetë e Partisë, për vëllazërimin e minoritetit grek me popullin shqiptar dhe për miqësinë në mes popujve.

Duke kujtuar takimet tona në Gjirokastrë, të uroj shëndet dhe gjithë të mirat. Shumë të fala në familje.

Përqafime

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Pararoja», nr. 20 (1866),  
9 mars 1985*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË ARTISTIT TË POPULLIT,  
SANDËR PROSI**

*Tiranë*

**25 mars 1985**

Bashkëshortes e djemve,

Më hidhëroi shumë vdekja e papritur e bashkëshortit e prindit tuaj të dashur, Artist i Popullit dhe një nga aktorët më të shquar të teatrit e të kinematografisë sonë, Sandër Prosit.

Sandri, si bir i thjeshtë i popullit, i edukuar me frymën e Partisë dhe me një botë të pasur shpirtërore ka interpretuar me aftësi, zgjuarsi e nivel të lartë artistik personazhe shumë të rëndësishme të autorëve tanë e të huaj dhe ka krijuar figura të mëdha historike kombëtare, duke lënë mbresa të pashlyeshme në edukimin patriotik e revolucionar të masave tona artdashëse. E kam njohur edhe personalisht dhe kam ndjekur,

sidomos në televizor, mjaft prej roleve që ai ka luajtur me pasion e talent të rrallë. Jeta dhe puna e tij, në teatër e në kinematografi, ku ai ka dhënë ndihmesën e tij të konsiderueshme, kanë qenë e do të mbeten shembull edukimi për artistët tanë të rinj.

Ju dërgoj në këto çaste të dhimbshme për ju ngushëllimet e mia më të përzemërta.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LËNDA

- |  |    |
|--|----|
| 1. Mesazh drejtuar pionierëve të Shqipërisë me rastin e 5-vjetorit të krijimit të organizatës së pionierit | 5  |
| <b>11 shkurt 1947</b>  |    |
| 2. Telegram dërguar ndërtuesve të hekurudhës Kashar—Zona industriale .....                                 | 11 |
| <b>4 shtator 1949</b>  |    |
| 3. Letër drejtuar ndërtuesve të kombinatit të Tekstil-it Yzberish .....                                    | 13 |
| <b>24 nëntor 1949</b>  |    |
| 4. Përshëndetje drejtuar kolektivit punonjës të fabrikës së sheqerit «8 Nëntori», Maliq .....              | 15 |
| <b>31 tetor 1951</b>   |    |
| 5. Letër drejtuar Shuaip Elezit, kultivues i dalluar i duhanit në Shtërmen .....                           | 16 |
| <b>22 shkurt 1954</b>  |    |
| 6. Letër drejtuar shokut Behar Shtylla .....   | 20 |
| <b>9 nëntor 1954</b>   |    |
| 7. Letër drejtuar kompozitorit Kristo Kono .....   | 21 |
| <b>20 nëntor 1954</b>  |    |
| 8. Letër drejtuar pionierëve të qytetit të Krujës .....  | 23 |
| <b>20 tetor 1956</b>   |    |

9. Letër drejtuar shokut Marsel Kashen .....	25
<b>(Tetor) 1956</b>	
10. Letër drejtuar përfaqësuesve të shoqërisë patriotike «Skënderbeu» në Argjentinë .....	28
<b>12 nëntor 1958</b>	
11. Letër drejtuar shokut Thoma Papapano .....	30
<b>3 dhjetor 1958</b>	
12. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo .....	31
<b>2 shtator 1959</b>	
13. Përshëndetje drejtuar nxënësve dhe pedagogëve të Shkollës së Partisë «V. I. Lenin» .....	33
<b>16 shtator 1959</b>	
14. Letër drejtuar qytetarit sovjetik A. Muromcjev .....	39
<b>21 tetor 1959</b>	
15. Letër drejtuar organizatës së BRPSH të repartit ushtarak «N» .....	42
<b>23 tetor 1959</b>	
16. Letër drejtuar të rejave në rrethe të ndryshme të vendit .....	49
<b>8 nëntor 1959</b>	
17. Letër drejtuar anëtarëve të kooperativës bujqësore «3 dëshmorët», Bodrishtë .....	57
<b>11 nëntor 1959</b>	
18. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Moskë .....	60
<b>1 tetor 1960</b>	
19. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë .....	65
<b>4 tetor 1960</b>	
20. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë .....	72
<b>7 tetor 1960</b>	

21. Letër drejtuar naftëtarëve dhe efektivit të repar-  
teve të aviacionit ..... 78  
**7 shkurt 1961**
22. Telegram dërguar komisionit për krenimin e 18-vje-  
torit të festës së Bregdetit ..... 80  
**10 qershor 1961**
23. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe  
Ramiz Alia ..... 82  
**1 qershor 1962**
24. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe  
Ramiz Alia ..... 85  
**2 qershor 1962**
25. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe  
Ramiz Alia ..... 88  
**2 qershor 1962**
26. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe  
Ramiz Alia ..... 91  
**15 qershor 1962**
27. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe  
Ramiz Alia ..... 94  
**19 qershor 1962**
28. Telegram dërguar ndërtuesve të hidrocentralit të  
Bisticës ..... 98  
**21 janar 1963**
29. Mesazh drejtuar organeve të Sigurimit të Shtetit  
me rastin e 20-vjetorit të krijimit të tyre ..... 100  
**19 mars 1963**
30. Përsëndetje drejtuar kolektivit të gazetës «Bash-  
kimi» ..... 105  
**25 mars 1963**

31. Letër përshëndetjeje dërguar Konferencës së Parë Kombëtare për përhapjen dhe leximin e librit .....	108
<b>3 qershor 1963</b>	
32. Letër drejtuar shokut Manush Myftiu në Vjenë .....	116
<b>31 dhjetor 1963</b>	
33. Letër drejtuar shokut Sadik Bleta, shoqëria «Skënderbeu», Argjentinë .....	117
<b>4 shkurt 1964</b>	
34. Letër drejtuar shokut Jakup Mahmut, Paris .....	119
<b>19 shkurt 1964</b>	
35. Letër drejtuar komsomolasve të shkollës «J. A. Gagarin», krahina e Krasnodarit .....	121
<b>10 mars 1964</b>	
36. Letër përshëndetjeje drejtuar Konferencës së 4-të Kombëtare të gazetarëve të Shqipërisë .....	124
<b>18 prill 1964</b>	
37. Përshëndetje drejtuar kolektivit të shtypshkronjës së pullave postare .....	132
<b>1 dhjetor 1964</b>	
38. Letër drejtuar shokut Behar Shtylla .....	133
<b>14 gusht 1965</b>	
39. Përshëndetje drejtuar Konferencës së 2-të Kombëtare të vëteranëve të luftës të popullit shqiptar .....	134
<b>29 shtator 1965</b>	
40. Letër drejtuar shokut Rita Marko .....	141
<b>10 nëntor 1965</b>	
41. Letër drejtuar mikes së Shqipërisë Bozhena Neumanova .....	150
<b>17 janar 1966</b>	

42. Letër drejtuar kooperativistëve të kooperativës bujqësore «31 korriku», Burrel .....	153
<b>21 shkurt 1967</b>	
43. Letër drejtuar kolektivit të gazetës «Puna» .....	155
<b>23 shkurt 1967</b>	
44. Letër drejtuar punëtorëve, inxhinierëve, teknikëve të ndërtimit, të montimit dhe shfrytëzimit të Fabrikës së Plehrave Azotike .....	157
<b>24 shkurt 1967</b>	
45. Letër drejtuar korrespondentëve vullnetarë të shtypit dhe të radios në kooperativën bujqësore të Fiersheganit .....	159
<b>28 shkurt 1967</b>	
46. Letër drejtuar popullit të Kurveleshit .....	161
<b>24 qershor 1967</b>	
47. Letër drejtuar të rejave lekbibase të rrethit të Tropojës pjesëtare të brigadës «Gjelosh Rama» në Hekurudhën Rrogozhinë—Fier .....	164
<b>26 korrik 1967</b>	
48. Letër drejtuar shokut Rakip Barolliu .....	169
<b>17 tetor 1967</b>	
49. Letër drejtuar kooperativistëve të Bugjonit .....	171
<b>16 nëntor 1967</b>	
50. Letër drejtuar familjes së Agron Elezit .....	174
<b>2 dhjetor 1967</b>	
51. Letër drejtuar nxënësve dhe mësuesve të shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka» .....	176
<b>7 dhjetor 1967</b>	
52. Letër drejtuar shokut Ramadan Deda .....	180
<b>8 dhjetor 1967</b>	
53. Letër drejtuar Xhevo dhe Idajet Koçit .....	183
<b>9 dhjetor 1967</b>	

54. Letër drejtuar efektivit të repartit «N» të Ministrisë së Punëve të Brendshme .....	185
<b>13 dhjetor 1967</b>	
55. Letër drejtuar familjes së Tosun Shahinasit .....	187
<b>21 dhjetor 1967</b>	
56. Letër drejtuar popullit të zonës së Gorës .....	191
<b>2 dhjetor 1968</b>	
57. Letër drejtuar të rinjve dhe të rejave të qytetit dhe të lokalitetit të Qendrës në rrethin e Dibrës .....	194
<b>12 dhjetor 1968</b>	
58. Letër drejtuar shoqes Gjela Lleshi .....	197
<b>23 dhjetor 1968</b>	
59. Letër drejtuar popullit të Libohovës .....	200
<b>28 dhjetor 1968</b>	
60. Letër drejtuar Mrikë e Llesh Syziut dhe Gjon Llesh Syziut .....	202
<b>29 janar 1969</b>	
61. Letër drejtuar Lulash dhe Pashkë Pjetërnikës .....	207
<b>7 maj 1969</b>	
62. Letër drejtuar nxënësve të shkollës «Hasan Koçi» .....	209
<b>9 maj 1969</b>	
63. Letër drejtuar shokut Reshat Shehu .....	211
<b>23 maj 1969</b>	
64. Letër drejtuar shoqes Drane Gjoka .....	213
<b>26 qershor 1969</b>	
65. Letër drejtuar shokut Haxhi Çemericë .....	216
<b>8 dhjetor 1969</b>	
66. Letër drejtuar shokut Abaz Hoxha .....	218
<b>25 dhjetor 1969</b>	

67. Letër drejtuar kolektivit punonjës të ndërmarrjes pyjore, Dibër .....	222
<b>26 dhjetor 1969</b>	
68. Përshëndetje drejtuar kolektivit punonjës të Agjen- cisë Telegrafike Shqiptare .....	225
<b>29 dhjetor 1969</b>	
69. Letër drejtuar kolektivit të studentëve dhe pe- dagogëve të fakultetit të inxhinierisë .....	229
<b>6 janar 1970</b>	
70. Letër drejtuar shoqes Lulë Beqiri .....	233
<b>24 janar 1970</b>	
71. Përshëndetje dërguar kolektivit të gazetës «Llaiko Vima» .....	236
<b>23 maj 1970</b>	
72. Letër drejtuar shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë .....	240
<b>22 tetor 1970</b>	
73. Letër drejtuar njëzet traktoristeve të para të SMT-së të Librazhdit .....	247
<b>2 dhjetor 1970</b>	
74. Letër drejtuar shokut Leonidha Kristaqi .....	250
<b>16 shkurt 1971</b>	
75. Letër drejtuar nxënësve dhe mësuesve të shko- llës së fshatit Mertur .....	254
<b>19 qershor 1971</b>	
76. Letër drejtuar Gjyle dhe Sadush Vrapit .....	257
<b>4 shtator 1971</b>	
77. Letër drejtuar shoqes Kostandina Buzo .....	258
<b>22 shkurt 1972</b>	

78. Letër drejtuar nxënëses Klementina Haska .....	261
.....	<b>6 mars 1972</b>
79. Telegram urimi dërguar Mustafa Xhanit dhe Vera Lleshit .....	262
.....	<b>16 prill 1972</b>
80. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Riza Kodheli .....	264
.....	<b>14 dhjetor 1972</b>
81. Përshëndetje drejtuar zotit Mustafa Kemal Pasha, Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Pakistan—Shqipëri .....	265
.....	<b>30 prill 1973</b>
82. Përshëndetje drejtuar Dr. Ibrahim El Tahavi, Kryetar i Shoqatës Egjipt—Shqipëri .....	267
.....	<b>17 mars 1973</b>
83. Letër drejtuar gjithë vullnetarëve që morën pjesë në ndërtimin e Hekurudhës Elbasan—Përrenjas .....	269
.....	<b>8 mars 1974</b>
84. Përshëndetje drejtuar kolektivit të fabrikës së cigareve «Telat Noga» .....	275
.....	<b>4 maj 1974</b>
85. Letër drejtuar vajzave volejbolliste të klubit sportiv «Dinamo» .....	279
.....	<b>14 maj 1974</b>
86. Letër drejtuar të rejave dhe të rinjve të kooperativës bujqësore «Enver Hoxha» të Bujanit .....	284
.....	<b>22 mars 1975</b>
87. Telegram dërguar shoqes Hyrie Hena .....	286
.....	<b>4 qershor 1975</b>
88. Letër drejtuar zonjës Jozefina Lambere .....	288
.....	<b>7 qershor 1975</b>

89. Letër drejtuar shoqes Llambrini Manastirliu	289
<b>20 qershor 1975</b>	
90. Letër drejtuar popullit të fshatit Mashkullorë	291
<b>13 mars 1976</b>	
91. Letër drejtuar gjithë vullnetarëve të rinisë që morën pjesë në ndërtimin e linjës hekurudhore të Kombinatit Metalurgjik	294
<b>20 gusht 1976</b>	
92. Letër drejtuar të rinjve dhe të rejave të rrethit të Beratit, iniciatorë të lëvizjes për të punuar e jetuar në fshat	298
<b>1 dhjetor 1976</b>	
93. Letër drejtuar nxënëseve Laureta dhe Alma Shehu	302
<b>31 dhjetor 1976</b>	
94. Letër drejtuar kolektivit të tipografëve, Gjirokastër	304
<b>16 shkurt 1977</b>	
95. Letër drejtuar kolektivit punonjës të tunelit Tatzat—Sasaj	306
<b>1 qershor 1977</b>	
96. Letër drejtuar shokut Pertef Badivuku	309
<b>30 dhjetor 1977</b>	
97. Letër drejtuar 10 të rinjve punëtorë të qytetit të Durrësit	312
<b>23 janar 1978</b>	
98. Letër drejtuar veteranëve dhe pensionistëve të Minierës së Bitumit në Selenicë	314
<b>13 maj 1978</b>	
99. Letër drejtuar shoqeve pjesëmarrëse në aktivin e mjelëseve të dalluara të rrethit të Krujës	317
<b>6 qershor 1978</b>	

100. Letër drejtuar shokut Hazmi Hashorva	320
<b>29 qershor 1978</b>	
101. Falënderim për urimet e dërguara me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes	322
<b>20 tetor 1978</b>	
102. Telegram dërguar Komitetit Qendror të Partisë Ko- muniste të Brazilit	326
<b>27 tetor 1978</b>	
103. Letër drejtuar qytetarit anglez Ajs Pulson	328
<b>27 tetor 1978</b>	
104. Letër drejtuar kooperativistëve të Kooperativës buj- qësore të tipit të lartë të Perondisë	330
<b>17 nëntor 1978</b>	
105. Letër drejtuar shoqes Suzanë Marti	335
<b>21 nëntor 1978</b>	
106. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Paris	337
<b>4 dhjetor 1978</b>	
107. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Paris	339
<b>16 dhjetor 1978</b>	
108. Letër drejtuar Llambrini Silës dhe Jorgji Dhamos	341
<b>22 mars 1979</b>	
109. Radiogram dërguar shokut Hysni Kapo në Paris	343
<b>11 shtator 1979</b>	
110. Radiogram dërguar shoqes Vito Kapo në Paris	346
<b>21 shtator 1979</b>	
111. Letër drejtuar shokut Nils Anderson	348
<b>21 dhjetor 1979</b>	
112. Letër drejtuar shokut Talat Shehu	351
<b>25 dhjetor 1979</b>	

113. Letër drejtuar shokut Gegë Marubi .....	353
.....	<b>25 janar 1980</b>
114. Letër drejtuar shokut Shyqyri Kanapari .....	355
.....	<b>22 maj 1980</b>
115. Telegram dërguar familjes së shokut Kolë Paparisto .....	358
.....	<b>28 gusht 1980</b>
116. Telegram dërguar shokut Emin Selenica .....	360
.....	<b>10 tetor 1980</b>
117. Letër drejtuar zotit Llambro Mallama .....	361
.....	<b>30 dhjetor 1980</b>
118. Letër drejtuar shokut Jashar Menzelxhiu .....	363
.....	<b>10 janar 1981</b>
119. Letër drejtuar shoqes Nedret Hoxha .....	367
.....	<b>3 shkurt 1981</b>
120. Letër drejtuar shokut Kujtim Buza, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë .....	369
.....	<b>29 prill 1981</b>
121. Letër drejtuar zotit Kostis Papakongos .....	371
.....	<b>8 maj 1981</b>
122. Letër drejtuar shokut Guri Madhi .....	373
.....	<b>29 qershor 1981</b>
123. Letër drejtuar kryetarit të Bashkisë së Golxhykut .....	375
.....	<b>8 shtator 1981</b>
124. Letër drejtuar shoqes Sejade Balla .....	377
.....	<b>9 tetor 1981</b>
125. Letër drejtuar Institutit të Lartë Bujqësor .....	379
.....	<b>10 tetor 1981</b>

126. Përshëndetje drejtuar kolektivit punonjës të kombinatit të tekstileve «Stalin» .....	383
<b>9 nëntor 1981</b>	
127. Përshëndetje drejtuar Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë .....	387
<b>23 nëntor 1981</b>	
128. Letër drejtuar shokut Veliko Tafil Derraj .....	393
<b>30 dhjetor 1981</b>	
129. Letër drejtuar kooperativës së tipit të lartë të Dajçit .....	395
<b>27 janar 1982</b>	
130. Përshëndetje drejtuar pionierëve dhe pioniereve të Shqipërisë .....	400
<b>10 shkurt 1982</b>	
131. Letër drejtuar Drejtorisë së Muzeve, Gjirokastrë .....	403
<b>10 shkurt 1982</b>	
132. Letër drejtuar shoqes Marie Biba .....	405
<b>14 gusht 1982</b>	
133. Letër drejtuar kooperativës bujqësore të tipit të lartë të Sofratikës .....	407
<b>27 janar 1983</b>	
134. Letër drejtuar shokut Aleks Çaçi .....	412
<b>18 mars 1983</b>	
135. Letër drejtuar shokut Nikolla Berovski .....	414
<b>25 mars 1983</b>	
136. Letër drejtuar kooperativistëve dhe punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore .....	416
<b>16 korrik 1983</b>	
137. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e kuadrove të Brigadës së Parë Sulmuese e pjesëmarrësve nga krahina e Vithkuqit dhe e rrethit të Korçës .....	420
<b>12 gusht 1983</b>	

138. Letër drejtuar kolektivit punonjës të Radiotelevizionit Shqiptar ..... 424  
**21 tetor 1983**
139. Telegram dërguar shoqes Elima Libohova (Selfo) ..... 428  
**5 nëntor 1983**
140. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e partizaneve, kuadrove të ish-Brigadës V Sulmuese ..... 430  
**19 janar 1984**
141. Përshëndetje drejtuar ish-partizanëve e partizaneve, kuadrove të ish-Brigadës VI Sulmuese ..... 434  
**25 janar 1984**
142. Përshëndetje drejtuar efektivit të Gardës së Republikës ..... 438  
**12 shkurt 1984**
143. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Vasil Nathanaili ..... 441  
**13 prill 1984**
144. Përshëndetje drejtuar pjesëmarrësve në festimin e 40-vjetorit të Kongresit të Përmetit ..... 443  
**23 maj 1984**
145. Përshëndetje drejtuar ish-delegatëve të Kongresit të Parë të BRASH-it ..... 447  
**7 gusht 1984**
146. Përshëndetje drejtuar me rastin e 40-vjetorit të Mbledhjes së Dytë të KANÇ-it ..... 451  
**21 tetor 1984**
147. Përshëndetje drejtuar ish-delegateve të Kongresit I të Bashkimit të Grave Antifashiste të Shqipërisë ..... 456  
**3 nëntor 1984**
148. Përshëndetje drejtuar efektivit të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve «Enver Hoxha» ..... 460  
**6 nëntor 1984**

149.	Telegram ngushëllimi dërguar familjes së File Musait	461
	<b>15 dhjetor 1984</b>	
150.	Letër drejtuar një ish-partizani grek, zotit Dh. Kremos	466
	<b>29 dhjetor 1984</b>	
151.	Letër drejtuar shokut Sami Ferizi	468
	<b>28 janar 1985</b>	
152.	Letër drejtuar mësuesit të merituar Ilia Gazhga	470
	<b>6 mars 1985</b>	
153.	Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Artistit të Popullit, Sandër Prosi	472
	<b>25 mars 1985</b>	

489